


VROJTIM KOMBËTAR ME BAZË POPULLATËN 2018

Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri





UNITED NATIONS
ALBANIA



Empowered lives.
Resilient nations.



VROJTIM KOMBËTAR ME BAZË POPULLATËN 2018

Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri

Ky vërtetim u krye nga INSTAT me ekspertizën teknike të Dr. Robin, konsulente ndërkombëtare, edhe shkrimi i tij u kryesua nga Robin Haarr, me mbështetjen e UNDP-së dhe UN Women dhe me ndihmën financiare të Qeverisë së Australisë, në kuadër të projektit rajonal për statistikat gjinore dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm “Të bëjmë që çdo grua dhe vajzë të ketë rëndësi” dhe të Qeverisë Suedeze në kuadër të Programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara T’i japim fund Dhunës ndaj Grave në Shqipëri. Opinione dhe mendimet e shprehura në këtë raport nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e UNDP-së, UN Women dhe donatorëve të tyre.

Mars 2019

PASQYRA E LËNDËS

Falënderime	6
Përkufizime	8
Shkurtime	11
PËRMBLEDHJE E SHKURTËR	12
KAPITULLI 1: HYRJJE	24
Historiku i këtij studimi	26
Vrojtimet kombëtare me bazë popullatën në Shqipëri	27
Ndryshimet në legjislacion dhe në politika dhe zhvillimi i programit që prej VKDhF-së të vitit 2013	29
-Ndryshimi i legjislacionit dhe i politikave që nga VKDhF e vitit 2013	30
-Forcimi i të dhënave administrative për DhNGV-në që prej VKDhF-së të vitit 2013	33
-Përmirësimet në ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat e DhNGV-së që prej VKDhF-së të vitit 2013	38
-Aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e DhNGV-së që prej VKDhF-së të vitit 2013	40
Përse të kryhet Vrojtimi i Tretë Kombëtar për DhNGV-në në Shqipëri	40
KAPITULLI 2: NDËRTIMI I STUDIMIT	42
Matja e shtrirjes së DhNGV-së	44
Zhvillimi i vërtimit kombëtar për DhNGV-në në Shqipëri i vitit 2018	45
-Marrja e informacionit maksimal	46
-Ndërtimi i kampionit	47
-Mbledhësit e të dhënave	48
-Administrimi i vërtimit në terren	48
-Konsiderata etike	48
-Ponderimi i kampionit	49
-Përpunimi, analizimi dhe raportimi i të dhënave	50
KAPITULLI 3: KARAKTERISTIKA TË GRAVE TË INTERVISTUARA	52
Karakteristikat e grave që përmbushin kushtet për intervistim	53
Demografia e grave të intervistuar	54
-Shtazënia dhe fëmijët	56
-Përdorimi i metodave për shmangien e shtatzënisë	57
-Infeksionet seksualisht të transmetueshme	59
KAPITULLI 4: NJË VËSHTRIM RRETH DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE	60
Përjetime të dhunës ndaj grave dhe vajzave	61
Marrëdhënia ndërmjet dhunës nga jopartneri dhe dhunës në familje	62
Përjetime të abuzimit seksual në fëmijëri	63
KAPITULLI 5: NORMAT SOCIALE LIDHUR ME DHUNËN NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE	64
Fuqia e normave sociale	65
Dallimi midis normave sociale, qëndrimeve dhe sjelljeve	67
Normat sociale të lidhura me dhunën në familje nga partneri intim	68
Normat sociale të lidhura me dhunën seksuale ndaj grave dhe vajzave	69
Ashpërsia e perceptuar e DhNGV-së	69
Rëndësia e ligjeve për DhNGV-në	70

KAPITULLI 6: DHUNA NË FAMILJE NGA PARTNERI INTIM	72
Kampioni i grave që kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim	74
Përjetime të dhunës në familje nga partneri intim	74
Sjellje kontrolluese shtrënguese	76
Dhuna ekonomike	79
Dhuna psikologjike	80
Dhuna fizike	83
Dhuna seksuale	85
Kur fillon dhuna në familje nga partneri intim	87
Dhuna fizike gjatë shtatzënisë	88
Lëndime të shkaktuara nga dhuna në familje	89
Ndërprerja e punës për shkak të dhunës në familje	92
Dhuna seksuale, përdorimi i mjeteve të kontrollit të lindjeve dhe rreziku i IST-ve	94
Alkooli dhe dhuna në familje	96
Ekspozimi i fëmijëve ndaj dhunës në familje	99
Sjellje që kërkojnë ndihmë	102
Shkurorëzimi dhe ndarja për shkak të dhunës në familje	105
Autorët e dhunës në familje	105
Të ardhurat e familjes dhe dhuna në familje	106
 KAPITULLI 7: DHUNA E USHTRUAR NGA JOPARTNERI	 108
Përjetimet e dhunës nga jopartneri që prej moshës 15 vjeçare	109
Përjetimet e abuzimit seksual në fëmijëri	111
Autorët e dhunës fizike nga jopartneri	112
Autorët e dhunës seksuale nga jopartneri	112
Sjellje që kërkojnë ndihmë për dhunën e ushtruar nga jopartneri	112
 KAPITULLI 8: NGACMIMISEKSUAL	 114
Përjetimet e ngacmimeve seksuale	116
Marrëdhënia ndërmjet moshës dhe ngacmimeve seksuale	117
Vendet ku ndodhin ngacmimet seksuale	118
Autorët e ngacmimeve seksuale	120
 KAPITULLI 9: PËRNDJEKJA	 122
Përjetimet e përndjekjes	125
Marrëdhënia ndërmjet moshës dhe përndjekjes	125
Autorët e përndjekjes	126
 KAPITULLI 10: PËRFUNDIME	 128
Përqindja e përhapjes së kampionit në popullata të ndryshme	130
 SHTOJCA A: Shembuj të masave, treguesve dhe pyetjeve që lidhen me normat sociale	 133
SHTOJCA B: Tabela me të dhëna të paponduara për treguesit kryesorë	134
REFERENCA	140
SHËNIME NË FUND	144

FALËNDERIME

Ky raport kërkimor mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri është fryt i bashkëpunimit të ngushtë midis Institutit të Statistikave të Shqipërisë (INSTAT), Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Entitetit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) me mbështetjen financiare të UN Women, të qeverisë së Australisë dhe qeverisë së Suedisë. Ky projekt e ka bazën tek pranimi i premisë së të dhënave kombëtare për dhunën ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri janë të domosdoshme për zhvillimin e politikave dhe të planeve të veprimit për reagim, ndërhyrje, dhe mbrojtje në rastet e dhunës në familje, dhe formave të tjera të dhunës të pësuar nga gratë dhe vajzat, përfshirë dhunën nga i dashuri, dhunën nga jopartneri, ngacmimin seksual dhe përndjekjen.

Dëshirojmë t'u shprehim falënderimet dhe mirënjohjen tonë të veçantë drejtuesve, personelit dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm të INSTAT-it, si institucioni kryesor teknik që hartoi dhe zbatoi këtë Vrojtje të Tretë Kombëtar mbi Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri, mbështetur në përvojat e Vrojtjeve të Parë dhe të Dytë Kombëtar mbi Dhunën në Familje ndaj Grave të kryera në vitet 2007 dhe 2013. Dr. Delina Ibrahimaj, në pozicionin e saj si Drejtore e Përgjithshme e INSTAT-it, bëri në vijimësi drejtimin administrativ dhe teknik të këtij projekti. Dëshiroj të falënderoj stafin e INSTAT për punën profesionale të kryer.

Dëshirojmë t'i shprehim mirënjohjen dhe të falënderojmë UNDP-në në Shqipëri për mbështetjen e këtij projekti kërkimor përfshirë znj. Entela Lako, Dr. Edlira Papavangjeli dhe znj. Elona Dini për këshillat dhe udhëzimet profesionale që ofruan. Po kështu dëshirojmë të falënderojmë konsulentin ndërkombëtar të UNDP-së, Dr. Robin Haarr, që i dha INSTAT-it këshilla për rishikimin e pyetësorit dhe për shkrimin e raportit në bashkëpunim të ngushtë me personelin e INSTAT.

Dëshirojmë të falënderojmë ekspertët teknikë, përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, sidomos të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe përfaqësuesit e UN Women Shqipëri dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, anëtarët e botës akademike dhe ekspertët e tjerë të statistikave dhe të dhunës me bazë gjinore për mendimet, komentet dhe rekomandimet e tyre të vëra mbi të dhënat paraprake të Vrojtimit dhe për draft raportin. Së fundi, dëshirojmë t'u shprehim mirënjohjen dhe falënderimet tona grave që morën pjesë në këtë studim dhe dhuruan kohën e tyre për t'iu përgjigjur pyetjeve tona dhe për të ndarë me ne përvojat e tyre vetjake. I kërkojmë ndjesë çdo kujt që, padashje, mund të ketë mbetur pa u përmendur.

Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave i vitit 2018 u ndërmor me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e agjencive dhe ekspertëve të mëposhtëm:

FALENDERIM SPECIAL

Drejtores e botimit

Znj. Delina Ibrahimaj, Ph.D
Drejtores e Përgjithshme e INSTAT

Ekipi i ekspertëve të INSTAT

Znj. Blerina Metanj (Subashi)
Përgjegjëse e sektorit të Zhvillimit të
Statistikave Sociale

Znj. Isida Gorce

Specialiste e Statistikave Gjimore, Sektori i
Zhvillimit të Statistikave Sociale

Z. Rudin Hoxha

Specialiste e Projektioneve të Popullsisë, Sektori
i Statistikave të Popullsisë

Znj. Albana Berbiu

Specialiste e Statistikave të Krimeve, Sektori i
Zhvillimit të Statistikave Sociale

UNDP Shqipëri

Znj. Entela Lako

Dr. Edlira Papavangjeli

Menaxhere e Programit për Barazi Gjimore

Znj. Elona Dini

Eksperte e Barazisë Gjimore

Dr. Robin Haarr

Konsulente ndërkombëtare e UNDP

UN Women

Znj. Estela Bulku

Drejtuese e Programit, Shqipëri

Znj. Agustela Nini Pavli

Analiste teknike, Shqipëri

Znj. Ala Negruta

Specialiste rajonale për statistikat gjimore, ECA

Znj. Juncal Plazaola Castano

Specialiste e politikës, Dhuna ndaj Grave,

Zyra Qëndrore

Bashkë renduese e vrojtimit

Ms. Emira Galanxhi

PËRKUFIZIME

Sjellje shtrënguese kontrolluese

“Një rrugë strategjike e sjelljes shtypëse për të siguruar dhe shtrirë privilegjin në bazë të gjinisë përmes privimit të grave nga të drejtat dhe liritë e tyre dhe vendosjes së një regjimi dominimi në jetën personale”.¹

Dhunë në lidhje dashurie

“Modele të sjelljeve abuzive, përfshirë abuzimin emocional, fizik, seksual dhe financiar të përdorura për të ushtruar pushtet dhe kontroll tek partneri në lidhjen dashurore”.²

Në mënyrë të ngjashme, Instituti European për Barazinë Gjimore e përkufizon dhunën në lidhjen dashurore si “lloji i dhunës nga ana e partnerit intim që ndodh midis dy personave në një marrëdhënie të ngushtë”.³

Dhunë në familje

“Çdo akt i dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake ose midis bashkëshortëve ose partnerëve ose midis ish-bashkëshortëve ose ish-partnerëve, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën”.⁴

Ligji shqiptar “Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” e përkufizon dhunën si “çdo akt dhune i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, që ndodh brenda familjes

ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7 të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën” (ndryshuar në vitin 2018).

Neni 130/a i Kodit Penal të Shqipërisë e përkufizon dhunën në familje si “rrahja, si edhe çdo vepër tjetër dhune ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij”. Po ashtu, neni 130/a pranon si dhunë në familje “kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues ose ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit psikik të tij”.

Dhunë ekonomike

“Veprime të kontrollit dhe monitorimit të sjelljes së një individi në terma të përdorimit dhe shpërndarjes së parave, dhe kërcënimi konstant për ndërprerjen e burimeve ekonomike”.⁵

Dhunë me bazë gjinore “Dhuna që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se është grua ose që ndikon tek gratë në mënyrë disproporcionale”.⁶⁷Ajo përbën një shkelje të së drejtës themelore për jetesë, liri, siguri, dinjitet, barazi ndërmjet grave dhe burrave, mosdikriminim dhe integritet fizik dhe mendor.⁸

Dhunë nga partneri intim “Çdosjelljenënjëmarrëdhënieintime që shkakton lëndim fizik, psikologjik ose seksual tëpersonave në një marrëdhënie, përfshirëveprime të agresionit fizik, detyrimit seksual, abuzimit psikologjik dhe sjelljes së kontrolluar”.⁹

Dhunë fizike “Çdo akt që shkakton lëndim fizik si rezultat i përdorimit të paligjshëm të forcës fizike. Dhuna fizike mund të marrë formën e, ndërmjet të tjerave, të sulmit të rëndë dhe të vogël, heqje e lirisë dhe të sulmit me armë”.¹⁰

Dhunë psikologjike “Çdo akt që shkakton dëm psikologjik tek një individ. Dhuna psikologjike mund të marrë formën e,përshembull,shtrëngimit,shpifjes, fyerjes me fjalë ose ngacmimit”.¹¹

Ngacmim seksual “Çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, jo-verbale ose fizike e një natyre seksuale me qëllim ose pasojë shkeljen e dinjitetit të një personi, në veçanti kur krijohet një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes, i nënshtrohet ndëshkimit penal ose ndëshkimeve të tjera ligjore”.¹²

“Politika e Modelit të sistemit të Kombeve të Bashkuara për ngacmimin seksual e përcakton ngacmimin seksual në vendin e punës si “çdo sjellje e padëshiruar me natyrë seksuale që ka arsye të pritet të shkaktojë ose perceptohet të shkaktojë ofendim ose poshtërim, kur një sjellje e tillë ndërhyr tek puna, bëhet kusht për punësim ose krijon një mjedis pune frikësues, armiqësor ose ofendues. Ngacmimi seksual mund të ndodhë në vendin e punës ose në lidhje me punën. Duke përfshirë zakonisht një model sjellje, ngacmimi seksual mund të marrë formën e një incidenti të vetëm. Në vlerësimin e arsyeve të pritshmërive ose percetimeve, duhet të merret në konsideratë këndvështrimi i personit që është objektivi i sjelljes”.

Dhunë seksuale “Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente të padëshiruara seksuale ose ndonjë akt tjetër drejtur kundër seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngimin, nga çdo person pavarësisht marrëdhënies së tyre me viktimën, në çdo ambient, përfshirë, por jo kufizuar vetëm në shtëpi dhe punë”.¹³

Norma sociale “Bindjet që kanë njerëzit për atë që është tipike dhe e përshtatshme në një grup referimi. Normat sociale janë besime të përbashkëta për të tjerët. Kjo përfshin a) besime se çfarë “bëjnë në fakt” të tjerët në një grup (cila është sjellja tipike) dhe b) çfarë mendojnë të tjerët në një grup që “duhet të bëjnë” të tjerët (cila është sjellja e përshtatshme). Këto besime formojnë “pritshmëritë sociale” brenda një grupi njerëzish. Norma sociale mundet ose jo të bazohet në besime të sakta rreth qëndrimeve dhe sjelljeve të të tjerëve”.¹⁴

Përndjekje “Përsëritja e akteve që ndërhyjnë në jetën e një personi që me kalimin e kohës shtohen. Ka shumë mënyra në të cilën mund të kryhet një ndërhyrje e tillë. Një prej tyre që quhet përndjekje kibernetike është ndërhyrje e vazhdueshme dhe kërcënuese në internet. Përndjekja shkakton shqetësim, ankth ose frikë. Ajo është një formë dhune në vetvete, por mund të çojë edhe në forma të tjera të dhunës, përfshirë vrasje”.¹⁵

Instituti Europian për Barazinë Gjinore e përkufizon përndjekjen e grave si “një formë dhune ndaj grave që përsëritet vazhdimisht me sjellje kërcënuese kundër një gruaje, duke i shkaktuar asaj frikë për sigurinë e saj”.¹⁶

Neni 121/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë e përkufizon përndjekjen si “kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllim përt’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frikë për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi me të cilët ka lidhje shpirtërore, apo për t’i detyruar ata të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës”.

Dhunë “Përdorimi me qëllim i forcës ose fuqisë fizike, në formë kanosje ose aktuale, kundër vetes, një personi tjetër ose kundër një grupi ose komuniteti, që sjell ose ka gjasa të sjellë dëmtim, vdekje, lëndim psikologjik, keqzhvillim ose heqje të lirisë”.¹⁷

Ligji shqiptar “Për Masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare “e përkufizon dhunën” çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cënim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik” (ndryshuar në vitin 2018)”.¹⁸

Dhunë ndaj grave “Deklarata e Kombeve të Bashkuara “Për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave” e përkufizon dhunën ndaj grave si “çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell ose ka gjasa të sjellë lëndime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike të grave, përfshirë edhe kanosjet për akte të tilla, shtrëngime apo heqjen arbitrare të lirisë, qoftë kur ndodhin në jetën publike, ashtu edhe në jetën private”.

“Konventa e Këshillit të Europës “Për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje” e përcakton dhunën ndaj grave si “shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që çojnë ose mund të çojnë në lëndime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike ose ekonomike të grave, përfshirë edhe kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë kur ndodhin në jetën publike, ashtu edhe në jetën private”.

SHKURTIME

MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
MPJT	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë, Australi
EA	Zonë numërimi
EU	Bashkimi European
DhFDhNG	Dhënia fund e dhunës ndaj grave
DhFDhNGV	Dhënia fund e dhunës ndaj grave dhe vajzave
ADTh	Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore
QSh	Qeveria e Shqipërisë
GREVIO	Grupi i ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje
IGG	Instituti Global i Grave
INSTAT	Instituti Kombëtar i Statistikave, Shqipëri
MODHI	Moduli i Informacionit
MODHL	Moduli i Strukturës Familjare
MODMA	Moduli i martesës
MODDV	Moduli i Dhunës në Familje ndaj Grave
MODDA	Moduli i Dhunës në Marrëdhënie Dashurie
MODNP	Moduli Dhunës nga jopartneri
MODSH	Moduli i Ngacmimit Seksual
MODST	Moduli i Përndjekjes
MODSNA	Moduli i Normave dhe i Qëndrimeve Sociale
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
VKDhNG	Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
VKDhF	Vrojtimi Kombëtar për Dhunën në Familje
VKDhNGV	Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave
IST	Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UN Women	Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
DhNG	Dhuna ndaj Grave
DhNGV	Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

HYRJJE

Dhuna ndaj grave dhe vajzave (DhNGV) është një shkelje e përhapur e të drejtave të njeriut dhe një problem global i shëndetit publik me përmasa epidemike. DhNGV-ja shfaqet në forma të ndryshme të dhunës fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike dhe ndodh në hapësira publike dhe private. DhNGV-ja shkatërron shëndetin mendor dhe fizik dhe mirëqenien e grave dhe vajzave dhe mund të ketë një efekt negativ në sigurinë, stabilitetin, dhe paqen e tyre afatgjatë. DhNGV-ja gjithashtu ka pasoja afatgjata në zhvillimin dhe avancimin e grave dhe në kontributin e tyre në ekonomi dhe në zhvillimin kombëtar.

DhNGV-ja nuk është një fenomen i ri në Shqipëri. Ajo ka rrënjë të thella në traditat dhe zakonet patriarkale të cilat i kanë dhënë formën Shqipërisë prej kohësh, përfshirë identitetet dhe rolet e ngurta gjinore, dhunuesit patriarkalë, respektimin e sistemit të nderit dhe turpit, zakonet e urdhrave hierarkike brenda familjes dhe kontrollin midis brezave në familje.

Me ndihmën teknike dhe mbështetjen e UNDP-së dhe UNICEF-it, Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) kreu në 2007 Vrojtimin e parë Kombëtar mbi Dhunën në Familje (VKDhF), dhe me mbështetjen dhe ndihmën teknike të UNPD-së, INSTAT-i kreu VKDhF-në e vitit 2013. Vrojtimi Kombëtar i vitit 2018 mbi DhNGV-në përdori një metodologji dhe instrumente të ngjashme për mbledhjen e të dhënave si në rastin e VKDhF-në së vitit 2013, për të mbledhur të dhëna të besueshme mbi natyrën dhe përhapjen e dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim, por u zgjerua për të mbledhur të dhëna mbi dhunën gjatë marrëdhënies dashurore, dhunën e ushtruar nga jopartneri, ngacmimet seksuale, përndjekjen, dhe sjelljen që kërkon ndihmë të të mbijetuarave të DhNGV-së.

Është e rëndësishme të monitorohet përhapja e

DhNGV-së në Shqipëri. Me kalimin e kohës, të dhënat mbi DhNGV-në i ndihmojnë ata që janë përgjegjës për vendimmarrjen dhe për hartimin e politikave të kuptojnë modelet dhe tendencat në kohë dhe ndikimin e iniciativave për dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe vajzave (DhFDhNGV).


NDËRTIMI I STUDIMIT

Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave (VKDhNGV) në Shqipëri për 2018 u bë për të matur natyrën dhe shkallën e pesë llojeve të ndryshme të DhNG-së (dhuna në familje ushtruar nga partneri intim, dhuna gjatë marrëdhënies dashurore, dhuna nga jopartneri, ngacmimi seksual dhe, përndjekja) dhe disa norma shoqërore të lidhura me DhNGV-në. Studimi përfshiu një vrojtim kombëtar të familjeve me bazë popullatën të kryer në secilën nga 12 prefekturat e Shqipërisë. U përdor modeli i kampionit me shtresëzim për përzgjedhjen e grave të kampioneve. Qëllimi ishte të nxirrej një kampion grash të moshës 18-74 vjeç, i cili do të bënte të mundur nxjerrjen e vlerësimeve të besueshme kombëtare statistikore për përhapjen e DhNGV-së.

Kampioni i grave

Kampioni përfundimtar i grave përfshiu 3.443 familje dhe gratë moshës 18-74 vjeç. Kampioni nuk ishte i barabartë në të gjitha prefekturat, duke qenë se kampioni i marrë në Tiranë përfshinte një numër më të madh grash (27,1%), për faktin se Tirana është kryeqyteti dhe ka një popullsi shumë më të madhe, në Fier (11,5%) dhe në Elbasan (10,6%), krahasuar me Kukësin (3,0%) dhe Gjirokastrën (2,6%), ku kampioni përfshinte një numër shumë më të vogël grash. Shpërndarja e grave që u mor për kampion ishte disi e barabartë në secilën grupmoshë. Gratë ishin të moshës 18 deri në 74 vjeç, me moshë mesatare 43,6 vjeç. Për sa i takon arsimin, 42,4% e grave kishin arsim të mesëm të ulët,

Grafiku 1. Përvoja të dhunës ndaj grave dhe vajzave



Vini re: Po t'i mbledhësh përqindjet shuma nuk del 100%, sepse të anketuarat mund të kenë përjetuar më shumë se një lloj dhune

27,8% kishin arsim të mesëm të lartë dhe 19,7% arsim universitar; vetëm 7,7% e grave kishin vetëm arsimin fillor apo më pak.


Shumica e grave të marra në kampion ishin aktualisht të martuara dhe/ose jetonin me një partner mashkull; në veçanti, 73,3% e tyre ishin aktualisht të martuara dhe jetonin bashkë me një mashkull; 20,3% nuk ishin aktualisht të martuara apo nuk jetonin me një partner mashkull. Vetëm 4,1% ishin të veja, 1,2% ishin të shkurorëzuara dhe 0,2% ishin të ndara apo nuk jetonin më me bashkëshortin/të dashurin aktual mashkull. Moshë kur shumica e grave ishin martuar fillimisht apo kishin filluar të jetonin bashkë me një burrë ishte 18-24 vjeç.

Në kampionin e grave, 80,9% e tyre kishin qenë ndonjëherë shtatzëna dhe 79,8% kishin lindur ndonjëherë në jetën e tyre; vetëm 0,9% ishin shtatzëna në kohën e vërtetimit. Përveç kësaj, 37,4% e grave kishin një fëmijë (fëmijë) të moshës 17 vjeç, apo një fëmijë më të vogël që jetonte me to.

NJË VËSHTRIM RRETH DHUNËS

Tabela 1 tregon përqindjen e grave të moshës 18-74 vjeç, që kanë pësuar (ndonjëherë) dhunë gjatë jetës së tyre, dhe gjatë 12 muajve përpara vërtetimit (aktualisht). Në përgjithësi, 1 në 2 apo 52,9% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës gjatë jetës së tyre (dhunë nga partneri intim, dhunë gjatë marrëdhënies dashurore, dhunë nga jopartneri, ngacmim seksual dhe/ose përdjekje) gjatë jetës së tyre. Në lidhje me dhunën e ushtruar nga partneri intim, 47,0% e grave (ato që ishin apo kishin qenë të martuara dhe/ose jetonin me një partner) kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje nga partneri intim, dhe 65,8% e grave (ato që nuk ishin martuar ndonjëherë dhe që nuk kishin jetuar ndonjëherë me një partner mashkull, por që ishin përfshirë në një marrëdhënie me një mashkull, por pa jetuar së bashku) kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë gjatë marrëdhënies dashurore. Ndër të gjitha gratë e moshës 18-74 vjeç, 18,2% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë nga jopartneri, 18,1%

Grafiku 2. Marrëdhënia midis abuzimit seksual në fëmijëri dhe dhunës seksuale në moshë të rritur



Vini re: Po t'i mbledhësh përqindjet shuma nuk del 100%, sepse të anketuarat mund të kenë përjetuar më shumë se një lloj dhune

kanë përjetuar “ndonjëherë” ngacmim seksual dhe, 12,6% kishin përjetuar “ndonjëherë” përndjekje.

Në lidhje me përjetimet aktuale të dhunës, Tabela 1 tregon se 1 në 3 gra, ose 36,6% e grave përjetonin “aktualisht” dhunë. Në veçanti 1 në 3, ose 36,7% e grave (ato që ishin ose kishin qenë të martuara dhe/ose që jetonin me një partner mashkull) përjetonin “aktualisht” dhunë në familje nga partneri intim, 61,8% e grave (ato që nuk ishin martuar kurrë dhe nuk kishin jetuar kurrë me një partner mashkull, por që kishin qenë në një marrëdhënie me një mashkull, por pa u martuar) përjetonin “aktualisht” dhunë gjatë marrëdhënies dashurore. Nga të gjitha gratë e moshës 18-74 vjeç, 3,4% kanë përjetuar “aktualisht” dhunë nga jopartneri, 8,5% kanë përjetuar ngacmime seksuale dhe 6,9% kanë përjetuar përndjekje.

Analiza tregoi se 3 në 4 ose 75,8% e grave që kishin përjetuar dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeç, kishin përjetuar gjithashtu dhunë në familje nga partneri

intim; gratë që kishin përjetuar dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeç, kishin dy herë më tepër gjasa të përjetonin dhunë në familje nga partneri intim (75,8%), krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeç (32,1%).

Gjithashtu, vërtetimi konstatoi se 3,1% e grave të moshës 18-74 vjeç ishin abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë (i kishin prekur seksualisht kur nuk kishin dashur apo i kishin bërë të kryenin diçka që nuk kishin dashur ta bënin). Diagrami 2 tregon se gratë që kishin përjetuar abuzim seksual si fëmijë kishin më tepër gjasa të përjetonin dhunë seksuale dhe/ose dhunë gjinore gjatë jetës (88,8%), krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar dhunë seksuale si fëmijë (51,5%). Gjithashtu, gratë që kishin përjetuar abuzime seksuale si fëmijë, kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje nga partneri intim (64,6%) dhe dy herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë nga jopartneri (41,9%), krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar dhunë seksuale si fëmijë (përkatesisht 39,2% dhe 17,7%).

NORMAT SHOQËRORE TË LIDHURA ME DHNCV-në

Është me rëndësi të kuptojmë fuqinë e normave shoqërore, të cilat prekin të gjitha qoshet e jetës publike dhe private të njerëzve çdo ditë. Individët mund t'i respektojnë normat shoqërore në sjelljet e tyre të jashtme, por privatisht, nuk pajtohen me këto norma shoqërore. Ndonëse normat shoqërore, qëndrimet dhe sjelljet personale nuk e përjashtojnë njëra tjetrën, shpesh ato e përforcojnë njëra tjetrën.

Normat shoqërore të lidhura me dhunën në familje

Vrojtimi gjeti se 1 në 2 apo 52,2% e grave të moshës 18-74 vjeç mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se dhuna midis burrit dhe gruas është një çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë, ndërsa 46,5% mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se një grua duhet të durojë një farë dhune për të ruajtur familjen. Përveç kësaj, 27,5% e grave mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se kur një grua rrihet nga burri i saj, faji apo gabimi është pjesërisht i saj. 27,5% të tjera mendonin se gruas duhet t'i vijë trup apo të ndihet keq të flasë me dikë tjetër jashtë familjes për abuzimin apo dhunën në martesën e saj. Këto norma shoqërore mund të kontribuojnë në mbizotërimin e dhunës të ushtruar nga partneri intim ndaj grave në familje, duke i mbajtur gratë që rrihen në kurthin e marrëdhënieve të dhunshme. Pavarësisht nga këto norma shoqërore, vetëm 13,5% e grave mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet ndonjëherë i qëllojnë me shpulla apo i rrahin gratë e tyre, dhe 11,4% mendonin se të gjithë apo shumica e burrave në komunitet i qëllojnë me shpulla apo i rrahin gratë sepse refuzojnë të kryejnë marrëdhënie seksuale me ta.

Normat shoqërore të lidhura me dhunën seksuale

Për sa u takon normave shoqërore të lidhura me dhunën seksuale, 1 në 4, apo 26,1% e grave të moshës 18-74 vjeç mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se gruaja duhet të ketë turp, apo të ndihet keq të flasë me dikë nëse është përdhunuar, dhe 21,2% e grave mendonin se të gjithë, apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se nëse një grua përdhunohet, ka të ngjarë që të ketë bërë diçka të pakujdesshme që e ka vënë veten në një situatë të tillë.

Normat shoqërore

janë besimet që kanë përgjithësisht njerëzit në lidhje me atë që quhet tipike dhe e përshtatshme në një grup referimi; besimet për atë që njerëzit e tjerë mendojnë se duhet bërë. Normat shoqërore mundet ose jo të bazohen në besime të sakta rreth qëndrimeve dhe sjelljeve të të tjerëve.

Sjellja

është ajo çka njeriu bën. Besimet dhe sjelljet janë të lidhura; shpesh normat shoqërore ndikojnë mbi sjelljen, por sjelljet po ashtu mund të ndikojnë mbi normat shoqërore.

Qëndrimi personal

është tendenca për të vlerësuar diçka (një njeri, simbol, besim, objekt) me një farë shkalle pëlqimi apo mospëlqimi.

Perceptimi i ashpërsisë së DHNCV-së

Vrojtimi gjeti se 3 në 4, apo 75,4% e grave deklaruan se dhuna në familje ndaj grave është problem i madh në Shqipëri. Gjithashtu, 70,8% e grave deklaruan se dhuna seksuale ndaj grave dhe vajzave është problem i madh në Shqipëri, 69,9% deklaruan se ngacmimi seksual i grave dhe vajzave është një problem i madh, ndërsa 68,4% deklaruan se përndjekja e grave është problem i madh në Shqipëri. Duke pasur parasysh këto gjetje, nuk është për t'u habitur që shumica e grave ishin të mendimit se është shumë e rëndësishme të ketë ligje në Shqipëri që të mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesë/familje (83,0%) dhe nga sulmet seksuale dhe përdhunimi (81,9%).

Gjithashtu, 79,5% e grave e shihte si të papranueshme që mjekët/infermieret t'i pyesnin gratë nëse lëndimet e tyre ishin shkaktuar nga dhunë seksuale dhe/ose gjinore.

DHUNA NË FAMILJE NGA PARTNERI INTIM

Grafiku 3 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar një prej llojeve të ndryshme të dhunës nga partneri intim. Për sa u takon përvojave të jetës, 47,0% e grave kishin përjetuar dhunë në familje nga partneri intim. Më konkretisht, 41,2% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” sjellje kontrolluese shtrënguese, 31,4% kanë përjetuar dhunë psikologjike, 18,0% kanë përjetuar dhunë fizike, 8,6% kanë përjetuar dhunë seksuale, dhe 7,0% kanë përjetuar dhunë ekonomike. Në fakt, 1 në 5, apo 21,0% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë dhunë fizike dhe/ose dhunë seksuale, ose të dyja” në marrëdhëniet e tyre martesore/intime. Për sa u përket përvojave aktuale, 1 në 3 ose 33,7% e grave kanë përjetuar dhunë nga partneri intim gjatë 12 muajve përpara vërtetimit. Më konkretisht, 1 në 4, ose 25,2% e grave kanë përjetuar sjellje kontrolluese shtrënguese, 19,7% përjetonin “aktualisht” dhunë psikologjike, 7,2% përjetonin dhunë fizike, 7,0% përjetonin dhunë ekonomike, dhe 3,6% përjetonin dhunë seksuale. Është për të vënë në dukje se 8,2% e grave kishin përjetuar

“aktualisht” dhunë fizike dhe/ose dhunë seksuale, ose të dyja, gjatë 12 muajve përpara vërtetimit.


Gratë e moshës 18-24 vjeç kishin shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje nga partneri intim (55,8% ndonjëherë, 55,8% aktualisht). Me plakjen e grave, përvojat e tyre “aktuale” të dhunës në familje nga partneri intim pakësohen, ku vetëm 25,8% e grave të moshës 55-64 vjeç dhe 18,2% të moshës 65-74 vjeç kishin përjetuar dhunë në familje nga partneri intim.

Kur fillon dhuna në familje nga partneri intim

Gratë që përjetojnë dhunë në familje nga partneri intim, u pyetën se kur kish filluar dhuna në familje në martesën e tyre. Të dhënat treguan se 1 në 4, ose 26,1% e grave, raportuan se dhuna në familje kish nisur brenda vitit të parë të martesës, 23,2% raportuan se dhuna kish nisur në vitin e 2-të dhe të 3-të të martesës, 14,9% raportuan se dhuna kish nisur pas 4 apo 5 vitesh që ishin martuar dhe 17,1% raportuan se dhuna kish nisur pasi kishin kaluar gjashtë apo më shumë vite që ishin martuar.

Grafiku 3. Përvoja dhune në familje nga partneri intim

Gratë e moshës 18-74 vjeç që janë aktualisht/kanë qenë të martuara dhe/ose kanë jetuar ndonjëherë me burrin/të dashurin
N=886,374



Vini re: Po t'i mbledhësh përqindjet shuma nuk del 100%, sepse të anketuarat mund të kenë përjetuar më shumë se një lloj dhune.

Dhuna fizike gjatë shtatzënisë

Midis grave që kishin qenë ndonjëherë shtatzëna, 1,1% ishin goditur, qëlluar me shpulla, shkelmuar apo abuzuar fizikisht gjatë shtatzënisë. Midis grave që kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike, 2,3% ishin goditur, qëlluar me shpulla, shkelmuar, apo abuzuar fizikisht gjatë shtatzënisë.

Midis grave që ishin goditur, qëlluar me shpulla, shkelmuar apo abuzuar fizikisht gjatë shtatzënisë, afërsisht 1 në 3, apo 30,5% raportuan se kjo kish ndodhur gjatë shtatzënisë së fundit dhe 10,1% se ishin grushtuar apo shkelmuar në bark gjatë shtatzënisë. Të pyetura se kush i kishte goditur, qëlluar me shpulla, shkelmuar apo abuzuar fizikisht gjatë shtatzënisë, 50,9% e grave e identifikuan dhunuesin si burrin/të dashurin aktual/të dikurshëm. Disa gra deklaruan se dhunuesi kishte qenë një anëtar tjetër i familjes, përfshirë nënën/njerkën (4,3%), babanë/njerkun (4,5%), motrën/vëllain (4,3%), vajzën/djalin (2,5%), të afërm të tjerë (7,3%), vjehrrën (1,6%), vjehrrin (1,6%) dhe të afërm të tjerë (2,6%). Gratë dëshmuan gjithashtu se autorët kishin qenë mësuesit (7,3%) dhe punëdhënësit apo dikush tjetër në punë (2,5%).

Për sa i takon grushtimit apo shkelmimit gjatë shtatzënisë, 79,1% e grave raportuan se dhunuesi kish qenë bashkëshorti/i dashuri aktual apo i dikurshëm dhe 10,4% raportuan se kish qenë dikush nga familja e burrit.

Lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje

Më shumë se 1 në 2, apo 58,8% e grave që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike, kanë pësuar lëndime nga dhuna në familje, dhe afërsisht 3 në 4, apo 72,4% e grave që përjetonin “aktualisht” dhunë në familje, kishin pësuar lëndime ngakjo dhunë.

Më konkretisht, 61,1% e grave që përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe më shumë se 1 në 2, apo 56,0% e grave që kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike, kishin përjetuar frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi, dhe/ose nervozizëm. Gjithashtu, 1 në 4, ose 28,1% e grave që përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe 23,6% që kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike, kishin pësuar të prera, të gërvishtura, dhimbje, skuqje apo ënjtje dhe/ose shenja të tjera të lehta.

Gratë gjithashtu kanë përjetuar lëndime më të rënda, duke përfshirë: lëndime në sy, thyerje, ndrydhje kockash dhe/ose flluska nga djegiet (6,5% ndonjëherë, 12,4% aktualisht); aborte (2,6% ndonjëherë, 1,2% aktualisht); lëndime, tronditje në kokë, dhe/ose humbje dëgjimi (2,0% ndonjëherë, 2,6% aktualisht); lëndime në bark (2,1% ndonjëherë, 1,0% aktualisht); plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, lëkurë të nxirë apo të përcëlluar nga djegiet dhe/ose lëndime në bark (2,1% ndonjëherë, 1,0% aktualisht); dëmtime dhe/ose shpërfytyrime të përhershme (1,1% ndonjëherë, 0,0% aktualisht); dhe humbje të kujtesës (0,5% ndonjëherë, 0,2% aktualisht). Gratë e rrahura shpesh përjetojnë më shumë se një lloj lëndimi nga dhuna në familje.

Gjithashtu gjetjet treguan se 5,6% e grave që kanë përjetuar dhunë fizike, ishin lënduar kaq rëndë nga bashkëshortët/partnerët sa që kishin pasur nevojë për kujdes shëndetësor, ndonëse nuk e kishin marrë. Midis grave që kishin pasur nevojë për kujdes shëndetësor, 23,1% kishin kaluar natën në spital për shkak të lëndimeve të pësura nga dhuna në familje dhe vetëm 13,4% e grave të rrahura i kishin treguar punonjësit të shëndetësisë se shkak i lëndimeve të tyre kish qenë dhuna në familje.

Ndërprerje e punës për shkak të dhunës në familje

Një në katër, ose njëzetë e pesë për qind e grave që kanë përjetuar dhunë fizike dhe lëndime për shkak të dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara vrojtimit (aktualisht) raportuan se nuk kishin qenë në gjendje të bënin punët e shtëpisë dhe/ose të kujdeseshin për fëmijët për shkak të dhunës në familje. Gjithashtu, 8,9% e grave raportuan se nuk kishin qenë në gjendje të shkonin në punë (kishin humbur ditë të tëra pune) për shkak të dhunës në familje, dhe 0,5% e grave kishin humbur punën apo burimin e të ardhurave për shkak të dhunës në familje.

Dhuna seksuale, përdorimi i mjeteve për kontrollin e lindjeve, rreziku i SST-ve

Gratë që përjetonin dhunë seksuale nga bashkëshortët/partnerët (27,1%) kishin pothuaj nëntë herë më shumë gjasa, krahasuar me gratë që nuk kanë përjetuar dhunë seksuale (3,1%) të raportonin se bashkëshorti/partneri nuk pranonte të përdorte

mjete për kontrollin e lindjeve, apo se ish orvatur t'i ndalonte ato të përdornin ndonjë metodë për të shmangur shtatzëninë.

Mënyra më e zakonshme me të cilën bashkëshortët/partnerët i pengonin gratë të përdornin kontraceptivë ishte me anë të dhunës psikologjike: 3 në 4, ose 79,7% e grave raportuan se bashkëshorti/i dashuri i tallte që përdornin kontraceptivë; 1 në 2, ose 56,4% e grave raportuan se bashkëshorti/i dashuri u ulërinte/zemërohej me to që përdornin mjete mbrojtëse; 1 në 2, ose 51,9% e grave raportuan se bashkëshorti/i dashuri i kërcënonte se do t'i rrihte; 1 në 3, ose 36,7% raportuan se bashkëshorti/i dashuri i kërcënonin se do t'i linte apo do t'i përzinte nga shtëpia sepse përdornin kontraceptivë; 18,3% i akuzonin se nuk ishin gra të mira; dhe 13,9% e grave raportuan se burri/i dashuri ua kish flakur tej kontraceptivët (13,9%). Gratë që përjetonin aktualisht dhunë seksuale (20,8%) kishin pothuaj dy herë më shumë gjasa të shqetësoheshin se mos merrnin një infeksion seksualisht të transmetueshëm (IST) dhe tre herë më shumë gjasa të kishin një IST (7,8%), krahasuar me gratë që nuk përjetonin aktualisht dhunë seksuale në martesë/lidhjen intime (përkatësisht 11,3% dhe 2,1%). Gratë që "aktualisht" përjetonin dhunë seksuale (36,0%) kishin dhjetë herë më shumë gjasa të kishin pasur më parë një IST gjatë 12 muajve të kaluar, krahasuar me gratë që nuk përjetonin aktualisht dhunë seksuale në martesën/marrëdhënien e tyre intime (5,8%).

Alkooli dhe dhuna në familje


Gratë që përjetonin "aktualisht" dhunë në familje (66,8%) kishin dy herë më gjasa që ta shihnin bashkëshortin/partnerin të dehur në shumicën e ditëve gjatë 12 muajve të kaluar, krahasuar me gratë që nuk përjetonin "aktualisht" dhunë në familje (33,2%). Gratë që e shihnin bashkëshortin/partnerin të dehur shumicën e ditëve (86,1%) dhe çdo javë (77,5%) kishin më gjasa të përjetonin frikë, ankth, depresion, ndjenjë izolimi, pagjumësi dhe/ose nervozizëm, krahasuar me gratë që e shihnin bashkëshortin/partnerin të dehur një here në muaj (42,4%), më pak se një herë në muaj (59,8%) dhe asnjëherë (49,2%). Gratë që e shihnin bashkëshortin/partnerin të dehur shumicën e ditëve (36,6%) dhe çdo javë (55,1%) kishin gjithashtu më shumë gjasa të pësonin të çara, të gërvishtura, dhimbje, skuqje apo

ënjtje dhe/ose shenja të lehta, krahasuar me gratë që e shihnin bashkëshortin/partnerin të dehur një herë në muaj (12,1%), më pak se një here në muaj (21,8%) dhe asnjëherë (21,6%) gjatë 12 muajve të fundit.

Për sa u përket përvojave të grave me lëndime më të rënda përshkak të dhunës në familje, më të rëndësishmet ishin ato të shkaktuara nga bashkëshortët/partnerët që e kishin zakon të konsumonin alkool. Gratë që e shihnin bashkëshortin të dehur shumicën e ditëve (14,5%) dhe çdo javë (11,9%) kishin tre deri në katër herë më shumë gjasa të përjetonin lëndime në sy, ndrydhje gjymtyrësh dhe/ose filluska nga të djegurat, krahasuar me gratë që i shihnin bashkëshortët/partnerët të dehur një herë në muaj (3,5%), më pak se një herë në muaj (5,5%) dhe asnjëherë (3,7%). Gratë që i shihnin burrat e tyre të dehur çdo javë (109%) kishin katër deri në dhjetë herë më shumë gjasa të përjetonin lëndime dhe tronditje në kokë, dhe/ose humbje dëgjimi dhe shtatë herë më shumë gjasa që të përjetonin humbjen e fëmijës (14,8%); ndërsa gratë që e shihnin bashkëshortin/partnerin të dehur shumicën e ditëve (5,0%) kishin dy deri në shtatë herë më shumë gjasa të përjetonin lëndime në kokë. Gjithashtu, gratë që e shihnin burrin/partnerin të dehur çdo javë (6,8%) kishin më gjasa të përjetonin lëndime dhe/ose shpërftyryme të përhershme.

Ekspozimi i fëmijëve ndaj dhunës në familje

Dhuna në familje nuk prek vetëm gratë që rrihen dhe abuzohen, por ajo ka ndikim negativ edhe ndaj fëmijëve të cilët janë viktimë të drejtpërdrejta dhe/ose të tërthorta. Vrojtimi tregoi se 47,7% e grave që kishin përjetuar dhunë në familje kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjen e tyre. Bazuar në kampionin prej 830.152 grash të moshës 18-74 vjeç me fëmijë 0-17 vjeç që jetonin në familje me to dhe bazuar në numrin e fëmijëve që secila prej tyre kishte, u përllogarit se në familjet që u vrojtuan, kishte gjithsej 591.476 fëmijë të moshës 0-17 vjeç. U bënë llogaritje të mëtejshme për të vlerësuar numrin e fëmijëve që jetonin në familje ku gratë raportuan përjetime të dhunës në familje (ndonjëherë dhe aktualisht), në përpjekje për të dokumentuar se sa fëmijë ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje në jetën e tyre dhe gjatë 12 muajve të kaluar. Bazuar në këto llogaritje, vlerësohet se 286.498 fëmijë të moshës 0-17 vjeç ishin ekspozuar ndaj dhunës në



61.1%

e grave që përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe më shumë se 1 në 2, apo 56,0% e grave që kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike, kishin përjetuar frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi, dhe/ose nervozizëm.

familje gjatë jetës së tyre (ndonjëherë), dhe 246.707 fëmijë ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht).

Fëmijët e moshës 5-17 vjeç të ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht) kishin dy herë më shumë gjasa të përjetonin ankthe të shpeshta (25%), krahasuar me fëmijët që nuk ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje (9,5%). Gjithashtu, fëmijët e moshës 5-17 vjeç të ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht), kishin dy herë më tepër gjasa të urinonin në shtrat shpesh (20,4%), të ishin shumë të ndrojtur ose të tërhequr (21,5%) dhe të vepronin në mënyrë agresive me nënën dhe/ose fëmijët e tjerë (6,9%), krahasuar me fëmijët që nuk ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje (përkatësisht, 6,7%, 7,1% dhe 1,9%). Këto gjetje janë bazuar në informacionin e dhënë nga nënat e këtyre fëmijëve; sepse fëmijët nuk u intervistuan në këtë vërtetim.

Sjellje të grave të rrahura që kërkojnë ndihmë

Vetëm 16,9% e grave që “aktualisht” përjetonin dhunë në familje i kishin treguar dikujt për dhunën, ndërsa 8,4% kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje; gratë që përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale kishin pothuaj dy herë më tepër gjasa t’i rrëfenin dikujt për dhunën (30,8%) dhe dy herë më tepër gjasa të kërkonin ndihmë (18,5%). Shumica e grave të rrahura në Shqipëri vazhdojnë të vuajnë në heshtje, pavarësisht

përpjekjeve të vazhdueshme për ndërgjegjësimin e publikut rreth dhunës në familje dhe hartimit kohët e fundit të legjislacionit mbi dhunën në familje dhe ngritjes së shërbimeve në mbështetje të viktimave.

Kur gratë kërkojnë ndihmë për dhunën në familje, shumica kërkojnë këtë ndihmë nga familjet e tyre (98,9%). Disa gra u kanë kërkuar ndihmë edhe familjeve të bashkëshortëve/partnerëve (40,4%). Ndonëse të pakta në numër, ka pasur disa gra që kanë kërkuar ndihmë nga rrjetet informale të tillë si, fqinjët (11,9%), mikeshat (6,7%), dhe nga udhëheqës fetarë (1,7%). Shumë më pak gra kanë kërkuar ndihmë nga rrjetet zyrtare të tilla si, policia (4,4%), avokatët (3,4%), mjekët/punonjësit e shëndetësisë (3,1%), gjyqtarët (2,8%), ndonjë agjenci e shërbimeve sociale (1,6%), dhe nga ndonjë strehë grash dhe vajzash (0,4%). Nuk kishte asnjë grua që të kish kërkuar ndihmë nga linja telefonike 24 orëshe pa pagesë apo nga koordinatori lokal i dhunës në familje.

Arsyet më të zakonshme përse gratë e rrahura kanë kërkuar ndihmë janë se miqtë dhe/ose familja i kanë nxitur ta bëjnë këtë (63,5%), e kanë ditur se dhuna është e papranueshme në marrëdhënie (62,6%), nuk mund ta duronin më tej dhunën (58,8%), dhe se ishin të shumë të lënduara (43,6%). Ndonëse më të pakta në numër, disa gra kishin kërkuar ndihmë sepse i shihnin fëmijët që vuanin (22,3%), kishin frikë se bashkëshortët/partnerët do t’i vrisnin (9,8%), bashkëshortët/partnerët i kishin kërcënuar se do t’i vrisnin (4,9%), i kishin përzënë

nga shtëpia (4,7%), dhe/ose u kishin kërcënuar apo goditur fëmijët e tyre (4,3%). Gjithashtu, 2,2% e grave kishin frikë se mund ta vrisnin burrin/partnerin.

Një numër i pakët grash që përjetonin dhunë në familje (10,0% aktualisht, 8,8% ndonjëherë) dhe dhunë fizike dhe/ose seksuale (18,3% aktualisht, 12,1% ndonjëherë) ndonjëherë ishin larguar nga shtëpia, për shkak të dhunës në familje qoftë edhe për një natë. Numri i ditëve që ato ishin larguar nga shtëpia ndryshonte nga 1 në 20, me një mesatare prej 2,1 ditë për grua.

Shumica e grave që përjetonin dhunë në familje nuk kishin kërkuar ndihmë. Arsyeja më e zakonshme që nuk kishin kërkuar ndihmë ishte sepse situata nuk ishte aq e rëndë sa ato të ankoheshin (47,8%). Gratë tjera raportuan se nuk kishin kërkuar ndihmë, sepse nuk donin të turpëronin familjet (12,0%), ndiheshin në siklet apo kishin turp apo frikë se nuk do t'i besonin (10,9%), mendonin se do t'i fajësonin ato (9,7%), mendonin se nuk kish arsye të ankoheshin, sepse dhuna është normale (6,8%), kishin frikë nga përfundimi i marrëdhënies (6,5%), kishin frikë se mos i kërcënonin dhe nga pasojat e dhunës së mëtejshme (6,1%), kishin frikë se mos humbitnin fëmijët (6,0%), nuk dinin ku të kërkonin ndihmë (4,9%) dhe besonin se nuk do t'u zgjidhej problemi që kishin (4,2%).

Autorët e ngacmimit seksual

Autorët e dhunës në familje në të shumtën e herëve ishin persona të moshës 24-35 vjeç (19,5%), 35-44 vjeç (25,8%), 45-55 vjeç (23,4%) dhe 55-64 vjeç (20,0%). Pak autorë ishin 65 vjeç apo më të vjetër (12,6%) dhe nën moshën 25 vjeç (1,7%).

Për sa i përket nivelit arsimor, 1 në 2, ose 47,9% e autorëve të dhunës në familje kishin arsim të mesëm të ulët (8-9 vjeçar) dhe 30,0% kishin arsim të mesëm të lartë. Një numër shumë më i vogël autorësh kishin vetëm arsim fillor (7,4%), ose nuk ishin të diplomuar (1,7%); këto përqindje mund të pasqyrojnë raportin e burrave me arsim fillor apo me më pak arsim midis popullatës. Vetëm 2,3% e autorëve të dhunës në familje kishin arsim universitar apo më të lartë. Shumica e autorëve të dhunës në familje ishin në punë (68,7%); vetëm 12,6% ishin të papunë dhe duke kërkuar punë, 11,9% ishin në pension, dhe 2,5% ishin me aftësi të kufizuara apo kishin një sëmundje afatgjatë.


DHUNA GJATË MARRËDHËNIES DASHURORE

Analiza tregoi se pothuaj 2 në 3, ose 65,8% e grave kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë dhe 61,8% përjetonin “aktualisht” dhunë gjatë marrëdhënies dashurore, nga të cilat të gjitha përjetonin sjellje kontrolluese shtrënguese dhe rreth gjysma përjetonin dhunë psikologjike. Të gjitha gratë që raportonin se i qëllonte i ati me shpulla apo i rrihte e ëma, përjetonin dhunë gjatë marrëdhënies dashurore dhe sjellje kontrolluese shtrënguese; nuk kishte ndonjë lidhje me llojet e tjera të dhunës gjatë marrëdhënies dashurore.

Shumica e autorëve të dhunës gjatë marrëdhënies dashurore ishin të moshës 25-34 vjeç (88,9%). Kjo ndodh megjithëse kampioni i grave që nuk ishin martuar kurrë dhe/ose nuk kishin jetuar kurrë me një burrë/partner ishin kryesisht të moshës 18-24 vjeç (46,3%) dhe të moshës 25-34 (45,5%).

88.9%

e autorëve të dhunës gjatë marrëdhënies dashurore ishin të moshës 25-34 vjeç. Kjo ndodh megjithëse kampioni i grave që nuk ishin martuar kurrë dhe/ose nuk kishin jetuar kurrë me një burrë/partner ishin kryesisht të moshës 18-24 vjeç (46,3%) dhe të moshës 25-34 (45,5%).



DHUNA NGA JOPARTNERI

Midis grave të moshës 18-74 vjeç, 18,2% përjetonin “ndonjëherë” dhe 2,4% “aktualisht” një apo më shumë nga katër llojet e dhunës nga jopartneri që nga mosha 15 vjeç (nga dikush tjetër nga i shoqi/i dashuri). Gratë kishin më tepër gjasa të përjetonin dhunë fizike (17,3%) se sa dhunë seksuale nga jopartneri (1,3%).

Autorët jopartnerë të dhunës fizike

Midis grave që përjetonin “ndonjëherë” dhunë fizike nga jopartneri që nga mosha 15 vjeç, 3 në 4, ose 76,1% raportuan se dhunuesja kish qenë nëna/njerka dhe më shumë se 1 në 2, ose 58,0% raportuan se dhunuesi kish qenë babai/njerku. Gjithashtu, 1 në 3, ose 35,7% e identifikuan dhunuesin si mësuesin, dhe 1 në 4, ose 28,0% e identifikuan dhunuesin si motrën apo vëllain. Gratë identifikuan një mori dhunuesish të tjerë, por në një masë më të vogël.

Autorët jopartnerë të dhunës seksuale

Gratë që përjetonin dhunë seksuale nga jopartneri që nga mosha 15 vjeç i identifikuan dhunuesit si shokë klase/shkolle (15,1%), mësues (7,1%), shokë/ të njohur (5,4%), babanë/njerkun (5,2%), nënën/njerkën (4,4%), dhe të panjohur (3,3%).

Sjellje që kërkojnë ndihmë për dhunën nga jopartneri

Midis grave që përjetonin dhunë nga jopartneri, vetëm 6,6% i kishin treguar dikujt dhe 4,6% kishin kërkuar ndihmë për dhunën. Shumica e grave kishin kërkuar ndihmë nga familjet e tyre (85,3%). Disa gra gjithashtu kishin kërkuar ndihmë nga fqinjët (16,6%), familja e bashkëshortit/të dashurit (15,5%), miqtë (12,1%) dhe bashkëshorti/i dashuri i aktual/i dikurshëm (2,6%). Shumë të pakta ishin gratë që kishin kërkuar ndihmë nga rrjetet zyrtare, por ato që kishin kërkuar ndihmë, në fakt ishin drejtuar në polici (8,3%), gjykata/gjyqtarëve (4,7%), mjekëve/infermiereve (2,6%), avokatëve (2,2%) dhe/ose një agjencie të shërbimeve sociale (2,2%).

Midis grave që kishin kërkuar ndihmë, shumica e kishin kërkuar ndihmën, sepse miqtë dhe/ose familja i kish nxitur ta bënin këtë (70,8%). Një përqindje e madhe kishte kërkuar ndihmë, sepse nuk e kishin duruar dot më dhunën (45,9%) dhe ishin të lënduara

shumë (43,9%). Një numër më i vogël grash kishin kërkuar ndihmë, për shkak se ajo që u kish ndodhur nuk ishte e pranueshme dhe ishte krim (17,4%), sepse kishin frikë se burri që kish kryer dhunë, u kërcënonte familjen (3,5%), dhe se burri i kish kërcënuar se do t'i vriste apo ish orvatur t'i vriste (2,2%).


Arsyet më të zakonshme për moskërkimin e ndihmës ishin se situata nuk ishte aq e rëndë sa për t'u ankuar (38,1%), sepse nuk donin të turpëronin familjen (10,9%), mendonin se do t'i fajësonin (9,6%), dhe ndiheshin në siklet, kishin turp apo frikë se nuk do t'i besonin (9,0%). Disa gra mendonin se nuk ka arsye të ankoresh, sepse dhuna është normale (7,0%), nuk e dinin ku të drejtoheshin për ndihmë (4,9%), dhe sepse mendonin se nuk do t'ua zgjidhte problemin (2,7%).

NGACMIMI SEKSUAL

Ngacmim seksual dot të thotë përpjekjet e pamirëpritura seksuale, kërkesa për favore seksuale dhe ngacmime të tjera verbale apo fizike me natyrë seksuale, që përbëjnë shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të

18.2%

përjetonin
“ndonjëherë” një
apo më shumë
nga katër llojet
e dhunës nga
jopartneri që nga
mosha 15 vjeç



burrave dhe grave. Ngacmimi seksual është një formë abuzimi seksual dhe diskriminimi dhe dhune me bazë gjinore. Vrojtimi konstatoi se 18,1% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar “ndonjëherë” ose “aktualisht” një apo më shumë nga gjashtë llojet e ngacmimeve seksuale të matura nga vrojtimi. Më konkretisht, gratë kanë raportuar se një person tjetër nga bashkëshorti/i dashuri u ka bërë komente rreth trupit dhe/ose pamjes së tyre fizike, që i ka bërë ato të ndihen jo rehat, apo të ofenduara (12,2%), dhe u ka bërë pyetje personale rreth jetës së tyre seksuale, intime apo private, që i ka bërë të ndihen jo rehat, në siklet apo të ofenduara (5,9%).

Gratë raportuan gjithashtu se dikush tjetër nga burri/i dashuri u kish treguar apo nxjerrë pjesët private të trupit apo “u kish tundur kundër dëshirës” së tyre organet gjenitale (4,5%), dhe i kish prekur, përqafuar apo puthur në mënyrë seksuale pa lejen e tyre (4,0%). Shumë më pak gra raportuan se u kishin dërguar emaille të turpshme apo të padëshiruara seksuale të shprehura apo mesazhe me tekst dhe/ose kishin bërë orvatje të papërshtatshme në faqe të rrjeteve sociale (1,9%) dhe u kishin dërguar apo treguar pamje, foto apo dhurata të qarta seksuale apo pornografike që i kishin bërë të ndiheshin keq, në siklet apo të ofenduara (1,4%).

Marrëdhënia midis moshës dhe ngacmimit seksual

Gratë e moshës 18-24 vjeç (22,2%), 25-34 vjeç (19,7%) dhe 35-44 vjeç (21,0%) kishin më tepër gjasa të përjetonin ndonjëherë ngacmim seksual, krahasuar me gratë e moshës 45-54 vjeç (18,0%), 55-64 vjeç (15,9%) dhe 65-74 vjeç (9,5%). Po ashtu, gratë e moshës 18-24 vjeç (12,6%), 25-34 vjeç (12,6%) dhe 35-44 vjeç (10,7%) kishin më tepër gjasa të përjetonin ngacmim seksual gjatë 12 muajve përpara vrojtimit, krahasuar me gratë 45-54 vjeç (7,0%), 55-64 vjeç (4,3%) dhe 65-74 vjeç (2,1%). Është për t'u vënë në dukje se gratë e moshës 45-74 vjeç kishin përjetuar ngacmim seksual gjatë 12 muajve përpara vrojtimit.

Vendet ku ndodh ngacmimi seksual

Shumica e rasteve të ngacmimit seksual kishin ndodhur në rrugë/rrugica (82,9%), të ndjekura nga shkollat (42,3%), pazaret/dyqanet (38,3%), në shtëpinë e gruas (29,1%), në vendin e punës (25,8%), në makina, autobusë dhe në mjete të tjera transporti (19,9%), bare,



12%

e grave kishin
përjetuar
ngacmim seksual
në shtëpinë e një
dhunuesi

restorante dhe/ose në disko/klube (17,5%), në shtëpinë e dikujt tjetër (15,7%), nëpër ara apo në ambiente natyrore (14,4%), dhe në det, liqen, lumë apo në ndonjë ambient tjetër ujor (13,5%). Vetëm 1,2% e grave kishin përjetuar ngacmim seksual në shtëpinë e një dhunuesi. Vendet ku kish ndodhur ngacmimi seksual ndryshonte sipas llojit të ngacmimit seksual.

Autorët e ngacmimit seksual

Gratë raportuan se kishin qenë të panjohur (79,3%) dhe miq/të njohur (51,2%) që kishin kryer shumicën e incidenteve të ngacmimit seksual, të ndjekur nga fqinjët (33,4%) dhe shokët e klasës/shkollës (32,6%). Ishin shumë më të pakta, vetëm disa gra, që identifikuan si ngacmuesit seksualë të tyre të afërm/pjesëtarë të familjes (16,8%), shokë pune (13,8%) dhe të dashurit aktualë/të dikurshëm (10,1%). Një përqind apo më pak identifikuan si ngacmuesit seksualë të tyre punëdhënësit, mësuesit, policë/ushtarë dhe udhëheqës të komunitetit. Asnjë grua nuk identifikoi ndonjë udhëheqës fetar si autor të ndonjë ngacmimi seksual. Autorët e ngacmimit seksual ndryshojnë sipas llojit të ngacmimit seksual.

PËRNDJEKJA

Sikundër dhuna në familje nga partneri intim, edhe përndjekja është një krim pushteti dhe kontrolli. Përndjekja është “një rrugë sjellje e drejtuar ndaj një

personi të caktuar që përfshin afërsi të përsëritur (dy apo më shumë herë) vizuale apo fizike, komunikim jo konsensual, të njëanshëm, apo verbal, kërcënime të nënkuptuara, apo kombinimin e të gjithave, që mund t'i shkaktojë frikë një personi të arsyeshëm". Sjellja e përndjekësit mund të përfshijë modele të vazhdueshme të lënies apo dërgimit të artikujve apo dhuratave të padëshiruara viktimës, të cilat mund të jenë në dukje romantike deri në të çuditshme, ndjekjen pas apo qëndrime në pritje të viktimës, dëmtimin apo kërcënimin për dëmtim të pronës së viktimës, përgojimin e karakterit të viktimës, apo ngacmimin e viktimës përmes internetit, duke postuar informacion personal rreth saj, apo përhapjes së thashethemeve për viktimën. Përndjekja mund të përfshijë akte që të marra veç e veç, mund të duken të pafajshme por, që së bashku, kanë për qëllim të shkatërrojnë ndjenjën e sigurisë së viktimës.

Studimi gjeti se 12,6% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar "ndonjëherë" apo 6,5% "aktualisht" një apo më shumë lloje nga gjashtë llojet e ndryshme të përndjekjes. Më konkretisht, 8,9% e grave kishin pasur dikë që në mënyrë të përsëritur u kish bërë thirrje telefonike fyese, kërcënuese apo pa folur, dhe 4,6% kishin pasur dikë që në mënyrë të përsëritur u kish dërguar emaille, mesazhe me tekst, apo mesazhe në faqet e internetit të rrjeteve sociale, të cilat ishin fyese dhe/ose kërcënuese. Vetëm 1,6% e grave raportuan se dikush u kish dërguar vazhdimisht letra, kartolina apo dhurata të padëshiruara, fyese apo kërcënuese, dhe 1,2% raportuan se dikush ishte sjellë vërdallë shtëpisë së tyre, apo i kish pritur përjashta shtëpisë, vendit të punës apo shkollës pa pasur ndonjë arsye legjitime, pastaj qëllimisht i kish ndjekur pas. Më pak se një për qind e grave kanë pasur dikë që vazhdimisht ka postuar komente fyese për to në internet, apo ka bërë publike foto apo video të tyre intime në faqet e rrjeteve sociale dhe në mënyrë të përsëritur dhe qëllimisht u ka shkatërruar pronën apo u ka hyrë në shtëpi me forcë. Vetëm 39,4% e grave që përjetonin "aktualisht" përndjekje i konsideronin kontaktet e padëshiruara dhe sjelljet ngacmuese si përndjekje.

Marrëdhënia midis moshës dhe përndjekjes

Gratë e moshës 18-24 (29,1%) kishin më tepër gjasa të përjetonin "ndonjëherë" përndjekje, krahasuar me gratë e moshës 25-34 vjeç (16,2%), 35-44 vjeç (11,1%), 45-

54 vjeç (6,9%), 55-64 vjeç (6,6%) dhe 65-74 vjeç (4,6%). Po ashtu, gratë e moshës 18-24 vjeç (19,7%) kishin më tepër gjasa të përjetonin "aktualisht" përndjekje, krahasuar me gratë e moshës 25-34 vjeç (10,1%), 35-44 vjeç (38%), 45-54 vjeç (2,9%), 55-64 vjeç (2,3%) dhe 65-74 vjeç (1,6%). %). Të bie në sy se gratë e moshës 55-74 vjeç kanë përjetuar përndjekje gjatë 12 muajve përpara vërtetimit.

Autorët e përndjekjes

Shumica e grave raportuan se përndjekësit e tyre ishin të panjohur (97,0%). Disa gra raportuan se përndjekësit e tyre ishin shokë klase/shkolle (14,7%), të dashurit aktualë/të dikurshëm (13,8%), miq/të njohur (10,8%), bashkëshortët aktualë/të dikurshëm (8,9%), fqinjë (7,1%), shokë pune (3,5%) dhe punëdhënësit (2,0%). Më pak se një për qind i identifikuan përndjekësit e tyre si oficerë policie/ushtarë dhe të afërm/pjesëtarë të familjes. Përndjekësit ndryshonin sipas llojit të përndjekjes.

PËRFUNDIME

Ky studim ishte përpjekja e tretë në Shqipëri për të përdorur standarde ndërkombëtare për mbledhjen e të dhënave mbi DhNGV-në, përfshirë jo vetëm dhunën në familje, por edhe dhunën gjatë marrëdhënies dashurore, dhunën nga jopartneri, abuzimet seksuale të fëmijëve dhe përndjekjen. Ai mati gjithashtu edhe normat shoqërore të lidhura me DhNGV-në, dhe perceptimet e grave për ashpërsinë e DhNGV-së në Shqipëri dhe rëndësinë e pasjes së ligjeve që kanë të bëjnë me DhNGV-në.

Të dhënat e këtij raporti ofrojnë dëshmi se DhNGV-ja në Shqipëri është e përhapur. Në bazë të këtyre të dhënave, DhNGV-ja nuk mund të shihet si një çështje anësore e cila prek vetëm jetën e disa grave në Shqipëri. DhNGV-ja prek shumicën e grave, si edhe rezulton në ekspozimin e fëmijëve ndaj dhunës në shtëpi, veçanërisht kur fëmijët janë dëshmitarë të dhunës së ushtruar ndaj nënave të tyre dhe bëhen viktimat të drejtpërdrejta dhe/ose të tërthorta të dhunës në familje.

KAPITULLI 1



HYRJE

Dhuna ndaj grave është “çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell ose ka gjasa të sjellë lëndime ose vuajtje fizike, seksuale ose psikologjike të grave, përfshirë edhe kanosjet për akte të tilla, shtrëngime apo heqjen arbitrare të lirisë, qoftë kur ndodhin në jetën publike, ashtu edhe në jetën private”.

Burimi: Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, 1993

Dhuna ndaj grave dhe vajzave (DhNGV)¹⁸ është një shkelje e përhapur e të drejtave të njeriut dhe një problem global i shëndetit publik me përmasa epidemike. DhNGV-jashprehet në forma të ndryshme fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike që ndodhin në vende publike dhe private. DhNGV-ja shkatërron shëndetin mendor dhe fizik dhe mirëqenien e grave dhe vajzave dhe mund të ketë një efekt negativ në sigurinë, stabilitetin, dhe paqen e tyre afatgjatë.¹⁹ DhNGV-jagjithashtu lë pasoja afatgjata në zhvillimin dhe përparimin e grave dhe në kontributin e tyre në ekonomi.

Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (referuar si Konventa e Stambollit) e përcakton dhunën ndaj grave si “shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore (DhBGj)²⁰ që çojnë ose mund të çojnë në lëndime ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike të

grave, përfshirë edhe kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë kur ndodhin në jetën publike, ashtu edhe në jetën private”. Ky përkufizim nuk ndryshon shumë nga përkufizimi i dhënë tek Deklarata e Kombeve të Bashkuara e vitit 1993 për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave.

Në nivel global, të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) vlerësojnë se 1 në 3 gra ose 35% e grave kanë përjetuar ose dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim dhe/ose dhunë seksuale nga njëjopartner gjatë jetës së tyre.²¹ Në mënyrë më specifike, 30% e grave me partner përjetonin dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim gjatë jetës së tyre dhe 7% përjetonin dhunë seksuale nga njëjopartner gjatë jetës së tyre.²² Në vitin 2012, UNODC dokumentoi se në nivel global, pothuajse gjysma e të gjitha grave viktimave të vrasjeve (47%) ishin vrarë nga pjesëtarë të familjes ose partnerë intimë krahasuar me 6% të viktimave meshkuj të vrarë në shtëpi.²³

Studimi i kryer nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) në vitin 2014 *Hidden in Plain Sight*²⁴, gjithashtu konstaton se në nivel global, rreth 1 në 10 ose 120 milion vajza nën moshën 20 vjeç kanë kryer marrëdhënie seksuale me detyrim ose akte të tjera seksuale me detyrim. Përveç kësaj, në nivel global është vlerësuar se miliona gra dhe vajza të tjera janë shfrytëzuar për prostitucion dhe pornografi çdo vit, shumicën e kohës të mashtruar dhe/ose detyruara për shfrytëzim seksual me premtime false nga trafikantët e qenieve njerëzore.

Gratë dhe vajzat e marginalizuara janë në rrezik gjithnjë e më të madh për diskriminim dhe dhunë sociale dhe ekonomike për shkak të statusit të tyre të marginalizuar në komunitet dhe shoqëri. Gratë e marginalizuara, mes të tjerave, përfshijnë refugjatet, azilkërkueset, gratë migrante me dhe pa dokumente, gratë e pakicave kombëtare dhe vendase, gratë që jetojnë në zona të largëta, gratë e moshuara, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë me HIV/AIDS. Për shkak të situatës së tyre të marginalizuar, gratë dhe vajzat kanë më pak mundësi për të marrë shërbime mbështetëse, mbrojtje dhe drejtësi kur ato pësojnë dhunë.

DhNGV pranohet edhe si shkak edhe si pasojë e pabarazisë gjinore dhe është një pengesë kryesore për të drejtat themelore të grave dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri dhe ekonomi. Nuk ka një faktor të vetëm që shkakton DhNGV-në; përkundrazi ka disa elementë që veprojnë në nivele të ndryshme të “ekologjisë sociale”, të cilët përjetësojnë dhe përforcojnë qëndrimet, normat dhe praktikatat diskriminuese dhe paragjyquese gjinore, të cilat kontribuojnë në pabarazinë e përhapur të pushtetit midis burrave dhe grave në shoqëri dhe në DhNGV.²⁵ Këto elemente përfshijnë:²⁶

- Faktorë individualë–qëndrimet ose besimet e personit që e harron, fal DhNGV-në dhe historia personale e zhvillimit të personit, agjencia, dhe vetë-efikasiteti.^{27,28}
- Faktorë shoqërorë– marrëdhëniet shoqërore të një personi, dinamikat në familje dhe normat e dëmshme shoqërore dhe gjinore.^{29,30}
- Faktorë materialë –varfëria e familjes dhe mungesa e mundësive ekonomike për gratë dhe vajzat.

- Forca strukturore ose faktorë të nivelit makro–kuadri ligjor dhe institucional i dobët ose diskriminues, racizmi, rregullat se kush mund të ketë në pronësi dhe të trashëgojë një pronë dhe ideologjitë për çështjet gjinore³¹ që përshkojnë dallimet gjinore në lidhje me pushtetin dhe statusin shoqëror qëndikon te realitetet në të gjitha nivelet.³²

Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm e identifikon dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe vajzave (DhFDhNGV) si një përparësi themelore për të arritur barazi gjinore dhe zhvillim të qëndrueshëm tek Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ 5).³³ Kjo përfaqëson një përparim të Objektive të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, në të cilat DhNGV nuk trajtohej. Sot, DhFDhNGV pranohet tek OZhQ 5 si një përparësi që përfshihet në shumë OZhQ dhe themelore për arritjen e OZhQ-ve në fushat që përfshijnë zhdukjen e varfërisë, shëndetin, arsimin, qytete të qëndrueshme dhe shoqëri të drejta dhe paqësore.³⁴

Historiku i këtij studimi

Qeveria e Shqipërisë ka ratifikuar një numër konventash dhe traktatesh globale dhe rajonale për çështjet gjinore, përfshirë, por jo kufizuar vetëm tek, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Platforma për Veprim e Pekinit, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW), Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, dhe Konventa e Stambollit. Konventa e Stambollit është një traktat gjithëpërfshirës dhe kompleks që prezanton dispozita të reja dhe të hollësishme për masat që duhet të merren nga Shtetet Palë për të parandaluar DhNGV, për të mbrojtur viktimat dhe ndëshkuar dhunuesit. Që atëhere ajo është zhvilluar në një traktat kyç të të drejtave të njeriut, në një traktat të së drejtës penale dhe në një instrument për barazi më të madhe gjinore dhe karakterizohet nga një qasje e integruar dhe tërësore. Përveç parimeve të Konventës së Stambollit, Rekomandimi (2002)5 i Këshillit të Europës për mbrojtjen e grave prej dhunës është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë.³⁵

Eliminimi i të gjitha formave të DhNGV-së është një fushë me përparësi kryesore për Kombet e

Bashkuara (OKB) në Shqipëri dhe është në përputhje me Programin e Bashkëpunimit (PB) 2017-2021 midis qeverisë shqiptare dhe OKB-së. PB 2017-2021 synon të kontribuojë në zbatimin e normave dhe realizimin e detyrimeve ndërkombëtare në mbështetje të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian (BE)³⁶, përfshirë zbatimin e përgjegjshëm gjinor të Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.³⁷ Në kuadër të PB 2017-2021, rezultatet e barazisë gjinore dhe të GBV-së kanë për qëllim të forcojnë kapacitetet për EVAWG duke përmirësuar mekanizmat, politikat dhe kushtet për zbatimin e legjislacionit mbi DhNGV.

Megjithë përpjekjet e qeverisë shqiptare për përmirësimin e të dhënave për të drejtat e njeriut dhe fuqizimin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut, organet e të drejtave të njeriut vazhdojnë të ngrenë shqetësime mbi shumë çështje gjinore, veçanërisht për pabarazinë gjinore dhe DhNGV. Qëndimet tradicionale patriarkale mbeten sunduese në të gjithë Shqipërinë dhe ndikojnë në pabarazitë gjinore në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe ekonomike³⁸, dhe në shpeshtësinë e DhNGV-së. Në 2017, Shqipëria u rendit në vendin e 52-të mes 189 vendeve në Indeksin e Pabarazisë Gjinore.³⁹

Vrojtimit Kombëtare me Bazë Popullatën në Shqipëri

DhNGV-ja nuk është një fenomen i ri në Shqipëri. Ajo ka rrënjë të thella në shoqërinë shqiptare, në traditat dhe zakonet patriarkale të cilat prej kohësh i kanë dhënë formën Shqipërisë, përfshirë identitetet dhe rolet e ngurta gjinore, autoritetin patriarkal, respektimin e sistemit të nderit dhe turpit dhe zakonet e urdhreve hierarkike brenda familjes si dhe kontrollin midis brezave në familje. Që në 2007, Instituti i Statistikave në Shqipëri ka kryer dy Vrojtime Kombëtare për Dhunën në Familje (VKDhF). Në 2007, me asistencën teknike dhe mbështetjen e UNDP-së dhe UNICEF-it, INSTAT-i ndërmori Vrojtimin e Parë Kombëtar për Dhunën në Familje (VKDhF).⁴⁰ Në 2013, me asistencën teknike të UNDP-së dhe mbështetjen financiare të Agjencisë suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), INSTAT-i ndërmori Vrojtimin e Dytë Kombëtar për Dhunën në Familje.⁴¹



Eliminimi i të gjitha formave të DhNGV-së është një fushë me përparësi kryesore për Kombet e Bashkuara (OKB) në Shqipëri dhe është në përputhje me Programin e Bashkëpunimit (PB) 2017-2021 midis qeverisë shqiptare dhe OKB-së.

Një përmbledhje e të dhënave të VKDhF-së 2007 dhe VKDhF-së 2013 është paraqitur në tabelat 1.1 dhe 1.2. Është e rëndësishme të vihet në dukje se nuk mund të bëhen krahasime mes të dhënave të dy vrojtimeve për tre arsye të rëndësishme: 1) kampioni i grave në VKDhF-në e 2007 përfshinte gra të moshës 15-49 vjeç dhe kampioni i VKDhF-së e vitit 2013 përfshinte gra të moshës 18-55 vjeç; 2) krahasimet duhet të mbështeten tek eksperiencat “aktualisht” të dhunës në familje (në 12 muajt përpara intervistimit) dhe VKDhF 2007 nuk raporton për eksperiencat “aktualisht” të dhunës në familje; dhe, 3) masat për dhunën psikologjike dhe emocionale ishin të ndara tek VKDhF 2007 dhe të kombinuara tek VKDhF 2013.⁴² Pavarësisht faktit se nuk mund të bëhen krahasime, përsëri është e rëndësishme të diskutohen shkurtime të gjetjet e VKDhF-së 2007 dhe VKDhF-së 2013 sepse ato lidhen me përhapjen e dhunës nga ana e partnerit intim (DhPI).

Tabela 1.1 tregon se VKDhF e vitit 2007 konstatoi se 56% e grave të moshës 15-49 vjeç kishin përjetuar një ose

më shumë se një nga katër llojet e dhunës në familje gjatë jetës së tyre. Në mënyrë më konkrete, 50,6% e grave kishin përjetuar dhunë emocionale, 39,1% e grave kishin përjetuar dhunë psikologjike, 31,2% e grave kishin përjetuar dhunë fizike dhe 12,7% e grave kishin përjetuar dhunë seksuale në jetën e tyre.

Tabela 1.1. Përqindja e grave që kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje (VKDhF 2007)

Dhunë në familje (të gjitha llojet)	56%
Dhunë psikologjike	39,1%
Dhunë emocionale	50,6%
Dhunë fizike	31,2%
Dhunë seksuale	12,7%

Burimi: Vrojtimi Kombëtar për Dhunën në Familje i vitit 2007, INSTAT/UNDP.

Tabela 1.2 tregon se VKDhF e vitit 2013 gjeti se 59,4% e grave të moshës 18-55 vjeç kishin përjetuar një ose më shumë nga pesë llojet e dhunës në familje gjatë jetës së tyre dhe 53,7% kishin përjetuar dhunë në familje në 12 muajt e fundit përpara intervistës. Në mënyrë më specifike, 24,6% e grave kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, gjatë jetës së tyre dhe 16,2% kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja në 12 muajt e fundit përpara intervistës.

Tabela 1.2. Përqindja e grave që kishin përjetuar dhunë në familje (VKDhF 2013)

	Ndonjëherë	Aktualisht
Dhuna në familje (të gjitha llojet)	59,4%	53,7%
Sjellje kontrolluese shtrënguese	51,4%	45,4%
Dhunë ekonomike	10,4%	8,6%
Dhunë psikologjike	58,2%	52,8%
Dhunë fizike	23,7%	14,7%
Dhunë seksuale	7,9%	5%
Dhunë fizike dhe/osedhunë seksuale në familje, apo të dyja	24,6%	16,2%

Burimi: Vrojtimi Kombëtar për Dhunën në Familje i vitit 2013, INSTAT/UNDP.

Duke marrë në konsideratë se në VKDhF 2007 dhe VKDhF 2013 u përdorën metoda dhe instrumente të ngjashëm për mbledhjen e të dhënave, krahasimi i gjetjeve tërheq vëmendjen tek disa konsiderata të rëndësishme:

- Përqindja e grave që pësojnë dhunë në familje gjatë jetës së tyre shkon nga 56% deri në 59,4%. Në mënyrë më specifike, eksperiencat e dhunës fizike gjatë jetës shkojnë nga 23,7% deri në 31,2% dhe të dhunës seksuale shkojnë nga 7,9% deri në 12,7%.
- Gratë e intervistuar në 2013 kishin më shumë gjasa të kërkonin dhe raportonin rastet e dhunës në familje tek organet shtetërore përkatëse krahasuar me VKDhF-në e vitit 2007. Megjithatë, vetëm 7% e grave që po përjetonin “aktualisht” dhunë në familje në kohën e realizimit të VKDhF 2013 kërkuan ndihmë.
- Rritja e përqindjes së grave të intervistuar që kërkonin ndihmë për dhunën në familje nga 2007 në 2013 mund të pasqyrojë përmirësimet në legjislacionin për DhNGV-në dhe/ose në institucionet që trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe të DhNGV-së, si edhe rritjen e besimit të publikut tek organet shtetërore përkatëse.
- Nxjerrja e përfundimeve për dhunën seksuale në marrëdhëniet intime me partnerin duhet të jetë e kujdesshme, veçanërisht sepse në Shqipëri dhuna seksuale mbetet tabu dhe nuk raportohet, sidomos në rastet e dhunës seksuale në marrëdhëniet intime me partnerin, përfshirë edhe përdhunimin në martesë.

Nuk janë vetëm bashkëshortët dhe partnerët aktualë dhe/ose të mëparshëm që kryejnë akte të DhNGV-së. VKDhF e vitit 2007 dhe VKDhF e vitit 2013 zbuluan se edhe pjesëtarë të tjerë të familjes, si prindër, vëllezër, motra, kunetër, kunata dhe të afërm të tjerë kanë kryer akte të dhunës fizike kundër grave.

Në vitin 2018, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE) drejtoi një sondazh për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave, që u krye në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Moldavi dhe Ukrainë. Qëllimi i sondazhit të drejtuar nga OSBE ishte të siguronte të dhëna të krahasueshme mbi format e ndryshme të dhunës që gratë pësojnë në fëmijëri dhe gjatë të gjithë jetës së tyre. Studimi analizoi dhunën që përjetojnë gratë në situata konflikti dhe jo-konflikti si edhe ndikimin

që ka dhuna tek gratë. Në sondazh kishte pyetje mbi normat dhe qëndrimet shoqërore në lidhje me DhNG për të kuptuar më mirë shkaqet kryesore të dhunës. Sondazhi i drejtuar nga OSBE përdori një metodologji të ndryshme dhe instrumente të ndryshëm për grumbullimin e të dhënave krahasuar me VKDhF-në dhe u ndërmor me qëllim që të siguronte të dhëna specifike dhetë krahasueshme për vendin, mbi format e ndryshme të dhunës që gratë përjetojnë në fëmijërinë e tyre dhe gjatë gjithë jetës së tyre. Po ashtu, studimi analizoi ndikimin që ka dhuna tek një grua, përfshirë pasojat afatgjata dhe normat dhe qëndrimet e lidhura me dhunën ndaj grave për të kuptuar më mirë shkaqet themelore të dhunës.⁴³

Gjetjet e sondazhit të drejtuar nga OSBE për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave zbuluan se 19% e grave të intervistuar të moshës 18-74 vjeç kishin pësuar dhunë nga partneri intim që në moshën 15 vjeçare, 4% kishin përjetuar dhunë seksuale dhe 19% dhunë fizike dhe/ose seksuale që në moshën 15 vjeçare. Përveç kësaj, 11% e grave të intervistuar kishin përjetuar dhunë fizike nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare, 1% kishin pësuar dhunë seksuale, dhe 11% dhunë fizike dhe/ose seksuale që në moshën 15 vjeçare. Në 12 muajt përpara sondazhit, 7,2% e grave të intervistuar të moshës 18-74 vjeç kishin pësuar dhunë fizike dhe / ose seksuale nga partneri intim dhe 2,5% kishin pësuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri. Në mënyrë më specifike, 50% e grave përjetonin sjellje të kontrolluara, 41% pësonin sjellje abuzive, 22% përjetonin dhunë ekonomike dhe 11% raportuan se dhunuesit e tyre përdornin fëmijët e tyre për t'i shantazhuar ato ose abuzonin me fëmijët e tyre. Sondazhi i drejtuar nga OSBE zbuloi gjithashtu se 13% e grave kishin përjetuar përndjekje që në moshën 15 vjeçare dhe 4,3% kishin përjetuar përndjekje në 12 muajt përpara zhillimit të anketimit. Po ashtu, studimi tregoi se 34% e grave kishin pësuar ngacmim seksual që në moshën 15 vjeçare dhe 17,2% kishin pësuar ngacmim seksual në 12 muajt përpara zhillimit të anketimit.⁴⁴

Në Shqipëri, dhuna në familje është një problem që ndikon negativisht tek gratë dhe fëmijët. Fëmijët janë shpesh viktimë të harruara të dhunës në familje, megjithëse ata janë shpesh dëshmitarë të akteve të dhunës në familje ose e kuptojnëse po ndodh një gjë e tillë e pse dëgjojnë britmat dhe grindjet, shohin

lëndimet dhe dëmet në orëdi. Studimet kanë treguar se fëmijët që rriten në familje të dhunshme janë shpesh viktimë të drejtpërdrejta dhe/ose të tërthorta të dhunës në familje dhe janë më të rrezikuar nga dhuna ndaj fëmijëve dhe lënia pas dore. VKDhF i vitit 2007 zbuloi se 53,3% e fëmijëve që ishin keqtrajtuar fizikisht thanë se kishin kërkuar ndihmë nga dikush në përpjekje për ta ndaluar keqtrajtuesin e tyre. Shumica e fëmijëve kishin kërkuar ndihmë nga një anëtar i familjes; shumë rrallë ndodhte që fëmija t'i kishte treguar dikujt jashtë familjes së ngushtë për keqtrajtimin ose dhunën. Në VKDhF-në e 2013, 86,4% e grave që kishin pësuar dhunë në familje raportuan se fëmijët e tyre kishin parë dhunë në familje dhe 19,2% thanë se fëmijët e tyre ishin lënduar ose vrrarë nga dhuna në familje. Përveç kësaj, 42,8% e grave thanë se dhuna në familje shkaktonte probleme të të nxëniet të fëmijët e tyre dhe 5,5% thanë se fëmijët u larguan nga shtëpia për të jetuar me të afërmit për shkak të dhunës në familje.

Megjithëse dhuna në familje është një problem që ndikon negativisht tek individët, familjet dhe komunitetet, shumë shqiptarë tentojnë ta konsiderojnë dhunën në familje si një problem privat, çështje familjare dhe pjesë të zakonshme të martesës dhe jetës familjare. Meqënëse dhuna në familje shpesh ndodh pas dyerve të mbyllura dhe nuk diskutohet, pranohet ose adresohet hapur në shoqërinë shqiptare, viktimat vuajnë zakonisht në heshtje.^{45,46}

Ndryshimet në legjislacion dhe në politika dhe zhvillimi i programit që prej VKDhF-së të vitit 2013

Kjo pjesë paraqet një pasqyrë të shkurtër të ndryshimeve në legjislacion dhe në politikatë zhvillimit të programit/projektit për DhFDhNGVqë janë zhvilluar, zbatuar dhe dokumentuar në Shqipëri që prej VKDhF të vitit 2013. Kuptimi i këtyre reformave dhe zhvillimeve mund të ndihmojnë për të shpjeguar ndryshimet në përhapjen e dhunës nga VKDhF 2013 deri në këtë *Vrojtim Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave të vitit 2018 (VKDhNGV)*. Kjo pasqyrë nuk ka qëllim të jetë një rishqyrtim i plotë historik ose analizë e situatës së nismave të DhFDhNGV-së në Shqipëri ose në rang global.

Ndryshimi i legjislacionit dhe i politikave që prej VKDhF-së të vitit 2013

Në vitin 2017, *Raporti i parë i GREVIO-s për Vlerësimin e masave legjislative dhe masave të tjeranë zbatim të dispozitave të Konventës së Këshillit të Europës mbi Parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) për Shqipërinë*⁴⁷ u përgatit nga Grupi i Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO).⁴⁸ Raporti i vlerësimit i GREVIO-s ofroi një udhërrëfyes githëpërfshirës për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare që lidhen me DhNGV.⁴⁹ Në përgjigje të Raportit të Vlerësimit të GREVIO-s dhe në përputhje me rekomandimet e organeve ndërkombëtare, Parlamenti votoi unanimisht një rezolutë⁵⁰ që dënon DhNGV-në dhe u bën thirrje autoriteteve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor të ndërmarrin veprime konkrete për të zbatuar në mënyrë efikase legjislacionin për parandalimin dhe eliminimin e DhNGV-së. Zhvillimet e fundit dhe nevojat aktuale në këtë fushë kërkonin përpjekje intensive për zbatimin e kuadrit ligjor dhe të politikave për DhNGV-në.

Në përmbushje të detyrimeve të Konventës së Stambollit dhe në vijim të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit të GREVIO-s, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS), me mbështetjen e UNDP-së Shqipëri, udhëhoqi procesin e përmirësimit të Ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” të vitit 2006, që u ndryshua së fundi në 2010.^{51,52} Për më shumë se një dekadë, ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ofroi masa mbrojtëse kundër dhunës në familje, përfshirë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes (një urdhër i lëshuar përkohësisht me vendim gjykatë që është i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykatë) dhe urdhrin e mbrojtjes të dhënë nga gjykata (një urdhër i lëshuar me vendim gjykatë që siguron masa mbrojtëse për viktimat). Sipas ligjit, kur një kërkesë për urdhër mbrojtje paraqitet nga policia apo prokuroria në gjykatë, edhe nëse viktimë (nën presion) dëshiron ta tërheqë padinë ose ta ndërpresë procedimin penal, kjo nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar sepse gruaja e keqtrajtuar përkufizohet si “dëshmitare e detyrueshme” në krim.⁵³ Sipas nenit 321 të Kodit Penal, shkelja e urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet. Dhënia e urdhrit të mbrojtjes ose e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procesin penal, përsa u përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale.⁵⁴

Në vitin 2018, ndryshimet në Ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” përmirësuan përkufizimin ligjor të dhunës në familje në përputhje me Konventën e Stambollit dhe CEDAW. Ndryshimet përfshinë edhe: mbrojtje më të mirë për gratë dhe fëmijët në situata të rrezikut të menjëhershëm përmes urdhrit të policisë për masa paraprake të mbrojtjes së menjëhershme; përgjegjësi të përcaktuara më mirë të institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësi ligjore ndaj personave vulnerabël, përfshirë personat me aftësi të kufizuara; përmirësimi i procedurave të sistemit gjyqësor dhe krijimi i qendrave të menaxhimit të krizës në shërbimin e urgjencës së spitalit për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale.^{55,56} Ligji i rishikuar e shtrin mbrojtjen edhe për viktimat e IPV të cilat jo domosdoshmërisht bashkëjetojnë, por janë të përfshira në marrëdhënie fizike dhe/ose emocionale me dhunuesit e tyre.

Në vitin 2018, MShMS-ja ngriti një grup pune të përbërë nga specialistë të çështjeve ligjore, sociale, gjinore dhe shëndetësore me pjesëmarrjen e ministrive përkatëse, të tilla si Ministria e Brendshme (MB), Ministria e Drejtësisë (MD), Policia e Shtetit dhe Mekanizmi i Kombëtar i Referimit (MKR). Grupi i punës, me mbështetjen e UNDP-së Shqipëri, përgatiti një model dhe standardet për një qendër të referimit të dhunës seksuale, quajtur “Qendra Liliu”. Nxitur nga nevoja për ofrimin e shërbimeve të specializuara për viktimat e dhunës seksuale, MShMS nën mori veprim të menjëhershëm për alokimin e burimeve për ngritjen e “Qendrës Liliu”, e para e këtij lloji në Shqipëri për t’u ofruar shërbimetë mbijetuarve nga dhuna seksuale gjatë 72 orëve të para, pavarësisht gjinisë, moshës, identitetit seksual dhe/ose orientimit seksual.⁵⁷

Përveç ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ekzistojnë gjithashtu dispozita që trajtojnë veprat penale që lidhen me dhunën në familje. Këto dispozitat penale përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë përmban një sërë nenesh lidhur me dhunën në familje ndaj bashkëshortit dhe fëmijës/fëmijëve. Ai **trajton detyrimet prindërore dhe të drejtat e fëmijëve në jetën familjare**, si edhe keqtrajtimin dhe lënien pas dore të fëmijëve.

- Neni 102 – Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura përfshin marrëdhënie seksuale midis bashkëshortëve/bashkëjetuesve pa pëlqimin e njërit prej tyre.
- Neni 106 – Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari përfshin kryerjen e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë në gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit.
- Neni 130/a – Përfshin akte të tilla si rrahja ose çdo vepër tjetër dhune, kanosje serioze ose plagosje e rëndë ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ishbashkëjetues, partner ose ishpartner, fëmijë ose pjesëtar familjeje, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij.
- Neni 121/a – Përndjekja, kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkakuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, sigurinë e një të afërmi ose sigurinë e një personi me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës.
- Neni 124 – Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga pjesëtarët e familjes ose kujdestari ligjor, përfshirë braktisjen e fëmijëve të mitur.

- Neni 125 – Mosdhënia e mjeteve për jetesë, përfshirë mos dhënien e mjeteve të nevojshme për jetesën e fëmijëve, të prindërve ose të bashkëshortit nga personi që në zbatim të një vendimi gjyqësor duhet ta japë, përbën kundërvajtje penale.

Me ndryshimet e bëra në Kodin Penal në vitet 2012/2013 u shtuan rrethanat rënduese kur veprat penale kryhen:

- a. në kundërshtim me urdhrat e mbrojtjes;
- b. duke përfituar nga marrëdhëniet familjare;
- c. të shtyra nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, identitetin gjinor dhe/ose preferencën seksuale.

Po ashtu, Kodi Penal u ndryshua duke pranuar “kanosjen” ose “veprimet e përsëritura” me qëllimin për t'i shkakuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, sigurinë e një të afërmi ose sigurinë e një personi me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e jetesës. Për vepra të tjera penale, si vrasja, vrasje të thjeshtë me pa paramendim, plagosje të rënda dhe të lehta parashikohen dënime më të rënda kur veprat penale janë kryer kundër një partneri, bashkëshorti apo pjesëtar të familjes.

Megjithë dispozitat ligjore për ndjekjen penale dhe dënimin e ushtruesve të dhunës në familje, në Shqipëri ka një prirje të përhapur gjerësisht të “negociohet” ose “ndërmjetësohet” për rastet e dhunës në familje. Problemi për përdorimin e ndërmjetësimi në rastet e dhunës në familje është se ndërmjetësimi mbështetet tek parimi i barazisë së palëve, por në rastet e dhunës në familje dhe dhunës nga partneri intim nuk ka barazi të

palëve sepse marrëdhënia nuk është as e balancuar, as e drejtë, dhe dhuna bazohet tek modelet e dominimit dhe kontrollit dhe varësinë e viktimës nga dhunuesi.⁵⁸ *Krijimi i Hartës së shërbimeve mbështetëse për DhNGV-në në Shqipëri* e vitit 2015 zbuloi se përpjekjet e ofruesve të shërbimit për të punuar me autorin e dhunës në familje, veçanërisht përmes këshillimit dhe ndërmjetësimit në familje, ndonjëherë fillohen me kërkesë të gjykatave. Por, puna me autorët e dhunës në familje është filluar gjithashtu edhe me kërkesën e të mbijetuarave të dhunës në familje. Një vlerësim i pogramëve të tilla pilot konstatoi se modelet e përdorura për të punuar me autorët e dhunës në familje duhet të përmirësohen dhe të konsolidohen dhe të zbatohen në të gjitha bashkitë e vendit.⁵⁹

Kodi Penal përmban një numër nenesh që trajtojnë krimet seksuale, përfshirë marrëdhënien seksuale me dhunë dhe përdhunimin. Këto janë: neni 100, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur; neni 101, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç; neni 102, Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura; neni 103, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur; neni 104, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës; neni 105, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën; neni 106, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari; neni 107, Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike, neni 107/a, Dhuna seksuale; neni 108, Vepra të turpshme; dhe, neni 108/a, Ngacmimi seksual.

Po kështu, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë përmban një sërë nenesh lidhur me dhunën në familje ndaj bashkëshortit dhe fëmijës/fëmijëve. Kodi i Familjes trajton detyrimet prindërore dhe të drejtat e fëmijëve në jetën familjare, si edhe keqtrajtimin dhe lënien pas dore të fëmijëve. Për shembull, neni 62 parashikon se “bashkëshorti dhunues mund të nxirret jashtë nga banesa bashkëshortore”. Po ashtu, Ligji “Për shëndetin riprodhues” parashikon që çdo grua mund të vendosë me vullnetin e saj të lirë dhe pa asnjë formë diskriminimi, presioni ose dhune, për të gjitha çështjet që lidhen me seksualitetin dhe me shëndetin e saj seksual dhe riprodhues.⁶⁰

Të mbijetuarat e DhNGV-së kanë të drejtë të përfitojnë nga sistemi i ri i ndihmës ligjore falas dhe masat mbrojtëse të shtuara për viktimat e krimit, në sajë të Ligjit të ri “Për ndihmë juridike falas” dhe ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Penale (korrik 2017).⁶¹ Përveç këtyre, është duke u përgatitur kuadri rregullator që ka për qëllim të përcaktojë standardet e shërbimeve të ofruara nga njësitë bashkiake për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, përfshirë të mbijetuarat e ngacmimit seksual dhe dhunës seksuale. Megjithatë, ka ende boshllëqe në legjislacionin, përfshirë mungesën e urdhrave të mbrojtjes dhe të masave të tjera mbrojtëse për viktimat e formave të tjera të dhunës, përveç dhunës në familje, duke përfshirë këtu edhe dhunën seksuale.⁶²

Pavarësisht prej ndryshimeve të fundit në legjislacionin dhe në politika për DhNGV-në, qeveria e Shqipërisë duhet të vërë përparësi zbatimin e legjislacionit dhe politikave të miratuara mbi DhNGV-në dhe të forcojë kapacitetet në sistemin gjyqësor që të bëhet i mundur zbatimi i kuadrit ligjor dhe i politikave që lidhen me DhNGV dhe dhunën në familje. Po ashtu, duhet të bëhet më shumë punë që legjislacioni për DhNGV-në të jetë në pajtim të plotë me Konventën e Stambollit. Kjo përfshin rishikimin e nevojshëm të përkufizimit të përdhunimit dhe garantimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese për viktimat e të gjitha formave të dhunës seksuale.⁶³ Përveç kësaj, qeveria shqiptare duhet të marrë masa për të nxitur gratë dhe vajzat të raportojnë rastet e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore që ato përjetojnë përmes ofrimit të ndihmës juridike falas dhe zbatimit të plotë të vendimeve gjyqësore që lidhen me masat mbrojtëse për të mbijetuarat e DhNGV-së. Gjithashtu, qeveria shqiptare duhet të sigurojë fondet e duhura dhe trajnimin e nevojshëm të avokatëve për të siguruar ndihmë juridike efikase falas për të mbijetuarat e DhNGV-së, si edhe, njohjen, mbështetjen dhe promovimin e punës së OJF-ve të specializuara në ofrimin e ndihmës juridike për të mbijetuarat e DhNGV-së.⁶⁴

Forcimi i të dhënave administrative për DhNGV-në që prej VKDhF-së të vitit 2013

Në vitet e fundit, është rritur interesi i qeverisë së Shqipërisë dhe partnerëve për zhvillim për forcimin e të dhënave administrative për monitorimin dhe raportimin për DhNGV-në. Në vijimësi, mbledhja e të dhënave administrative është institucionalizuar përmes krijimit të sistemit “Regjistrimi i dhunës në Shqipëri” (REVALB), një sistem kombëtar on-line gjurmimi që përdoret nga Koordinatorët e Dhunës në Familje pranë çdo njësie të qeverisjes vendore, dhe që administrohet në nivel qendror nga MShMS (më parë menaxhohej nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR). Megjithatë ka vështirësi kur vjen puna për përdorimin sistematik të sistemit REVALB dhe për garantimin e bashkërendimit midis anëtarëve të mekanizmit të referimit në gjurmimin dhe menaxhimin e rastit.⁶⁵

Fuqizimi i të dhënave administrative për DhNGV-në është një investim i rëndësishëm dhe i dobishëm sepse të dhënat administrative mund të përdoren për qëllime të shumta. Shumë institucione dhe organizata mbledhin automatikisht dhe rregullisht të dhëna administrative për DhNGV-nënë pikat hyrëse (në kuptimin që pika në të cilën gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë marrin shërbime, mbrojtje dhe/ose drejtësi), dhe rregullisht i përpunojnë këto të dhëna në nivel qyteti, nënprefekturë, prefekturë dhe nivel kombëtar. Të dhënat administrative janë të ndryshme nga të dhënat e sondazhit për shtrirjen që mbledhen periodikisht (një herë në disa vite) dhe shpesh vetëm në një kohë të caktuar. Një nga pikat e forta të të dhënave administrative është se ato sjellin informacion për të gjitha ata që marrin shërbime në kuadër të DhNGV-së, përfshirë gra dhe vajza nga popullata që është e vështirë t'i kontaktosh, të tillë si grupe të marginalizuara (p.sh., persona të zhvendosur, dhe pakica kulturore, fetare dhe etnike ose raciale) eksperiencat e të cilave ndoshta nuk janë pasqyruar plotësisht në vërtetimet për shtrirjen e DhNGV-së. Megjithatë, kjo është e vërtetë vetëm në masën që gratë dhe vajzat e grupeve të marginalizuara kanë mundësi të marrin shërbimet themelore për DhNGV-në.


Në shumicën e rasteve, të dhënat administrative janë mbledhur dhe përdorur për qëllime të brendshme, por

jo domosdoshmërisht janë përpunuar dhe raportuar jashtë agjencisë apo organizatës. Zakonisht, qëllimi kryesor i të dhënave administrative nuk është të studiohet DhNGV-ja, por të sigurohet informacion për menaxhimin e rastit dhe për qëllime administrative (të tilla si ngarkesa e punës, logjistika, buxheti dhe raportimi). Shpesh, të dhënat administrative nuk përgatiten ose nuk shkëmbehen ndërmjet sektorëve ose nuk analizohen nga këndvështrimi i DhNGV-së ose as nuk përdoren për të përmirësuar ofrimin e shërbimit për të mbijetuarat e DhNGV-së. Trajtimi i këtyre të dhënave për qëllimet e DhNGV-së nënkupton mbledhjen, sistemimin, shpërndarjen, analizën dhe përdorimin e të dhënave duke u udhëhequr nga njohuri dhe konceptet e përdorura në teoritë dhe literaturën për DhNGV-në. Qëllimi i kësaj pune është përdorimi i të dhënave për të kuptuar më mirë DhNGV-në, për t'i bazuar qasjet në fakte, për të parandaluar dhe reaguuar ndaj DhNGV-së, përfshirë këtu edhe përmirësimin e cilësisë dhe ekzistencën e shërbimeve ndaj të mbijetuarave të DhNGV-së.

Të dhënat administrative për DhNGV-në janë të dobishme sepse mund të ndihmojnë ofruesit e shërbimeve dhe agjencitë e drejtësisë dhe politikëbërësit dhe vendimmarrësit të kuptojnë numrin e rasteve të DhNGV-së të raportuara dhe për të cilat është reaguuar, numrin e të mbijetuarave të DhNGV-së që marrin shërbime në pikat e hyrjes, cilat janë shërbimet që marrin, si iu përgjigjen këto shërbime nevojave të të mbijetuarave të DhNGV-së brenda një periudhe të caktuar kohe dhe në nënprefekturat dhe prefekturat. Po ashtu, të dhënat administrative mund të përdoren për të identifikuar se çfarë shërbimesh kërkojnë gratë, sa shpesh dhe për cilat qëllime, rezultatet e shërbimeve si edhe referimet e bëra nga ofruesit e shërbimeve. Në nivel praktik, të dhënat administrative mund të përdoren për të bërë planifikimin e programit dhe alokimin e burimeve meqënëse të dhënat mund të pasqyrojnë përdorimin e shërbimeve dhe aksesin në drejtësi.

Është e rëndësishme që kur diskutohet për të dhënat administrative për DhNGV-në të kuptohet mungesa e raportimit të plotë të të gjitha rasteve të DhNGV-së. Të dhënat administrative për DhNGV-në mbështeten kryesisht tek raportimi i vetë të mbijetuarave të DhNGV-së, megjithatë shumica e

Grafiku 1.1. Rastet e regjistruara të dhunës në familje nga Policia e Shtetit (2010-2018)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, janar 2019


grave nuk janë të gatshme të raportojnë përvojat e tyre me dhunën. Gratë nuk janë të gatshme të raportojnë tek autoritetet përvojat e tyre me dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore për një numër arësyesh, duke përfshirë:

- Mungesën e besimit dhe/ose frikën nga hakmarrja
- Frikën se do të kritikohet që ka folur me zë të lartë sepse nuk duan të “nxirren në publik çështjet private”, iu sjell turp familjes së tyre
- Kërcënimin e shumë grave dhe vajzave me më shumë dhunë, bile edhe me vdekje nëse japin mendimin e tyre ose iu tregojnë autoriteteve për personin që kryen dhunën
- Mungesën e dëshirës për të zbuluar identitetet e tyre për të ruajtur reputacionin nga ana e autorëve të DhNGV-së që mund të kenë pozicione të ndryshme në komunitet, gjë që i shtyn ata të bëjnë kërcënime të besueshme për t'u mbyllur gojën grave me të cilat kanë abuzuar
- Mostrajtimin me respekt ose trajtimin me armiqësi të grave dhe vajzave që raportojnë dhunën, që çon një mesazhin e fortë të thyerjes së heshtjes për gratë dhe vajzat e tjera për pasojat e thyerjes së heshtjes
- Varësinë ekonomike që i pengon gratë të raportojnë dhe t'i shpëtojnë dhunës në familje dhe DhPI-së
- Besimin se dhuna që përjetojnë nuk është e rëndë

Kur gratë nuk i raportojnë eksperiencat e tyre të DhNGV-së tek shërbimet apo autoritetet zyrtare, përvojat e tyre nuk pasqyrohen në të dhënat administrative për DhNGV-në (shihni Kapitujt 6 dhe 7 për arsyet që gratë nuk kërkojnë ndihmë për dhunën në familje dhe/ose dhunën në marrëdhënie dashurore). Po ashtu, disa punonjës të policisë nuk i regjistrojnë gjithmonë rastet e DhNGV-së, veçanërisht rastet e dhunës në familje. Policia mund edhe t'i dekurajojë gratë në mënyrë që ato të mos denoncojnë duke fajësuar të mbijetuarat e DhNGV-së ose mund t'i inkurajojë ato të kthehen dhe të pajtohen me bashkëshortët dhe familjen. Në Shqipëri po bëhen përpjekje për të përmirësuar reagimin e punonjësve të shëndetësisë, ofruesve të shërbimit, punonjësve të policisë dhe të drejtësisë ndaj DhNGV-së. Ndërkohë, mbetet ende një sfidë të garantohet që rastet e denoncuar të DhNGV-së të regjistrohen si duhet.⁶⁶

Grafiku 1.1 tregon numrin e rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga policia çdo vit që nga 2010 deri në 2018 (1 janar–31 dhjetor). Mbani

Grafiku 1.2. Rastet e regjistruara të dhunës në familje sipas nenit 130/a të Kodit Penal nga Policia e Shtetit (2013-2018)




Burimi: INSTAT, janar 2019

parasysh se shumica e rasteve të dhunës në familje nuk raportohen dhe rastet që shpesh raportohen janë rastet më të rënda të dhunës në familje. Tendencia që shihet tek grafiku 1.1 zbulon rritjen e vazhdueshme të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës në familje nga 1.998 raste në vitin 2010 deri në 4.951 raste në vitin 2018. Çdo vit që nga 2010 deri në 2018, ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të rasteve të dhunës në familje të regjistruara, përveç në vitin 2015 kur kishte një zbritje të lehtë, e ndjekur me rritje në 2016. Gjatë tre viteve të fundit (2016-2018), ka pasur një rritje të vazhdueshme me 9% çdo vit të numrit të rasteve të regjistruara të dhunës në familje. Këto të dhëna janë të rëndësishme sepse zbulojnë se viktime dhunës në familje kanë më

shumë vullnet të denoncojnë në polici rastet e dhunës në familje dhe se policia po regjistron më shumë raste të dhunës në familje. Këto ndryshime mund të lidhen me reformat që janë ndërmarrë gjatë dekadës së fundit për zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” të vitit 2006”.


Grafiku 1.2 paraqet numrin e rasteve të dhunës në familje të raportuara dhe regjistruara në përputhje me nenin 130/a të Kodit Penal, që përfshin akte të tilla si rrahja, ose një vepër tjetër dhune, kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish bashkëjetues, fëmijë ose pjesëtarë të familjes

Grafiku 1.3. Kërkesat për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra të mbrojtjes (2010-2018)




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, janar 2019

Grafiku 1.4. Procedimi penal i rasteve të dhunës në familje sipas nenit 130/a të Kodit Penal (2013-2018)



Burimi: INSTAT, janar 2019

Grafiku 1.5. Autorët e dhunës në familje të dënuar sipas nenit 130/a të Kodit Penal (2013-2017)



Burimi: Ministria e Drejtësisë, janar 2019


me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të personit. Të dhënat tregojnë se kishte një rritje prej 45,3% të numrit të rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga policia sipas nenit 130/a nga 1.169 raste në 2013 në 1.699 raste në 2014, ndjekur me një rënie prej 23,5% në 1.300 raste në 2015, pastaj një rritje prej 14,5% në 1.488 raste në 2016, ndjekur përsëri me një rënie prej 5,1% në 1.412 raste në 2017.

Grafiku 1.3 tregon numrin e kërkesave për urdhër të menjëhershëm mbrojtje/urdhra të mbrojtjes të bëra çdo vit nga viti 2010 deri në 2018 (1 janar–31 dhjetor). Tendenda që shihet tek grafiku 1.3 tregon rritjen e vazhdueshme të numrit të kërkesave për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra të mbrojtjes nga 2010 deri në 2018; në veçanti, kishte një rritje prej 146% të numrit të kërkesave për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra të mbrojtjes nga 1.234 kërkesa në 2010 në 3.037 kërkesa në 2018. Çdo vit nga 2010 deri në 2018, kishte një rritje të vazhdueshme të numrit të kërkesave për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra të mbrojtjes, përveç vitit 2015 kur kishte një rënie të lehtë, ndjekur me një rritje në 2016. Grafiku 1.3 tregon se kërkesat për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhra të mbrojtjes ishin bërë për më shumë se 50% të rasteve të regjistruara të dhunës

në familje çdo vit (shihni Grafikon 1.1). Në fakt, në 2018, urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes/urdhra të mbrojtjes u dhanë në 61,3% të rasteve të regjistruara të dhunës në familje (nga 57% në 2017, dhe 53% në 2016). Këto të dhëna janë të rëndësishme sepse zbulojnë se viktime të dhunës në familje kanë më shumë vullnet të përdorin dispozitat për mbrojtje që parashikohen në ligjin “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” të vitit 2006”.

Grafiku 1.4 zbulon numrin e rasteve të dhunës në familje të akuzuar dhe ndjekur penalisht sipas nenit 130/a të Kodit Penal. Të dhënat tregojnë se kishte një rritje me 47,1% të numrit të rasteve të dhunës në familje të regjistruara për procedim penal nga prokuroria, nga 826 raste në 2013 në 1.215 raste në 2014, ndjekur me një rritje prej 12,4% nga 1.206 raste në 2015 në 1.355 raste në 2016, pastaj një rënie në 1.310 raste në 2017 dhe 1.209 raste në 2018 (10,8% rënie). Edhe më pak raste të dhunës në familje u dërguan për gjykim nga gjykatat. Megjithatë, kishte një rritje në vazhdim prej 96,4% të numrit të rasteve të dhunës në familje të dërguara për gjykim nga gjykatat, nga 589 raste në 2013 në 1.157 raste në 2016, ndjekur me një rënie në vazhdim prej 13% në 1.007 raste në 2018. Nuk është e qartë se çfarë ka çuar në këtë rënie të madhe të

Grafiku 1.6. Gjinia e personave të dënuar për dhunë në familje, sipas nenit 130/a (2013-2017)



Burimi: Ministria e Drejtësisë, janar 2019

numrit të rasteve të dhunës në familje të akuzuar dhe ndjekur penalisht sipas nenit 130/a të Kodit Penal gjatë periudhës dy vjeçare 2016 deri në 2018.

Është e dukshme se sistemi i drejtësisë penale nuk i mban autorët e dhunës në familje në institucionet e paraburgimit gjatë kohës që presin për të dalë përpara gjykatës dhe për të marrë vendimin e saj. Në vitin 2016, u ndaluan në këto institucione 196 autorë të dhunës në familje, ndjekur me 241 në 2017 dhe 2018 (23% rritje).

Grafiku 1.5 tregon numrin e autorëve të dhunës në familje të dënuar sipas nenit 130/a të Kodit Penal. Numri i personave të dënuar për dhunë në familje ishte 821 në 2015 dhe 885 në 2016 (+7,5% rritje), ndjekur me një zvogëlim 16,4% në 2017 deri 740 persona të dënuar për dhunë në familje sipas nenit 130/a. Është e dukshme se numri i personave të mbajtur në institucionet korrigjuese për veprën penale të dhunës në familje ishte shumë më i vogël sesa numri i personave të dënuar, por kishte një rritje me 31,8%, nga 286 raste në 2016 dhe 377 në 2017. Numri i personave që janë në burg për dhunë në familje është shumë më i vogël sesa i atyre të dënuar për këtë veprë penale (shihni tabelën 1.2). Nuk ka të dhëna për numrin e atyre që

Tabela 1.2. Të dënuarit me burgim sipas nenit 130/a (2016-2018)

Viti	Numri	% e ndryshimit
2016	90	
2017	136	+51,1%
2018	97	-28,7%

vuajnë dënimin në burg për dhunë në familje sipas nenit 130/a për vitet 2013 deri 2015.

Grafiku 1.6 tregon numrin e meshkujve dhe femrave të dënuara për dhunë në familje sipas nenit 130/a të Kodit Penal. Të dhënat tregojnë se ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të grave të dënuara për dhunë në familje sipas nenit 130/a, nga 1 rast në vitin 2013 në 76 raste në vitin 2017. Po ashtu, kishte një rritje të vazhdueshme të numrit të burrave të dënuar për dhunë në familje nga viti 2012 në vitin 2016, ndjekur me një rënie prej 15,6%, nga 787 raste në 2015 në 664 raste në 2017. Në vitin 2013, gratë përbënin vetëm 0,4% të personave të dënuar për raste të dhunës në familje sipas nenit 130/a; megjithatë, në vitin 2017, gratë përbënin 10,3% të personave të dënuar për dhunë në familje sipas nenit 130/a. Këto të dhëna janë të rëndësishme sepse pasqyrojnë një rritje të madhe të numrit të grave të dënuara për dhunë në familje sipas nenit 130/a, krahasuar me një rënie të dukshme të numrit të burrave të dënuar për dhunë në familje. Këto të dhëna janë shqetësuese sepse mund të pasqyrojnë rritje në numrin e arrestimeve të dyfishta në situatat e dhunës në familje. Arrestimi i dyfishtë i referohet praktikës së arrestimit njëkohësisht të të dyja palëve – viktimas dhe dhunuesit – për të njëjtin rast të dhunës në familje. Arrestimet e dyfishta ka shumë gjasa të ndodhin kur policia nuk mund të vendosë ose zgjedh të mos vendosë se cili është agresori kryesor/dominant në një rast të dhunës në familje. Agresori dominant është personi i cili përcakton kërcënimin më serioz për sigurinë dhe mirëqënien dhe i cili kontrollon dhe dominon personin tjetër. Nëse agresori dominant nuk përcaktohet siç duhet mund të ketë pasoja të rënda ligjore për viktimën. Të dhënat nga gjykatat tregojnë një tendencë për të dënuar një grua nëse ka qenë një viktimë e një arrestimi të dyfishtë ose e dënuar për vetmbrojtje nga bashkëshorti/partneri që ka abuzuar me të ose ndonjë anëtar tjetër i familjes, ose në raste të rralla kur ato kanë qenë agresori kryesor.

Grafiku 1.7 tregon përqindjen e burrave dhe grave të ndjekur penalisht për vepra penale të parashikuara në nenin 130/a të Kodit Penal si persona të dyshuar dhe të pandehur për dhunë në familje, si edhe të atyre kundërvajtësve të dënuar për dhunë në familje në vitin 2017. Po ashtu, grafiku pasqyron edhe përqindjen e viktimave të dhunës në familje sipas nenit 130/a të Kodit Penal në vitin 2017. Ajo që bie më shumë në sy është se 90% e personave të dyshuar ishin meshkuj, 93,5% e të pandehurve ishin meshkuj, dhe 88,7% e personave të dënuar për dhunë në familje ishin meshkuj. 71,6% e viktimave të dhunës në familje sipas nenit 130/a të Kodit Penal ishin femra, 2,4% ishin meshkuj. Kini kujdes, nuk ishin gjithmonë femrat autoret e dhunës në familje ndaj burrave, autorët ishin më shpesh pjesëtarë meshkuj të familjes duke pasur parasysh faktin se përqindja e grave që ishin persona të dyshuar dhe të pandehur ishte më pak se 10%.

Përmirësimet në ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat e DhNGV-së që prej VKDhF-së të vitit 2013


Ofrimi i shërbimeve themelore për të mbijetuarat e DhNGV-së mbetet një sfidë e madhe në Shqipëri. Në të gjithë vendin, të mbijetuarat e DhNGV-së ende nuk kanë mundësi të marrin shërbimet më të thjeshta, bazike dhe themelore për sigurinë dhe mbrojtjen e tyre. Shumica e shërbimeve ofrohen vetëm në qytetet më të mëdha, të tilla si Tirana. Edhe kur ekzistojnë shërbimet themelore, shpesh nuk ka fonde dhe

personel të mjaftueshëm. Raporti i vitit 2015 “Shqipëria - Raporti përfundimtar: Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave” arriti në përfundimin:^{67,68}

“[...] shërbime të tjera plotësuese duhet të krijohen dhe shtrihen në të gjithë vendin. Minimalisht, situata gjatë krizës dhe nevojat e menjëhershme të grave dhe vajzave duhet të plotësohen përmes linjës telefonike kombëtare falas, ndërhyrjes së menjëhershme për sigurinë dhe mbrojtjen e tyre, strehimit të sigurt për to dhe fëmijët e tyre, këshillimin dhe mbështetjen psiko-sociale, kujdesit pas përdhunimit dhe ndihmës juridike falas për t'i ndihmuar ato të kuptojnë të drejtat dhe mundësitë e tyre”.

Në vitet e fundit, mekanizmi i MKR-së është ngritur në 39 nga 61 bashkitë në Shqipëri. Shërbimet për të mbijetuarat e dhunës në familje përfshijnë edhe nisma afatshkurtra (p.sh. mbrojtje në krizë, siguri, ndihmë mjekësore, strehim, transport në akomodim të sigurt, informacion për/ndihmë për marrjen e urdhrave të mbrojtjes, referimin në shërbime të mëtejshme, dhe më shumë), edhe nisma afatgjata (p.sh., mes të tjerave mbështetje për punësim, asistencë sociale, akomodim, këshillim dhe ndihmë juridike për procedurat e divorcit, këshillim dhe psiko-terapi, dhe ndihmë për fëmijët). Në vitin 2015, vlerësimi i funksionimit të mekanizmit të MKR-së konstatoi se mekanizmi funksionon dhe vepron në

Grafiku 1.7. Personat në kontakt me sistemin e drejtësisë për dhunën në familje sipas nenit 130/a, të ndarë sipas gjinisë(2017)



Burimi: INSTAT, janar 2019

#HearMeToo

Gjatë Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, zëra të të mbijetuarave të DhNGV-së dhe të aktivistëve në terren u nderuan në lëvizjen globale dhe fushatën, Bëje botën portokalli, #Më DëgjoedheMua (Orange the world, #HearMeToo).



nivel vendor me nivel të ndryshëm të efektivitetit, pra, megjithëse është bërë përparim, ka ende një rrugëtë gjatë përpara deri sa mekanizmi i MKR-së të bëhet plotësisht funksional, efektiv dhe i qëndrueshëm.⁶⁹

Vlerësimi dokumentoi vështirësi të shumta për funksionimin e mekanizmit të MKR-së. Disa prej tyre janë: Komitetet Drejtuese u identifikuan si relativisht pasive kur është puna për bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërmjet institucioneve; u krijuan ekipet teknike operacionale ndërdisiplinore, por është shqetësim ndryshimi i shpeshtë i anëtarëve të tyre (punonjësit e policisë, punonjësit e gjyqësorit, punonjësit e shëndetësisë); ofrimi i shërbimeve për të mbijetuarat e DhNGV-së mbetet një sfidë për shkak se ka një rrjet të kufizuar të shërbimeve ndërdisiplinore për viktimat e dhunës në familje në nivel vendor dhe gratë nga grupet e disavantazuara përballen me pengesa të tjera shtesë për të pasur mundësi për përfitimin e këtyre shërbimeve; ofruesit e shërbimeve nëpër sektorë të ndryshëm dhe anëtarët e agjencive ligjzbatuese, përfshirë edhe gjyqësorin, mbeten të painformuar mbi detyrimet e tyre ligjore për DhNGV-së; dhe mbledhja dhe raportimi i të dhënave

për menaxhimin e rastit në nivel vendor dhe nivel kombëtar është përmirësuar, por mospërputhja e të dhënave ishte një sfidë e vazhdueshme.^{70,71}

Në vitin 2018, gjatë Rishikimit Periodik Universal, ekipi i agjencive të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dha disa rekomandime kyçe, duke përfshirë: sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare për parandalimin e DhNGV-së dhe shërbimet e rehabilitimit për të mbijetuarat e DhNGV-së; shtrirja e mekanizmit të MKR-së, të shërbimeve ndërdisiplinore, dhe e programeve të rehabilitimit dhe të integritetit për të garantuar që ato të jenë të mundshme për t'u arritur nga të gjitha gratë, përfshirë grupet e disavantazuara dhe gratë që jetojnë në zonat rurale; garantimi i të gjitha ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe të politikave për të institucionalizuar shërbime të specializuara mbështetëse për viktimat e dhunës seksuale përmes përdorimit të një qasjeje të koordinuar shumësektoriale; zhvillimi i qendrave dhe shërbimeve model për të mbijetuarat e DhNGV-së, duke përfshirë të mbijetuarat e dhunës dhe ngacmimit seksual; dhe forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve në nivel qendror dhe vendor.⁷²

Aktivite për rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e DhNGV-së që prej VKDhF-së të vitit 2013

Në Shqipëri, arritja e barazisë gjinore dhe parandalimi i DhNGV-së janë angazhime kryesore të qeverisë dhe kanë qenë në fokus të aktiviteteve të programit/projektit të organizatave ndërkombëtare dhe vendase. Që në vitin 2013, organizatat ndërkombëtare dhe vendase, përfshirë organizatat joqeveritare dhe grupe të shoqërisë civile, kanë ndërmarrë një numër aktivitete, që nga kryerja e studimit për DhNGV dhe dhunën në familje deri tek organizimi i aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ngritjen e kapaciteteve. Atopobëjnë për përpjekje për të mbështetur përmirësimin e legjislacionit dhe të politikave që lidhen me DhFDhNGV dhe programe dhe nisma për parandalimin e DhNGV-së.⁷³ Këto aktivitete kanë sjellë përparim të dukshëm në vitet e fundit, përfshirë përmirësime në shtrirjen e DhNGV-së dhe dhunës në familje dhe përmirësime në të dhënat administrative për e DhNGV-në dhe dhunën në familje dhe miratimin edhe të ndryshimeve të ligjit të 2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe të Kodit Penal, dhe në rritjen e standardeve të shërbimeve dhe ofrimit të shërbimeve për të mbijetuarat e DhNGV-së.⁷⁴

Përveç sa më sipër, organet shtetërore në nivel qendror dhe vendor në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare kanë organizuar çdo vit fushata ndërgjegjëse. Për shembull, kryerja e përbashkët e fushatës “16 ditë aktivizmi” është bërë një traditë tashmë në Shqipëri.⁷⁵ Në vitin 2015, gjatë fushatës “16 ditë aktivizmi”, ish MMSR përgatiti dhe firmosi një “Deklaratë të përbashkët kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje” me të gjitha komunitetet fetare në Shqipëri. Kjo u ndoq me trajnime për udhëheqësit fetarë në 2016 se si të ndërmerren veprime të përbashkëta kundër DhNGV-së dhe dhunës në familje.^{76,77} Në 2018, gjatë Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, zëra të të mbijetuarave të DhNGV-së dhe të aktivistëve në terren u nderuan në lëvizjen globale dhe fushatën në bazë, “Bëje botën portokalli #MëDëgjoedheMua” (Orange your world #HearMeToo).

Përpjekjet për të angazhuar dhe mobilizuar burrat dhe djemtë në nismat për DhFDhNGV-në janë trajtuar në Planin Kombëtar të Veprimit për pjesëmarrjen e burrave/djemve si partnerë me gratë/vajzat për barazi gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, 2014-2019 (NAPM&B). Disa elemente të këtij plani u përfshinë tek Plani i Veprimit të Strategjisë së re Kombëtare për Barazi Gjinore, 2016-2020.⁷⁸ Që në 2013, u zbatuan disa elemente të Planit të Veprimit në kuadër të fushatave të përbashkëta kombëtare nën sloganin “Burrat dhe gratë janë pjesë të zgjidhjes: trego se je kundër dhunës!”⁷⁹ Në vitet e fundit, në këto fushata kanë marrë pjesë gjithnjë e më shumë burra dhe djem. Në 2014, MMSR-ja iu bashkua fushatës “AipërAtë” (“HeForShe”) të ndërmarrë nga Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women).^{80,81}

Përveç fushatave, aktivitetet ndërgjegjëse janë fokusuar tek edukimi i grave për të drejtat e tyre dhe rritja e kualifikimeve të ofruesve të shërbimeve dhe punonjësve të drejtësisë për të kuptuar dhe reaguar ndaj DhNGV-së. Për shembull, MMSR-ja e mëparshme (aktualisht MShMS) dhe ministritë e tjera të linjës dhe institucionet e tjera të varësisë organizuan aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve për DhNGV-së (p.sh., policë, mjekë, infermierë, punonjës socialë, profesionistë të drejtësisë dhe mësues). Por vështirësia është se donatorët ndërkombëtarë mbeten burimi kryesor i financimit të aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit dhe ngritjen e kapaciteteve.⁸²

Përse duhet të kryhet Vrojtimi i Tretë Kombëtar për DhNGV-në në Shqipëri?

Vrojtimit Kombëtar për dhunën në familje të viteve 2007 dhe 2013 u kufizuan në matjen e natyrës dhe shtrirjes së dhunës në familje ndaj grave në Shqipëri, ndërsa VKDhF e vitit 2013 përfshiu gjithashtu edhe dhunën fizike të jopartnerit ndaj grave që në moshën 15 vjeçare. Sondazhi i vitit 2018 i udhëhequr nga


OSBE mbi Mirëqënien dhe Sigurinë e Grave përdori një metodologji dhe instrumente për mbledhjen e të dhënave të ndryshme nga metodologjia e VKDhF-së dhe e zgjeroi fokusin tek forma të ndryshme të dhunës të përjetuara nga gratë në fëmijërinë e tyre dhe në të gjithë jetën e tyre, përfshirë edhe dhunën nga partneri intim, dhunën nga jopartneri, ngacmimin seksual dhe përndjekjen. Përveç këtyre tre vrojtimeve, studime kërkimore për DhNGV-së në Shqipëri vazhdojnë të mbeten të kufizuara. Të dhënat e këtyre vrojtimeve janë të rëndësishme sepse ato ofrojnë dëshmi për natyrën dhe shtrirjen e DhNGV-së, pasojat negative të dhunës dhe sjelljet e të mbijetuarave të DhNGV-së në kërkimin e ndihmës. Të dhëna të tilla mund të përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar ndikimin e nismave të DhFDhNGV-së, përfshirë reformat legjislativë dhe nismat për masat për parandalimin, mbrojtjen dhe ndërhyrjet.

VKDhNGV-ja e vitit 2018 përdori një metodologji dhe instrumente të ngjashme për mbledhjen e të dhënave me ato të VKDhF-së 2013 për të mbledhur të dhëna të besueshme mbi natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje, por u shtri për të mbledhur të dhëna nga një kampion grash të grupmoshës 18-74 vjeç, dhe të dhëna për natyrën dhe shtrirjen e dhunës në marrëdhënie dashurore, dhunën nga

jopartneri, ngacmimin seksual dhe përndjekjen si edhe normat shoqërore dhe qëndrimet që lidhen me DhNGV-së. Po ashtu, *VKDhNGV-ja e vitit 2018* u përgatit edhe për të mbledhur të dhëna mbi sjelljet e të mbijetuarave të DhNGV-së në kërkimin e ndihmës, pasojat negative të DhNGV-së mbi jetën e grave, dhe të dhëna demografike për autorët e dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Në Shqipëri, grupe të tilla të të dhënave të kryqëzuara⁸³ për DhNGV-në (2007, 2013 dhe 2018) i japin mundësi qeverisë së Shqipërisë dhe organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare që, përmes të dhënave, të kuptojnë më mirë DhNGV-në dhe të marrin vendime mbi bazën e të dhënave dhe dëshmime kur përgatisin politika dhe programe për DhFDhNGV-në. Të dhënat e kryqëzuara për DhNGV-në janë të nevojshme për të raportuar për Objektivat e Zhhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ), veçanërisht arritjet e bëra për OZhQ 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave. OZhQ 5 ka tregues dhe objektiva që synojnë dhënien fund të të gjitha formave të diskriminimit të grave dhe vajzave dhe eliminimin e të gjitha formave të DhNGV-së në sferat publike dhe private, përfshirë eliminimin e trafikimit dhe të shfrytëzimit seksual dhe të formave të tjera të të shfrytëzimit të grave dhe vajzave.

KAPITULLI 2



NDËRTIMI I STUDIMIT

DhNGV-ja është një problem i ndjeshëm, gjë që e bën mbledhjen e të dhënave mbi shtrirjen e saj një proces kompleks.⁸⁴ Kjo ndodh sepse një pjesë e madhe e dhunës që përjetojnë gratë, ndodh pas dyerve të mbyllura dhe ushtrohet nga partnerët intimë, anëtarët e familjes dhe/ose nga burrat me të cilët ato dalin për t'u njohur.

Të mbijetuarat e DhNGV-së shpesh ngurrojnë, apo kanë frikë të raportojnë rastet e dhunës, nga frika e shpagimit të dhunuesit (dhunuesve) dhe/ose e reagimeve negative të familjes dhe miqve. Femrat që flasin apo që kërkojnë ndihmë në rastet e DhNGV-së, sidomos të dhunës në familje, shpesh fajësohen për viktimizimin e tyre.⁸⁵ Për këto arsye, gratë zakonisht nuk e bëjnë të njohur në mënyrë spontane një histori dhune.⁸⁶

Sfida të tjera që hasin studiuesit që mbledhin të dhëna mbi shtrirjen e DhNGV-së janë hartimi i përkufizimeve të qarta për punën e tyre për sa u takon llojeve të ndryshme të DhNGV-së dhe instrumenteve të matjes së secilit lloj DhNGV-je.⁸⁷ ***Zhvillimet metodologjike nuk kanë avancuar mjaftueshëm për të kapur të gjitha format e DhNGV-së.***⁸⁸

Pavarësisht nga sfidat e mbledhjes së të dhënave, INSTAT-i ka kryer vërtetimin e 3-të kombëtar me bazë popullatën mbi DhNGV-në në Shqipëri. Vërtetimi i parë kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje ndaj grave dhe fëmijëve u zhvillua më 2007⁸⁹, ndërsa vërtetimi i dytë kombëtar me bazë popullatën për dhunën në familje ndaj grave u krye më 2013.⁹⁰ Secili

prej këtyre vërtetimeve kombëtare me bazë popullatën u krye duke përdorur metodologji dhe instrumente të ngjashme për mbledhjen e të dhënave; megjithatë, ka pasur disa dallime të dukshme dhe ndryshime që janë bërë me kalimin e viteve (shih Tabelën 2.1). Më i dukshmi është se vërtetimi i parë përfshiu një kampion grash të moshës 15-49 vjeç dhe fëmijë të moshës 10-14 vjeç, ndërsa vërtetimi i dytë mori në kampion vetëm gra të moshës 18-55 vjeç, kurse vërtetimi i tretë përfshiu në kampion gra të moshës 18-74 vjeç. Gjithashtu, llojet e DhNGV-së së matura u zgjeruan ndjeshëm më 2018, duke përfshirë jo vetëm dhunën në familje⁹¹ të përjetuar nga gratë nga parteri intim (ato që ishin, apo që kishin qenë të martuara dhe/ose jetonin me një parter), por edhe dhunën gjatë marrëdhënieve dashurore (të përjetuar nga gratë që nuk ishin martuar kurrë dhe nuk kishin jetuar kurrë bashkë me një mashkull, por që kishin pasur një marrëdhënie me një mashkull pa jetuar me të), dhunën e ushtruar nga jopartneri, ngacmimin seksual dhe përndjekjen, si edhe normat dhe qëndrimet shoqërore të lidhura me DhNGV-në. Është me rëndësi të vihet në dukje se matja e dhunës në familje nga partneri intim u modifikua dhe zgjerua nga VKDhF-ja e dytë në VKDhG-në e tretë.

Tabela 2.1. Vrojtimet kombëtare për dhunën në familje dhe DhNGV-në në Shqipëritë kryera nga INSTAT

	VKDHF-ja e parë (2007)	VKDHF-ja e dytë (2013)	VKDhF-ja e tretë (2018)
Kampioni	12 Prefektura	12 Prefektura	12 Prefektura
Madhësia e kampionit	Gra, N=2.590 Fëmijë, N=991	Gra, N=3.589	Gra, N=3.443
Demografia e kampionit	Gratë moshës 15-49 vjeç Fëmijëtë moshës 10-14 vjeç	Gratë moshës 18-55 vjeç	Gratë moshës 18-74 vjeç
Llojet e DhNGV-së që u matën	Dhuna në familje e përrjetuar nga gratë nga parteri intim (dhuna emocionale, psikologjike, fizike and seksuale) Dhuna në familjee përrjetuar nga fëmijët (dhuna psikologjike dhe fizike)	Dhuna në familje e përrjetuar nga gratë nga partneri intim (dhuna psikologjike, fizike dhe seksuale) ¹ Dhuna nga jopartneri e përrjetuar nga gratë që në moshën 15 vjeç (fizike)	Dhuna në familjee ushtruar nga partneri intim (sjellje kontroluese shtrënguese dhe dhuna ekonomike, psikologjike, fizike dhe seksuale) Dhuna gjatë marrëdhënieve dashurore (sjellje kontrolluese shtrënguese dhe dhunë ekonomike, psikologjike, fizike dhe seksuale) Dhuna nga jo-partneri e përrjetuar nga gratë që në moshën 15 vjeç (dhunë fizike dhe seksuale) Ngacmimi seksual Përndjekja Normat dhe qëndrimet shoqërore të lidhura me DhNGV-në

¹**Vini re:** Dhuna emocionale dhe psikologjike u mat në 2013, duke përdorur matje të ngjashme si në 2007, megjithatë, gjatë analizës, ato nuk u ndanë sipas kategorive të ndryshme, sikundër u bë në 2007.

Secili prej këtyre vrojtimeve shërben për të mbledhur të dhëna të besueshme të kryqëzuara për natyrën dhe shkallën e DhNGV-sënë Shqipëri, bashkë me pasojat negative të DhNGV-së, sjelljet që kërkojnë ndihmë të mbijetuarave të DHNGV-së, dhe karakteristikat e dhunuesve. Ndryshimet që u janë bërë me kohë metodologjisë dhe instrumenteve për mbledhjen e të dhënave e bëjnë të vështirë të krahasohen shkallët e shtrirjes së DHNGV-së, por të dhënat e kryqëzuara na lejojnë të kuptojmë vlerësimet për gamën e grave që kanë përrjetuar dhunë në fëmijëri dhe në moshë të rritur, dhe autorët e DhNGV-së. Studime të ndryshme mbi shtrirjen e DhNGV-së përdorin metodologji, instrumente të ndryshme për mbledhjen e të dhënave dhe kampione të ndryshme grash; si rrjedhojë, ka gjasa që këto studime të rezultojnë në shkallë të ndryshme shtrirjeje të DhNGV-së. Por, kini parasysh, nuk ka një mënyrë të vetme për të matur shkallët e shtrirjes DhNGV-së dhe ka një mori instrumentesh për mbledhjen e të dhënave që kanë dalë të vlefshme dhe të besueshëm për matjen e shkallëve të shtrirjes së saj. Të dhënat e kryqëzuara dhe gjetjet e këtyre studimeve mund dhe duhet të krahasohen, sepse ofrojnë vlerësime për gamën e grave që përrjetojnë dhunë.

Kështu, secili nga vrojtimit kombëtare të 2007, 2013 dhe 2018 për DhNGV-në me bazë popullatën shërben për të ndihmuar Qeverinë e Shqipërisë të kuptojë më mirë DhNGV-në në Shqipëri, të monitorojë modelet dhe tendencat e saj në kohë, si dhe të eksplorojë ndikimin e iniciativave të kohëve të fundit në lidhje me shtrirjen e DhNGV-së dhe sjelljet e grave që kërkojnë ndihmë për parandalimin, ndërhyrjet dhe mbrojtjen prej saj. Të dhënat dhe gjetjet e këtij studimi mund të informojnë zhvillimet legjislative dhe të politikave, të modelojnë përpjekjet parandaluese dhe ndërhyrjet dhe të përmirësojnë mbrojtjen dhe mbështetjen e të mbijetuarave të DhNGV-së dhe fëmijëve të tyre.

Matja e shtrirjes së DHNGV-së

VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri u hartua për të matur natyrën dhe shkallën e pesë llojeve të ndryshme të DhNGV-së:

- Dhuna në familje të ushtruar nga partneri intim
- Dhuna gjatë marrëdhënieve dashurore
- Dhuna nga jopartneri

- Ngacmimi seksual
- Përndjekja

(Përkufizimet e secilit prej këtyre llojeve të DhNGV-së jepen në fillim të raportit).

Secila prej llojeve të DhNGV-së u operacionalizua në vërtetim nëpërmjet një game pyetjesh të lidhura me secilën DhNGV të ndryshme. Studimi nuk u përpoq të maste një listë shteruese aktesh, por bëri një numër pyetjesh për akte specifike që ndodhin rëndom në martesë dhe familje të dhunshme dhe dhunuese, dhe që gratë dhe vajzat i përjetojnë rëndom në hapësirat publike. Aktet e përdorura për të përkufizuar secilën nga llojet e ndryshme të DhNGV-së paraqiten dhe diskutohen në kapitujt që vijojnë.

Zhvillimi i vërtimit kombëtar për DhNGV-në në Shqipëri

Pas një shqyrtimi të gjerë të letërsisë ndërkombëtare mbi dhunën në familjedhe të instrumenteve ekzistuese të vërtetimeve, të përdorura në Shtetet e Bashkuara, Evropë dhe Afrikë, INSTAT-i zhvilloi fillimisht VKDHF-në e vitit 2007⁹². Asokohe, INSTAT-i analizoi edhe të dhënat e botuara nga Ministria e Brendshme për periudhën 2004 deri në 2007 dhe të dhënat dhe informacionin mbi dhunën në familje botuar nga OJQ-të anëtare të Rrjetit kundër Dhunës me bazë Gjinore dhe Trafikut të Qenieve Njerëzore⁹³. Gjithashtu, INSTAT-i shqyrtoi edhe botimin e vitit 1996 të *Minnesota Advocates for Human Rights*, titulluar, *Dhuna në familje në Shqipëri*. VKDHF-ja e vitit 2007 përbëhej nga 10 module të veçanta, duke përfshirë dy module të hartuara për të mbledhur të dhëna rreth pranisë dhe përdorimit të armëve në shtëpi, dhe dy module për të mbledhur të dhëna nga fëmijët mbi përvojat e tyre të dhunës në familje. Vërtimi gjithashtu u fokusua në intervistimin e një gruaje në çdo familje, nga moshë 15 deri në 49 vjeç, ose të një fëmijë të moshës 10 deri në 14 vjeç.


Në 2013, INSTAT-i e rishikoi VKDHF-në e vitit 2007 me ndihmën teknike të UNDP-së. Rishikime iu bënë pyetjeve të vërtimit dhe formulimeve, për të përmirësuar matjet e përvojave të grave nga dhuna

në familje gjatë martesave dhe marrëdhënieve intime. VKDHF-ja e vitit 2013 përfshinte 5 module; u përjashtuan pesë module nga VKDHF-ja e vitit 2007, që ishin hartuar për të mbledhur të dhëna mbi praninë dhe përdorimin e armëve në shtëpi dhe përvojat e fëmijëve të dhunës në familje. VKDHF-ja e 2013 po ashtu u rishikua për t'u fokusuar në intervistimin e një gruaje për çdo familje, nga moshë 18 deri në 55 vjeç, në lidhje me përvojat e saj nga dhuna në familje.

Në 2018, INSTAT e rishikoi VKDHF-në e vitit 2013 me ndihmën teknike të UNDP-së. Qëllimi ishte të zgjerohet VKDHF-ja për të matur përveç dhunës nga partneri intim, edhe dhunën e ushtruar nga jopartneri dhe të përfshihej ngacmimi seksual dhe përndjekja, si edhe normat dhe qëndrimet shoqërore të lidhura me DhNGV-në. Si pjesë e procesit të rishikimit, INSTAT-i shqyrtoi edhe VKDHF-në e vitit 2013 dhe vërtimet e DHNGV-së të përgatitura dhe kryera në vendet e BE-së në 2012 nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, vërtimet e DhNGV-së të kryera me financim dhe mbështetjen teknike të UN Women në Gjeorgji dhe Xhamajka, si edhe literaturën për matjen e normave dhe qëndrimeve shoqërore të lidhura me DhNGV-në dhe studimin e normave shoqërore dhe praktikave të dëmshme të kryera në Malaui me financimin dhe mbështetjen teknike të UN Women. Bazuar në këtë shqyrtim u bënë rishikime të matjeve fillestare të dhunës së partnerit intim dhe të dhunës së jopartnerit të përfshira në VKDHF-në e vitit 2013, dhe u zgjeruan për të përfshirë ngacmimin seksual, përndjekjen dhe normat dhe qëndrimet shoqërore të lidhura me DhNGV-në. *VKDHF-ja e vitit 2018 në Shqipëri* përfshiu 9 module të veçanta:

- Moduli 1: Moduli i Informacionit (MODHI)⁹⁴
- Module 2: Moduli i Strukturës Familjare (MODHL)⁹⁵
- Moduli 3: Moduli i Martesës, përdorimi i kontraktivëve dhe sjellja seksuale (MODMA)⁹⁶
- Moduli 4: Moduli i Dhunës në Familje (MODDV)⁹⁷
- Moduli 5: Moduli i Dhunës në Marrëdhënie Dashurore (MODDA)⁹⁸
- Moduli 6: Moduli i Dhunës së Jopartnerit (MODNP)⁹⁹
- Moduli 7: Moduli i Ngacmimit Seksual (MODSH)¹⁰⁰
- Moduli 8: Moduli i Përndjekjes (MODST)¹⁰¹
- Moduli 9: Moduli i Normave dhe Qëndrimeve Shoqërore të Lidhura me DHNGV-në (MODSNA)¹⁰²

Diagrami 2.1. Grafiku i Modulit të VKDhNG-së së vitit 2018



VKDhNG-ja e vitit 2018 u përgatit në Excel dhe u kalua në programin CSPro, pastaj u hodh në Tableta që u përdorën në terren nga intervistueset e INSTAT-it për të administruar vërtetimin dhe për të mbledhur të dhëna. Intervistueset e administruan vërtetimin në një mjedis të drejtpërdrejt, duke intervistuar një grua të moshës 18-74 vjeç për familje. Diagrami 2.1 tregon grafikun e modulit për VKDhNG e vitit 2018 në Shqipëri.

Marrja e informacionit maksimal

Që në fillim të vërtetimit, u pranua se DhNGV-ja është një çështje tejet e ndjeshme dhe se do të kishte mjaft gjasa që gratë të ngurronin të zbulonin përvojat e tyre të dhunës. Për këto arsye, u bërë përpjekje që vërtetimi të ndërtohej në atë mënyrë që t'i bënte gratë të ndiheshin mirë dhe të ishin në gjendje për të zbuluar përvojat e tyre të DhNGV-së, duke

përfshirë edhe në marrëdhëniet e tyre intime. Në veçanti, vrojtimi u strukturua në atë mënyrë që pjesët e para të tij të mblidhnin informacion për çështje më pak të ndjeshme (për shembull, demografia), ndërsa çështjet më të ndjeshme (për shembull, dhuna e vetë-raportuar) të eksploroheshin më pas në vrojtimit. Gjithashtu vëmendje iu kushtua edhe formulimit të drejtimeve të vrojtimit.

Të anketuarat u paralajmëruan se ku do të përqendrohej vrojtimi dhe për natyrën e ndjeshme të pyetjeve të përfshira në të; përqendrimi i vrojtimit nuk iu bë i njohur anëtarëve të tjerë të familjes. Mbledhësit e të dhënave u udhëzuan që të siguronin privatesinë përpara se të bënin pyetjet rreth dhunës së përjetuar nga gratë gjatë jetës së tyre dhe në 12 muajt e fundit përpara vrojtimit. Të anketuarat u informuan se përgjigjet e tyre do të mbeteshin konfidenciale dhe se ato mund t'i jepnin fund intervistës në çdo kohë pa asnjë pasojë.

Ndërtimi i kampionit

VKDhNG-ja e vitit 2018u krye në nivel vendi në secilën prej 12 prefekturave të Shqipërisë. U përdor modeli i kampionit të shtresëzuar për përzgjedhjen e grave që do të bënin pjesë në kampion. Njësitë Parësore që u morën si kampione (NjPK), të përzgjedhura në fazën e parë, ishin zonat e numërimit (ZN-të), të cilat janë zona të vogla të përcaktuara në hartat e përdorura për numërimet në kuadrin e regjistrimit të popullsisë së vitit 2011. Programi SAS u përdor në këtë fazë për të përzgjedhur sistematikisht kampionët e ZN-ve me probabilitet në përpjesëtim me madhësinë (PPM) brenda secilës prefekturë. Faza e dytë e përzgjedhjes ishte lista e familjeve nga ZN-të e përzgjedhura. Lista e familjeve të numëruara në regjistrimin e popullsisë së vitit 2011 për secilin kampion ZN-je u përdor si kuadër për marrjen e kampioneve për përzgjedhjen e 8 familjeve + 4 familje rezervë në secilin kampion të ZN-së, duke përdorur marrje të rastësishme kampionesh sistematike, me probabilitet të barabartë.

Faza e tretë ishte përzgjedhja e grave; një grua u zgjodh për çdo familje të përzgjedhur në fazën e dytë. Bazuar në kritere të parapërcaktuara, një grua quhej se i plotësonte kushtet për t'u anketuar, nëse ishte

midis moshës 18 dhe 74 vjeç dhe nëse kishte banuar rregullisht në atë familje. Për familjet me një grua të pranishme, ajo grua u përzgjodh për intervistë, duke përdorur Modulin 2, Moduli i Strukturës Familjare. Për familjet me më shumë se një grua, intervistesja u udhëzua të zgjidhte rastësisht gruan në bazë të metodës së ditëlindjes më të afërt.

Qëllimi ishte të gjenerohej një kampion grashtë moshës 18-74 vjeç, që do të mundësonte prodhimin e vlerësimeve statistikisht të besueshme të shtrirjes së DhNGV-së në nivel vendi. Duhet vënë në dukje se INSTAT-i kuptoi që në fazën e ndërtimit të vrojtimit se madhësia e kampionit të një vrojtimi të caktuar, përcaktohet nga saktësia që kërkohet për vlerësime në nivel vendi, si edhe nga ndikimet e lidhura me kostot, burimet, dhe kufizimet operacionale. Madhësia e kampionit është ndikuar gjithashtu nga çështjet logjistike të lidhura me organizimin dhe madhësinë e ekipeve të mbledhjes së të dhënave, dhe nga ngarkesa e punës për administrimin e vrojtimit dhe mbledhjen e të dhënave. Duke marrë parasysh të gjithë këta faktorë, përlogaritjet sugjeruan se një kampion me madhësi prej 3.600 familjesh do të ofronte mundësi të mjaftueshme për t'i realizuar këto objektiva.

Tabela 2.2. Shkalla e përgjigjeve të Vrojtimit

	Familjet e kontaktuara N=4.613 %
Familjet me gra që i plotësojnë kushtet e vrojtimit	76.5
Familjet pa gra që i plotësojnë kushtet e vrojtimit	3.0
Familjet që refuzuan të marrin pjesë	5.1
Banesa të shkatërruara/që nuk u gjetën	2.4
Banesa që nuk përdorshin më për të jetuar	3.3
Të tjera	9.7

Tabela 2.2 tregon se u kontaktuan gjithsej 4.613 familje, nga të cilat 3.528 familje kishin gra që i plotësonin kushtet për t'u intervistuar. Nga këto familje, 3.445 gra dhanë pëlqimin për t'u intervistuar (shkalla e përgjigjeve 97,6%). Kampioni përfundimtar përfshiu 3.443 të anketuara; 2 vrojtme u eliminuan sepse nuk ishin të plota.

Mbledhësit e të dhënave

Përpara se të fillonte administrimi i vrojtimit, INSTAT-i përzgjodhi me kujdes dhe trajnoi ekipin e stafit në terren i cili përbëhej nga 20 mbikëqyrës rajonalë dhe 61 intervistues. INSTAT-i ka një ekip të kualifikuar mbledhësish të të dhënave/intervistues, kështu që shumica e mbledhësve të të dhënave/intervistuesve të përdorura në këtë projekt kërkimor u punësuan nga INSTAT-i dhe të gjitha ishin gra. Secila nga anëtarët e ekipit kërkimor u trajnuar për një periudhë pesë-ditore në shtator të vitit 2018. Trajnimi mbuloi qëllimin dhe përmbajtjen e VKDhNG-së, përkufizimet kyçe, çështjet e DhNGV-së, procedurat e marrjes së kampioneve dhe të vrojtimit, mënyrën e administrimit të vrojtimit në një mjedis ballë për ballë, mënyrën se si të ndihmoheshin të anketuarat që të kujtonin me saktësi ngjarjet e e dhunshme,¹⁰³ dhe aspektet etike dhe të sigurisë të intervistimit të të mbijetuarave të DhNGV-së. Gjithashtu, ato u trajnuan për mënyrën e përdorimit të programit CSPro dhe të tabletave për të kryer vrojtimin. Anëtarëve të ekipit kërkimor gjithashtu iu dha mbështetje e vazhdueshme gjatë gjithë kryerjes së studimit.

Siguria e të anketuarave dhe ekipit kërkimor ishte me rëndësi parësore; kështu që në ndërtimin e kampionit të vrojtimit u përfshinë konsideratat etike lidhur me kërkimet mbi DhNGV-në të përcaktuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë¹⁰⁴ dhe nga Instituti Global i Grave (GWI) i Departamentit Australian të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë (DFAT),¹⁰⁵ procedurat e administrimit dhe trajnimi i intervistuesve. Intervistueset u udhëzuan rreth rëndësisë së sigurimit të konfidencialitetit dhe privatësisë së të anketuarave, për të mbrojtur sigurinë e të anketuarave dhe për të përmirësuar cilësinë e të dhënave. Për të mbrojtur konfidencialitetin, intervistueset u trajnuan që të anketuarat t'i pyesnin privatisht. Koordinator i projektit të INSTAT-it dhe mbikëqyrësit e ekipit monitoronin rregullisht punën e intervistuesve dhe cilësinë e të dhënave të mbledhura.

Administrimi i vrojtimit në terren

VKDhNG-ja e vitit 2018 në Shqipëri u administrua në 12 Prefekturanë tetor dhe nëntor 2018. Vrojtimet u administruan ballë për ballë, nëpër shtëpitë e të anketuarave. Të anketuarat nuk u paguan për pjesëmarrjen në intervista; pjesëmarrja ishte plotësisht vullnetare. Sikurse është përmendur më parë, u garantua anonimiteti dhe konfidencialiteti i të gjitha të anketuarave, dhe u siguria privatësia e tyre përpara se të bëheshin pyetjet për DhNGV-në.

Konsideratat etike

Është e dokumentuar më së miri se konsideratat etike janë jashtëzakonisht të rëndësishme kur kryet një studim mbi DhNGV-në, për shkak të natyrës delikate të subjektit. Gratë rrezikojnë shpagimin e partnerit dhunues dhe/ose të pjesëtarit të familjes, si pasojë e bërjes së njohur të dhunës dhe gratë mund të ri-traumatizohen përmes natyrës ndërhyrëse të pyetjeve të intervistës. Këto risqe përfshijnë edhe vetë studiuesit, duke qenë se në shkallë ndërkombëtare janë dokumentuar raste kur punonjësit në terren janë kërcënuar nga anëtarë të familjeve dhe/ose të komunitetit gjatë kryerjes së kërkimeve të tyre mbi DhNGV-në.^{106,107}

Në përgjigje të këtyre shqetësimeve, OBSH-ja ka botuar *Rekomandime etike dhe të sigurisë për kërkimet ndërhyrëse mbi dhunën ndaj grave*. Duke u mbështetur në mësimet e nxjerra nga botimi i OBSH-së (2016), GWI-ja e Australisë e Departamentit të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë (DFAT), botoi *Konsiderata Etike për Studimin dhe Vlerësimin e Dhënies Fund të Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave* (2018). Këta dokumente udhëzuese ofrojnë udhëzime dhe konsiderata për mbrojtjen e subjekteve njerëzore, të cilat duhen zbatuar gjatë kryerjes së studimeve për DhNGV-në. Aty përfshihen udhëzime konkrete në lidhje me sigurimin e privatësisë, garantimin e anonimitetit dhe konfidencialitetit të të anketuarave, sigurimin e pjesëmarrjes vullnetare, pasjen e procedurave të përshtatshme dhe të informuara në lidhje me dhënien e pëlqimit nga pjesëmarrëset, dhe ofrimin e rekomandimeve për gratë që kanë përjetuar dhunë dhe që kanë kërkuar

ndihmë tek shërbimet lokale të disponueshme dhe burimet e mbështetjes.^{108,109} INSTAT-i ndërmori hapa për të garantuar një proces të shëndoshë etik dhe sigurinë e pjesëmarrëseve dhe ekipit kërkimor që në fazën e projektimit të kërkimit, duke e ndjekur pastaj atë gjatë zbatimit të VKDhNG-së dhe analizës dhe përhapjes së të dhënave.

Ky studim u hartua për të qenë metodologjikisht i shëndoshë dhe i bazuar mbi mësimet e nxjerra nga VKDhF-të e vitit 2007 dhe 2013, si edhe mbi literaturën aktuale ndërkombëtare për mënyrën e minimizimit të nën-raportimit të DhNGV-së gjatë kryerjes sëstudimeve mbi përhapjen e DhNGV-së. Të gjithë anëtarët e ekipit kërkimor, përfshirë mbledhësit e të dhënave, u përzgjedhën me kujdes nga INSTAT-i dhe morën trajnim të specializuar dhe mbështetje të vazhdueshme nga INSTAT-i. INSTAT-i dhe donatorët gjithashtu pranuan detyrimet etike për të siguruar që gjetjet e paraqitura gjatë raportit të interpretoheshin si duhet dhe të përdorreshin për avancimin e politikave dhe programimit të Dhënies Fund të Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave (DhFDhNGV).

Ponderimi i kampionit

Për shkak të ndarjes jo saktësisht proporcionale të kampionit nëpër prefekturat e ndryshme dhe në zonat e tyre urbane dhe rurale dhe të ndryshimeve të mundshme në shkallët e përgjigjeve, kërkohet ponderimi në marrjen e kampioneve për çdo analizë që përdor të dhëna mbi VKDhNG-në, për të siguruar karakterin real përfaqësues në nivel vendi si edhe në nivel domeni. Meqë kampioni është një kampion grup (cluster) i shtresëzuar me tre faza, koeficienti i ponderimit të kampionit është përlogaritur në bazë të probabilitetit të marrjes së kampioneve veçmas për çdo fazë të marrjes së kampioneve dhe për çdo grup. U përdorën shenjat e mëposhtme:

P_{1hi} : Probabiliteti i fazës së parë të marrjes së kampioneve të grupit i^{th} në shtresën h .

P_{2hi} : Probabiliteti i fazës së dytë të marrjes së kampioneve brenda grupit i^{th} (probabiliteti i përzgjedhjes së familjeve).

P_{hi} : Probabiliteti i përgjithshëm i secilës familje të grupit i^{th} në shtresën h

Hij: Numri i femrave në popullsinë e synuar në familjen j të shtresës h dhe grupit i^{th} (femra të moshës 18-74 vjeç në familje).

Ta zëmë se a_h është numri i grupeve të përzgjedhura në shtresën h , M_{hi} është numri i familjeve sipas bazës së marrjes së kampionit në grupin i^{th} , ndërsa $\sum M_{hi}$ është numri i përgjithshëm i strukturave në shtresën h . Probabiliteti i fazës së parë të përzgjedhjes së grupin i^{th} në shtresën h është përlogaritur si vijon:

$$P_{1hi} = \frac{a_h M_{hi}}{\sum M_{hi}}$$

Ta zëmë se L_h është numri i familjeve të renditura në operacionin e renditjes së familjeve në grupin i^{th} në shtresën h , ta zëmë se g_{hi} është numri i familjeve të përzgjedhura në grup. Probabiliteti i përzgjedhjes së fazës së dytë për secilën familje në grup përlogaritet si vijon:

$$P_{2hi} = \frac{g_{hi}}{L_h}$$

Probabiliteti i përzgjedhjes së secilës familje në grupin i të shtresës h është rrjedhojë e prodhimit të probabilitetit të përzgjedhjeve së të dy fazave:

$$P_{hi} = P_{1hi} \times P_{2hi}$$

Koeficienti i ndërtimit të kampionit për çdo familje në grupin i të shtresës h është e kundërta e probabilitetit të përgjithshëm të përzgjedhjes:

$$W_{hi} = 1/P_{hi}$$

Marrja e kampioneve me tre faza të gravetë moshës 18-74 vjeç brenda familjes është bërë me procedurën e përzgjedhjes së rastësishme. Probabiliteti i përzgjedhjes së grave matet:

$P_{3hij} = 1/H_j$ është probabiliteti i përzgjedhjes të grave në çdo familje.

Probabiliteti i përgjithshëm i përzgjedhjes së grave j në grupin i të shtresës h është e kundërta e probabilitetit të përgjithshëm të përzgjedhjes:

$$P_{h\ j} = P_{1h} \times P_{2h} \times P_{3h\ j}$$

Koeficienti i kampionit të marrë për gratë j në grupin h është e kundërta e probabilitetit të përgjithshëm të përzgjedhjes së grave:


$$W_{h\ j} = 1/P_{h\ j}$$

Procesi i ponderimit pasohet nga ri-ponderimi për efekt mospërgjigjesh dhe nga kalibrimi për efekt të numrit të popullsisë së grave të moshës 18-74 vjeç në nivel prefekturë dhe në nivel fashash 10 vjeçare moshash, për të prodhuar koeficientin përfundimtar të ponderimit që përdoret për analizimin e të dhënave.

Përpunimi, analizimi dhe raportimi i të dhënave

Procedurat për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave ishin rigorozë dhe të mbikëqyrura me kujdes nga INSTAT-i. U përdor një qasje e standardizuar për kodimin dhe u hartua një program për hedhjen e të dhënave në programin CSPro; kjo ndihmoi që të sigurohej administrimi dhe regjistrimi i duhur në terren. Të gjitha të dhënat u hodhën në tableta në terren, duke përdorur programin CSPro. Ponderimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave filloi në dhjetor të 2018 dhe përfundoi në mars 2019 dhe u bë nga INSTAT-i me mbështetjen teknike të UNDP-së. Gjatë gjithë raportit, gjetjet paraqiten në bazë të të dhënave të ponderuara në formë përqindjesh, ku "N" përfaqëson madhësinë e përgjithshme të popullsisë bazuar në të dhëna të ponderuara. Shtojca B paraqet shifra të pa ponderuara ku "n" i referohet numrin aktual të grave të intervistuar.

KAPITULLI 3



KARAKTERISTIKA TË GRAVE TË INTERVISTUARA

Ky kapitull trajton karakteristikat e grave në familjet e kampionit bashkëme të dhënat demografike për kampionin përfundimtar të grave të grupmoshës 18-74 vjeç që u përzgjedhën dhe ranë dakord të intervistoheshin.

Karakteristikat e grave që përmbushin kushtet për intervistim

Midis familjeve të përzgjedhura në kampion, kishte zakonisht më shumë se një grua që plotësonte kushtet për intervistim. Tabela 3.1 tregon të dhëna për të gjitha gratë e intervistuar në familjet pjesë e kampionit. Midis 4142 grave qëpërmbushin kushtet për t'u intervistuar, 68,8% e tyre u identifikuan si bashkëshorte /partnere (aktualisht e martuar ose jeton me bashkëshortin/partnerin); vetëm 9,5% e identifikuan veten si kryefamiljare e familjes dhe 7,3% ishin nuse në familje . Përsa i përket nivelit arsimor, 43,1% kishin arsim të mesëm të ulët (8-9vjet), 28,4% kishin arsim të mesëm të lartë dhe 17,2% kishin arsim universitar; vetëm 9,4% kishin arsim fillor ose më pak.

Tabela 3.1. Karakteristika të grave të intervistuar, grupmosha 18-74 vjeç (të dhëna të paponderuara)

N=4,142	
Pozicioni në familje	%
Kryefamiljare	9,5
Bashkëshorte/partner	68,8
Fëmijë/fëmijë i adoptuar	11,2
Mbesë	0,7
Mama	1,7
Motër	0,4
Nuse	7,3
Tjetër	0,4
Niveli arsimor	
Pa diplomë	0,7
Arsim fillor	8,7
Arsim i mesëm i ulët (8-9 vjet)	43,1
Arsim i mesëm i lartë	28,4
Pas shkollës së mesme, jo universitet	1,8
Arsim universitar	17,2

Demografia e grave të intervistuar

Kampioni përfundimtar përfshiu 3443 familje dhe gra të moshës 18 -74 vjeç. Siç u shpjegua në Kapitullin 2, për të prodhuar ponderimin final të përdorur për analizën e të dhënave, të dhënat u ponderuan nga INSTAT-i mbi bazën e numrit të grave të moshës 18 deri 74 vjeç në nivel prefekturë; ndaj 'N' që përfaqëson madhësinë e kampionit të përgjithshëm dhe përqindjet (%) e raportuara në të gjitha tabelat e këtij raporti mbështetennë të dhëna të ponderuara (shihni Shtojcën B për shifra të paponduara).

Mbi bazën e të dhënave të ponderuara, tabela 3.2 zbulon se kampioni i grave nuk ishte i shtrirë në mënyrë të barabartë në të gjitha prefekturat, sepse më shumë gra ishin marrë si kampion në Tiranë (31,2%), kryeqyteti me popullsinë më të madhe, dhe në Fier (9,9%) dhe Elbasan (9,8%), krahasuar me Kukësin (2,6%) dhe Gjirokastrën (2,6%) ku ishin shumë më pak gra pjesëmarrëse në kampion. (Shihni Shtojcën B për rezultate të paponduara).

Tabela 3.3 zbulon grupmoshat dhe nivelin arsimor të kampionit të grave. Gratë ishin të moshës nga 18 deri 74 vjeç me një moshë mesatare 43,6 vjeç. Gratë e të gjitha grupmoshave kishin një shpërndarje të barabartë, përveç pak grave të moshës 65 deri 74 vjeç (11,2%). Për nivelin arsimor, 42,4% e grave kishin arsim të mesëm të ulët (8-9 vjet), 27,8% kishin arsim të mesëm të lartë dhe 19,7% e grave kishin arsim universitar. Vetëm 7,7% e grave kishin arsim fillor ose më të ulët. Duhet të vihet në dukje se arsimi i grave nuk u integrua në një bazë më të madhe të dhënash për përvojat e grave me dhunën, ndaj nuk mund të bëhen krahasime mbi bazën e nivelit të arsimimit.

Në lidhje me situatën e gjendjes së punësimit të grave, tabela 3.4 tregon se 38,2% e grave ishin në punë, 29,5% e grave po kërkonin punë, por ishin aktualisht të papuna, dhe 18,2% ishin në pension. Vetëm 4,5% ishin studente ose studionin dhe 1,4% e grave ishin me aftësi të kufizuara ose ishin të sëmura prej një kohe të gjatë. Llojet e punësimit në të cilat përfshiheshin gratë përfshijnë: punë me pagesë në ndërmarrjet private (31,3%), punonjëse në shtet me

Tabela 3.2. Kampioni i grave sipas prefekturave (të dhëna të ponderuara)

Prefekturat	Kampioni gjithsej (i ponderuar) N=1,040,726 %
Berat	4.7
Dibra	4.2
Durres	8.0
Elbasan	9.8
Fier	9.9
Gjirokaster	2.6
Korce	7.5
Kukes	2.6
Lezhe	4.2
Shkoder	7.4
Tirana	31.2
Viore	8.0

Tabela 3.3. Grupmoshat e grave dhe niveli arsimor (të dhëna të ponderuara)

	Kampioni gjithsej %
Gra dhe vajza	100.0
Grupmosha	
18-24 vjeç	16.1
25-34 vjeç	19.6
35-44 vjeç	16.0
45-54 vjeç	18.6
55-64 vjeç	18.4
65-74 vjeç	11.2
Niveli arsimor	
Më i ulët se arsimi fillor	0.6
Arsim fillor	7.1
Arsim i mesëm i ulët, 8-9 vjet	42.4
Arsim i mesëm i lartë	27.8
Pas shkollës së mesme, jo universitet	2.4
Arsim universitar	19.7

pagë (19,2%), e vetëpunësuar pa punonjës me pagë (7,7%) e vetëpunësuar me punonjës me pagë (1,2%), dhe e punësuar me pagë në shtëpi private (2,5%). Përveç këtyre, 14,4% e grave ishin punonjëse pa rrogë në bujqësi ose në një sektor tjetër. Një përqindje e grave punonin në lloje të tjera të punësimit (21,1%).

Tabela 3.5 tregon se 40,4% e grave raportuan se paratë e mara nga puna e tyre ishin burimi kryesor i të ardhurave në familjen e tyre; vetëm 22,4% e grave raportuan se merrnin mbështetje nga bashkëshorti/i dashuri dhe 18,7% e grave raportuan se pensioni ishte burimi kryesor i të ardhurave të tyre. Vetëm 3,6% e grave identifikuan shërbimet shoqërore /asistencën sociale si burimi kryesor i të ardhurave të tyre dhe 1% raportuan se familja e tyre nuk kishte asnjë të ardhur.

Të intervistuarat u pyetën edhe për të ardhurat mujore të familjes së tyre. Tabela 3.5 tregon se 22,4% e grave kishin të ardhura mujore në familje prej 12.001-26.000 Lekë (USD \$109-\$234), 25,4% kishin të ardhura mujore në familje prej 26.001-38.000 Lekë (USD \$235-\$342), 24,7% raportuan një të ardhur mujore në familje prej 38.001-60.000 Lekë (USD \$343-540). Pak të intervistuarat raportuan të ardhura mujore në familje prej 60.001-111.000 Lekë (USD \$541-\$990) dhe më shumë se 110.000 Lekë (USD \$991). Po ashtu, vetëm 9,1% e grave të intervistuarat raportuan të ardhura mujore në familje prej 12.000 Lekë ose më pak (USD \$108 USD ose më pak).

Tabela 3.6 zbulon gjendjen civile dhe mënyrat e jetës të grave të intervistuarat. Shumica e grave në kampion ishin të martuara dhe/ose jetonin me një partner mashkull (79,7%); në veçanti, 73,3% ishin të martuara dhe jetonin bashkë me një partner mashkull, 5,7% ishin të martuara por nuk jetonin bashkë me një partner mashkull, dhe 0,7% jetonin me një partner mashkull, por nuk ishin të martuara. Vetëm 20,3% nuk ishin të martuara dhe nuk bashkëjetonin me një partner mashkull; në veçanti, 10,8% nuk kanë qenë asnjëherë të përfshira në një marrëdhënie me një mashkull, 5,4% kanë qenë të martuara më parë dhe 4% kanë qenë të përfshira në një marrëdhënie me një mashkull por pa bashkëjetuar me të (p.sh., në marrëdhënie dashurie ose e fejuar). Po ashtu, 4,1% e grave të anketuara ishin të veja, 1,2% të divorcuara dhe 0,2% të ndara

Tabela 3.4. Punësimi i grave (të dhëna të ponderuara)

Situata e gjendjes sëpunësimit	Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Në punë	38.2
Duke kërkuar për punë/e papunë	29.5
Në pension	18.2
Student/duke ndjekur studimet	4.5
Me aftësi të kufizuara/sëmurë për një kohë të gjatë	1.4
Tjetër	8.0
Lloji i punësimit (punësimi kryesor ose punësimi më i fundit)	
Punonjës në shtet me pagë	19.2
Punonjës me pagë në ndërmarrje private	31.3
Punonjës me pagë në shtëpi private	2.5
Punonjës pa pagë në bujqësi ose në lloje të tjera biznesi	14.4
I vetëpunësuar me punonjës me pagë	1.2
I vetëpunësuar pa punonjës me pagë	7.7
Tjetër	21.1

Tabela 3.5. Të ardhurat e kampionit të grave (të dhëna të ponderuara)

Burimi kryesor i të ardhurave në familjen tuaj	Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Asnjë e ardhur	1.0
Para nga puna personale	40.4
Mbështetje nga bashkëshorti /i dashuri juaj	22.4
Mbështetje nga të afërm të tjerë	9.3
Pensioni	18.7
Shërbime shoqërore /asistencë	3.6
Fonde nga emigrantët	0.5
Tjetër	4.1
Të ardhurat mujore të familjes	
12.000 Lekë ose më pak	9.1
12.001 – 26.000 Lekë	22.4
26,001 – 38,000 Lekë	25.4
38,001 – 60,000 Lekë	24.7
60,001 – 110,000 Lekë	11.1
More than 110,000 Lekë	3.1
Nuk e di /Refuzoi të përgjigjet	4.2

nga bashkëshorti /i dashuri i tyre aktual. Moshë në të cilën gratë ishin martuar ose jetonin bashkë për herë të parë me një burrë ishte më shpesh 18-24 vjeç (63,2%); vetëm 9,7% raportuan se ishin martuar ose bashkëjetonin me një burrë në moshën 17 vjeçare ose më të vogël.

Tabela 3.6. Gjendja civile e grave dhe mënyrat e jetesës (të dhëna të ponderuara)

Gjendja civile dhe jetesa	Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Aktualisht e martuar, jetoj me një partner mashkull	73.3
Aktualisht e martuar, por nuk jetoj me një partner mashkull	5.7
Jetoj me një partner mashkull, nuk jam e martuar	0.7
Aktualisht nuk jam e martuar dhe nuk bashkëjetoj me një partner mashkull	20.3
Aktualisht nuk jam e martuar ose nuk bashkëjetoj me një partner mashkull	N=210,985
Kam qenë e martuar më parë	5.4
Nuk jam martuar asnjëherë, por kam bashkëjetuar më parë me një partner mashkull	0.1
E përfshirë në një marrëdhënie me një mashkull pa bashkëjetuar me të	4.0
Asnjëherë nuk kam qenë e përfshirë në një marrëdhënie me një mashkull	10.8
Përfundimi i partneritetit të fundit me një burrë	N=1,040,726
E shkurorëzuar	1.2
E ndarë	0.2
E ve /partneri ndërroi jetë	4.1
Moshë në martesën e parë/bashkëjetesën me një burrë	
≤ 17 vjeçe	9.7
18-24 vjeçe	63.2
25-30 vjeçe	11.0
≥ 31 vjeçe	1.2

Të dhënat u analizuan për të raportuar për indikatorin 5.3.1 të OZhQ-së, përqindjen e grave të

moshës 20-24 vjeç që ishin martuar ose ishin në një lidhje përpara moshës 15 vjeçare dhe përpara 18 vjeç. Gjetjet zbuluan se asnjë grua e moshës 20-24 vjeçare nuk ishte martuar përpara moshës 15 vjeç dhe 6,1% e grave ishin martuar përpara moshës 18 vjeç, kryesisht në moshën 16 ose 17 vjeçare.

Shtatzënia dhe fëmijët

Midis grave të anketuara, 80,9% kishin qenë shtatzënë gjatë jetës dhe 79,8% kishin lindur fëmijë. Vetëm 0,9% ishin shtatzëna në kohën e sondazhit. Moshë në të cilën gratë ishin shtatzëna për herë të parë ishte zakonisht 18-24 vjeç (63,2%); por 9,7% e grave ishin shtatzëna për herë të parë përpara moshës 18 vjeç dhe 11% ishin shtatzëna për herë të parë në moshën 25-30 vjeç. Shumë më pak gra ishin shtatzëna për herë të parë në moshën 31 vjeç ose më të madhe (1,2%).

Tabela 3.7. Shtatzënia dhe lindja (të dhëna të ponderuara)

	Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Ka qenë ndonjëherë shtatzënë	80.9
Ka lindur ndonjëherë	79.8
Shtatzënë aktualisht	0.9
Moshë kur ke qenë shtatzënë për herë të parë	
≤ 17 vjeç	9.7
18-24 vjeç	63.2
25-30 vjeç	11.0
≥ 31 vjeç	1.2

Tabela 3.8 tregon se 37,4% e grave të intervistuar kishin një fëmijë (disa fëmijë) të moshës 17 vjeçare ose më të vogël që jetonte me to. Midis grave që kishin fëmijë që jetonin me to, 20,9% raportuan se një ose më shumë se një nga fëmijët e tyre ishin larguar një herë nga shtëpia. Përveç kësaj, 13,6% raportuan se fëmijët e tyre shikonin shpesh ëndrra të frikshme, 11,1% raportuan se fëmijët e tyre ishin të ndrojtur ose të tërhequr, 10,5% raportuan se fëmijët e tyre urinonin shpesh në shtrat dhe 3,4% raportuan se fëmijët e tyre kishin sjellje agresive me to ose fëmijët

e tjerë. Marrëdhënia midis problemeve të sjelljes së fëmijëve dhe ekspozimit ndaj dhunës në familje do të trajtohen më me hollësi në Kapitullin 6: Dhuna në familje nga partneri intim.

Tabela 3.8.Fëmijët në familje dhe problemet e sjelljes (të dhëna të ponderuara)

	Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Keni një fëmijë të moshës ≤ 17 vjeç që jeton me ju	37.4
Probleme të sjelljes tek fëmijët e moshës 5-17 vjeç	N=389,509
Shikon shpesh ëndrra të frikshme	13.6
Urionon shpesh në shtrat	10.5
Është mjaft i ndrojtur ose i tërhequr	11.1
Ka sjellje agresive me ju ose fëmijët e tjerë	3.4
Është larguar ndonjëherë nga shtëpia	20.9


Përdorimi i metodave për shmangien e shtatzënisë

Gratë u pyetën për mjetet kontraceptive për shmangien e shtatzënisë. Tabela 3.9 tregon se vetëm 8,2% e grave të intervistuar po përdornin në kohën e sondazhit një metodë për parandalimin e shtatzënisë. Midis grave që përdornin metoda për shmangien e shtatzënisë, 60,9% e tyre përdornin metodën e tërheqjes ose të largimit; ndërsa vetëm 32,3% e grave përdornin kontraceptivë dhe 24,8% përdornin

Tabela 3.9. Përdorimi i metodave dhe mjeteve kontraceptive për shmangien e shtatzënisë(të dhëna të ponderuara)

	Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Aktualisht përdorimi i një metode për shmangien e shtatzënisë	8.2
Metodat e shmangies së shtatzënisë	N=85,212
Sterilizimi femëror	1.1
Sterilizimi mashkullor	0.0
Tableta/pilula	24.8
Injektime	2.2
Implante	0.7
IUD	0.6
Diafragma/shkumë/xhelatinë	0.0
Kalendari/Metoda e mukusit	1.3
Prezervativë	32.3
Ushqyerja me gji	7.4
Bimë	2.6
Metoda e tërheqjes/largimit	60.9
Tjetër	1.0
Cili vendos për metodën e kontrollit të shtatzënisë	N=87,133
Ju	7.6
Bashkëshorti/i dashuri	9.6
Të dy bashkë, ju dhe bashkëshorti/i dashuri	80.9
Tjetër	0.7

Grafiku 3.1. Përdorimi i metodave për shmangien e shtatzënisë sipas grupmoshave (të dhëna të ponderuara)



tableta/pilula. Shumë më pak gra përdornin metoda të tjera për parandalimin e shtatzënisë. Gratë u pyetën se cili vendos për përdorimin e kontraceptivëve në martesën/marrëdhënien intime të tyre dhe 80,9% e grave raportuan se të dyja palët, edhe ato, edhe bashkëshorti/i dashuri vendosin për përdorimin dhe metodën e kontraceptivëve. Duhet vënë në dukje se 9,6% e grave të intervistuar raportuan se bashkëshortët /të dashurit e tyre vendosin nëse do të përdorin metoda për shmangien e shtatzënisë dhe cilat metoda. Të dhënat në tabelën 3.7 tregojnë se kur burrat përfshihen në marrjen e vendimit për përdorimin e metodës për shmangien e shtatzënisë, metoda më e preferuar është metoda e tërheqjes ose largimit.

Grafiku 3.1 tregon se gratë e moshës 25-34 vjeç (18,8%) dhe 35-44 vjeç(14,8%) kishin më shumë gjasa të përdornin një metodë për parandalimin e shtatzënisë krahasuar me gratë e moshës 18-24 vjeç (7,5%) dhe 45-54 vjeç (6,8%). Është e çuditshme se disa gra të moshës 55-64 vjeç (0,7%) dhe 65-74 vjeç (1,4%) raportuan përdorimin e një metode për shmangien e shtatzënisë, veçanërisht duke patur parasysh faktin që gratë e këtyre grupmoshave ka shumë të ngjarë që të jenë në situatë pas menopauze. Një shpjegim është se gratë e moshës 55 vjeçare dhe më shumë mund të përdorin prezervativë për të zvogëluar rrezikun e infeksioneve seksuale të transmetueshme (IST-ve), veçanërisht nëse ato kanë marrëdhënie seksuale jashtëmartesore.

Tabela 3.10 tregon se vetëm 2,8% e grave të intervistuar raportuan se bashkëshorti/i dashuri aktual apo më i fundit ka refuzuar të përdorë një metodë për të shmangur shtatzëninë ose është përpjekur t'i ndalojë ato të përdorin mjete kontraceptive për të shmangur shtatzëninë. Midis këtyre grave, shumica raportuan se bashkëshorti/i dashuri i tyre tallej me to (64,5%) me qëllim që t'i ndalonte të përdornin metoda për të shmangur shtatzëninë. Përveç kësaj, 33,8% e grave raportuan se bashkëshorti/i dashuri i tyre iu tha se nuk ishte dakord me përdorimin e kësaj metode për të shmangur shtatzëninë. Disa gra raportuan gjithashtu se bashkëshorti/i dashuri i


Tabela 3.10. Refuzimi i bashkëshortëve/të dashurve për përdorimin e metodave kontraceptive për shmangien e shtatzënisë (të dhëna të ponderuara)

Kampioni gjithsej N=1,040,726 %	
Bashkëshorti/i dashuri aktual apo më i fundit ka refuzuar ndonjëherë të përdorë një kontraceptiv për të shmangur shtatzëninë ose është përpjekur t'ju ndalojë të përdorni një metodë për të shmangur shtatzëninë	2.8
Mënyrat përmes të cilave bashkëshorti/i dashuri nuk pranon të përdorni metodat kontraceptive për të shmangur shtatzëninë	
Ju tha se nuk është dakord me përdorimin e kësaj metode për të shmangur shtatzëninë	23.1
Ju ka bërë tërheqje/është inatosur me ju	33.8
I hodhi poshtë kontraceptivët	6.8
Ju akuzoi se nuk jeni grua e mirë	6.9
Ju kërcënoi se do t'ju rrihte	15.6
Ju kërcënoi se do t'ju linte ose nxirrte jashtë nga shtëpia	17.8
U tall me ju	64.5
Tha se nuk është e nevojshme	12.0
Ju ka goditur ose rrahur	4.2
Tjetër	0.0

Tabela 3.11. Infeksionet seksuale të transmetueshme (IST) (të dhëna të ponderuara)

Kampioni gjithsej N=1,040,726 %	
Kanë frikë se janë në rrezik të marrin infeksione seksuale të transmetueshme, të tilla si HIV/AIDS	12.2
Kanë pasur ndonjëherë infeksione seksuale të transmetueshme	2.3
Kanë pasur infeksione seksuale të transmetueshme në 12 muajt e fundit	0.2

Grafiku 3.2. Përdorimi i metodave për shmangien e shtatzënisë (PMSHSH) dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme (të dhëna të ponderuara)



tyre i kërcënoi se do t'i linte ose nxirrte jashtë nga shtëpia për përdorimin e metodave për shmangien e shtatzënisë (17,8%), i kërcënoi se do t'i rrihte (15,6%), i akuzoi se nuk ishin gra të mira (6,9%), i hodhi poshtë kontraktivët (6,8%), dhe i ka goditur /rrahur ato (4,2%) sepse përdornin mjete kontraceptive për shmangien e shtatzënisë.

Infeksionet seksualisht të transmetueshme

Tabela 3.11 tregon se 12,2% e grave ishin të frikësuar se ishin në rrezik të merrnin infeksione seksualisht të transmetueshme, të tilla si HIV/AIDS. Përveç kësaj, 2,3% e grave kanë pasur gjatë jetës një infeksion seksualisht të transmetueshëm dhe 0,2% kishin një infeksion seksualisht të transmetueshëm në 12 muajt e fundit.

U analizuan të dhëna për të kuptuar marrëdhënien midis përdorimit të mjeteve kontraceptive dhe infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST). Mbani parasysh, metodat më të zakonshme të kontrollit të lindjeve ishin metodat e tërheqjes/largimit (60,9%), prezervativët (32,3%), dhe tabletat/pilulat (24,8%; shihni tabelën 3.7). Grafiku 3.2 tregon se gratë që përdornin metoda për shmangien e shtatzënisë (23,8%) kishin më shumë gjasa të kishin frikë se ishin në rrezik të merrnin ndonjë IST krahasuar me gratë që nuk përdornin metoda për shmangien e shtatzënisë (11,6%). Po ashtu, gratë që përdornin metoda për shmangien e shtatzënisë kishin më shumë gjasa të kishin ndonjë IST (6,6%) dhe të kishin ndonjë IST në 12 muajt e fundit (20,1%), krahasuar me gratë që nuk përdornin metoda për shmangien e shtatzënisë (përkatësisht 1,8% dhe 8,5%).

KAPITULLI 4



NJË VËSHTRIM RRETH DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE

Ky kapitull ofron një vështrim të disa prej gjetjeve kyçe që janë prezantuar në të gjithë këtë raport në lidhje me shtrirjen e DhNGV-së dhe marrëdhënien midis llojeve të ndryshme të DhNGV-së. Këto gjetje dhe një analizë më komplekse që ofrojnë një kuptim më të thelluar të natyrës dhe shtrirjes së DhNGV-së paraqiten në kapitujt në vazhdim.

Përjetimet e dhunës ndaj grave dhe vajzave

Tabela 4.1 jep një foto të përqindjes së grave të moshës 18-74 vjeç në Shqipëri që kanë përjetuar dhunë gjatë jetës së tyre (ndonjëherë) dhe në 12 muajt e fundit përpara intervistës (aktualisht). Të dhënat e paraqitura në tabelën 4.1 janë përqindjet e përgjithshme të shtrirjes për secilën prej llojeve të ndryshme të dhunës që diskutohen më me hollësi në kapitujt 6 deri në 10.

Në tërësi, 1 në 2 gra, apo 52,9% e grave të moshës 18-74 vjeç, kanë përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë se një nga pesë llojet e ndryshme të dhunës gjatë jetës së tyre – dhunë në familje nga partneri intim, dhunë në marrëdhënie dashurore, dhunë nga jopartneri, ngacmim seksual dhe/ose përndjekje. Në terma të DhPI-së, (dhunë nga partneri intim) 47% e grave (ato që ishin apo kishin qenë të martuara dhe/ose kishin jetuar me një partner mashkull) kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje nga partneri intim dhe 2 në 3 gra ose 65,8% e grave (ato që nuk ishin martuar ndonjëherë dhe që nuk kishin jetuar ndonjëherë me një partner

mashkull, por që janë përfshirë në një marrëdhënie me një mashkull pa jetuar së bashku) kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë gjatë marrëdhënieve dashurore (për të dhëna për pesë llojet e ndryshme të dhunës në familje nga partneri intim dhe marrëdhënie dashurore pasqyrohen në kapitullin 5 dhe kapitullin 6). Ndër të gjitha gratë e moshës 18-74 vjeç, gjatë jetës së tyre 18,2% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë nga jopartneri, 18,1% kanë përjetuar “ndonjëherë” ngacmim seksual dhe 12,6% kanë përjetuar “ndonjëherë” përndjekje (për të dhëna për llojet e ndryshme të dhunës nga jopartneri, ngacmimin seksual dhe përndjekjen shihni kapitujt 7 deri në 10).

Tabela 4.1 tregon gjithashtu se 1 në 3 gra ose 36,6% të të intervistuarave kanë përjetuar një apo më shumë se një nga pesë llojet e ndryshme të dhunës në 12 muajt përpara intervistës (aktualisht). Në terma të DhPI-së, 1 në 3 gra ose 33,7% e grave (ato që ishin apo kishin qenë të martuara dhe/ose kishin jetuar me një partner mashkull) kanë përjetuar “aktualisht” dhunë

në familje nga partneri intim dhe 61,8% e grave (ato që nuk ishin martuar ndonjëherë dhe që nuk kishin jetuar ndonjëherë me një partner mashkull, por që janë përfshirë në një marrëdhënie me një mashkull pa jetuar së bashku, të tillë si lidhje dashurie apo fejesë) kanë përjetuar “aktualisht” dhunë në lidhjen dashurore. Ndër të gjitha gratë e moshës 18-74 vjeç, 2,4% e grave kanë përjetuar “aktualisht” dhunë nga jopartneri, 8,5% e grave kanë përjetuar “aktualisht” ngacmime seksuale dhe 6,9% e grave kanë përjetuar “aktualisht” përndjekje në 12 muajt përpara vërtetimit.

Gratë zakonisht përjetojnë më shumë se një lloj dhune gjatë jetës së tyre. Grafiku 4.1 paraqet përqindjen e grave të moshës 18-74 vjeç që kanë përjetuar një ose më shumë se një nga llojet e dhunës të identifikuar në tabelën 4.1. Në mënyrë më specifike, 27% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” vetëm një nga llojet e dhunës, 15,7% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” dy lloje të dhunës, 7,6% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” tre lloje të dhunës, dhe 2,7% kanë përjetuar “ndonjëherë” katër lloje të dhunës. Kur flitet për eksperiencat “aktuale” të dhunës, 26,8% e grave kanë përjetuar “aktualisht” vetëm një nga llojet e dhunës të paraqitura në tabelën 4.1; 7,4% e grave kanë përjetuar “aktualisht” dy lloje të dhunës, 2,2% e grave kanë përjetuar “aktualisht” tre lloje të dhunës, dhe 0,2% e grave kanë përjetuar “aktualisht” katër lloje të dhunës.

Marrëdhënia ndërmjet dhunës nga jopartneri dhe dhunës në familje

Për të kuptuar marrëdhënien ndërmjet eksperiencave të grave me dhunën nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare dhe eksperiencave të dhunës në familje nga partneri intim u krye një analizë e mëtejshme. Tabela 4.2 tregon se 3 në 4 gra ose 75,8% e grave që kanë pësuar dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare kanë përjetuar edhe dhunë në familje nga partneri intim (shih kapitullin 7 për më shumë informacion rreth autorëve të dhunës nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare). Më i dukshëm është fakti se gratë që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (75,8%) kishin dy herë më shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje nga partneri intim, krahasuar me gratë që *nuk* kanë përjetuar dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (32,1%).

Table 4.1. Përjetime të dhunës ndaj grave dhe vajzave (të dhëna të ponderuara)

	Ndonjëherë %	Aktualisht %
Ka përjetuar dhunë (një ose më shumë se një nga 5 llojet)	52.9	36.6
Ka përjetuar dhunën në familje nga partneri intim	47.0	33.7
Ka përjetuar dhunë në lidhje dashurie	65.8	61.8
Ka përjetuar dhunë nga jopartneri që nga moshë 15 vjeçare	18.2	2.4
Ka përjetuar ngacmim seksual	18.1	8.5
Ka përjetuar përndjekje	12.6	6.9

Table 4.2. Marrëdhënia ndërmjet dhunës në familje nga jopartneri dhe partneri intim (të dhëna të ponderuara)

Përjetoi dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (ndonjëherë)	Përjetoi dhunë në familje nga partneri intim (ndonjëherë) %
Po	75.8
Jo	32.1

Shënja = .000

Tabela 4.3. Marrëdhënia ndërmjet dhunës në familje nga partneri intim dhe dhunës nga jopartneri (të dhëna të ponderuara)

Përjetoi dhunë në familje nga partneri intim (ndonjëherë)	Përjetoi dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (ndonjëherë) %
Po	34.5
Jo	7.4

Shënja = .000

Tabela 4.4. Përjetime të abuzimit seksual në fëmijëri (të dhëna të ponderuara)

Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Jeni prekur “ndonjëherë” seksualisht kundër dëshirës apo jeni detyruar të bëni diçka seksuale që keni dashur ta bëni kur ishit një vajzë e re në moshën 0 deri 17 vjeç
3.1

Grafiku 4.1. Numri i llojeve të dhunës të përjetuar (Të dhëna të ponderuara)




Tabela 4.3 tregon se 1 në 3 gra ose 34,5% e grave që kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim kanë pësuar dhunë gjithashtu edhe nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare. Kështu, marrëdhënia ndërmjet dhunës nga jopartneri dhe dhunës në familje nga partneri intim është shumë e fortë.


Përjetimet e abuzimit seksual në fëmijëri

Gratë u pyetën nëse ato kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë seksuale gjatë fëmijërisë së tyre, në moshën 0-17 vjeç. Tabela 4.4 tregon se 3,1% e grave të moshës 18-74 vjeçare raportuan se ishin abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë (domethënë, ato ishin prekur seksualisht kur nuk kishin dashur apo ishin detyruar të bënin diçka seksuale që nuk kishin dashur ta bënin).

Të dhënat u analizuan më tej për të kuptuar marrëdhënien ndërmjet përvojave të abuzimit seksual si fëmijë dhe përvojave të grave me llojet e tjera të dhunës

në moshë të rritur. Grafiku 4.2 tregon se gratë që kanë përjetuar abuzim seksual në fëmijëri (88,8%) kishin më shumë gjasa të përjetonin “ndonjëherë” dhunë seksuale dhe/ose dhunë me bazë gjinore në moshë të rritur në jetën e tyre krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (51,5%). Përveç kësaj, gratë që kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (64,6%) kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje nga partneri intim, krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (39,3%). Po ashtu, gratë që kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (41,9%) kishin dy herë më shumë gjasa të pësonin dhunë nga jopartneri që prej moshës 15 vjeçare, krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (17,7%). Këto gjetje tregojnë se gratë e abuzuara seksualisht në fëmijëri janë në rrezik të madh të pësojnë edhe forma të tjera të dhunës më vonë, në jetën e tyre. Studimet sugjerojnë që viktimizimi seksual në fëmijëri dhe/ose adoleshencë rrit mundësinë e viktimizimit seksual në moshë të rritur me 2 deri në 13,7 herë.^{110,111,112,113,114,115,116}

Grafiku 4.2. Marrëdhënia midis dhunimit seksual në fëmijëri dhe dhunës në moshë të rritur (Të dhëna të ponderuara)



KAPITULLI 5



NORMAT SOCIALE LIDHUR ME DHUNËN NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE

Ky kapitull shqyrton normat sociale lidhur me dhunën në familje nga partneri intim dhe dhunën seksuale ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri, së bashku me qëndrimet ose perceptimet mbi ashpërsinë e DhNGV-së në Shqipëri dhe rëndësinë e legjislacionit për DHNGV-në.

Ky kapitull nis me një vlerësim të fuqisë së normave sociale dhe një shpjegim të dallimeve ndërmjet normave sociale, qëndrimeve dhe sjelljeve personale, pas të cilave paraqiten gjetjet e Vrojtimit Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave (VKDhNGV) 2018 në Shqipëri.

Fuqia e normave sociale

“Psikologët socialë e pranojnë ndikimin e fuqishëm që ka identiteti i grupit social në qëndrimet dhe sjelljet individuale”.¹¹⁷ Në përgjithësi, individët përpigjen t’u përkasin dhe të ‘përshtaten’ me grupet shoqërore përkatëse, dhe duke bërë kështu, ata miratojnë dhe veprojnë në përputhje me normat sociale të grupit.¹¹⁸ Në disa raste, individët ndeshen me presionin për të vepruar në përputhje me normat sociale të një grupi shoqëror dhe grupet shoqërore ndëshkojnë anëtarët që devijojnë nga normat dhe standardet sociale të

grupeve.¹¹⁹ Ndëshkimi zakonisht ndodh nëpërmjet qortimit, shmangies dhe izolimit.¹²⁰

Përputhshmëriame normat dhe standardet sociale të një grupi shoqëror ‘nuk është dobësi njerëzore që duhet anashkaluar, por një tipar themelor i psikologjisë njerëzore që mund të motivojë rezultatet që janë edhe prosocialë, edhe antisocialë’.¹²¹ Duke pasur parasysh këtë realitet, është e rëndësishme të kuptohet fuqia e normave sociale, të cilat shtrihen deri tek të gjitha skajet e jetës publike dhe private të njerëzve çdo ditë. Normat sociale shpesh ‘funksionojnë si ligje, por zbatohen në mënyrë shoqërore dhe joformale; shkelësit ndëshkohen njësoj si shkelësit e ligjit, por ndëshkimi bëhet në mënyrë shoqërore (p.sh., nëpërmjet qortimit, shmangies ose izolimit social) nga anëtarët më të shquar të grupit.¹²² Kjo do të thotë se normat sociale shtrihen edhe më tej sesa ligjet shtetërore, sepse çdo anëtar i një grupi shoqëror mund të zbatojë normat sociale të grupit, domethënë burimet për të zbatuar

normat sociale janë të pakufizuara.¹²³ Nga dëshira për të qenë pjesë e një grupi, individët në jetën private nuk pajtohen me normën sociale (mbajnë qëndrime që bien ndesh me normat sociale).¹²⁴

Alexander-Scott, Bell dhe Holden¹²⁵ sjellin një rishikim të komponentëve të rëndësishëm të normave sociale. Edhe pse ka shumë përkufizime të normave sociale nga një sërë këndvështrimesh teorike dhe disiplina akademike, ka një marrëveshje të përgjithshme se normat shoqërore kanë tre komponentë të rëndësishëm:¹²⁶

1) Normat sociale janë besime të përbashkëta për të tjerët. Kjo përfshin: a) besimet për atë që të tjerët *“bëjnë në fakt”* në një grup (cila është sjellja tipike) dhe b) çfarë mendojnë të tjerët në një grup që *“duhet të bëjnë” të tjerët* (cila është sjellja e përshtatshme). Këto bindje u japin formë ‘pritshmërive sociale’ brenda një grupi njerëzish.

2) Për shkak se normat sociale janë bindje të përbashkëta për të tjerët, këto bindje ndonjëherë mund të jenë të pasakta.¹²⁷ Nga njëra anë, njerëzit mund të mendojnë gabim se sjelljet janë më tipike se ata vetë. Nga ana tjetër, shumica e një grupi mund të refuzojnë privatisht një sjellje, por i përmbahen sjelljes sepse ata gabimisht supozojnë se gjithkush mendon se është e sjellje e përshtatshme (e njohur si *padituri pluraliste*).^{128, 129} Në psikologjinë sociale, *padituria pluraliste* është kur shumica nuk e aprovon një sjellje, por supozon se të gjithë e miratojnë sjelljen (paaftësia e individëve për të pranar se të tjerët në grupin shoqëror nuk pajtohen me normën sociale të perceptuar).¹³⁰ Padituria pluraliste mund të shpjegojë pse sjelljet jofunksionale të grupeve¹³¹, siç është DHNGV-ja, i rezistojnë kohës kur individët nuk e kuptojnë shkallën e mbështetjes private për përmbysjen e normës sociale. Padituria pluraliste mund të përbëjë një shkak për vazhdimësinë e zakoneve që dëmtojnë individët, siç është martesja e hershme e vajzave, edhe pasi shumë individë të grupit shoqëror janë të bindur se praktika është e dëmshme për vajzat dhe gratë.¹³²

3) Normat sociale ekzistojnë brenda grupeve të referimit. Një ‘grup referimi’ ose “rrjet referimi”

është një grup me njerëz të rëndësishëm për një individ kur ai merr vendime.¹³³ Është e rëndësishme të theksohet se grupi i referimit mund të shpërndahet dhe të largohet, në vend që të përqendrohet dhe të gjendet në afërsinë fizike me individin që merr vendimin.

4) Normat sociale ruhen pjesërisht me miratimin dhe mospranimin brenda grupit të referimit.

Personat që shkelin pritshmërinë sociale brenda një grupi referimi ka të ngjarë të ndëshkohen ose të dënohen nga grupi, ndërsa personat që përmbushin normat sociale mund të shpërblehen. Sanksionet mund të shkojnë nga ndëshkimi i drejtpërdrejtë deri te humbja e mundësive nëpërmjet izolimit.^{134, 135} Dëshira për të qenë në përputhje me pritshmëritë sociale të një grupi referimi dhe kërcënimi i nënkuptuar ose i qartë me sanksione, nënkupton që normat shoqërore mund të jenë më bindëse dhe domethënëse në disa situata sesa faktorë të tjerë, të tillë si kërcënimi për dënim më formal nga shteti. Kjo gjithashtu do të thotë se për të përmbushur sjelljet e caktuara të pritshme, normat mund të tejkalojnë ndalimet ligjore. Për shembull, DhPI-ja është ende e zakonshme në shumë vende ku praktika është e paligjshme.

Është e rëndësishme të kuptohet se normat shoqërore dallohen nga bindjet dhe qëndrimet personale të individit. Kjo pasi një individ mund të ketë besime dhe qëndrime personale që janë të ndryshme nga normat sociale të grupit shoqëror. Për shembull, një individ mund të ketë bindje personale për DHNGV-në (p.sh. që një vend zhvillohet kur vendos ligje që mbrojnë gratë dhe fëmijët nga dhuna në familje) ose kanë qëndrime private që nuk e mbështesin kështjellimin e gruas (p.sh. bindjet që një burrë nuk ka të drejtë të godasë ose rrahë gruan dhe/ose fëmijët e tij) por këto besime dhe qëndrime mund të bien ndesh me normat sociale që individit percepton në komunitetin e tij lokal (p.sh., burrat duhet të përdorin dhunën për të disiplinuar dhe kontrolluar gratë dhe fëmijët e tyre, veçanërisht për sjelljet që shkelin pritshmëritë për sjelljet e grave dhe vajzave).¹³⁶

Duhet patur parasysh se normat sociale janë vetëm perceptime të sjelljes tipike ose të dëshiruar të një grupi; megjithatë, individët nuk i bazojnë idetë e tyre për

normat sociale në sondazhet përfaqësuese të opinionit mbi çka është me të vërtetë e dëshirueshme për grupin e tyre. Prandaj, individët shpesh i keqkuptojnë normat sociale dhe perceptimet e tyre mbi normat sociale të grupeve mund të jenë “të ekzagjeruara, të vjetëruara ose thjesht të gabuara”.¹³⁷ Megjithatë, normat sociale të perceptuara gabim mund të kenë një ndikim të fortë në qëndrimet dhe sjelljet e individit, pasi është perceptimi i normës sociale ai që ndikon tek qëndrimet dhe sjelljet.¹³⁸ Kjo është arsyeja pse ky kapitull është i rëndësishëm, pasi ai do të përdoret për të zhvilluar një kuptim më të mirë të normave dhe qëndrimeve sociale që pengojnë të drejtat e grave dhe vajzave dhe i japin jetëgjatësi mosbalancimeve gjinore dhe DHNGV-së në Shqipëri.

Dallimi midis normave sociale, qëndrimeve dhe sjelljeve

Është e rëndësishme të bëhet dallimi mes normave sociale dhe qëndrimeve personale që janë në fokus të këtij kapitulli. **Normat sociale** janë ato bindje të mbajtura gjerësisht në lidhje me atë që është tipike dhe e përshtatshme në një grup referimi; bindje në lidhje me atë që njerëzit e tjerë mendojnë se duhet të bëhet. Normat sociale mund të bazohen ose jo në bindje të sakta për qëndrimet dhe sjelljet e të tjerëve”.¹³⁹ Ndryshe nga kjo, **sjelljet** janë ato që dikush bën në fakt. Edhe pse bindjet dhe sjelljet janë të

lidhura mes tyre, ndodh shpesh që një normë sociale ndikon në sjellje dhe një sjellje mund të ndikojë në një normë sociale.¹⁴⁰ Ndërsa një normë sociale është një bindje e përbashkët, një **qëndrim personal** është një “tendencë për të vlerësuar diçka (një person, simbol, besim, objekt) me një shcallë favorizimi ose mosmiratim”.¹⁴¹ Qëndrimet personale nuk kanë gjasa të drejtojnë sjelljen e shumicës së njerëzve në një grup referimi, veçanërisht kur normat sociale bien ndesh me atëqëndrim.¹⁴² Ndërsa normat shoqërore, qëndrimet personale dhe sjelljet nuk e përjashtojnë njëra tjetrën, shpesh ato e përforcojnë njëra-tjetrën. Në veçanti, me kalimin e kohës, ajo që një individ bën për shkak të normave sociale (pritshmëritë sociale) mund të bëhet faktor i brendshëm dhe të respektohet për shkak të motiveve të brendshme, pavarësisht nga ajo që mendojnë të tjerët.¹⁴³

Pyetjet e intervistës janë hartuar për të matur në mënyrë sasiore normat sociale që lidhen me DHNGV-në. Duhet patur parasysh se matja e normave sociale nuk zëvendëson matjen e qëndrimeve dhe të sjelljeve; këto matje e plotësojnë njëra-tjetrën. Krahësimi i normave sociale me qëndrimet dhe sjelljet mund të zbulojë se deri në çfarë niveli normat bazohen në perceptime të sakta ose të pasakta të të tjerëve, të cilat mund të jenë të dobishme për hartimin e programit.¹⁴⁴ Shtojca A jep një shembull të masave, shembuj të treguesve dhe shembuj të pyetjeve për matjen e normave, qëndrimeve dhe të sjelljeve sociale që lidhen me DHNGV-në.

Tabela 5.1. Normat shoqërore të lidhura me dhunën në familje ndaj gruas nga partneri (të dhëna të ponderuara)

	Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se dhuna ndërmjet burrit dhe gruas është njëçështje private dhe të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë	52.2
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se një grua duhet të durojë njëfarë dhune për ta mbajtur familjen të bashkuar	46.5
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se kur një grua rrihet nga bashkëshorti është pjesërisht faji i saj	27.5
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se gruas duhet t'i vijë turp nëse flet me dikë jashtë familjes së saj për abuzimin apo dhunën në jetën bashkëshortore	27.6
Të gjithë ose shumica e burrave në komunitetin tuaj godasin apo rrahin ndonjëherë gratë e tyre	13.5
Të gjithë ose shumica e burrave në komunitetin tuaj godasin apo rrahin ndonjëherë gratë e tyre nëse ato refuzojnë të kryejnë marrëdhënie seksuale me ta	11.4

Fuqia e normave sociale në lidhje me DhNGV-në

Perceptimi i një burri se meshkujt në komunitetin e tij nuk i godasin gratë e tyre, ka të ngjarë ta kufizojë atë nga abuzimi me gruan e vet; nëse ai do të godiste ose do të keqtrajtonte gruan e tij, ai mund të ndeshej me mosmiratimin apo izolimin nga komuniteti. Normat sociale funksionojnë jo vetëm për të kufizuar sjelljen, por edhe për të miratuar sjelljen. Perceptimi se përdhunimi është i zakonshëm në komunitetin e një burri, mund ta lejojë atë që ta detyrojë gruan e tij të ketë marrëdhënie seksuale me të, me kuptimin se ai nuk do të përjetojë asnjë ndëshkim social. Ai madje mund të marrë miratimin shoqëror që ka mundur të kryejë marrëdhënie seksuale me gruan e tij, edhe pse nëpërmjet forcës. Ky shembull tregon se si sjelljet pozitive dhe negative janë zbatuar përmes normave sociale dhe forcave të tilla kufizuese dhe lejuese të sanksionimit social.

Burimi: Paluck, E.L. & L. Bell (2010). Shënimi i normave sociale që synojnë dhunën me bazë gjinore: Një rishikim i literaturës dhe vlerësimi kritik. Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit, f. 9.

“Normat sociale” janë bindje të mbajtura gjerësisht në lidhje me çfarë është tipike dhe e përshtatshme në një grup referimi. Normat shoqërore mund të bazohen ose jo në besime të sakta rreth qëndrimeve dhe sjelljeve të të tjerëve. Normat sociale janë një rregull i sjelljes të cilës i përmbahen njerëzit në një grup sepse besojnë se:

- a. Shumica e njerëzve të tjerë në grup veprojnë në përputhje me të (është sjellje tipike) DHE
- a. Shumica e njerëzve të tjerë në grup besojnë se duhet të veprojnë në përputhje me të (është sjellje e përshtatshme).

Burimi: Alexander-Scott, M., E. Bell & J. Holden (2016). Shënime të Udhëzuesit të DFID-it: Zhvendosja e normave sociale për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe vajzave. Londër: VAW Helpdesk, f. 9-11.

Matja sasiore e normave sociale mund të përdoret për të matur ndryshimin me kalimin e kohës të normave sociale, së bashku me qëndrimet dhe sjelljet; kjo është e rëndësishme sepse normat sociale nuk janë statike, por normat sociale mund dhe ndryshojnë me kalimin e kohës.¹⁴⁵ Ndryshimet në normat dhe sjelljet sociale mund të ndikohen nga aktivistë individualë, sjellësit e ndryshimeve dhe grupet e njerëzve me mendime të njëjta që organizohen për të ndryshuar gjendjen egzistuese.¹⁴⁶

Normat sociale të lidhura me dhunën në familje nga partneri intim

Tabela 5.1 zbulon normat shoqërore të lidhura me dhunën në familje ndaj gruas nga partneri intim. Është shumë e dukshme se 1 në 2 gra, ose 52,2% e grave të grupmoshës 18-74 vjeç pranonin se të gjithë ose shumica e personave në komunitet besojnë se dhuna ndërmjet burrit dhe gruas është një çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë, dhe 46,5% e grave pranonin se të gjithë ose shumica e personave në komunitet besojnë se një grua duhet të durojë njëfarë dhune për ta mbajtur familjen të bashkuar. Po ashtu, 1 në 4 gra pranonin se të gjithë ose shumica e personave në komunitet besojnë se kur një grua rrihet nga bashkëshorti është pjesërisht faji i saj (27,5%), dhe se gruas duhet t'i vijë turp nëse flet me dikë jashtë familjes së saj për abuzimin apo dhunën në jetën bashkëshortore (27,6%). Këto norma sociale mund të kontribuojnë në mbizotërimin e dhunës në familje ndaj grave nga ana e partnerit intim dhe të mbajtjes së grave të rrahura në kurthin e marrëdhënieve abuzive dhe të dhunshme.

Tabela 5.2. Normat sociale të lidhura me dhunën në familje ndaj gruas (të dhëna të ponderuara)

	Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se kur një grua përdhunohet, ajo duhet të ketë bërë ndonjë veprim të pakujdesshëm që e ka vënë veten në atë situatë	21.2
Të gjithë ose shumica e personave në komunitetin tuaj besojnë se gruas duhet t'i vijë turp ose të ndihet në siklet të flasë me dikë nëse është përdhunuar	26.1

Megjithë normat sociale që lidhen me dhunën në familje ndaj grave nga partneri intim, tabela 5.1 tregon se vetëm 13,5% e grave mendonin se të gjithë ose shumica e burrave në komunitetin e tyre i godasin ose rrahin ndonjëherë gratë e tyre, dhe 11,4% e grave mendonin se të gjithë ose shumica e burrave në komunitetin e tyre i godasin ose rrahin ndonjëherë gratë e tyre nëse ato refuzojnë të kryejnë marrëdhënie seksuale me ta.

Normat sociale të lidhura me dhunën seksuale ndaj grave dhe vajzave

Në lidhje me normat sociale të lidhura me dhunën seksuale, tabela 5.2 tregon se 1 në 4 gra ose 26,1% e grave të grupmoshës 18-74 vjeç mendonin se të gjithë ose shumica e personave në komunitet besojnë se gruas duhet t'i vijë turp ose të ndihet në siklet të flasë me dikë nëse është përdhunuar dhe 1 në 5, ose 21,2% gra mendonin se të gjithë ose shumica e personave në komunitet besojnë se kur një grua përdhuhet, ajo duhet të ketë bërë ndonjë veprim të pakujdesshëm që e ka vënë veten në atë situatë.

Ashpërsia e perceptuar e DhNGV-së

Kur u pyetën rreth ashpërsisë së DhNGV-së në Shqipëri, 3 në 4 gra ose 75,4% e grave raportuan se dhuna ndaj grave është një problem madhor në Shqipëri, dhe 70,8% e grave mendonin se dhuna seksuale ndaj grave dhe vajzave është një problem madhor në Shqipëri. Përveç këtyre, 2 në 3 gra ose 69,9% e grave raportuan se ngacmimi seksual i grave dhe vajzave është një problem madhor në Shqipëri dhe 2 në 3 gra ose 68,4% raportuan se në Shqipëri është problem madhor përndjekja e grave. Të dhënat tregojnë se gratë e pranojnë se DhNGV, në të gjitha format e saj, është një problem madhor dhe i rëndë në Shqipëri.

Në pranimin e ashpërsisë dhe seriozitetit të DhNGV-së në Shqipëri, tabela 5.4 tregon se 79,5% e grave e quajnë të pranueshme nëse mjekët /personeli mjekësor i pyesin gratë që kanë lëndime të ndryshme nëse janë të shkaktuara nga dhuna seksuale dhe/ose dhuna me bazë gjinore.

Tabela 5.3. Ashpërsia e perceptuar e DhNGV-së në Shqipëri (të dhëna të ponderuara)

Sa i rëndë është problemi i dhunës ndaj grave në familje/jetën bashkëshortore në Shqipëri?	Kampioni gjithsej N=1,040,726 %
Problem madhor	75.4
Problem mesatar	17.6
Problem i vogël	2.3
Nuk është fare problem	1.9
Nuk e di	2.5
Sa i rëndë është problemi i dhunës seksuale ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri?	
Problem madhor	70.8
Problem mesatar	19.1
Problem i vogël	4.3
Nuk është fare problem	1.2
Nuk e di	4.3
Sa i rëndë është problemi i ingacmimit seksual ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri?	
Problem madhor	69.9
Problem mesatar	18.6
Problem i vogël	5.9
Nuk është fare problem	1.7
Nuk e di	3.9
Sa i rëndë është problemi i përndjekjes së grave dhe vajzave në Shqipëri?	
Problem madhor	68.4
Problem mesatar	19.1
Problem i vogël	7.1
Nuk është fare problem	2.1
Nuk e di	3.2

Tabela 5.4. Pranueshmëria që punonjësit e shëndetësisë të pyesin për DhNGV-në (të dhëna të ponderuara)

	Kampioni gjithsej N=1.040.726 %
A do të ishte e pranueshme nëse mjekët /personeli mjekësor i pyesin gratë që kanë lëndime të ndryshme nëse janë të shkaktuara nga dhuna	79,5


Rëndësia e ligjeve për DhNGV-në

Përveç pranimi të DhNGV-sësi një problem madhor në Shqipëri, tabela 5.5 tregon se 83% e grave të grupmoshës 18-74 vjeç mendonin se është shumë e rëndësishme që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesat/familjet e tyre dhe 81,9% mendonin se është shumë e rëndësishme që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga sulmet seksuale dhe përdhunimi.

Tabela 5.5. Rëndësia e ekzistencës në Shqipëri të ligjeve për dhunën në familje dhe dhunën seksuale (Të dhëna të ponderuara)

Sa e rëndësishme është që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesat/familjet e tyre?	Kampioni gjithsej
	N=1.040.726 %
Shumë e rëndësishme	83,0
E rëndësishme	15,4
Nuk është e rëndësishme	1,1
Nuk e di	,4
Sa e rëndësishme është që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga sulmet seksuale/përdhunimi?	
Shumë e rëndësishme	81,9
E rëndësishme	16,7
Nuk është e rëndësishme	,9
Nuk e di	,4

KAPITULLI 6



DHUNA NË FAMILJE NGA PARTNERI INTIM

Në shkallë globale, Dhuna nga Partneri Intim (DhPI) është forma më e përhapur e DHNGV-së. DhPI-ja është një shfaqje e pabarazive gjinore që ekzistojnë në marrëdhënie intime, familje dhe në shoqëri, në përgjithësi. Ndonëse DhPI-ja ekziston në të gjitha shoqëritë, shoqëritë me praktika më tradicionale patriarkale dhe me stereotipa të roleve gjinore¹⁴⁷ janë të prira të kenë shkallë më të larta të DhPI-së.

Gjithashtu, në vendet ku praktikat kulturore janë të tilla që diktojnë ikjen e grave nga familja ku janë lindur dhe vajtjen për të jetuar me burrin dhe familjen e tij, e përforcojnë izolimin e grave nga familja e tyre e lindjes dhe i vënë ato në një rrezik më të madh dhune martesore. Në situata të tilla, autorët e dhunës martesore nuk janë vetëm bashkëshortët, por mund të jenë edhe njerëzit e burrit, sidomos vjehrrat dhe kunatat, sidomos në familje ku gratë e porsamartuara lihen në pozicionin më të ulët në familjen martesore (dhuna nga jo-partneri do të diskutohet në Kapitullin 8).^{148, 149}

Në Shqipëri, VKDhF-të e vitit 2007 dhe 2013 treguan se rreth 56,0% deri në 59,4% e grave që ishin martuar/kishin bashkëjetuar ndonjëherë kishin kanë përjetuar DhPI¹⁵⁰ gjatë jetës së tyre, dhe pjesa më e madhe e DhPI-së kish ndodhur në kuadër të martesës dhe mjedisit familjar. VKDhF-ja e vitit 2013 tregoi se 24,6% e grave kishin kanë përjetuar DhPI fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, gjatë jetës së

tyre. Ky kapitull përqendrohet konkretisht tek dhuna në familje nga partneri intim e përjetuar nga gratë e moshës 18-74 vjeç, të cilat aktualisht janë/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose kanë jetuar me bashkëshortë/partnerë. DhPI-ja është përjetuar nga gratë e moshës 18-74 vjeç që nuk janë martuar dhe/ose që nuk kanë jetuar kurrë me një me një bashkëshort/partner, por që janë përfshirë në një marrëdhënie me një mashkull, që do të analizohet veçan dhe që quhet dhunë gjatë një marrëdhënie dashurore. Nga njëra anë, këto ishin dy module të veçanta në vërtetim, por nga ana tjetër, analiza e të dhënave tregoi ndryshimin midis dhunës në familje nga partneri intim (nga bashkëshorti/partneri aktual ose i mëparshëm) dhe dhunës në marrëdhënie dashurore (nga i dashuri aktual ose i dikurshëm). Ky dallim është i rëndësishëm sepse gratë përjetojnë lloje të ndryshme dhune, në shkallë të ndryshme, në lloje të ndryshme marrëdhëniesh, kështu që ishte me rëndësi të theksoheshin këto dallime në procesin e përpilimit të raportit.

Llojet e zakonshme të dhunës në familje nga partneri intim përfshijnë dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike. Studimet ndërkombëtare kanë konstatuar se shumica e grave që përjetojnë dhunë në marrëdhëniet intime, shpesh përjetojnë forma të shumëfishta dhune dhe durojnë akte të përsëritura dhune nga bashkëshorti/partneri aktual dhe/ose i dikurshëm. Në kuadër të martesës, dhuna seksuale mund të mos njihet dhe përkufizohet si e tillë, për shkak të supozimeve se bashkëshortët janë të përligjur kur i detyrojnë bashkëshortet të bëjnë seks me ta dhe se gratë janë të detyruara të kënaqin seksualisht nevojat e bashkëshortëve. Në shumë vende, ka një ngurrim për t'i përcaktuar aktet seksuale me detyrim në kuadër të martesës si dhunë seksuale apo përdhunim martesor. Megjithatë, Shqipëria ka ligje që adresojnë përdhunimin martesor dhe parashikojnë ndëshkime më të ashpra për autorët e përdhunimit martesor, që tashti është vepër penale më vete.

Në shumë shoqëri, besohet se ka “arsye të përligjura” për dhunën në familje nga partneri intim, sidomos kur gratë nuk i plotësojnë pritshmëritë e roleve të tyre gjinorë (për shembull, gruaja djeg gjellën, kundërshton burrin, del pa i dhënë atij, lë pas dore fëmijët, apo refuzon të bëjë seks me të shoqin). Në këto rrethana që supozohen si të përligjura, gratë fajësohen për viktimizimin e tyre, duke ua bërë të vështirë të hapin gojën dhe të kërkojnë mbrojtje nga bashkëshortët/partnerët e tyre dhunues. Studimet ndër-kulturore tregojnë se në shumë shoqëri, si burrat edhe gratë, të rinjtë e të moshuarit pajtohen me qëndrimet kulturore dhe normat shoqërore që përligjin rrahjen e gruas.¹⁵¹

Përveç se pranohet në kulturën e shumë shoqërive, dhuna në familje nga partneri intim mbetet në një masë të madhe e fshehtë pas dyerve të mbyllura dhe tejet e stigmatizuar, duke ua bërë të vështirë grave të flasin për të dhe të kërkojnë ndihmë dhe mbrojtje. Gratë që përjetojnë dhunë në familje nga partneri intim shpesh e dinë se nuk kanë ku të shkojnë, veçanërisht në ato shoqëri ku shërbimet mbështetëse janë të kufizuara dhe ku është e vështirë që gratë t'i lenë bashkëshortët/partnerët dhe të jetojnë vetëm.¹⁵² Në shoqëri me shkallë të larta dhune në familje nga partneri intim, vajzat mësojnë që në moshë të re se nuk duhet t'i kundërshtojnë abuzimet dhe dhunën,

duke u mësuar ta shohin dhunën ndaj grave të bëhet diçka normale në familjet e tyre.¹⁵³

Ky kapitull paraqet të dhëna mbi natyrën dhe shtrirjen e dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim, të përjetuar nga gratë e moshës 18-74 vjeç në Shqipëri, dhe dallimet e bazuara në grupimet e moshave. Ky kapitull shqyrton gjithashtu: përjetimet e lëndimeve të grave nga dhuna në familje; sjelljet e grave që kërkojnë ndihmë; marrëdhënien midis përdorimit/abuzimit të alkoolit nga bashkëshorti/partneri dhe përjetimeve të grave të dhunës në familje dhe të lëndimeve të dhunës në familje; dhe përjetimin nga gratë të dhunës seksuale dhe përdorimin prej tyre të mjeteve të kontrollit të lindjes dhe riskun e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST). Kapitulli shqyrton gjithashtu ndikimin e mundshëm të dhunës në familje tek fëmijët dhe karakteristikat e autorëve të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim.

Kampioni i grave që kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim

Në këtë kapitull, kampioni i grave përfshin vetëm gratë moshës 18-74 vjeç që ishin aktualisht ishin/kishin qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose jetonin/kishin jetuar me një bashkëshort/partner në kohën e intervistës (N=886.374). Tabela 6.1 tregon se kampioni përfshinte një shpërndarje mjaft të barabartë të grave në grup-moshat 25-34 vjeç (19,2%), 35-44 vjeç (18,3%), 45-54 vjeç (21,6%), dhe 55-64 vjeç (21,4%), por më pak gra në grup-moshat 18-24 vjeç (6,5%) dhe 65-74 vjeç (13,0%). Mosha mesatare e grave që ishin martuar dhe/që jetonin aktualisht/kishin jetuar ndonjëherë me një bashkëshort/partner ishte 47.1 vjeç (3.5 vjeç më e madhe se mosha mesatare e të gjithë kampionit të grave, që ishte 43.6 vjeç).

Përjetime të dhunës në familje nga partneri intim

Grave të moshës 18-74 vjeç që ishin aktualisht/kishin qenë ndonjëherë të martuara dhe jetonin/ose kishin jetuar me një bashkëshort/partner iu bënë një varg pyetjesh për përjetimet e tyre të dhunës në familje nga partneri intim të ushtruar

Tabela 6.1. Kampioni sipas moshës i dhunës në familje nga partneri intim (të dhëna të ponderuara)

Grupmoshat	N=886,374	
	%	
18-24 vjeç	6.5	
25-34 vjeç	19.2	
35-44 vjeç	18.3	
45-54 vjeç	21.6	
55-64 vjeç	21.4	
65-74 vjeç	13.0	

Tabela 6.2. Përjetime të dhunës në familje nga partneri intim (të dhëna të ponderuara)

	N=886,374	
	Ndonjëherë %	Aktualisht %
Kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim (një apo më shumë nga 5 llojet)	47.0	33.7
Sjellje kontrolluese shtrënguese (një apo më shumë nga 7 llojet)	41.2	25.2
Dhunë ekonomike (një apo më shumë nga 3 llojet)	7.0	7.0
Dhunë psikologjike (një apo më shumë nga 8 llojet)	31.4	19.7
Dhunë fizike (një apo më shumë nga 11 llojet)	18.0	7.2
Dhunë seksuale (një apo më shumë nga 3 llojet)	8.6	3.6
Dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja	21.0	8.2

Vini re: Përqindjet kur mbledhen nuk arrijnë shumën 100% sepse të anketuarat mund të kenë kanë përjetuar më shumë se një lloj dhune.

nga bashkëshorti/partneri aktual dhe/ose i fundit. Tabela 6.2 tregon se pothuaj 1 në 2, ose 47,0% e grave kishin përjetuar “ndonjëherë” dhe 1 në 3, ose 33,7% përjetonin “aktualisht” një apo më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës në familje nga partneri intim të renditura në Tabelën 6.2. Më konkretisht, 21,0% e grave kishin përjetuar “ndonjëherë” dhe 8,2% përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose


seksuale, ose të dyja, nga bashkëshorti/partneri aktual dhe/ose i fundit.

Për sa u takon përjetimeve të dhunës në familje nga partneri intim gjatë jetës, 41,2% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” sjellje kontrolluese shtrënguese, 31,4% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë psikologjike, 18,0% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike, 8,6% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë seksuale, dhe 7,0% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë ekonomike. Midis grave që kanë përjetuar dhunë nga partneri intim gjatë 12 muajve përpara intervistës, 1 në 4, ose 25,2% përjetonin “aktualisht” sjellje kontrolluese shtrënguese, 19,7% përjetonin “aktualisht” dhunë psikologjike, 7,2% përjetonin “aktualisht” dhunë fizike, 7,0% përjetonin “aktualisht” dhunë ekonomike, dhe 3,6% përjetonin “aktualisht” dhunë seksuale (për listën e akteve të sjelljeve të veçanta të përdorura për matjen e sjelljeve kontrolluese shtrënguese, si dhuna ekonomike, dhuna psikologjike, dhuna fizike dhe dhuna seksuale, shih pjesët përkatëse dhe Tabelat që vijojnë).

U kryen analiza të mëtejshme për të kuptuar marrëdhënien midis moshës dhe përjetimeve të dhunës në familje nga partneri intim. Grafiku 6.1 tregon se gratë e moshës 18-24 vjeç kishin më shumë gjasa të përjetonin “ndonjëherë” dhe “aktualisht” dhunë në familje nga partneri intim (55,8% ndonjëherë, 55,8% aktualisht). Me rritjen e moshës së grave, përjetimet e tyre “aktuale” të dhunës në familje nga partneri intim pakësoheshin ndjeshëm. Në fakt, gratë e moshës 55-64 vjeç (25,8%) dhe 65-74 vjeç (18,2%) kishin më pak gjasa të përjetonin dhunë në familje nga partneri intim; pavarësisht se dhuna në familje vijonte të ishte e pranishme në jetën e tyre. Ndonjëherë, Shenja = .000; Aktualisht, Shenja = .000

Është e dokumentuar mirë se gratë e rrahura nuk përjetojnë vetëm një lloj dhune në familje, por shpesh përjetojnë lloje të shumëfishta dhune.^{154,155} Grafiku 6.2 tregon se vetëm 16,1% e grave kanë përjetuar vetëm një lloj dhune në familje nga partneri intim, renditur në Tabelën 6.1, tregon se 13,1% e grave kanë përjetuar dy lloje dhune, 10,0% kanë përjetuar tri lloje të ndryshme, 5,1% kanë përjetuar katër lloje, dhe 2,7% i kanë përjetuar të pesë llojet e dhunës në familje nga partneri intim gjatë jetës së tyre. Një model i ngjashëm doli në lidhje me përjetimet

Grafiku 6.1. Përjetime të dhunës në familje nga partneri intim sipas grupmoshës (të dhëna të ponderuara)




aktuale të grave nga dhuna në familje nga partneri intim, ku 16,8% e tyre përjetonin aktualisht vetëm një lloj dhune në familje nga partneri intim, 10,0% përjetonin aktualisht dy lloje, 3,5% përjetonin tri lloje, 1,5% përjetonin katër lloje, dhe 1,9% e grave përjetonin aktualisht të pesë llojet e dhunës në familje nga partneri intim, të renditura në Tabelën 6.1.

Ndonjëherë, Shenja = .000; Aktualisht, Shenja = .000

U bënë analiza të tjera për të shqyrtuar marrëdhënien midis secilës nga pesë llojet e dhunës në familje të ushtruara nga partneri intim. Tabela 6.3 tregon shkallën në të cilën secila nga pesë llojet e ndryshme të dhunës, shërben si parashikuese e llojeve të tjera të dhunës që ndodhin në martesën/marrëdhënien e tyre intime të grave. Në veçanti, 65,3% e grave që kanë përjetuar sjellje kontrolluese shtrënguese në martesë/marrëdhënien intime të tyre, kanë përjetuar edhe dhunë psikologjike, 38,4% kanë përjetuar dhunë fizike, 20,0% kanë përjetuar dhuna seksuale, dhe 16,0% kanë përjetuar dhunë ekonomike. Midis grave që kanë përjetuar dhunë ekonomike, 93,8% e grave kanë përjetuar gjithashtu edhe sjellje kontrolluese shtrënguese, 88,2% kanë përjetuar dhunë psikologjike, 73,4% kanë përjetuar dhunë fizike, dhe 41,7% kanë përjetuar dhunë seksuale. Tabela 6.3 tregon gjithashtu se 85,5% e grave që kanë përjetuar dhunë psikologjike, kanë përjetuar edhe sjellje kontrolluese shtrënguese, 48,7% kanë përjetuar dhunë fizike, 25,2% kanë

Grafiku 6.2. Numri i llojeve të dhunës në familje nga partneri intim të përjetuara nga gratë (të dhëna të ponderuara)



përjetuar dhunë seksuale, dhe 19,7% kanë përjetuar dhunë ekonomike.

Midis grave që kanë përjetuar dhunë fizike, 87,8% kanë përjetuar sjellje kontrolluese shtrënguese, 85,1% kanë përjetuar dhunë psikologjike, 31,2% kanë përjetuar dhuna seksuale, dhe 28,7% kanë përjetuar dhunë ekonomike. Këto gjetje vënë në dukje se gratë që rrihen fizikisht nga bashkëshortët/partnerët e tyre, kanë shumë gjasa të përjetojnë edhe sjellje kontrolluese shtrënguese dhe dhunë psikologjike.

Së fundi, Tabela 6.3 tregon se 95,2% e grave që kanë përjetuar dhuna seksuale, kanë përjetuar edhe sjellje kontrolluese shtrënguese, 91,8% kanë përjetuar dhunë psikologjike, 65,1% kanë përjetuar dhunë fizike, dhe 33,9% kanë përjetuar dhunë ekonomike. Me fjalë të tjera, prania e dhunës seksuale në martesën/marrëdhënien intime të një gruaje është një parashikues shumë i fortë se po ndodhin gjithashtu edhe lloje të tjera të dhunës dhe abuzimeve në martesën/marrëdhënien e saj intime.

Sjellje kontrolluese shtrënguese

Kontrolli shtrëngues është një formë e dhunës në familje e bazuar në dhunimin emocional dhe psikologjik, i cili përfshin një rrugë strategjike sjelljesh

Tabela 6.3. Marrëdhënia midis llojeve të ndryshme të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim (të dhëna të ponderuara)

N=886,374					
	Sjellje kontrolluese shtrënguese	Dhunë ekonomike	Dhunë psikologjike	Dhunë fizike	Dhunë seksuale
	%	%	%	%	%
Sjellje kontrolluese shtrënguese	---	16.0a	65.3a	38.4a	20.0a
Dhunë ekonomike	93.8a	---	88.2a	73.4a	41.7a
Dhunë psikologjike	85.5a	19.7a	---	48.7a	25.2a
Dhuna fizike	87.8a	28.7a	85.1a	---	31.2a
Dhuna seksuale	95.2a	33.9a	91.8a	65.1a	---

^a Shenja = .000


shtypëse që kanë për qëllim të sigurojnë dhe zgjerojnë privilegjet gjinore, duke u hequr grave të drejtat dhe liritë e tyre, dhe duke vendosur një regjim sundimi në jetën e tyre personale. Burrat dhunues përdorin sjellje kontrolluese shtrënguese për të izoluar dhe kontrolluar gratë, dhe për t'u ngjallur atyre frikë dhe ankth. Vrojtimi përfshiu shtatë zëra specifikë të sjelljes të cilët matin forma të ndryshme të sjelljes kontrolluese shtrënguese që gratë përjetojnë zakonisht në martesë/marrëdhënie intime të dhunshme. Si pjesë e analizës, të shtatë zërat specifikë të sjelljes u përlogaritën për të krijuar një matje të përgjithshme të përjetimeve nga gratë të sjelljeve kontrolluese shtrënguese. Studiuesit e dhunës në familje janë të mendimit se ka shumë për të mësuar përmes matjes së sjelljeve kontrolluese shtrënguese me vrojtme kombëtare me bazë popullatën për sa i takon DhPI-së, sepse shtrirja e abuzimeve kontrolluese shtrënguese mbështetet tek gjinia, duke i mposhtur plotësisht viktimat.¹⁵⁶

Tabela 6.4 tregon se 41,2% e grave të moshës 18-74 vjeç, që ishin aktualisht/kishin qenë ndonjëherë të martuara dhe jetonin/ose kishin jetuar me një bashkëshort/partner, kishin përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë nga shtatë sjelljet e ndryshme kontrolluese shtrënguese, dhe 1 në 4, ose 25,2% kishin përjetuar një apo më shumë sjellje kontrolluese shtrënguese gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht). Lloji më i zakonshëm i sjelljes kontrolluese shtrënguese që gratë përjetonin ishte fakti që burri/partneri bëhej xheloz/zemërohej kur ato flisnin

Tabela 6.4. Përjetime të sjelljes kontrolluese shtrënguese të ushtruara nga bashkëshortët/partnerët (të dhëna të ponderuara)

N=886,374		
	Ndonjëherë	Aktualisht
	%	%
Kanë përjetuar sjellje kontrolluese shtrënguese (një apo më shumë nga 7 llojet)	41.2	25.2
Bëhet xheloz/zemërohet kur flisni me burra të tjerë	38.6	20.6
Ju akuzon se jeni të pabesa	5.8	2.8
Përpiqet t'ju kufizojë apo nuk ju lejon të takoheni me shoqet	17.4	11.3
Orvatet të kufizojë kontaktet me prindërit apo të afërm të tjerë	5.7	3.7
Ju kontrollon sepse dëshiron të dijë ku jeni gjatë gjithë kohës	16.8	12.9
Ju kufizon/pengon të merrni kujdes shëndetësor	0.8	0.4
Ju bën presion apo ju detyron t'i jepni fjalëkalimin e telefonit celular, emailit apo llogarive të mediave sociale	8.1	6.0

Grafiku 6.3. Numri i llojeve të sjelljeve kontrolluese shtrënguese të përjetuara (të dhëna të ponderuara)



Ndonjëherë, Shenja = .000; Aktualisht, Shenja = .000

me burra të tjerë (38,6% ndonjëherë, 20,6% aktualisht). Disa gra raportuan gjithashtu se bashkëshortët/partnerët orvateshin t'i kufizonin apo nuk i lejonin të takoheshin me shoqet e tyre (17,4% ndonjëherë, 11,3% aktualisht) dhe i kontrollonin, duke dashur të mësonin se ku kishin qenë gjatë gjithë kohës (16,8% ndonjëherë, 12,9% aktualisht).

Ndonëse të pakta në numër, gratë raportuan gjithashtu se bashkëshortët/partnerët: u bënëin presion apo i detyronin t'u tregonin fjalëkalimet e telefonave celularë, të emailit dhe/ose të llogarive të medias sociale (8,1% ndonjëherë, 6,0% aktualisht); i akuzonin se ishin të pabesa (5,8% ndonjëherë, 2,8% aktualisht); përpiqeshin t'u kufizonin kontaktet me prindërit dhe me të afërm të tjerë (5,7% ndonjëherë, 3,7% aktualisht); dhe i kufizonin apo i pengonin të merrnin kujdes shëndetësor (0,8% ndonjëherë, 0,4% aktualisht).


Është e rëndësishme të kuptojmë se gratë e rrahura nuk përjetojnë vetëm një formë sjelljeje kontrolluese shtrënguese në martesën/marrëdhënien e tyre intime; shpesh ato përjetojnë forma të shumëfishta sjelljesh kontrolluese shtrënguese. Grafiku 6.3 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar “ndonjëherë”një apo më shumë nga shtatë sjelljet e ndryshme kontrolluese shtrënguese, të cilat përbënin shkallën kontrolluese shtrënguese. Ndërsa 41,2% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” sjellje kontrolluese

shtrënguese në martesën/marrëdhënien intime të tyre, vetëm 16,3% e grave kanë përjetuar një lloj sjelljeje kontrolluese shtrënguese, të renditur në Tabelën 6.3, 9,5% përjetojnë dy lloje, 8,1% kanë përjetuar tri lloje, 4,6% kanë përjetuar katër lloje, 1,4% kanë përjetuar pesë lloje, 1,0% kanë përjetuar gjashtë lloje, dhe më pak se 1,0% kanë përjetuar secilën nga shtatë llojet e sjelljeve kontrolluese shtrënguese. Përqindja e grave që përjetonin “aktualisht” një apo më shumë nga shtatë llojet e sjelljeve kontrolluese shtrënguese tregoni një model të ngjashëm.

Të dhënat u analizuan më tej për të kuptuar marrëdhënien midis moshës së grave dhe përjetimeve të sjelljeve kontrolluese shtrënguese në martesën/marrëdhënien e tyre intime. Grafiku 6.4 tregon se një përqindje e konsiderueshme e grave në të gjitha grupmoshat kanë përjetuar “ndonjëherë” sjellje kontrolluese shtrënguese nga bashkëshorti/partneri aktual dhe/apo i fundit. Kini parasysh se gratë më të vjetra mund ta kenë pasur të vështirë të kujtonin sjelljet kontrolluese shtrënguese të kohëve të para të martesës.

Për sa u takon përjetimeve aktuale të sjelljeve kontrolluese shtrënguese, Grafiku 6.4 tregon se 1 në 2, ose 49,7% e grave të moshës 18-24 dhe 1 në 3, ose 38,7% e grave të moshës 25-34 kishin më shumë gjasa të përjetonin “aktualisht” sjellje kontrolluese shtrënguese në martesën/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar

Grafiku 6.4. Përjetime sjelljesh kontrolluese shtrënguese sipas grupmoshave (të dhëna të ponderuara)



Ndonjëherë, Shenja = .000; Aktualisht, Shenja = .000

me gratë e moshës 35-44 vjeç (28,2%), 45-54 vjeç (21,%), 55-64 vjeç (16,5%) dhe 65-74 vjeç (8,8%). Ndonëse gratë më të vjetra kishin më pak të ngjarë të përjetonin sjellje kontrolluese shtrënguese gjatë 12 muajve përpara intervistës, përsëri kishte disa gra që kishin përjetuar këtë lloj dhune në familje nga partneri intim.


Dhuna ekonomike

Dhunë ekonomike janë aktet e kontrollit dhe monitorimit të sjelljes së një individi në lidhje me përdorimin dhe shpërndarjen e parave dhe kërcënimin e vazhdueshëm të mbarimit të burimeve ekonomike.¹⁵⁷ Dhuna ekonomike përfshin akte të tilla si mohimi i parave, refuzimi për të kontribuar financiarisht, mosplotësimi i nevojave për ushqim dhe nevojave bazë, dhe kontrolli i qasjes në shërbimin shëndetësor, punësim, dhe të tjera. Në marrëdhënie shtëpiake dhe intime, burrat dhunues përdorin dhunën ekonomike për të kontrolluar paratë e familjes, duke përfshirë pagat e grave kur ato punojnë jashtë shtëpisë. Vrojtimi përfshiu zëra specifikë sipas sjelljeve të tyre, të cilët matën forma të ndryshme të dhunës ekonomike që gratë përjetojnë zakonisht në martesë/marrëdhënie intime dhunuese. Si pjesë e analizës, tre zërat e sjelljes specifike u përlogaritën për të krijuar një matje të përgjithshme të përjetimeve të grave nga dhuna ekonomike.

Tabela 6.5. Përjetime të dhunës ekonomike të ushtruar nga bashkëshorti/partneri (të dhëna të ponderuara)

N=886,374	
	%
Kanë përjetuar dhunë ekonomike (një apo më shumë nga 3 llojet)	7.0
Ju ndalon të gjeni një punë, të shkoni në punë, të tregtoni, të fitoni para apo të merrni pjesë në projekte që gjenerojnë të ardhura	4.0
Jua merr të ardhurat apo ju kontrollon paratë apo pronat kundër vullnetit tuaj	3.8
Refuzon t'ju japë paratë që ju nevojiten për shpenzimet e familjes, edhe kur ka para për gjëra të tjera (si alkool apo cigare)	2.9

Grafiku 6.5. Numri i llojeve të dhunës ekonomike të përjetuara nga gratë (Të dhëna të ponderuara)



3,8% e grave raportuan se bashkëshortët/partnerët ua merrnin të ardhurat kundër vullnetit të tyre dhe/ose ua kontrollonin paratë apo pronat kundër vullnetit të tyre, madje edhe kur për vete kishin para për gjëra të tjera, si për alkool dhe/ose cigare.

Gratë e rrahura zakonisht nuk përjetojnë vetëm një formë dhunë ekonomike në martesën/marrëdhënien e tyre intime të tyre; shpesh ato përjetojnë forma të shumëfishta të dhunës ekonomike. Grafiku 6.5 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar një apo më shumë nga tri llojet e ndryshme të dhunës ekonomike të renditura në Tabelën 6.5; vetëm 4,0% e grave kanë përjetuar një lloj të dhunës ekonomike, 2,3% kanë përjetuar dy lloje, dhe 0,7% kanë përjetuar secilën nga tre llojet e dhunës ekonomike.

Të dhënat u analizuan më tej për të kuptuar marrëdhënien midis moshës së grave dhe përjetimeve të dhunës ekonomike. Grafiku 6.6 tregon se gratë e moshës 18-24 vjeç (10,9%) dhe 45-54 vjeç (9,0%) kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë ekonomike në martesën/marrëdhëniet e tyre, krahasuar me gratë e moshës 25-34 (6,3%), 35-44 vjeç (6,8%), 55-64 vjeç (6,0%) dhe 65-74 vjeç (4,9%). Ka a të ngjarë që gratë e moshës 18-24 vjeç të kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë ekonomike, sepse ishin në fillim të martesës së tyre, por nuk është e qartë se çfarë kontribuon në përqindjen më të lartë


të grave të moshës 45-54 vjeç, të cilat kanë përjetuar dhunë ekonomike. Nevojiten të bëhen më shumë kërkime për të kuptuar përjetimet nga gratë të dhunës ekonomike.

Dhuna psikologjike

Dhuna psikologjike përfshin një gamë sjelljesh që synojnë të kontrollojnë, izolojnë, trembin, shkaktojnë frikë dhe sulmojnë karakterin e një gruaje dhe t'i shkatërrojnë vetë-vlerësimin dhe vlerat e vetes. Dhuna psikologjike përfshin *abuzimet verbale* (kritika, fyerje, poshtërime dhe/ose të folur në një mënyrë që sulmon karakterin dhe shkatërron ndjenjën e vetë-vlerësimit dhe vlerave të vetes) dhe *kërcënimet psikologjike* (trembjen dhe shkaktimin e frikës tek një grua, duke e kërcënuar se do t'i shkaktojë lëndim fizik dhe/ose do të lëndojë të afërm të tjerë të saj, dhe /ose do të shkatërrojë diçka që për të është e rëndësishme, për t'i hequr ndjenjën e sigurisë). Kërcënimimi me lëndim është një formë e dhunës psikologjike që burrat dhunues përdorin për të ngjallur frikë dhe ankth tek gratë dhe për të ruajtur kontrollin ndaj tyre.

Vrojtimi përfshiu tetë zëra të sjelljes specifike, të cilët matën forma të ndryshme të dhunës psikologjike që gratë përjetojnë zakonisht në martesë/marrëdhënie

Grafiku 6.6. Përjetime të dhunës ekonomike sipas grupmoshave (Të dhëna të ponderuara)



Shenja = .000


intime të dhunshme; në kuadër të analizës, tetë zërat e sjelljes specifike u përlogaritën për të krijuar një matje të përgjithshme të përjetimeve nga gratë të dhunës psikologjike. Tabela 6.5 tregon se pothuaj 1 në 3, ose 31,4% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë nga tetë llojet e dhunës psikologjike, dhe 1 në 5, ose 19,7% e grave përjetonin “aktualisht” një apo më shumë nga tetë llojet e dhunës psikologjike në martesën/marrëdhënien intime të tyre. Llojet më të zakonshme të dhunës psikologjike të përjetuara nga gratë ishin fyerja nga bashkëshorti/partneri dhe të ndierit keq për veten (24,8% ndonjëherë, 14,2% aktualisht) dhe të folurit me to në një mënyrë që i bënte të ndiheshin budallaqe dhe pa vlerë (19,1% ndonjëherë, 10,3% aktualisht).

Disa gra kanë përjetuar edhe format e tjera të dhunës psikologjike, të tilla si thënia apo bërja e diçkaje nga bashkëshorti/partneri i tyre që i kishte bërë ato të ndiheshin të poshtëruara përpara njerëzve të tjerë (9,7% ndonjëherë, 4,5% aktualisht), këmbëngulja për të mësuar se ku kishin qenë, në një mënyrë që i kish bërë të ndiheshin të kontrolluara apo i kish frikësuar (9,0% ndonjëherë, 5,1% aktualisht), i kish bërë të ndiheshin të paafta si prindër (6,6% ndonjëherë, 3,8% aktualisht), dhe thënia e fjalëve që i kishin frikësuar të tilla si “nëse nuk bëhesh imja, nuk ke për të qenë e askujt tjetër” (5,0% ndonjëherë, 1,9% aktualisht). Një përqindje e vogël e grave raportuan se bashkëshortët/

Tabela 6.5. Përjetime të dhunës psikologjike të ushtruar nga bashkëshorti/partneri (të dhëna të ponderuara)

	Ndonjëherë %	Aktualisht %
Kanë përjetuar dhunë psikologjike (një apo më shumë nga 8 lloje)	31.4	19.7
Ju ka fyer/ju ka bërë të ndiheni keq për veten	24.8	14.2
Ju ka folur në një mënyrë që ju bën të ndiheni idiote dhe pa vlerë	19.1	10.3
Ka thënë/ka bërë diçka që ju ka bërë të ndiheni e poshtëruar përpara njerëzve të tjerë	9.7	4.5
Ka thënë gjëra që ju kanë bërë të keni frikë, të tillë si “nëse nuk bëhesh imja, nuk ke për të qenë kurrë e njeriu”	5.0	1.9
Ka këmbëngulur të mësojë se ku jeni në një mënyrë që ju ka bërë të ndiheni e kontrolluar apo e frikësuar	9.0	5.1
Ka kërcënuar se do t’ju lëndojë juve, apo dikë tjetër që është i dashur për ju	1.3	.7
Ka shkatërruar gjëra që janë të rëndësishëm për ju, si diçka vetjake, kafshën që mbani në shtëpi apo sende të tjera	2.1	1.5
Ju ka bërë të ndiheni e pazonja si prind	6.6	3.8

Grafiku 6.7. Numri i llojeve të dhunës psikologjike të përjetuara (të dhëna të ponderuara)



partnerët e tyre u kishin shkatërruar gjëra që për to kishin qenë të rëndësishme, si një send vetjak, një kafshë shtëpiake apo gjëra të tjera (2,1% ndonjëherë, 1,5% aktualisht), dhe i kishin kërcënuar se do t'i lëndonin ato apo dikë tjetër të dashur për to (1,3% ndonjëherë, 0,7% aktualisht).


Është me rëndësi të kuptojmë se gratë e rrahura zakonisht nuk përjetojnë vetëm një formë dhunë psikologjike në martesën/marrëdhëniet e tyre intime; shpesh ato përjetojnë forma të shumëfishta të dhunës psikologjike. Grafiku 6.7 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar një apo më shumë nga tetë llojet e ndryshme të dhunës psikologjike të renditura në Tabelën 6.5. Vetëm 10,4% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” një lloj dhune psikologjike, 8,3% kanë përjetuar “ndonjëherë” dy lloje, 6,9% kanë përjetuar tri lloje, 2,6% përjetojnë katër lloje, 1,9% kanë përjetuar pesë lloje, dhe pothuaj 2,0% kanë përjetuar gjashtë apo më shumë lloje të dhunës psikologjike. Shumë gra që aktualisht kanë përjetuar dhunë psikologjike, kanë përjetuar edhe më shumë se një lloj nga llojet e dhunës të renditura në Tabelën 6.5.

Analiza e marrëdhënies midis dhunës psikologjike dhe moshës, tregoi se gratë e moshës 18-24 vjeç kishin ndjeshëm më gjasa të përjetonin “ndonjëherë” (42,9%) dhe “aktualisht” (38,7%) dhunë psikologjike në martesën/marrëdhënien e tyre intime, krahasuar me gratë në grupmoshat e tjera. Gjithsesi, përsëri 1

në 4, ose 28,2% e grave të moshës 25-34 dhe pothuaj 1 në 3 gra në secilën prej grupmoshave të tjera, kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë psikologjike. Grafiku 6.8 tregon gjithashtu se 1 në 5 gratë e moshës 25-34 vjeç, 35-44 vjeç dhe 45-54 vjeç kishin përjetuar dhunë psikologjike gjatë 12 muajve përpara intervistës. Krahasuar me to, gratë e moshës 65-74 vjeç (9,4%) kishin më pak gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë psikologjike; megjithatë, gratë e moshës 65-74 vjeç kishin po aq gjasa sa edhe gratë e grupmoshave të tjera të përjetonin “ndonjëherë” dhunë psikologjike në martesën/marrëdhënien e tyre intime.

Grave viktimat të dhunës psikologjike shpesh iu duket sikur nuk ka rrugëdalje nga marrëdhënia psikologjikisht dhunuese dhe se pa partnerin e tyre dhunues, ato janë një hiç. Gratë e dhunuara psikologjikisht shpesh e jetojnë jetën me frikë, përjetojnë ankth dhe e kanë të vështirë të përqendrohen, duke i mohuar vazhdimisht nevojat dhe ndryshuar mendimet, ndjenjat dhe sjelljet e tyre, në përpjekje për të shmangur abuzime dhe dhunë të mëtejshme.¹⁵⁸ Gjithashtu, gratë që vuajnë dhunë psikologjike në martesë/marrëdhënie intime mdodhen në risk të shtuar të problemeve të shëndetit mendor (për shembull, ankth, depresion, çrregullime të ngrënies, stres vetëvrasjeje dhe stres post-traumatizues), probleme të shëndetit fizik (për shembull, çrregullime të zorrëve, dhimbje koke, dhimbje kronike, sëmundje kardiovaskulare,

Grafiku 6.8. Përjetime të dhunës psikologjike sipas grupmoshës (të dhëna të ponderuara)



Ndonjëherë, Shenja = .000; Aktualisht, Shenja = .000

hipertension), përdorim substancash (për shembull, alkool, duhan, dhe droga të tjera), dhe probleme para lindjes/shtatzënie, (për shembull, dështim, lindje para kohe, dhe peshë të ulët në lindje të foshnjës së sapolindur).^{159,160} Kërkimet ndërkombëtare tregojnë se pasojat e dhunës psikologjike mund të jenë po aq të dëmshme sa edhe të dhunës fizike, duke çuar në ndjenja vetë-dyshimi dhe pavlefshmërie.^{161,162}

Gratë e rrahura mund edhe të reagojnë ndaj abuzimit psikologjik të bashkëshortit/partnerit intim, duke përfshirë vetëkritika dhe vetëposhtërim, në orvatje të ndryshojnë veten dhe/ose të minimizojnë sjelljet e bashkëshortëve/partnerëve intimë, duke ua atribuar ato sjellje problemeve të tjera si konsumi i alkoolit dhe dehja. Gjithsesi, me kohë, shumë gra të rrahura e kuptojnë se asgjë që bëjnë nuk sjell ndonjë ndryshim, ndërsa ndjesia e tyre e sigurisë në marrëdhënie pakësohet.¹⁶³


Dhuna fizike

Kur njerëzit flasin për dhunë në familje ndaj grave, shpesh e kanë fjalën për aktet e dhunës fizike. Dhuna fizike është përdorimi i forcën fizike ndaj dikujt në atë mënyrë që e lëndon apo rrezikon atë person. Ka një gamë të gjerë sjelljesh që futen nën titullin dhunë fizike në situatat e dhunës në familje, duke përfshirë goditjet, të rrahurat, kapjen me forcë, të shkelmuarit,

të zënit e frymës, të shkulurit e flokëve, dhe sulmin me armë, por pa u kufizuar vetëm tek to. Llojet e ndryshme të dhunës fizike zakonisht bazohen në ashpërsinë dhe gjasat e shkakutimit të lëndimit fizik, duke përfshirë *dhunën fizike të moderuar* ((e cila përfshin një apo më shumë nga aktet fizike që vijnë: të qëlluarit me shkelma, të hedhurit përtokë, të shtyrët, tërheqjen zvarrë, të qëlluarat me shuplaka, dhe/ose të shkulurit e flokëve), *dhunë e ashpër fizike* (përfshin një apo më shumë nga aktet fizike që vijnë: gjuajtjet, rrahjen, djegiet e qëllimshme, të kapurit për fyti, zënie e frymës dhe/ose kërcënimin me armë apo përdorimin e armës), dhe *dhunë fizike me armë* (përfshin kërcënimin dhe/ose goditjen me armë ose me objekte të tjera që mund të shkaktojnë lëndime fizike). Sulmi fizik apo rrahja e bashkëshortes/partneres intime përbën krim, pavarësisht nga ashpërsia e dhunës dhe pavarësisht nëse ndodh brenda apo jashtë shtëpisë.

Vrojtimi përfshiu 11 zëra të sjelljes specifike që matën forma të ndryshme të dhunës fizike që gratë përjetojnë zakonisht në martesë/marrëdhënie intime të dhunshme; në kuadër të analizës, 11 zërat e sjelljes specifike u përlllogaritën për të krijuar një matje të përgjithshme të përjetimeve nga gratë të dhunës fizike. Tabela 6.6 tregon se 18,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar “ndonjëherë” dhe 7,2% përjetonin “aktualisht” një apo më shumë nga 11 llojet e ndryshme të dhunës fizike në

Grafiku 6.9. Numri i llojeve të dhunës fizike të përjetuara nga gratë (të dhëna të ponderuara)



martësën/marrëdhënien e tyre intime. Gratë kishin më shumë gjasa të qëulloheshin me shuplaka nga bashkëshortët/partnerët e tyre (17,3% ndonjëherë, 6,4% aktualisht), por disa gra kishin përjetuar edhe raste kur bashkëshorti/partneri i tyre i kishte kapur për flokësh (4,8% ndonjëherë, 2,6% ndonjëherë), i kish goditur me diçka që mund t'i lëndonte (3,7% ndonjëherë, 1,5% aktualisht), dhe i kish përplasur, shtyrë, shkundur dhe/ose tërhequr zvarrë (3,0% ndonjëherë, 1,5% aktualisht).


Për sa u takon formave më të rënda të dhunës fizike, kishte disa gra të cilat raportuan se bashkëshortët i godisnin me grushte ose me ndonjë gjë tjetër që mund t'i lëndonte (2,1% ndonjëherë, 1,4% aktualisht) dhe i qëllonin me shkelma apo i rrihnin (2,1% ndonjëherë, 1,1% aktualisht). Më pak se një për qind e grave raportuan se bashkëshortët/partnerët e tyre i përplasnin pas muri apo pas diçkaje tjetër, u vinin duart në grykë dhe u zinin frymën, u shkaktonin të prera apo i godisnin me thikë, i digjnin qëllimisht, dhe i kërcënonin/i sulmonin me thikë, pistoletë apo ndonjë armë tjetër.

Zakonisht, gratë e rrahura përjetojnë më shumë se një lloj dhune fizike në martesat/marrëdhëniet e tyre intime. Grafiku 6.9 tregon përqindjen e grave që kanë përjetuar një apo më shumë nga 11 format e ndryshme të dhunës fizike të renditura në Tabelën 6.6. Në lidhje me përjetimet e dhunës fizike gjatë gjithë jetës, 11,0% e grave kanë përjetuar

Tabela 6.6. Përjetime të dhunës fizike të ushtruar nga bashkëshorti/partneri (të dhëna të ponderuara)

	Ndonjëherë %	Aktualisht %
Kanë përjetuar dhunë fizike (një apo më shumë nga 11 llojet)	18.0	7.2
Ju ka qëlluar me shpullë	17.3	6.4
Ju ka shkukur flokët	4.8	2.6
Ju ka goditur me diçka që mund t'ju ketë lënduar	3.7	1.5
Ju ka hedhur për tokë, shtyrë, tërhequr zvarrë	3.0	1.5
Ju ka qëlluar me grusht apo me diçka tjetër që mund t'ju lëndonte	2.1	1.4
Ju ka shkelmuar apo rrahur	2.1	1.1
Ju ka përplasur pas murit apo diçkaje tjetër	0.9	0.3
Ju ka marrë frymën	0.2	0.1
Ju ka kërcënuar/sulmuar me thikë, me armë dhe mjete të tjera	0.1	0.1
Ju ka prerë apo goditur me thikë qëllimisht	0.1	0.0
Ju ka djegur qëllimisht	0.1	0.0

Grafiku 6.10. Përjetime të dhunës fizike sipas grupmoshave (të dhëna të ponderuara)



Ndonjëherë, Shenja = .000; Aktualisht, Shenja = .000

“ndonjëherë” një lloj dhune fizike, dhe 3,5% kanë përjetuar dy lloje. Më pak gra kanë përjetuar dy, më shumë se dy, apo më shumë lloje dhune fizike gjatë jetës së tyre. Për sa u takon përjetimeve aktuale të dhunës fizike, 4,2% e grave kishin përjetuar vetëm një lloj dhune fizike gjatë 12 muajve përpara intervistës, 1,2% kishin përjetuar dy lloje dhe shumë më pak gra kishin përjetuar tri apo më shumë lloje të dhunës fizike. Pasojat e dhunës fizike në format e saj të shumëfishta mund të jenë të rënda, duke çuar në probleme shëndetësore fizike afatshkurtra dhe afatgjata, paaftësi dhe/ose shpërfytyrime, madje edhe në vdekje me vrasje apo vetëvrasje.^{164,165}

Të dhënat u analizuan më tej për të kuptuar përjetimet e gratë të dhunës fizike në martesën/marrëdhënien e tyre intime sipas grupmoshave. Grafiku 6.10 tregon se gratë e moshës 65-74 vjeç (22,2%) kishin më shumë gjasa të përjetojnë “ndonjëherë” dhunë fizike, dhe gratë e moshës 25-34 vjeç (14,0%) kishin më pak gjasa të përjetojnë “ndonjëherë” dhunë fizike. Për sa u takon përjetimeve aktuale të dhunës fizike, gratë e moshës 18-24 vjeç (14,6%) kishin ndjeshëm më gjasa të përjetonin dhunë fizike në martesën/marrëdhënien e tyre intime gjatë 12 muajve përpara intervistës, krahasuar me gratë në secilin prej grupmoshave të tjera. Gratë e moshës 55-64 vjeç (4,4%) dhe 65-74 vjeç (3,6%) kishin më pak gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë fizike në martesën/marrëdhënien e tyre intime.


Dhuna seksuale

Dhuna seksuale është një lloj tjetër e dhunës në familje e matur nga vrojtimi. Dhuna seksuale është çdo situatë në të cilën gruaja detyrohet të marrë pjesë apo të kryejë veprime seksuale pa dëshirë, të pasigurta, degraduese dhe/ose poshtëruese; kjo përfshin seksin e


Tabela 6.7. Përjetime të dhunës seksuale të ushtruar nga bashkëshorti/partneri aktual/ose i dikurshëm (të dhëna të ponderuara)

Gra të moshës 18-74 vjeç që aktualisht janë/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe që jetojnë/ose kanë jetuar me një bashkëshort/partner N=886,374	Ndonjëherë %	Aktualisht %
Kanë përjetuar dhunë seksuale (një apo më shumë nga 3 llojet)	8.6	3.6
Ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale kur nuk keni dashur, për shembull duke ju kërcënuar apo mbajtur të shtrirë	4.1	2.1
Ju ka detyruar të kryeni akte seksuale që nuk i keni dashur apo që ju janë dukur degraduese apo poshtëruese	.9	.1
Keni kryer marrëdhënie seksuale me bashkëshortin/partnerin sepse keni pasur frikë nga ajo që mund të bënte nëse e refuzonit	7.5	3.3

Grafiku 6.11. Numri i llojeve të dhunës seksuale të përjetuar nga gratë (të dhëna të ponderuara)



Grafiku 6.12. Përjetime të dhunës seksuale sipas grupmoshave (të dhëna të ponderuara)



Ndonjëherë, Shenja = .000; Aktualisht, Shenja = .000

detyruar nga bashkëshorti/partneri me të cilin gruaja ka bërë edhe seks me dëshirë (përdhunimi martesor). Si pjesë e analizës, u përllogaritën tri zëra të sjelljes specifike të krijuar për të matur dhunën seksuale për të krijuar një matje të përgjithshme të përjetimeve nga gratë të dhunës seksuale.

Tabela 6.7 tregon se 8,6% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” dhe 3,6% përjetonin “aktualisht” një apo më shumë nga tri llojet e dhunës seksuale në martesën/marrëdhënien e tyre intime. Gratë kishin më shumë gjasa të përjetonin marrëdhënie seksuale me bashkëshortin/partnerin për shkak të frikës të asaj që ai mund të bënte nëse ato do të refuzonin (7,5% ndonjëherë, 3,3% aktualisht). Gjithashtu, disa gra ishin detyruar të kryenin marrëdhënie

seksuale kur nuk kishin pasur dëshirë, për shembull duke i kërcënuar apo duke u mbajtur të shtrira nga bashkëshorti/partneri (4,1% ndonjëherë, 2,1% aktualisht). Shumë pak gra ishin detyruar të kryenin akte seksuale që nuk kishin dashur t'i kryenin, apo që u ishin dukur degraduese apo poshtëruese (0,9% ndonjëherë, 0,1% aktualisht).

Grafiku 6.11 tregon se 5,3% e grave kanë përjetuar “ndonjëherë” vetëm një formë të dhunës seksuale të përcaktuar në Tabelën 6.7, 2,8% kanë përjetuar dy forma të dhunës seksuale, dhe 0,6% kanë përjetuar secilën nga tre llojet e dhunës seksuale.

Grafiku 6.12 tregon se gratë e moshës 18-24 vjeç kishin më shumë gjasa të përjetonin “ndonjëherë”

dhe të përjetonin “aktualisht” dhunë seksuale në martesën/marrëdhënien e tyre intime (përkatësisht 14,4% dhe 14,4%), krahasuar me gratë në secilën nga grupmoshat e tjera. Është për të theksuar se gratë e moshës 25-34 vjeç kishin më pak gjasa të përjetonin “ndonjëherë” dhunë seksuale nga bashkëshortët/partnerët e tyre (përkatësisht 6,2% dhe 3,4%); ndërsa gratë e moshës 55-64 vjeç (1,4%) dhe 65-74 vjeç (1,1%) kishin më pak gjasa të përjetonin “aktualisht” dhuna seksuale nga bashkëshortët/partnerët e tyre.

Kur fillon dhuna në familje nga partneri intim

Gratë që kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim u pyetën se kur kishte filluar dhuna në familje në martesën e tyre. Tabela 6.8 tregon se 1 në 4, ose 26,1% e grave raportuan se dhuna në familje kish filluar gjatë vitit të parë të martesës së tyre dhe 1 në 5, ose 23,2% raportuan se dhuna kish filluar në vitin e dytë apo të tretë të martesës. Është për t'u vënë në dukje se 14,9% e grave raportuan se dhuna kish filluar në vitin e katërt apo të pestë të martesës dhe 17,1% raportuan se dhuna kish filluar pas gjashtë apo më shumë viteve që ishin martuar. Gjithashtu 17,5% nuk e dinin se kur dhuna kish filluar ose refuzuan të përgjigjeshin. Vetëm 1,1% e grave raportuan se dhuna kish filluar përpara martesë.

Tabela 6.9 tregon se kur ka filluar secila nga llojet e ndryshme të dhunës në familje në martesën e një gruaje. Në veçanti, 1 në 4 gra raportuan se sjellja kontrolluese (25,7%), dhuna psikologjike (25,4%), dhuna fizike (25,7%) dhe dhuna seksuale (29,5%) kishin filluar gjatë vitit të parë të martesës; një numër pak më i vogël grash (20,8%) raportuan se dhunë ekonomike kish filluar gjatë vitit të parë të martesës. Dhuna seksuale (33,7%) dhe dhuna ekonomike (31,6%) kishin më shumë gjasa të fillonin në vitin e dytë[apo të tretë të martesës.

Kishte gra që raportuan gjithashtu se secila nga format e ndryshme të dhunës nga partneri intim kish filluar në vitin e katërt dhe të pestë të martesës dhe gjashtë apo më shumë vite pas martesës. Gratë kishin dy herë më gjasa të raportonin se nuk e dinin apo refuzuan të përgjigjeshin se kur kish filluar

Tabela 6.8. Kur ka filluar dhuna në familje nga partneri intim (të dhëna të ponderuara)

Kur filloi dhuna	Kanë përjetuar ndonjëherë dhunë në familje nga partneri intim
	%
Përpara martesë	1.1
≤ vitit të parë	26.1
Në vitin e dytë deri në të tretin	23.2
Në vitin e katërt deri në të pestin	14.9
Pas 6 apo më shumë viteve	17.1
Nuk e di/refuzuan të përgjigjen	17.5

sjellja kontrolluese (17,2%), dhuna ekonomike (19,3%), dhuna psikologjike (16,3%) dhe dhuna fizike (17,5%), krahasuar me gratë që raportuan se nuk e dinin apo refuzuan të përgjigjeshin se kur kish filluar dhuna seksuale në martesën e tyre (95%).

U analizua edhe dhuna në marrëdhëniet dashurore dhe tregoi se pothuaj 2 në 3, ose 65.8% e grave të moshës 18-74 vjeç, që nuk kishin qenë kurrë të martuara dhe/ose që nuk kishin jetuar ndonjëherë me një bashkëshort/partner, por kishin qenë të përfshira në një marrëdhënie me një mashkull (gjatë dashurisë dhe/ose periudhës romantike) kishin përjetuar dhunë gjatë marrëdhënies dashurore në jetën e tyre, ndërsa 61,8% kishin përjetuar dhunë në marrëdhënien e tyre dashurore gjatë 12 muajve përpara vërtetimit. Ajo që të bie më shumë në sy është se të gjitha këto gra kanë përjetuar sjellje kontrolluese shtrënguese nga i dashuri aktual dhe/ose i fundit. Është e rëndësishme të kuptohet dhuna gjatë marrëdhënies dashurore si model dhune, abuzimi dhe/sjelljeje shtrënguese që përdoret për të ruajtur pushtetin dhe kontrollin ndaj një partneri intim aktual apo ish partneri intim, në kuadër të marrëdhënies dashurore apo romantike. Dhuna gjatë marrëdhënies dashurore shpesh fillon me sjellje kontrolluese shtrënguese dhe dhunë psikologjike; këto sjellje mund të shpien në lloje më të rënda dhunimi, duke përfshirë dhunën ekonomike, dhunën fizike dhe dhunën seksuale. Në disa raste, dhuna gjatë marrëdhënies dashurore mund të jetë në formën e përndjekjes. Dhuna gjatë marrëdhënies

Tabela 6.9. Kur ka filluar dhuna në familje nga partneri intim (të dhëna të ponderuara)

	Sjellje kontrolluese (ndonjëherë) N=141,661	Dhunë ekonomike (ndonjëherë) N=45,729	Dhunë psikologjike (ndonjëherë) N=137,273	Dhunë fizike (ndonjëherë) N=159,543	Dhunë seksuale (ndonjëherë) N=49,842
	%	%	%	%	%
Përpara martese	1.1	0.4	1.0	1.2	0.0
≤ vitit të parë	25.7	20.8	25.4	25.7	29.5
Në vitin e dytë deri në të tretë	23.3	31.6	23.5	23.4	33.7
Në vitin e katërt deri në vitin e pestë	15.1	13.5	15.8	14.8	15.4
Pas vitit të gjashtë apo pas më shumë vitesh	17.7	14.4	18.0	17.5	11.9
Nuk e di/refuzuan të përgjigjen	17.2	19.3	16.3	17.5	9.5

dashurore mund të ndodhë që në takimin e parë dhe më shpesh përjetohet nga femrat, pavarësisht nga mosha, arsimi, raca/prejardhja etnike, statusi socio-ekonomik dhe/ose social.^{166,167}

Më përpara, dhuna gjatë marrëdhënies dashurore është nën/përfaqësuar në literaturën mbi dhunën ndër-personale. Por, gjatë disa dekadave të kaluara, studimet kanë avancuar nga shkallët e shtrirjes dhe llojet e dhunës gjatë marrëdhënies dashurore, në eksplorimin e veçorive të viktimës dhe autorit; studiuesit i kanë avancuar njohuritë tona mbi dhunën gjatë marrëdhënies dashurore dhe variableve të lidhura me dhunën gjatë marrëdhënies dashurore. Gjithashtu studimet kanë treguar se të qëndruarit në një marrëdhënie dashurore dhunuese mund të ketë pasoja afatgjata në shëndetin mendor dhe fizik të vajzave dhe grave.^{168,169} Vrojtimi Kombëtar për Dhunën Ndaj Grave dhe Vajzave (VKDhNGV) përfshiu një modul për dhunën gjatë marrëdhënies dashurore që duhej plotësuar nga gratë e moshës 18-74 vjeç, të cilat nuk kishin qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose që nuk kishin jetuar ndonjëherë me një bashkëshort/partner, por që ishin të përfshira në një marrëdhënie me një mashkull (në marrëdhënie dashurore/apo romantike), por për shkak të nën/përfaqësimit të grave në këtë kategori të kampionit, nevojiten të bëhen studime të mëtejshme, për të eksploruar dhunën në kuadër të marrëdhënieve dashurore. Studimi i ardhshëm duhet të përqendrohet në

dhunën gjatë marrëdhënieve dashurore midis grave dhe vajzave të moshës 15-25 vjeç.¹⁷⁰

Dhuna fizike gjatë shtatzënisë

Gratë u pyetën nëse bashkëshorti i kish dhunuar fizikisht gjatë shtatzënisë. Midis grave që ishin aktualisht/kishin qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose jetonin me një bashkëshort/partner, 94,9% kishin qenë shtatzëna ndonjëherë. Tabela 6.10 tregon se midis grave që kishin qenë ndonjëherë shtatzëna, 1,1% ishin goditur, qëlluar me shpulla, shkelmuar apo dhunuar fizikisht ndonjëherë gjatë shtatzënisë. Midis grave që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike, 2,3% raportuan se i kishin goditur, qëlluar me shpulla, shkelmuar apo dhunuar fizikisht gjatë shtatzënisë. Midis grave të cilat i kishin goditur, qëlluar me shpulla, shkelmuar apo dhunuar fizikisht ndonjëherë gjatë shtatzënisë, 30,5% raportuan se kjo kish ndodhur gjatë shtatzënisë së fundit dhe 10,1% raportuan se i kishin grushtuar apo shkelmuar në bark kur kishin qenë shtatzëna.

Gratë u pyetën se kush i kishte kryer aktet e dhunës fizike ndaj tyre gjatë shtatzënisë. Tabela 6.11 tregon se 50,9% e grave raportuan se bashkëshorti/i dashuri aktual dhe/ose i dikurshëm i kish goditur, qëlluar me shpulla ose i kish dhunuar fizikisht gjatë shtatzënisë. Disa gra gjithashtu raportuan se një larmi pjesëtarësh të familjes i kishin goditur, qëlluar me shpulla ose

Tabela 6.10. Përjetime të dhunës fizike gjatë shtatzënisë (të dhëna të ponderuara)

Gra të moshës 18-74 vjeç që aktualisht janë/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe jetojnë/ose kanë jetuar me një bashkëshort/partner N=886,374	Kanë qenë ndonjëherë shtatzëna N=841,193	Kanë përjetuar ndonjëherë dhunë fizike N=404,974
	%	%
A jeni goditur, qëlluar me shpulla, shkelmuar apo dhunuar ndonjëherë fizikisht gjatë shtatzënisë?	1.1	2.3
N=9,422		
A ka ndodhur kjo gjatë shtatzënisë së fundit?	30.5	
Jeni grushtuar, apo shkelmuar ndonjëherë në bark gjatë kohës që keni qenë shtatzënë?	10.1	

Tabela 6.11. Personat që kanë kryer akte të dhunës fizike ndaj grave gjatë shtatzënisë (të dhëna të ponderuara)

Anëtar i familjes	I kish goditur, qëlluar me shpulla apo i kish dhunuar fizikisht ndonjëherë gjatë shtatzënisë N=9,422	I kish grushtuar apo shkelmuar ndonjëherë në bark gjatë shtatzënisë N=949
	%	%
Bashkëshorti/i dashuri aktual/i dikurshëm	50.9	79.1
I dashuri aktual/i dikurshëm	0.0	0.0
Nëna/njerka	4.3	0.0
Babai/njerku	4.5	0.0
Motra/vëllai	4.3	0.0
Motra e gjetur/vëllai i gjetur	0.0	0.0
Vajza/djali	2.5	0.0
Të afërm të tjerë	7.3	0.0
Vjehrra	1.6	0.0
Vjehrri	1.6	0.0
Njerëz të tjerë të familjes së burrit	2.6	10.4
Jo pjesëtarë të familjes		
Mësues	7.3	0.0
Oficer policie/ushtar	0.0	0.0
Punëdhënësi/dikush në punë	2.5	0.0
Të tjerë	0.0	0.0

i kishin dhunuar fizikisht gjatë shtatzënisë. Kjo përfshin: nënën/njerkën (4,3%), babanë/njerkun (4,5%), motrat/vëllezërit (4,3%), vajzat/djemtë (2,5%), të afërm të tjerë (7,3%), vjehrrën (1,6%), vjehrrin (1,6%) dhe njerëz të tjerë të familjes së burrit (2,6%). Për çudi, gratë raportuan gjithashtu se edhe jo anëtarë të familjes, përfshirë mësues (7,3%) dhe punëdhënësi apo dikush në punë (2,5%), i kish goditur, qëlluar me shpulla, ose i kish dhunuar fizikisht gjatë shtatzënisë.

Në lidhje me të grushtuarat dhe të shkelmuarat gjatë shtatzënisë në bark, Tabela 6.11 tregon se 79,1% e grave raportuan se bashkëshorti/i dashuri aktual apo i dikurshëm i kish grushtuar apo shkelmuar në bark gjatë shtatzënisë, ndërsa 10,4% raportuan se një i afërm i burrit kish kryer akte të tilla dhune fizike ndaj tyre kur kishin qenë shtatzëna. Autorët që grushtojnë apo shkelmojnë një grua shtatzënë në bark sulmojnë jo vetëm nënën, por qëllimi është të dëmtojnë edhe fëmijët, dhe ndoshta t'i japin fund shtatzënisë.

Lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje

Gratë e rrahura shpesh përjetojnë lëndime nga dhuna në familje. Lëndimet nga dhuna në familje nuk kufizohen vetëm me thyerje kockash, të mavijosura, të nxira në sy, apo të prera. Studimet kanë treguar se sëmundjet kronike mund të shkaktohen ose acarohen nga dhuna në familje dhe stresi që dhuna dhe marrëdhëniet dhunuese shkaktajnë ndaj grave të rrahura.¹⁷¹ Dhuna në familje mund të kontribuojë në:

- Sëmundjet dhe dëmtimet neurologjike – dhimbje kronike, probleme të të folurit, migrena dhe/ose dhimbje koke, probleme të sistemit nervor qendror, dhimbje shpine, goditje në tru, lëndime traumatizuese në tru, hemorragji dhe/ose dëmtimet në shikim,
- Sëmundjet dhe dëmtimet kardiovaskulare dhe respiratore – hipertension, dhimbje gjoksi, hiperventilim, sëmundje zemre, astmë dhe/ose atak në zemër,
- Sëmundje dhe probleme të tretjes – probleme gastrointestinale, ulcera në stomak, irritim të

zorrës së trashë/dispepsi/ diarre, sindroma e zorrëve të irrituara dhe/ose dhimbje barku,

- Sëmundjet dhe problemet me riprodhimin dhe organet gjenitale–kancer cervical,dismenorrhea, rezultate të dobëta të shtatzënisë, infeksione të transmetuara seksualisht, gjakderdhje/çarje vagjinale, infeksion vaginal, infeksione të traktit urinar, dhimbje gjatë kontaktit seksual dhe/ose gjakderdhje dhe çarje anale,
- Sëmundjet dhe problemet fizike dhe të dukshme – probleme me shërimin, tronditje, të çjerra, thyerje dhe krisje kockash, shenja duarsh (shenja të dikujt tjetër), shenja përpjekjesh për asfiksion (rreth qafës), hematoma, dëmtime tendinësh/ligamenti, trauma faciale dhe/ose dhëmbë të thyer,
- Sëmundjet shëndetësore mendore – depresion, ide dhe sjellje vetëvrasëse, çrregullime stresi post-traumatik, abuzim me alkoolin, drogën, stres kronik dhe/ose akut.

Pavarësisht nga vështirësia për t'i bindur gratë të flisinin për lëndimet e tyre nga dhuna në familje, vrojtimi u hartua për të matur lëndimet e grave të lidhura me incidentet e dhunës fizike. Tabela 6.12 tregon se më shumë se 1 në 2, ose 58,8% e grave që kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike, kishin përjetuar edhe lëndime nga dhuna në familje, dhe afërsisht 3 në 4, ose 72,4% e grave që përjetonin “aktualisht”dhunë fizike, përjetonin edhe lëndime nga dhuna në familje (një apo më shumë nga 9 llojet e matura të dhunës në familje).


Shumica e grave që përjetonin dhunë fizike, përjetonin frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi dhe/ose nervozizëm (56,0% e grave kishin përjetuar “ndonjëherë” dhe 61,1% përjetonin “aktualisht”dhunë fizike). Studimet ekzistuese dokumentojnë lidhjen midis dhunës në familje dhe shëndetit mendor, ndërsa kërkimet kanë konstatuar se shqetësimi psikologjik është më i madh tek gratë që përjetojnë dhunë nga partneri intim, krahasua, me gratë në përgjithësi. Gjithashtu kërkimet kanë gjetur se risku i çrregullimeve të stresit post-traumatizues (PTSD) është më imadh tek gratë e ekspozuara

ndaj dhunës nga partneri intim se sa nga ndonjë sëmundje tjetër e shëndetit mendor.¹⁷² Kini parasysh se vetëm gratë që kishin përjetuar dhunë fizike, u pyetën nëse kishin përjetuar frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi apo nervozizëm, kështu që nuk e dimë se çfarë përqindje e grave të rrahura, të cilat kishin përjetuar sjellje kontrolluese shtrënguese, dhunë ekonomike dhe/ose dhunë psikologjike në martesën/marrëdhënien e tyre intime, kanë vuajtur gjithashtu edhe ndjenja frike, ankthi, depresioni,

Tabela 6.12. Lëndimet nga dhuna në familje tek gratë që kanë përjetuar dhunë fizike (të dhëna të ponderuara)

	Dhunë fizike (ndonjëherë) N=159,541	Dhunë fizike (aktualisht) N=64,072
	%	%
Kanë përjetuar lëndime nga dhuna në familje (një apo më shumë nga 9 llojet)	58.8	72.4
Frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi dhe/ose nervozizëm	56.0	61.1
Të prera, të gërvishtura, dhimbje, skuqje apo ënjtje dhe/ose shenja të lehta	23.6	28.1
Lëndime në sy, nxjerrje kockash nga vendi,ndrydhje dhe/ose flluska nga djegiet	6.5	12.4
Lëndime, tronditje në kokë dhe/ose humbje dëgjimi	2.0	2.6
Lëndime abdominale	2.1	1.0
Plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, lëkurë të nxirë apo të përcëlluar nga të djegurat, apo nga ndonjë lëndim tjetër i rëndë	1.2	1.2
Humbje kujtese	0.5	0.2
Dështim	2.6	1.2
Lëndim apo shpërfytyrim i përhershëm	1.1	0.0

Grafiku 6.13. Numri i llojeve të lëndimeve nga dhuna në familje të përjetuara ndonjëherë (të dhëna të ponderuara)



ndjenja izolimi, pagjumësie ose nervozizëm. Në martesat/marrëdhëniet intime, sjelljet kontrolluese shtrënguese dhe dhuna psikologjike ishin më të përhapurat. Në të ardhmen vërtetimi duhet të rikoncepohet për t'i pyetur të gjitha gratë që kanë përjetuar një apo më shumë nga llojet e ndryshme të dhunës në martesën/marrëdhënien intime të tyre, nëse kanë përjetuar frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi dhe/ose nervozizëm, dhe këto duhen matur veçan, për të kuptuar më mirë sëmundjet e shëndetit mendor nga të cilat vuajnë gratë për shkak të DhPI-së. Gjithashtu duhen shtuar disa pyetje për të përcaktuar nëse ato përdorin alkool dhe/ose drogë për të përballuar DhPI-në.

Tabela 6.12 tregon gjithashtu se pothuaj 1 në 4, ose 23.6% e grave të cilat kanë përjetuar “ndonjëherë” dhe 28,1% që përjetonin “aktualisht” dhunë fizike, kanë përjetuar lëndime fizike nga dhuna në familje në formën e të prerave, të gërvishturave, dhimbjeve, skuqjeve, apo ënjtjeve dhe/ose shenja të tjera të lehta. Gratë raportuan gjithashtu se kishin përjetuar lëndime edhe më të rënda, duke përfshirë: lëndime në sy, nxjerrje kockash nga vendi, ndrydhje dhe/ose filluska nga djegiet (6,5% ndonjëherë, 12,4% aktualisht); dështime (2,6% ndonjëherë, 1,2% aktualisht); lëndime dhe tronditje në kokë dhe/ose humbje dëgjimi (2,0% ndonjëherë, 2,6% aktualisht); lëndime abdominale (2,1% ndonjëherë, 1,0% aktualisht; plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, lëkurë të nxirre apo të përcëlluar nga djegiet dhe/ose ndonjë lëndim

tjetër të rëndë (1,2% ndonjëherë, 1,2% aktualisht); lëndime dhe/ose shpërhytje të përhershme (1,1% ndonjëherë, 0,0% aktualisht); dhe humbje kujtese (0,5% ndonjëherë, 0,2% aktualisht)).

Gratë e rrahura shpesh përjetojnë më shumë se një lloj lëndimi nga dhuna në familje. Grafiku 6.13 tregon se nga gratë që kanë përjetuar dhunë në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht), 43,7% kanë përjetuar vetëm një lloj lëndimi nga dhuna në familje, të renditur në Tabelën 6.12; ndërsa 16,4% kanë përjetuar dy lloje lëndimesh, 9,3% kanë përjetuar tri lloje lëndimesh, 1,7% kanë përjetuar katër lloje lëndimesh, 0,2% kanë përjetuar pesë lloje, dhe 1,0% kanë përjetuar gjashtë apo më shumë lloje lëndimesh nga dhuna në familje. Llojet e shumfishta të lëndimeve mund të lidhen me një incident të dhunës në familje, ose me pasojat në rritje të akteve të shumfishta dhe të përsëritura të dhunës në familje.

Gratë që kanë përjetuar lëndime nga dhuna në familje, u pyetën nëse ishin lënduar ndonjëherë aq keq nga bashkëshorti/partneri sa të kishin pasur nevojë për kujdes mjekësor, edhe kur nuk e kishin marrë atë. Tabela 6.13 tregon se 5,5% e grave që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike dhe 5,6% që kanë përjetuar dhunë fizike gjatë 12 muajve të fundit (aktualisht) ishin lënduar aq keq nga bashkëshorti/partneri i tyre sa të kishin pasur nevojë për kujdes shëndetësor, edhe nëse nuk e kishin marrë atë. Midis grave të cilat kishin pasur nevojë për kujdes

shëndetësor për lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje, 7,7% raportuan se kishin pasur nevojë për kujdes shëndetësor për lëndimet e pësuar nga dhuna në familje gjatë 12 muajve të fundit.

Tabela 6.13 tregon gjithashtu se nga gratë që përjetonin aktualisht dhunë fizike dhe që kishin pësuar lëndime nga dhuna në familje, gjithsej 23,1%, u ishte dashur të kalonin natën në spital për shkak të lëndimeve të marra dhe vetëm 13,4% i kishin treguar një punonjësi të shëndetësisë se shkak i lëndimeve të tyre ishte dhuna në familje. Ka gjasa që gratë shpesh nuk u tregojnë mjekëve dhe/ose infermiereve se dhuna në familje është shkak i lëndimeve të tyre; viktimat e dhunës në familje shpesh gënjën në lidhje me shkakun e lëndimeve të saj, për të mbrojtur bashkëshortin/partnerin, dhe nga frika, turpi dhe/ose sikleti. Por, në të njëjtën kohë, mjekët dhe infermieret shpesh nuk bëjnë verifikime për dhunën në familje dhe nuk i pyesin ato për shkakun e lëndimeve të rënda, veçanërisht kur nuk janë të detyruar ta bëjnë një gjë të tillë.

Ndërprerja e punës për shkak të dhunës në familje

Të dhënat u analizuan për të kuptuar se deri në çfarë mase lëndimet nga dhuna në familje ndikojnë negativisht në aftësitë e grave për të mbajtur shtëpinë e për t'u kujdesur për fëmijët dhe sa prej tyre kanë rezultuar në mungesën e grave në punën e paguar. Tabela 6.14 tregon se 1 në 4, ose 25,0% e grave që kanë përjetuar dhunë fizike dhe lëndime nga dhuna në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës, raportuan se nuk kishin qenë në gjendje të kryenin punët e shtëpisë dhe/ose të kujdeseshin për fëmijët, për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje. Gjithashtu, 8,9% e grave raportuan se nuk kishin qenë në gjendje të shkonin në punë (kishin humbur ditë pune) për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje, dhe 0,5% e grave kishin humbur punën apo burimin e të ardhurave për shkak të dhunës në familje.

Tabela 6.15 tregon numrin e ditëve që gratë nuk kishin qenë në gjendje të kryenin punët e shtëpisë dhe të kujdeseshin për fëmijët për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje. Numri i ditëve që gratë nuk ishin

Tabela 6.13. Sjellje që kërkojnë ndihmë nga sektori shëndetësor për lëndimet nga dhuna në familje (të dhëna të ponderuara)

Kanë përjetuar lëndime nga dhuna në familje N=93,278	Dhunë fizike (ndonjëherë) N=93,278 %	Dhunë fizike (aktualisht) N=46,609 %
Jeni lënduar ndonjëherë aq keq nga bashkëshorti/partneri sa të keni pasur nevojë për kujdes shëndetësor (edhe kur nuk e keni marrë atë)	5.5	5.6
	N=5,128	N=2,618
Keni pasur nevojë për kujdes shëndetësor gjatë 12 muajve të fundit për lëndimet nga dhuna në familje	3.9	7.7
	N=9,504	N=5,421
Keni kaluar net në spital për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje	22.9	23.1
I keni treguar një punonjësi të shëndetësisë se dhuna në familje ishte shkak i lëndimeve tuaja	18.5	13.4

Tabela 6.14. Lëndime nga dhuna në familje dhe ndërprerja e punës (të dhëna të ponderuara)

Kanë përjetuar dhunë fizike dhe lëndime nga dhuna në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht)	N=46,608 %
Nuk ishin në gjendje të kryenin punët e shtëpisë dhe/ose të kujdeseshin për fëmijët për shkak të dhunës në familje	25.0
Nuk ishin në gjendje të shkonin në punë (kishin humbur ditë pune) për shkak të dhunës në familje	8.9
Kishin humbur punën apo burimin e të ardhurave për shkak të dhunës në familje	0.5

në gjendje të bënin punët e shtëpisë dhe/ose të kujdeseshin për detyrimet ndaj fëmijëve ndryshonin nga 1 në 30 ditë; çdo vit, gratë e rrahura humbitnin mesatarisht 4.4 ditë nga bërja e punëve të shtëpisë dhe kujdesia për fëmijët për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje. Ky informacion pastaj u përdor

Ndërprerje në punën e grave për shkak të lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje:

- Nga 11.673 gratë që nuk ishin në gjendje të kryenin punët e shtëpisë dhe/ose të kujdeseshin për fëmijët e tyre për shkak të lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje, 4.137 gra nuk kishin mundësi të shkonin në punë për shkak të lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje gjatë 12 muajve të kaluara,
- Ato kishin humbur gjithsej 15.220 ditë punë gjatë 12 muajve të shkuar, 381.70 Lek për ditë x 15.220 ditë = 36.249.474 Lek (330,615 dollarë) në vit paga të humbura.

për numrin e vlerësuar të grave që kishin përjetuar dhunë fizike gjatë 12 muajve përpara intervistës, për të prodhuar vlerësime vjetore të prodhimtarisë së përgjithshme të humbur. Po ashtu, analiza tregoi se 11.673 gra, të cilat nuk kishin qenë në gjendje të kryenin punët e shtëpisë dhe/ose të kujdeseshin për fëmijët për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje, kishin humbur gjithsej 51.096 ditë punë shtëpie dhe kujdesi për fëmijët gjatë 12 muajve përpara intervistës, që është e barabartë me 140 vite - njerëz¹⁷³. Gjithashtu, gratë kishin humbur ditë pune për shkak të lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje. Numri i ditëve që gratë kishin humbur nga puna për shkak të dhunës në familje, ndryshonte nga 1 ditë deri në 30 ditë; në bazë vjetore, gratë e rrahura kishin munguar mesatarisht 3.7 ditë nga puna për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje (shih Tabelën 6.15). Analiza e mëtejshme tregoi se 4.137 gra, të cilat nuk ishin në gjendje të shkonin në punë për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje, kishin humbur gjithsej 15.220 ditë pune gjatë 12 muajve përpara intervistës, që është barabar me 59 punë me orë të plota çdo vit.¹⁷⁴ Gjithashtu është barabar me 42 vite -njerëz.¹⁷⁵

Vlera e produktivitetit të humbur nga puna e paguar për viktimat e lënduara të dhunës në familje u përllogarit duke përdorur vlerat mesatare ditore të punës, që mbështeten në të dhënat statistikore të vitit 2018 për pagat ditore të vlerësuara të grave (kjo e dhënë është përllogaritur nga INSTAT-i).¹⁷⁶ Vlera aktuale e fitimeve të humbura është përllogaritur duke shumëzuar numrin gjithsej të ditëve të humbura të punës (15.220) gjatë 12 muajve të fundit,

Tabela 6.15. Lëndimet nga dhuna në familje dhe pamundësia për të bërë punë shtëpie, për t'u kujdesur për fëmijët dhe për të shkuar në punë (të dhëna të ponderuara)

Numri i ditëve kur gratë nuk ishin në gjendje të kryenin punët e shtëpisë dhe/ose të kujdeseshin për fëmijët për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje	Dhunë fizike (ndonjëherë) N=14,245 %	Dhunë fizike (aktualisht) N=11,673 %
1 ditë	19.7	18.6
2-3 ditë	43.0	56.3
4-5 ditë	10.0	8.6
7 ditë	10.3	11.2
12 ditë	1.0	0.0
30ditë	5.9	5.4
Numri i ditëve që gratë nuk ishin në gjendje të shkonin në punë (humbën ditë pune) për shkak të lëndimeve nga dhuna në familje	N=5,881	N=4,137
1 ditë	31.8	26.3
2-3 ditë	27.1	30.2
4-5 ditë	7.4	4.2
7 ditë	3.4	4.9
28 ditë	5.3	7.6
30 ditë	1.7	0.0

me pagën ditore të vlerësuar të grave (2.381.70 Lek).¹⁷⁷ Bazuar në këtë llogaritje, kostoja vjetore e vlerësuar për pagat e humbura të viktimave të lënduara të dhunës në familje u vlerësua me 36.249.474 Lek / USD \$330,615. Nëse punët e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijët do të ishin punë të paguara, kostoja e pagave të humbura do të ishte shumë më e larta në bazë vjetore. Gjithashtu, për 0,5% të grave të cilat humbën punën apo burimin e të ardhurave për shkak të dhunës në familje, nuk e dimë se për sa muaj apo vite ato mbetën jashtë fuqisë punëtore dhe sa ishte vlera e përgjithshme e pagave që ato humbën për shkak të dhunës në familje.

Këto të dhëna tregojnë se dhuna në familje ka pasoja të konsiderueshme ekonomike për gratë, si edhe për familjet, bizneset private dhe sektorët

publikë, përmes humbjes së produktivitetit dhe pakësimit të të ardhurave të grave, për shkak të humbjes së punës. Humbja e punës mund të përfshijë mungesa afatgjata dhe afatshkurtra përmes ardhjes me vonesë, mosparaqitjes në punë, dhe përdorimit të ditëve të lejes për sëmundje për lëndimet e shkaktuara nga dhuna në familje, si edhe probleme me përqendrimin, kryerjen e punës dhe produktivitetin. Studimet ekzistuese tregojnë se gratë e punësuar që përjetojnë dhunë në familje shpesh janë subjekt i një game taktikash të përdorura nga bashkëshortët/partnerët e tyre dhunues, të cilat ua ulin aftësinë që të mbajnë një punë të rregullt. Disa nga taktikat e përdorura nga bashkëshortët/partnerët e tyre dhunues për të minuar përpjekjet e grave për shkuar në punë, përfshijnë fshehjen apo vjedhjen e çelësave apo paratë e transportit dhe mosardhja në shtëpi për t'u kujdesur për fëmijët.

Dhuna seksuale, përdorimi i mjeteve të kontrollit të lindjeve dhe risku i IST-ve

Studimi ka gjetur se gratë që përjetojnë dhuna seksuale në martesën/marrëdhënien e tyre intime shpesh kufizohen nga bashkëshorti/partneri i tyre dhunues të përdorin kontraceptivë apo të praktikojnë metoda për kontrollin e lindjes, dhe përballen me risk të shtuar të shtatzënive të padëshiruara dhe ekspozimit ndaj IST-ve, duke përfshirë HIV/AIDS.^{178,179,180,181,182} Të dhënat u analizuan për të kuptuar marrëdhënien midis përjetimeve të grave nga dhuna seksuale e ushtruar nga partneri intim, përdorimit të kontrollit të lindjeve dhe risku i marrjes së IST-ve. Grafiku 6.14 tregon se gratë që kanë përjetuar dhuna seksuale nga bashkëshortët/partnerët e tyre (27,1%) kishin nëntë herë më të ngjarë të raportonin se bashkëshortët/partnerët e tyre kishin refuzuar apo ishin orvatur t'i pengonin përdorimin e metodave për kontrollin e lindjeve për të shmangur mbetjen shtatzënë, krahasuar me gratë të cilat nuk përjetonin dhunë seksuale nga bashkëshortët/partnerët e tyre (3,1%).

Të dhënat u analizuan më tej për të kuptuar mënyrat me anë të të cilave bashkëshortët/partnerët ua kufizonin grave përdorimin e mjeteve të kontrollit

Grafiku 6.14. Marrëdhënia midis dhunës seksuale dhe kufizimit nga bashkëshorti/partneri i përdorimit të mjeteve për kontrollin e lindjeve (Të dhëna të ponderuara)





Tabela 6.16. Marrëdhënia midis dhunës seksuale dhe kufizimit të përdorimit të mjeteve për kontrollin e lindjes nga gratë (të dhëna të ponderuara)

	Dhunë seksuale	Nuk përjetojnë aktualisht dhunë seksuale
	%	%
Ju ka qëlluar apo rrahur	0	0.5
Ju ka hedhur tej kontraceptivët	13.9	3.3
Ju ka akuzuar se nuk jeni grua e mirë	18.3	2
Ju ka kërcënuar se do t'ju lerë ose do t'ju përzerë nga shtëpia	36.7	8.6
Ju ka thënë se nuk ishte e nevojshme	41	0.7
Ju ka kërcënuar se do t'ju rrihte	51.9	1.3
Ju ka treguar se nuk pajtohet me përdorimin e kësaj metode për të mos ngelur shtatzënë	52.5	9.6
Ju ka bërtitur/është nxehur me ju	56.4	20.5
Ju ka vënë në lojë	79.7	48

Grafiku 6.15. Lidhja midis dhunës seksuale dhe ITS-ve (të dhëna të ponderuara)



të lindjeve, sidomos grave që kanë përjetuar dhunë seksuale në martesën/marrëdhënien e tyre intime dhe atyre që nuk kishin përjetuar, por mund të kenë përjetuar forma të tjera dhune në martesën/marrëdhënien e tyre intime. Grafiku 6.15 tregon se mënyra më e zakonshme përmes të cilës bashkëshortët/partnerët ua kufizonin grave përdorimin e mjeteve të kontrollit të lindjes ishte me anë të dhunës psikologjike. Në veçanti, 3 në 4, ose 79,7% e grave që kishin përjetuar dhuna seksuale raportuan se bashkëshortët/partnerët e tyre i tallnin që përdornin mjete për kontrollin e lindjeve dhe 1 në 2, ose 56,4% e grave që përjetonin dhunë seksuale raportuan gjithashtu se bashkëshortët/partnerët e tyre u ulërinin/zemëroheshin me të pse përdornin mjete për kontrollin e lindjeve (të dy llojet e dhunës psikologjike); në krahasim me to, 48,0% e grave që nuk përjetonin dhuna seksuale në martesën/marrëdhënien e tyre intime, raportuan gjithashtu se bashkëshortët/partnerët e tyre talleshin me to që përdornin mjete për kontrollin e lindjeve, ndërsa 51,9% raportuan se bashkëshortët/partnerët e tyre i kërcënonin se do t'i rrihnin. Gjithashtu, 1 në 3, ose 36,7% e grave që përjetonin dhunë seksuale raportuan se bashkëshorti/partneri i kërcëronte se do t'i linte apo do t'i përzinte nga shtëpia sepse përdornin mjete për kontrollin e lindjeve, 18,3% raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre dhunues i akuzonte se nuk ishin gra të mira, dhe 13,9% e grave raportuan se bashkëshorti/partneri ua kishte

flakur tutje kontraceptivët (secila nga këto tri forma janë forma të dhunës psikologjike).

Disa gra raportuan se bashkëshortët/partnerët e tyre përdornin metoda më pak dhunuese për t'i kufizuar ato në përdorimin e mjeteve për kontrollin e lindjeve, si për shembull, se nuk pajtoheshin me përdorimin prej tyre të mjeteve të kontrollit të lindjeve për të shmangur mbetjen shtatzënë (52,5%), dhe duke u thënë se kontrolli i lindjeve nuk është i nevojshëm (41,0%).

Të dhënat u analizuan gjithashtu për të eksploruar marrëdhënien midis përjetimeve të dhunës seksuale të ushtruar nga partneri intim dhe ITS-ve. Grafiku 6.16 tregon se gratë që përjetonin “aktualisht” dhunë seksuale (20,8%) kishin dy herë më gjasa të shqetësoheshin se mos merrnin një IST dhe se mos kishin pasur një IST (6,3%), krahasuar me gratë të cilat nuk kishin përjetuar dhunë seksuale në martesën/marrëdhënien e tyre intime gjatë 12 muajve përpara intervistës (përkatësisht 11,3% dhe 2,5%). Gratë që përjetonin “aktualisht” dhuna seksuale gjithashtu kishin dhjetë herë më gjasa të kenë pasur një IST gjatë 12 muajve përpara intervistës, krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar dhunë seksuale në martesën/marrëdhënien e tyre intime gjatë 12 muajve përpara intervistës (5,8%). Gratë që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë seksuale (7,8%) kishin tre herë më gjasa të kenë pasur një IST, krahasuar me gratë të cilat nuk kanë përjetuar ndonjëherë dhunë seksuale në martesën/marrëdhënien intime të tyre (2,1%).

Alkooli dhe dhuna në familje

Marrëdhënia midis përdorimit/abuzimit të alkoolit dhe dhunës në familje është e ndërlikuar.^{183,184} Një nga mitet – idetë e rreme që i kanë shumë njerëz – për dhunën në familje është se alkooli është një shkak madhor i dhunës në familje; në të vërtetë, nuk është alkooli ai që shkakton dhunë në familje, ndonëse disa bashkëshortë/partnerë dhunues e përdorin alkoolin si pretekst për t'u bërë të dhunshëm.^{185,186} Ndonëse përdorimi/abuzimi i alkoolit nga dhunuesi mund të ndikojë në ashpërsinë e dhunës në familje, apo në lehtësinë me të cilën bashkëshorti/partneri dhunues i justifikon veprimet e veta, bashkëshorti/partneri dhunues nuk bëhet i dhunshëm për shkak të alkoolit. Me fjalë të tjera, të pirët e alkoolit nuk bën që bashkëshorti/partneri dhunues të humbasë kontrollin, përkundrazi, dhuna në familje përdoret për të ushtruar pushtet dhe kontroll mbi një person tjetër, pra nuk përfaqëson humbje të kontrollit.¹⁸⁷

Tabela 6.16 tregon se 50,5% e grave të moshës 18-74 vjeç të cilat ishin aktualisht/kishin qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose kishin jetuar me një bashkëshort/partner, raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre aktual/i fundit pinte alkool. Më konkretisht, 21,2% e grave raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre pinte alkool më pak se një herë në muaj, 13,0% raportuan se ai pinte alkool 1-3 herë në muaj, 11,0% raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre përdorte alkool një apo dy herë në javë, dhe vetëm 5,2% e grave raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre pinte alkool çdo ditë, apo pothuaj çdo ditë.


Gratë të cilat raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre aktual/i fundit pinte alkool, u pyetën se sa herë gjatë 12 muajve të fundit (ose të paktën gjatë 12 muajve të fundit të marrëdhënies së tyre të fundit) e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur. Tabela 6.16 tregon se 47,8% e grave raportuan se e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre ndonjëherë të dehur; ndërsa 25,5% e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur më pak se një herë në muaj, 10,3% e kishin parë të dehur një herë në muaj, 9,1% e kishin parë të dehur çdo javë, dhe 1,9% e shihnin bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve.

Tabela 6.17. Konsumi i alkoolit nga bashkëshorti/partneri (të dhëna të ponderuara)

Gra të moshës 18-74 vjeç që aktualisht janë/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose kanë jetuar me një bashkëshort/partner		N=886,374
		%
Bashkëshorti/partneri konsumon alkool		50.5
Sa shpesh konsumon alkool bashkëshorti/partneri juaj?		
Çdo ditë apo pothuaj çdo ditë		5.2
Një herë apo dy herë në javë		11.0
1-3 herë në muaj		13.0
Më pak se një herë në muaj		21.2
Ndonjëherë		47.3
Gjatë 12 muajve të fundit (gjatë 12 muajve të fundit të marrëdhënies) sa shpesh e keni parë bashkëshortin/partnerin të dehur?		Bashkëshorti/partneri konsumon alkool
		N=447,216
Shumicën e ditëve		1.9
Çdo javë		9.1
Një herë në muaj		10.3
Më pak se një herë në muaj		25.5
Ndonjëherë		47.8

U bënë analiza të mëtejshme për të eksploruar marrëdhënien midis konsumit të alkoolit nga bashkëshorti/partneri, sidomos shpeshtësinë e dehjeve dhe përjetimeve "aktuale" të grave nga dhuna në familje (një apo më shumë nga pesë llojet e dhunës), dhe dhunës fizike dhe/ose seksuale, ose nga të dyja. Grafiku 6.17 tregon se gratë të cilat përjetonin aktualisht dhuna në familje (66,8%) kishin dy herë më gjasa ta shihnin bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve, krahasuar me gratë të cilat nuk përjetonin dhuna në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (33,2%). Gratë të cilat e shihnin bashkëshortin të dehur shumicën e ditëve kishin gjithashtu më shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje, krahasuar me gratë të cilat e shihnin bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur çdo javës (52,3%), një herë në muaj (53,6%) dhe më pak se një herë në muaj (56,2%). Është për të vënë ndjekje se gratë të cilat nuk kishin përjetuar dhuna

Grafiku 6.16. Marrëdhënia midis gjendjes së dehur të bashkëshortit/partnerit dhe dhunës në familje (të dhëna të ponderuara)




në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (66,5%) kishin dy herë më gjasa ta mos e kishin parë kurrë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur gjatë 12 muajve të fundit, krahasuar me gratë që përjetonin “aktualisht” dhunë në familje (33,5%). Këto të dhëna tregojnë një lidhje midis përdorimit/abuzimit me alkoolin dhe dhunës në familje.

Ndonëse ka një lidhje të qartë midis përdorimit/abuzimit të alkoolit nga bashkëshorti/partneri dhe përjetimeve nga grave të dhunës në familje, nuk kishte një lidhje aq të qartë midis përjetimeve të grave nga dhuna fizike dhe/ose seksuale dhe dehjes së bashkëshortit/partnerit. Ajo që të bie më në sy është se gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur gjatë 12 muajve të fundit, në shkallë të ndryshme shpeshtësie, kishin më shumë gjasa të raportonin se nuk kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale në martesën/marrëdhënien intime të tyre gjatë 12 muajve përpara intervistës. Ajo që bie më në sy është se gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve (47,4%) kishin dy herë më gjasa të përjetonin dhunë fizike dhe/ose seksuale në martesën martesën/marrëdhënien intime të tyre, krahasuar me gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur çdo javë (20,5%), një herë në muaj (25,6%) dhe më pak se

një herë në muaj (18,7%). Këto të dhëna tregojnë se shpeshtësia e dehjes së bashkëshortit/partnerit është e lidhur me përjetimet nga gratë të dhunës fizike dhe/ose seksuale, ose nga të dyja. Vetëm 3,8% e grave të cilat e kishin parë ndonjëherë /partnerin e tyre të dehur gjatë 12 muajve përpara intervistës kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja.

Përdorimi/abuzimi me alkoolin nga një dhunues mund të ketë pasoja në ashpërsinë e dhunës në familje dhe riskun e lëndimeve të grave nga dhuna në familje. Grafiku 6.18 tregon se gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve (86,1%) dhe çdo ditë (77,5%) kishin më shumë gjasa të përjetonin frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi dhe/ose nervozizëm, krahasuar me gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur një herë në muaj (42,4%), më pak se një herë në muaj (59,8%) dhe ndonjëherë (49,2%). Gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve (36,6%) dhe çdo ditë (55,1%) kishin më shumë gjasa të pësonin të prera, të gërvishtura, dhimbje, skuqje apo ënjtje dhe/ose shenja të lehta, krahasuar me gratë të cilat i shihnin bashkëshortët/partnerët e tyre të dehur një herë në muaj (12,1%), më pak se një herë në muaj (21,8%) dhe ndonjëherë (21,6%).

Grafiku 6.17. Marrëdhënia midis dehjes së bashkëshortit/partnerit dhe lëndimeve të shkaktuara nga dhuna në familje (të dhëna të ponderuara)



Kur vjen puna tek lëndimet më të rënda të grave nga dhuna në familje, zakonet e përdorimit të alkoolit nga bashkëshorti/partneri i tyre ishin me rëndësi. Në veçanti, gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin të dehur shumicën e ditëve (14,5%) dhe çdo ditë (11,9%) kishin tri deri në katër herë më gjasa të pësonin lëndime në sy, ndrydhje gjymtyrësh dhe/ose filluska nga djegiet, krahasuar me gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur një herë në muaj (3,5%), më pak se një herë në muaj (5,5%) dhe ndonjëherë (3,7%). Gjithashtu, gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin të dehur çdo javë (10,9%) kishin katër deri në dhjetë herë më gjasa të përjetonin lëndime, tronditje në kokë dhe/ose humbje dëgjimi, krahasuar me gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve (1,9%), një herë në muaj (1,0%), më pak se një herë në muaj (0,0%) dhe ndonjëherë (2,3%).

Gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve (5,0%) gjatë 12 muajve të fundit kishin dy deri në shtatë herë më

gjasa të përjetonin lëndime, tronditje në kokë dhe/ose humbje dëgjimi, krahasuar me gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur çdo javë (0,0%), një herë në muaj (0,0%), më pak se një herë në muaj (0,7%) dhe ndonjëherë (2,5%). Gjithashtu, 3,1% e grave të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve, vuanin nga humbja e dëgjimit; gratë e tjera nuk vuanin nga humbja e dëgjimit.

Më në fund, gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur çdo javë (14,8%), kishin tri deri në tridhjetë e shtatë herë më gjasa të përjetonin humbjen e fëmijës, krahasuar me gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur shumicën e ditëve (5,0%), një herë në muaj (2,1%), më pak se një herë në muaj (0,4%) dhe ndonjëherë (2,4%). Gjithashtu, gratë të cilat e kishin parë bashkëshortin/partnerin e tyre të dehur çdo javë (6,8%) gjatë 12 muajve të fundit kishin më shumë gjasa të përjetonin lëndime dhe/ose shpërfytyrime të përhershme.

Ekspozimi i fëmijëve ndaj dhunës në familje

Dhuna në familje nuk prek vetëm gratë e rrahura dhe të keqtrajtuara, por ka efekte negative edhe ndaj fëmijëve që janë viktimë të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të dhunës në familje dhe dëshmitarë të dhunës në familje. Është e dokumentuar mirë se fëmijët vuajnë pasoja negative kur ekspozohen ndaj dhunës në shtëpi dhe familje. Nga njëra anë, ata janë në risk më të madh të përjetimit të neglizhencës, abuzimeve fizike dhe/ose seksuale.^{188,189} Në Mbretërinë e Bashkuar, Shoqata Kombëtare për Parandalimin e Mizorive ndaj Fëmijëve (NSPCC) ka konstatuar se të rinjtë që përjetojnë dhunë në familje, kanë nga 2,9 deri në 4,4 herë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë fizike dhe neglizhencë nga kujdestari se sa të rinjtë që nuk janë ekspozuar ndaj dhunës në familje.¹⁹⁰ Po ashtu, një studim në Zelandën e Re konstatoi se risku i abuzimit të fëmijëve ishte tre deri në nëntë herë më i madh në ato shtëpi ku prindërit ziheshin me njëri tjetrin.¹⁹¹ Kërkimet gjithashtu kanë provuar se pasojat negative për fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës në familje përfshijnë probleme të menjëhershme dhe afatgjata emocionale dhe të shëndetit mendor, si edhe probleme të zhvillimit, të sjelljes dhe sociale.^{192,193,194,195} Dhuna në familje gjithashtu i mëson fëmijët se dhuna është pjesë normale e jetës dhe e rrit riskun që ata të bëhen brezi tjetër i viktimave dhe dhunuesve në shoqëri.¹⁹⁶


Ndryshe nga VKDHF-të e 2007 dhe 2013 në Shqipëri, studimi i 2018 nuk i pyeti gratë që kanë përjetuar dhunë në familje nëse fëmijët e tyre ishin prekur nga dhuna dhe për mënyrat se si ishin prekur (për shembull, kishin qenë dëshmitarë të dhunës, jetonin me frikë, ishin lënduar, ishin larguar nga shtëpia për të jetuar me të afërm, u ishte ulur aftësia për të mësuar, apo diçka tjetër). Ky grup pyetjesh duhet të përfshihet në vërtetimet e ardhshme, sepse është e rëndësishme të mësohet nga këndvështrimi i grave (nënave) se çfarë ndikimi ka dhuna në familje ndaj fëmijëve të tyre. Pavarësisht faktit se këto pyetje u hoqën nga vërtetimi, të dhënat u analizuan për të vlerësuar se sa fëmijë ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje dhe për të eksploruar lidhjen midis dhunës në familje dhe gamës së problemeve të sjelljes që gratë raportuan se fëmijët e tyre të moshës 5-17 vjeç (që jetonin në shtëpi) kishin përjetuar.

Të dhënat e ponderuara u analizuan për të vlerësuar numrin e grave të moshës 18-74 vjeç, të cilat kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjen e tyre, pastaj u bënë përlllogaritje për të gjeneruar numrin e përgjithshëm të fëmijëve të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjet e grave që kanë përjetuar dhunë në familje (ndonjëherë dhe aktualisht) dhe dhunë fizike dhe/ose seksuale (ndonjëherë dhe aktualisht). Tabela 6.17 tregon se 47,7% e grave të moshës 18-74 vjeç, të cilat kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjet e tyre, raportuan se kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje dhe 40,1% se përjetonin

Tabela 6.18. Numri i vlerësuar i fëmijëve të ekspozuar ndaj dhunës në familje midis grave të marra në kampion (të dhëna të ponderuara)

	# e fëmijëve		
	Gra të moshës 18-74 vjeç të cilat kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç në shtëpi N=830.152	Numri i fëmijëve të moshës 0-17 vjeç që jetojnë në shtëpitë e grave që kanë përjetuar dhunë në familje N=591.476	% numrit gjithsej të fëmijëve në familjet e vrojtura
	%	n	%
Dhunë në familje (ndonjëherë)	47.7	286,498	48.4
Dhunë në familje (aktualisht)	40.1	246,707	41.7
Dhunë fizike dhe/ose seksuale (ndonjëherë)	21.1	128,144	21.7
Dhunë fizike dhe/ose seksuale në familje (aktualisht)	11.7	73,535	12.3

Grafiku 6.18. Problemet e fëmijëve (të moshës 5-17 vjeç) për shkak të ekspozimit të nënës ndaj dhunës në familje (të dhëna të ponderuara)



“aktualisht” dhuna në familje (një nga pesë llojet matura të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim). Më konkretisht, 21,1% e grave që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, dhe 11,7% që po përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjet e tyre.

Nga 591.475 fëmijët e moshës 0-17 vjeç që jetojnë në familjet e vrojtuar:

- 286,498 fëmijë të moshës 0-17 vjeç kishin më shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë jetës së tyre.
- 246.707 fëmijë të moshës 0-17 vjeç kishin më gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktuale)

Bazuar në të dhënat e ponderuara për gratë të cilat kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjet e tyre dhe numrin e fëmijëve që secila prej tyre kishte, u përllogarit se gjithsej ishin 591.476 fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjet e vrojtuar. U bënë përllogaritje të mëtejshme për të vlerësuar numrin e fëmijëve që jetonin në familje ku gratë përjetonin dhunë në familje (ndonjëherë dhe aktualisht) dhe

dhunë fizike dhe/ose seksuale (ndonjëherë dhe aktualisht) në përpjekje për të dokumentuar se sa fëmijë kishin më shumë gjasa të ishin të ekspozuar ndaj dhunës në familje. Tabela 6.17 tregon se afërsisht 286.498 fëmijë të moshës 0-17 vjeç kishin më shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje për shkak se nënat e tyre kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje, dhe 246.707 fëmijë kishin më gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës për shkak se nënat e tyre përjetonin “aktualisht” dhuna në familje. Më konkretisht, 128.144 fëmijë të moshës 0-17 vjeç kishin më gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale në familjen e tyre, sepse nënat e tyre kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike dhe/ose seksuale nga bashkëshorti/partneri, dhe 73.535 fëmijë të moshës 0-17 vjeç kishin shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale gjatë 12 muajve përpara intervistës, sepse nënat e tyre përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja.

Të dhënat në Tabelën 6.17 u analizuan më tej për të përcaktuar se sa përqind e 591.475 fëmijëve të moshës 0-17 vjeç jetonin në familje ku ish ushtruar apo ushtrohej dhunë në familje. Tabela 6.17 tregon se 48,4% e 591.475 fëmijëve që jetonin në familjet e vrojtuar, kishin mjaft të ngjarë të ishin të ekspozuar ndaj dhunës në familje, dhe 41,7% kishin shumë të

ngjarë të ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës, duke qenë se nënat e tyre kishin përjetuar dhunë në familje. Më konkretisht, 21,7% e 591.475 fëmijëve që jetonin në familjet e vrojtura, kishin shumë të ngjarë të ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale, dhe 12,3% kishin shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale gjatë 12 muajve përpara intervistës, sepse nënat e tyre përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja.

Gjithashtu të dhënat u analizuan për të eksploruar marrëdhënien midis ekspozimit të fëmijëve ndaj dhunës në familje dhe problemeve emocionale dhe të sjelljes të përjetuara nga fëmijët e moshës 5-17 vjeç që jetojnë në familje. Grafiku 6.18 tregon se fëmijët e moshës 5-17 vjeç të cilat kishin mjaft gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht), kishin dy herë më gjasa të përjetonin ankthe të shpeshta (25,3%), krahasuar me fëmijët të cilët nuk ishin të ekspozuar ndaj dhunës në familje (9,5%). Gjithashtu, fëmijët e moshës 5-17 vjeç të cilët kishin shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht) kishin tre herë më gjasa të urinonin në shtrat (20,4%), të ishin shumë të ndrojtur apo të tërhequr (21,5%) dhe të vepronin me agresivitet ndaj nënave dhe/ose fëmijëve të

tjerë (6,9%), krahasuar me fëmijët të cilat nuk ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje (përkatesisht 6,7%, 7,1% dhe 1,9%). Këto gjetje bazohen në informacionin e dhënë nga nënat e këtyre fëmijëve; fëmijët nuk u intervistuan në këtë vërtetim.

Më e dukshme është se 44,2% e fëmijëve të moshës 5-17 vjeç të cilat kishin shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht), kishin përjetuar makthe të shpeshta; ata kishin tre herë më gjasa të përjetonin makthe të shpeshta, krahasuar me fëmijët të cilët nuk ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale (12,1%). Fëmijët që kishin më shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale gjatë 12 muajve përpara intervistës (aktualisht), kishin gjithashtu tri herë më gjasa të urinonin në shtrat shpesh (30,9%) dhe katër herë më gjasa të ishin shumë të ndrojtur apo të tërhequr (9,4%), krahasuar me fëmijët të cilët nuk ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale (përkatesisht 9,7% dhe 9,4%). Gjithashtu, fëmijët të cilët kishin më shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale gjatë 12 muajve përpara intervistës (6%) kishin pothuaj dy herë më gjasa të vepronin me agresivitet ndaj nënës dhe/ose fëmijëve të tjerë, krahasuar me fëmijët të cilët nuk ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale

Gratë e rrahura në Shqipëri vijnë të vuajnë në heshtje

Vetëm 16,9% e grave që përjetonin “aktualisht” dhunë në familje kishin treguar dikujt për dhunën dhe vetëm 8,4% kishin kërkuar ndihmë përdhunën në familje

Gratë që përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale ose të dyja, kishin dy herë më gjasa t’i tregonin dikujt për dhunën (30,8%) dhe dy herë më gjasa të kërkonin ndihmë (18,5%)



Tabela 6.19. Sjellje që kërkojnë ndihmë midis grave të rrahura (të dhëna të ponderuara)

	Dhunë në familje (aktualisht) N=298.198 %	Dhunë në familje (ndonjëherë) N=416.998 %	Dhunë fizike dhe/ose seksuale (aktualisht) N=186.272 %	Dhunë fizike dhe/ose seksuale (ndonjëherë) N=186.272 %
I kanë treguar dikujt për dhunën në familje	16.9	14.9	30.8	23.3
Kanë kërkuar ndihmë për dhunën në familje	9.0	6.7	18.5	10.5

(3,7%). Këto gjetje bazohen në informacionin e dhënë nga nënat e këtyre fëmijëve; fëmijët nuk u intervistuan në këtë vrojtim.

Nënat gjithashtu u pyetën nëse fëmija (fëmijët) e tyre kish ikur ndonjëherë nga shtëpia. Grafiku 6.19 tregon se fëmijët e moshës 5-17 vjeç jo pa tjetër kishin gjasa të iknin nga shtëpia nëse ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje ose dhunës fizike dhe/ose seksuale. Përkundrazi, fëmijët e moshës 5-17 vjeç, të cilët nuk ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje (28,8%) apo dhunës fizike dhe/ose seksuale (26,0%) gjatë 12 muajve të fundit, në fakt kishin më gjasa të iknin nga shtëpia, krahasuar me fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës në familje (17,8%) ose dhunës fizike dhe/ose seksuale (12,0%). Një model i ngjashëm doli kur analizat panë ekspozimet ndaj dhunës në familje dhe dhunës fizike dhe/ose seksuale gjatë jetës.

Sjellje që kërkojnë ndihmë

Gratë e rrahura shpesh ngurrojnë të kërkojnë ndihmë për dhunën në familje. Tabela 6.18 tregon se vetëm 16,9% e grave që përjetonin “aktualisht” dhunë në familje, i kishin treguar dikujt për dhunën dhe vetëm 8,4% e grave kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje; përqindja e grave që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje dhe i kanë treguar dikujt për të (14,9%) dhe kanë kërkuar ndihmë (6,7%) ishte pak më e vogël. Përkundrejt tyre, gratë që përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, kishin pothuaj dy herë më gjasa t’i tregonin dikujt për dhunën (30,8%) dhe dy herë më gjasa të kërkonin ndihmë (18,5%). Gratë që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, kishin më pak gjasa t’i tregonin dikujt për dhunën (23,3%) dhe të

kërkonin ndihmë për dhunën në familje (10,5%)

Këto gjetje tregojnë se shumica e grave të rrahura në Shqipëri vijojnë të vuajnë në heshtje, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për problemin e dhunës në familje dhe legjislacionit të hartuar kohët e fundit për dhunën në familje, si dhe shërbimet shoqërore për viktimat e dhunës në familje. Kështu, gratë e rrahura nuk marrin mbrojtje, shërbime mbështetëse dhe nuk sigurojnë qasje në drejtësi, që është e drejta e tyre ligjore dhe njerëzore. Fakti që gratë të cilat përjetonin aktualisht dhunë fizike dhe/ose seksuale kishin ndjeshëm më shumë të ngjarë t’i tregonin dikujt për dhunën dhe të kërkonin ndihmë, mund të pasqyrojë ndryshimin e normave shoqërore dhe rritjen e ndërgjegjësimin të grave në lidhje me mbrojtjet e tyre ligjore dhe shërbimet shoqërore që ekzistojnë për viktimat e dhunës në familje.

Tabela 6.19 tregon se kur gratë kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje, shumica kishin kërkuar ndihmën e familjeve të tyre (98,9%) dhe një përqindje e konsiderueshme grash kishin kërkuar ndihmë nga familja e bashkëshortit/partnerit të tyre (40,4%). Ndonëse në numër të paktë, disa gra kishin kërkuar ndihmë nga rrjetet informale të tilla si fqinjët (11,9%), mikeshat (6,7%) dhe udhëheqësit fetarë (1,7%). Shumë më pak gra kishin kërkuar ndihmë nga rrjete zyrtare si policia (4,4%), avokatët (3,4%), mjekët/punonjësit e shëndetësisë (3,1%), gjyqtarët (2,8%), një agjenci/organizatë e shërbimit social (1,6%) dhe një strehe për gratë dhe vajzat (0,4%). Asnjë grua nuk kish kërkuar ndihmë nga linja telefonike 24 orëshe pa pagesë dhe/ose nga koordinatori lokal për dhunën në familje; kjo gjetje mund të të bëjë të mendosh se, ose gratë nuk kanë dijeni për linjën telefonike pa pagesë dhe/ose

Tabela 6.20. Nga kush kishin kërkuar ndihmë viktimat e dhunës në familje (të dhëna të ponderuara)

Familja	Gratë të cilat kanë kërkuar ndihmë për dhunën në familje N=28,097 %
Familja e tyre	98.0
Familja e bashkëshortit/partnerit	40.4
Bashkëshorti/i dashuri aktual/i dikurshëm	4.2
Rrjetet informale	
Shoqet	6.7
Fqinjët	11.9
Udhëheqës fetar	1.7
Rrjetet formale	
Mjeku/punonjësit e shëndetësisë	3.1
Oficeri i policisë	4.4
Avokati	3.4
Gjyqtari	2.8
Agjenci/organizatë e shërbimeve sociale	1.6
Streha për gratë dhe vajzat	0.4
Linja telefonike pa pagesë	0.0
Koordinatori lokal i dhunës në familje	0.0
Të tjerë	0.0

për koordinatorët lokalë për dhunën në familje, ose të mbijetuarat e dhunës në familje nuk kanë besim në këto rrjete formale të shërbimeve mbështetëse.

Gratë e rrahura të cilat kishin kërkuar ndihmë, u pyetën përse kishin kërkuar ndihmë. Tabela 6.20 tregon se arsytet më të zakonshme që gratë e rrahura dhanë për kërkimin e ndihmës ishin se miqtë e mikeshat

Tabela 6.21. Arsytet përse viktimat e dhunës në familje kishin kërkuar ndihmë (të dhëna të ponderuara)

	Gratë të cilat kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje N=28,097 %
Nuk mund ta duroja dot më dhunën	58.8
Ndihesha shumë e lënduar	43.6
Miqtë e mikeshat apo familja më nxitën të kërkoja ndihmë	63.5
Ai më kërcënoi apo u përpoq të më vriste	5.9
Kisha frikë se do të më vriste	9.8
Shihja fëmijët që vuanin	22.3
Ai i kërcënonte apo godiste fëmijët	4.3
Ai më nxori nga shtëpia	4.7
Kisha frikë se mos e vrisja unë atë	2.2
E di se dhuna është e papranueshme	62.6
Të tjera	1.1

dhe familja i kishin nxitur të kërkonin ndihmë (63,5%), e dinin se dhuna është e papranueshme në marrëdhënie (62,6%), nuk mund ta duronin dot më dhunën (58,8%), dhe se ishin të lënduara rëndë (43,6%). Ndonëse më të pakta në numër, 22,3% e grave kishin kërkuar ndihmë, sepse i kishin parë fëmijët e tyre të vuanin. Gjithashtu, 9,8% e grave kishin frikë se mos bashkëshorti/partneri i tyre i vriste, 4,9% raportuan se bashkëshorti/partneri i tyre i kërcënonte se do t'i vriste, 4,7% thanë se bashkëshorti/partneri i tyre i kish përzënë nga shtëpia, 4,3% thanë se u kish kërcënuar apo kish goditur fëmijët, dhe 2,2% kishin frikë se mos e vrisnin bashkëshortin/partnerin e tyre.

Tabela 6.22. Viktimat e dhunës në familje të cilat janë larguar nga shtëpia për shkak të dhunës në familje (të dhëna të ponderuara)

	Dhunë në familje (aktualisht) N=298.199 %	Dhunë në familje (ndonjëherë) N=416.998 %	Dhunë fizike dhe/ose seksuale (aktualisht) N=72.338 %	Dhunë fizike dhe/ose seksuale (ndonjëherë) N=186.272 %
Jeni larguar ndonjëherë nga shtëpia, qoftë edhe për një natë për shkak të dhunës në familje?	10.0%	8.8	18.3	12.1

Tabela 6.21 tregon se të pakta janë gratë që kanë përjetuar dhunë në familje (10,0% aktualisht, 8,8% ndonjëherë) dhe më konkretisht dhunë fizike dhe/ose seksuale (18,3% aktualisht, 12,1% ndonjëherë), dhe që janë larguar ndonjëherë nga shtëpia për shkak të dhunës në familje, qoftë edhe për një natë. Numri i ditëve gjatë të cilave ato ishin larguar nga shtëpia, ndryshonte nga 1 në 20 ditë, në varësi të gruas, për një kohë mesatare prej 2.1 ditë për grua. Gjithsej 36.879 gratë të cilat kanë përjetuar ndonjëherë dhunë në familje ishin larguar nga shtëpia për 76,486 ditë, për shkak të dhunës në familje (e barasvlershme me 209.5 vite).

Tabela 6.22 tregon arsyet për largimin e grave të rrahura nga shtëpia. Arsyet ndryshonin shumë, duke përfshirë: nuk mund ta duronin më tej dhunën (34,8%); i kishin shtyrë miqtë e mikeshat apo familja të largoheshin (22,9%); ishin lënduar rëndë (13,8%); bashkëshorti/partneri i tyre i kish kërcënuar apo ish orvatur t'i vriste (12,4%) dhe u kish goditur fëmijët

Tabela 6.23. Arsyet përse viktimat e dhunës në familje ishin larguar nga shtëpia (të dhëna të ponderuara)

Arsyet për largimin e viktimave të dhunës në familje herën e fundit	Gratë të cilat ishin larguar nga shtëpia për shkak të dhunës në familje N=37.405
	%
Nuk kish ndodhur ndonjë incident i veçantë	24.1
Më nxitën miqtë, mikeshat/familja	22.9
Nuk e duroja dot dhunën	34.8
Isha lënduar rëndë	13.8
Ai më kërcënoi apo u orvat të më vriste	12.4
Kërcënoi se do të godiste fëmijët	12.2
Pashë fëmijët që vuanin	9.3
Më nxori jashtë nga shtëpia	4.7
Kisha frikë se mos më vriste	10.4
Më nixti organizata	0.0
Kisha frikë se mos e vrisja unë atë	.6
Të tjera	0.7

(12,2%); kishin frikë se mos bashkëshorti/partneri i tyre do t'i vriste (10,4%); shihnin fëmijët që vuanin (9,3%); dhe, bashkëshorti/partneri i tyre i kish nxjerrë jashtë nga shtëpia (4,7%).

Tabela 6.18 tregoi se shumica e grave që kishin përjetuar dhunë në familje, nuk kishin kërkuar ndihmë. Tabela 6.23 tregon se arsyeja më e zakonshme që dhanë gratë për moskërkimin e ndihmës ishte se mendonin se situata nuk ishte aq e rëndë sa të ankoheshin (47,8%). Ndonëse më të pakta në numër, 12,0% e grave të rrahura thanë se nuk donin të turpëronin familjen, 10,9% ndiheshin në siklet, kishin turp apo frikë se nuk do t'i besonin dhe 9,7% mendonin se do t'i fajësonin ato vetë.

Tabela 6.24. Arsyet përse viktimat e dhunës në familje nuk kanë kërkuar ndihmë (të dhëna të ponderuara)

Viktimat e dhunës në familje të cilat nuk kanë kërkuar ndihmë N=403.551	
	%
Nuk e di/nuk e dija ku të kërkoja ndihmë	4.9
Besoj se nuk do më zgjidhte gjë/njoh gra të tjera që nuk i ka ndihmuar njeri	4.2
Kam/kisha frikë se mos më kërcënonin dhe nga pasojat apo nga dhuna e mëtejshme	6.1
Jam/isha në siklet, kisha turp apo frikë se nuk do më besonin	10.9
Kam/kisha frikë nga shkurorëzimi apo nga përfundimi i marrëdhënies	6.5
Mendoj/mendoja se fajin do ma vinin mua	9.7
Mendoj se nuk ka arsye të ankohem/dhunë është normale	6.8
Situata nuk ishte aq e rëndë sa të ankohesha	47.8
Kam/kisha frikë se mos humbisja fëmijët	6.0
Nuk dua të turpëroj familjen time	12.0
Të tjera	0.9

Një përqindje e vogël e grave mendojnë se nuk kishte arsye të ankoheshin, sepse dhuna është diçka normale (6,8%), kishin frikë nga shkurorëzimi apo nga marrja fund e marrëdhënies (6,5%), kishin frikë nga kërcënimi dhe nga pasojat apo nga përdorimi i mëtejshëm i dhunës (6,1%), kishin frikë se mos humbitnin fëmijët (6,0%), nuk dinin ku të drejtoheshin për ndihmë (4,9%), dhe besonin se nuk do t'u zgjidhte gjë (4,2%).

Të dhënat në Tabelën 6.23 tregojnë arsyet përse gratë e rrahura nuk kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje. Edhe kur gratë nuk kërkojnë ndihmë për dhunën në familje, shenjat e dhunës në familje vazhdojnë të jenë ende mjaft reale dhe janë të rrënjësura thellë tek gratë e rrahura, gjë që shpjegon edhe arsyen përse gratë e rrahura e kanë të vështirë të kërkojnë ndihmë, të shohin opsionet që kanë, dhe të organizojnë burimet që ju nevojiten për t'u larguar nga një martesë/marrëdhënie e dhunshme.

Divorci dhe ndarja për shkak të dhunës në familje

Tabela 6.24 tregon se 93.9% e grave të cilat ishin ndarë nga bashkëshortët/partnerët e tyre ishin viktimat e dhunës në familje; ndërsa 31,7% e të divorcuarave dhe 35,9% e grave të veja kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje.


Tabela 6.25. Shkurorëzimi dhe ndarja për shkak të dhunës në familje (të dhëna të ponderuara)

	Dhunë në familje (ndonjëherë) N=57.077	
	Jo %	Po %
Të divorcuara	68.3	31.7
Të ndara	6.2	93.9
Të veja	64.1	35.9


Autorët e dhunës në familje

Të dhënat u analizuan për të kuptuar karakteristikat demografike të autorëve të dhunës në familje. Gratë nuk u pyetën konkretisht për moshën e autorëve të tyre; të vetmet të dhëna që u mbledhën ishin për moshën e bashkëshortit/partnerit aktual/të fundit. Për këtë arsye u analizuan moshat e bashkëshortëve/partnerëve aktual/të fundit të grave që përjetonin “aktualisht” dhunë në familje dhe më konkretisht, dhunë fizike dhe/ose seksuale. Grafiku 6.20 tregon se shumë pak autorë ishin nën moshën 25 vjeç, por më së shumti, ishin të moshës 24-35 vjeç, 35-44 vjeç, 45-55 vjeç dhe 55-64 vjeç. Ishin më të paktë autorët e moshës 65 vjeç apo më shumë.

Grafiku 6.19. Mosha e autorëve të dhunës në familje (të dhëna të ponderuara)



Grafiku 6.20.Niveli i arsimit të autorëve të dhunës në familje (të dhëna të ponderuara)



Ka një mundësi të vogël që, në rastin e disa grave, bashkëshorti/partneri aktual/i fundit mund të ishte i ndryshëm nga autori i dhunës në familje; gjithsesi, konstatimi do të vlente për shumicën e rasteve, për shkak se kampioni përbëhej nga gra që aktualisht ishin/kishin qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose jetonin me bashkëshortin/partnerin, dhe 86,1% e kampionit ishin aktualisht martuara të dhe jetonin me bashkëshortët.

Grafiku 6.21 tregon nivelin arsimor të autorëve të dhunës në familje. Shumica e autorëve të dhunës në familje kishin arsimin e ulët 8 dhe 9 nëntë vjeçar (47,9%) ose arsimin 8 ose 9 vjeçar (30,0%). Shumë më pak autorë kishin vetëm arsimin fillor (7,4%) ose ishin

pa diplomë (1,7%); megjithatë, këto përqindje mund të pasqyrojnë më shumë përqindjen e burrave në popullatë që kanë arsim fillor apo më pak. Të bie në sy se vetëm 2,3% e autorëve të dhunës në familje kishin diplomë universiteti apo më lart. Këto konstatime mund të pasqyrojnë faktin se shkallët e dhunës në familje mund të jenë më të ulëta midis individëve me arsim universitar, megjithatë, nevojitet një studim i mëtejshëm për të kuptuar marrëdhënien midis niveleve të arsimit dhe dhunës në familje.

Tabela 6.25 tregon se shumica e autorëve të dhunës në familje punonin (68,7%) në kohën e kryerjes së vrojtimit; vetëm 12,6% ishin të papunë dhe në kërkim të punës, 11,9% kishin dalë në pension dhe 2,5% ishin të paaftë apo kishin një sëmundje afatgjatë.


Tabela 6.26. Statusi i punës i autorëve të dhunës në familje (Të dhëna të ponderuara)

Statusi i punës aktualisht	Dhuna në familje (aktualisht)
	N=298,692
	%
Punon	68.7
Në kërkim të punës/i papunë	12.6
Në pension	11.9
Student/në shkollë	0.0
I paaftë/me sëmundje afatgjatë	2.5
Tjetër	3.3

Të ardhurat e familjes dhe dhuna në familje

Pavarësisht se të anketuarat nuk raportojnë gjithnjë të ardhura të sakta familjare, Grafiku 6.22 tregon marrëdhënien midis përjetimeve aktuale të dhunës në familje dhe të ardhurave të familjes. Me sa del, gratë që kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale gjatë 12 muajve përpara intervistës, kishin më shumë gjasa të raportonin të ardhura familjare prej <12,000 Lek (11,8%) dhe 12.001-26.000 Lek (32,7%) në muaj, krahasuar me gratë të cilat përjetonin

Grafiku 6.21. Marrëdhënia midis dhunës në familje dhe të ardhurave familjare (të dhëna të ponderuara)



aktualisht dhuna në familje (përkatësisht, 8,3% dhe 23,0). Gratë që kishin përjetuar dhuna në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës, kishin pothuaj dy herë më gjasa të raportonin të ardhura familjare prej 60.001-110/000 Lek (10,2%) në muaj, krahasuar me gratë që kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose

seksuale (përkatësisht 5,8%). Këto të dhëna mund të pasqyrojnë faktin që gratë në grupimet më të larta të të ardhurave, kanë më shumë gjasa të përjetonin sjellje kontrolluese shtrënguese, dhunë psikologjike dhe/ose dhunë ekonomike, se sa dhunë fizike dhe/ose seksuale.

KAPITULLI 7



DHUNA E USHTRUAR NGA JOPARTNERI

Është e dokumentuar mirë se gratë dhe vajzat janë në rrezik të dhunës fizike dhe/ose seksuale të ushtruar nga jopartnerët (jopartner – çdo person tjetër përveç bashkëshortit/partnerit/të dashurit) në kontekstin e familjes dhe shtëpisë dhe në ambientet publike. Në vitin 2005, OBSH globale vlerësoi se 7,2% e grave përjetonin dhunë seksuale nga jopartneri në jetën e tyre.¹⁹⁷

Sondazhi i gjerë i BE-së në 2013 mbi DhNGV-në konstatoi se 22,0% e grave kishin pësuar dhunë fizike që prej moshës 15 vjeçare nga dikush tjetër i ndryshëm nga partneri i tyre.¹⁹⁸

Studimi përqendrohet tek dhuna fizike dhe seksuale e përjetuar nga gratë që prej moshës 15 vjeçare nga pjestarë të familjes dhe të afërm të tjerë, dhe nga të tjerë që nuk janë pjestarë të familjes (jopartneri). Ky kapitull zbulon shtrirjen e dhunës fizike dhe seksuale të jopartnerit të pësuar nga gratë që në moshën 15 vjeçare, dhe zbulon autorët e dhunës ndaj grave dhe sjelljet e kërkimit të ndihmës të grave që përjetonin dhunë jo nga partneri.


Përjetimet e dhunës nga jopartneri që prej moshës 15 vjeçare

Tabela 7.1 tregon se midis grave të moshës 18-74 vjeç, 18,2% e tyre kanë përjetuar “ndonjëherë” dhe 2,4% “aktualisht” një ose më shumë se një nga katër llojet e dhunës fizike dhe/ose seksuale që në moshën 15 vjeçare nga dikush që është i ndryshëm nga bashkëshorti/i dashuri i tyre. Gratë kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë fizike nga jopartneri (17,3% ndonjëherë, 2,3% aktualisht) se sa dhunë seksuale nga jopartneri (1,3% ndonjëherë, 0,1% aktualisht).

Tabela 7.1. Përjetime të dhunës nga jopartneri që prej moshës 15 vjeçare (të dhëna të ponderuara)

	Kampioni gjithsej N=1,040,726	
	Ndonjëherë %	Aktualisht %
Përjetoi dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (një ose më shumë se një nga katër llojet)	18.2	2.3
Që prej moshës 15 vjeçare, një jopartner ju ka goditur, goditur me shuplakë, ju ka gjuajtur me shkelma ose ka kryerndonjë veprim tjetër për t'ju lënduar fizikisht (dhunë fizike)	17.3	2.3
Përjetoi dhunë seksuale nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare (një ose më shumë se një nga tre llojet)	1.3	0.0
Që prej moshës 15 vjeçare, një jopartner ju ka prekur seksualisht kundër dëshirës tuaj ose u përpoq t'ju prekte seksualisht, por nuk ia doli t'ju detyronte të kryenit marrëdhënie seksuale kundër dëshirës tuaj	0.0	0.0
Që prej moshës 15 vjeçare, një jopartner ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale kundër dëshirës tuaj, për shembull duke ju kërcënuar, duke ju mbajtur me forcë, ose duke ju vendosur në një situatë ku nuk mund të kundërshtoni	1.0	0.0
Që prej moshës 15 vjeçare, një jopartner ju detyroi të kryeni marrëdhënie seksuale kur ishit shumë e dehur apo e droguar për të refuzuar	1.1	0.0

Grafiku 7.1. Përjetimet e dhunës nga jopartneri sipas grupmoshave (të dhëna të ponderuara)



Për të kuptuar marrëdhënien midis moshës dhe përvojave të dhunës të ushtruar nga jopartneri u krye një analizë e mëtejshme. Grafiku 7.1 tregon se gratë e moshës 45 vjeç dhe më shumë kanë shumë më tepër gjasa të përjetojnë dhunë nga jopartneri që prej moshës 15 vjeçare krahasuar me gratë e moshës 18 deri në 44 vjeç. Gratë e moshës 25-34 vjeç kishin më pak gjasa të raportonin se kishin përjetuar dhunë nga jopartneri në jetën e tyre. Shumë më pak gra raportuan se kishin përjetuar dhunë nga jopartneri në 12 muajt përpara intervistës, por gratë e moshës 18-24

vjeç (3.2%), 45-54 vjeç (3.2%) dhe 65-74 vjeç (3.2%) kishin më shumë gjasa të përjetonin “aktualisht” dhunë nga jopartneri, krahasuar me gratë e moshës 25-34 vjeç (1.9%), 35-44 vjeç (1.8%) dhe 55-64 vjeç (1.6%). Përqindja e lartë e dhunës “aktualisht” nga jopartneri tek gratë e moshës 65-74 vjeç mund të zbulojë faktin se gratë e kësaj grupmoshe janë në rrezik të rritur të abuzimit të të moshuarve nga pjestarë të familjes.

Grafiku 7.2 tregon se shumica e grave kishin përjetuar vetëm një nga llojet e dhunës të ushtruar nga

Grafiku7.2. Numri i llojeve të dhunës fizike dhe/ose seksuale të ushtruar nga jopartneri (të dhëna të ponderuara)




Tabela7.2.Përjetime të abuzimit seksual në fëmijëri (të dhëna të ponderuara)

Kampioni gjithsej N=1.040.726	%
Jeni prekur "ndonjëherë" seksualisht kundër dëshirës apo jeni detyruar të bëni diçka seksuale pa dëshirën tuaj kur ishit një vajzë e re në moshën 0 deri 17 vjeç	3.1

jopartneri të renditura në tabelën 8.1 gjatë jetës së tyre (17.4%); megjithatë, disa gra kishin përjetuar dy ose tre nga llojet e ndryshme të dhunës fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja në jetën e tyre. Midis grave që përjetuan dhunën e ushtruar nga jopartneri që prej moshës 15 vjeç në 12 muajt përpara intervistës, ato raportuan se kishin përjetuar vetëm një nga llojet e dhunës së ushtruar nga jopartneri.

Përjetimet e abuzimit seksual në fëmijëri

Gratë u pyetën nëse ato kishin përjetuar "ndonjëherë" dhunë seksuale gjatë fëmijërisë së tyre, në moshën 0-17 vjeç. Tabela 7.2regon se 3,1% e grave të grupmoshës 18-74 vjeçare raportuan se ishin abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë së tyre (domethënë, ato ishin prekur seksualisht pa dëshirën e tyre ose ishin detyruar të bënin diçka seksuale kundër dëshirës së tyre).

Tabela7.3. Autorët e dhunës fizike të ushtruar nga jopartneri (të dhëna të ponderuara)

N=180.039	%
Nëna/njerka	76.1
Babai/ njerku	58.0
Motra/vëllai	28.0
Motër nga njëri prind/Vëlla nga njëri prind	0.9
Vajza/djali	0.4
Të afërm të tjerë	6.6
Vjehrra	3.0
Vjehri	0.6
Persona të tjerë nga familja e bashkëshortit	2.1
Shoku/i njohuri	1.7
Shoku i klasës/i shkollës	11.1
Komshiu	7.2
Mësuesi	35.7
Punëdhënësi	0.2
Kolegu	0.2
Polici/ushtari	0.0
Drejtuesi i komunitetit	0.1
Udhëheqësi fetar	0.0
I panjohuri	0.2
Tjetër	0.3

Tabela7.4. Autorët e dhunës seksuale të ushtruar nga jopartneri (të dhëna të ponderuara)

	N=21,254 %
Nëna/njerka	4.4
Babai/njerku	5.2
Motra/vëllai	3.5
Motër nga njëri prind/Vëlla nga njëri prind	0.0
Vajza/djali	0.0
Të afërm të tjerë	2.4
Vjehrra	0.0
Vjehri	0.0
Persona të tjerë nga familja e bashkëshortit	1.9
Shoku/i njohuri	5.4
Shoku i klasës/i shkollës	15.1
Komshiu	2.4
Mësuesi	7.1
Kolegu	0.0
Bashkëpunëtori	1.0
Polici/ushtari	0.0
Drejtuesi i komunitetit	0.0
Udhëheqësi fetar	0.0
I panjohuri	3.3
Tjetër	0.0

Autorët e dhunës fizike nga jopartneri

Tabela7.3 tregon se midis grave qëkanë përjetuar “ndonjëherë”dhunë fizikengajopartneri që në moshën 15vjeçare, 3 në 4 gra ose 76.1% e grave raportuan se dhunuesi ishte nëna/njerka dhe 1 në 2 gra ose 58.0% e grave raportuan se dhunuesi ishte babai/njerku. Këto gjetje tregojnë se një përqindje e konsiderueshme e grave kishin qenë viktimat të dhunës në familje nga prindërit e tyre që prej moshës 15 vjeçare. Përveç kësaj, 1 në 3 gra ose 35,7% e grave identifikuan autorin e dhunës fizike nga jopartneri si mësuesin, 1 në 4 gra ose 28,0% e grave raportuan se autori ishte motra/vëllai (dhunë mes motrave dhe vëllezërve), dhe 11,1% raportuan se autori ishte shoku i klasës/

shkollës së tyre. Gratë identifikuan edhe një numër të dhunuesve të tjerë, por në një numër më të vogël.

Autorët e dhunës seksuale nga jopartneri

Tabela 7.4 tregon se midis grave që kanë përjetuarndonjëherë dhunë seksuale nga jopartneriqë prej moshës 15 vjeçare, ato që identifikuan autorët e tyre identifikuan shokun e klasës/shkollës (15,1%), mësuesin (7,1%), miqtë /të njohurit (5.4%), babai/njerku (5,2%), nëna/ njerka (4,4%), dhe të panjohurit (3,3%). Një përqindje e madhe e grave nuk pranoi ose refuzoi të identifikonin autorët e dhunës seksuale të ushtruar nga jopartnerë.

Sjellje që kërkojnë ndihmë për dhunën e ushtruar nga jopartneri

Tabela 7.5 tregon se midis grave që kanë përjetuarndonjëherë dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri, vetëm 6,6% i kanë treguar dikujt për dhunën e ushtruar nga jopartneri dhe 4,6% kanë kërkuar ndihmë për dhunën e ushtruar ndaj tyre nga jopartneri. Tabela 7.6 tregon se shumica e grave që kërkuan ndihmë për dhunën e ushtruar nga jopartneri, e kanë kërkuar këtë ndihmë nga familja e tyre (85,3%), familja e bashkëshortit/të dashurit të tyre (15,5%), dhe/osenga bashkëshorti/i dashuri aktual/i mëparshëm (2,6%). Më pak grakanë kërkuar ndihmë nga rrjetet informale, të tilla si fqinjët (16,6%) dhe miqtë (12,1%); vetëm 1,1% e grave kërkuan ndihme nga udhëheqësit fetarë. Shumë pak gra kanë kërkuar ndihmë nga burime zyrtare,megjithatë, ata që e bënë, kërkuan ndihmë nga policia (8,3%), gjykatat/gjyqtarët (4,7%), mjekët/ personeli mjeksor (2,6%), avokatët (2,2%) dhe agjenci/ organizata të shërbimeve sociale(2,2%).

Tabela7.5. Sjelljet e kërkimit të ndihmës për dhunën e ushtruar nga jopartneri (të dhëna të ponderuara)

	N=189,697 %
I keni treguar ndonjëherë dikujt rreth dhunës së pësuar nga jopartneri	6.6
Keni kërkuar ndonjëherë ndihmë për dhunën e pësuar nga jopartneri	4.6

Tabela 7.6. Nga cilët kanë kërkuar ndihmë gratë për dhunën e ushtruar nga jopartneri (të dhëna të ponderuara)

	N=8,656
Familja	%
Familja ime	85.3
Familja e bashkëshortit/të dashurit	15.5
Bashkëshorti/i dashuri aktual/i mëparshëm	2.6
Rrjetet informale	
Mik	12.1
Fqinj	16.6
Udhëheqësi fetar	1.1
Rrjetet formale	
Mjeku/personeli mjekësor	2.6
Policia	8.3
Avokati	2.2
Gjykatat/gjyqtari	4.7
Agjencia/organizata e shërbimeve sociale	2.2
Strehëza për gratë dhe vajzat	0.0
Shërbimi i ndihmës (0800 11112)	0.0
Koordinatori lokal për dhunën në familje	0.0
Tjetër	2.7

Tabela 7.7. Arsyet për kërkimin e ndihmës për dhunën e ushtruar nga jopartneri (të dhëna të ponderuara)

	N=8.656
	%
Nuk mund të duroja më tepër dhunë	45,9
Isha lënduar keq	43,9
Miqtë ose familja më inkurajuan që të kërkoja ndihmë	70,8
Burri që ushtroi dhunë më kërcënoi ose u orvat të më vriste	2,2
Kisha frikë se burri që ushtroi dhunëdo të më vriste	0,0
Burri që ushtroi dhunë kërcënoi familjen time	3,5
Ajo që po më ndodhte mua ishte e papranueshme/ishte krim	17,4
Tjetër	22,4



Tabela 7.7 tregon se midis grave që kanë kërkuar ndihmë për dhunën e ushtruar nga jopartneri jointim, shumica kanë kërkuar ndihmë sepse miqtë dhe/ose familja e tyre i ka nxitur ta bëjnë këtë (70,8%). Një përqindje e konsiderueshme ka kërkuar ndihmë sepse nuk mund ta duronin dot më dhunën (45,9%) dhe ishin lënduar keq (43,9%). Po ashtu, disa gra kërkuar ndihmësepse besonin që ajo që po u ndodhte ishte e papranueshme dhe ishte krim (17,4%), sepse burri që ushtroi dhunë kërcënoi familjen e tyre (3,5%) dhe/ose kërcënoi ose u orvat t'i vrasë (2,2%).

Së fundi, tabela 7.8 tregon arsyet e ndryshme që shumica e grave që pësonin dhunë nga jopartneri zgjidhnin të mos kërkonin ndihmë. Arsyet më të zakonshme për moskërkimin e ndihmës ishin se ato mendonin që situata nuk ka qenë aq e rëndë sa të ankoheshin (38,1%). Disa gra të intervistuar raportuan gjithashtu se nuk kërkonin ndihmë sepse nuk kanë dashur të turpërojnë familjen (10,9%), ato mendonin që do t'i fajësonin (9,6%) dhe sepse kishin droje, u ka ardhur turp, apo kanë pasur frikë se nuk do t'i besonin (9,0%). Disa gra mendonin edhe se nuk ka arsye për t'u ankuar sepse dhuna është diçka normale (7,0%), nuk dinin ku të drejtoheshin për ndihmë (4,9%), dhe besonin se kërkimi i ndihmës nuk do t'ua zgjidhte problemin (2,7%).

Tabela 7.8. Arsyet për moskërkimin e ndihmës për dhunën e ushtruar nga jopartneri (të dhëna të ponderuara)

	N=181.041
	%
Nuk e di/dija se ku të kërkoja ndihmë	4,9
Mendova se nuk do të më ndihmonin/Njoh gra të tjera që nuk kanë marrë ndihmë	2,7
Kam/kisha frikë se do të kërcënohesha, nga pasojat se do të dhunohesha më shumë	3,0
Kam/kisha droje, turp ose frikë se nuk do të më besonin	9,0
Kam/kisha frikë se marrëdhënia do të përfundonte	1,5
Mendoj/mendoja se do të më fajësonin mua	9,6
Mendoj se nuk ka arsye për t'u ankuar/dhuna është normale	7,0
Situata nuk ishte aq e rëndë sa për t'u ankuar	38,1
Nuk dua që familja ime të turpërohet	10,9
Tjetër	1,0

KAPITULLI 8



NGACMIMI SEKSUAL

Ngacmim seksual do të thotë përpjekje të padëshiruara seksuale, kërkesa për favore seksuale dhe ngacmime të tjera verbale apo fizike me natyrë seksuale, që përbëjnë shkelje të parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave. Prandaj, ngacmimi seksual pranohet si një formë e diskriminimit gjinor, abuzimit seksual dhe e DhNGV-së.¹⁹⁹

Studimet ekzistuese mbi ngacmimin seksual trajtojnë shumë shpesh ngacmimet në vendin e punës dhe mjediset arsimore. Por ky studim ka përdorur një qasje më të gjerë, duke i pyetur gratë së pari nëse kishin pësuar forma specifike të ngacmimit seksual në ndonjë situatë, pastaj duke i pyetur më me shumë hollësi se ku kishte ndodhur incidenti dhe kush ishte përfshirë.²⁰⁰

Vrojtimi trajtoi katër format e mundshme të ngacmimit seksual që ishin të padëshiruara dhe ofenduese sipas të intervistuarave.²⁰¹

- Format fizike të ngacmimit –prekja, përqafimi ose puthja e padëshiruar.
- Format verbale të ngacmimit – komente ose shaka me përmbajtje seksuale bezdisëse, ofenduese dhe fyese; pyetje bezdisëse dhe fyese rreth jetës private; komente bezdisëse, fyese, ofenduese rreth paraqitjes fizike të një gruaje.

- Format joverbale të ngacmimit – marrja ose tregimi i fotove ose dhuratave me përmbajtje të qartë seksuale; dikush që ekspozon pjesë të trupit.
- Ngacmimi në internet– marrja e e-maileve ose mesazheve të padëshiruara, ofenduese, me përmbajtje të qartë seksuale; sjellje të papërshtatshme në rrjetet sociale ose bashkëbisedimet në internet.

Ky kapitull paraqet gjetjet mbi përvojat e grave lidhur me ngacmimet seksuale. Në intervistë, gratë u pyetën për gjashtë veprime specifike të ngacmimit seksual që gratë e ndjenin se ishin veprime të padëshiruara nga ana e tyre dhe ato i përjetonin si veprime fyese dhe/ose frikësuese. Po ashtu, në këtë kapitull trajtohet marrëdhënia midis moshës dhe eksperiencave të ngacmimit seksual, si edhe cilat janë vendet ku gratë i kanë përjetuar ngacmimet seksuale dhe cilët janë autorët e tyre.

Mbani parasysh se vlerësimet për shkallën e ngacmimit seksual mbështeten tek eksperiencat vetjake të grave dhe kuptimit subjektiv që të intervistuarat kanë për atë që mund të konsiderohet si sjellje e padëshiruar dhe ofenduese. Studimet ekzistuese kanë treguar se gratë kanë perceptime të ndryshme për atë se cila lloj sjellje mund të përbëjë ngacmim seksual.^{202,203} Ndryshimi për kuptimin e ngacmimit seksual ndikohet nga niveli i përgjithshëm i ndërgjegjësimit dhe informacionit për të drejtat e tyre ligjore dhe ligjet ekzistuese, si edhe nga kulturat gjinore (të tilla si pranimi i barazisë gjinore dhe mosdiskriminimi për shkak të gjinisë përkundrejt kulturave që “lejojnë” ose “shpërblejnë” ngacmimin e grave) dhe vlerat, normat dhe qëndrimet mbisunduese sociale dhe kulturore në një shoqëri.^{204,205} Kështu, pikëpamjet e grave se çfarë përbën “ngacmim seksual” mund të ndryshojnë shumë nga vendi në vend. Për të zvogëluar ndryshimet kulturore në interpretimin subjektiv të ngacmimit seksual, ky vërtetim nuk i pyeti të intervistuarat për “ngacmimin seksual” si një problem, por u pyetën për përjetimin e veprimeve specifike të padëshiruara dhe ofenduese. Megjithatë, mund të ketë ende dallime në shkallën në të cilën gratë në kontekste të ndryshme kulturore i gjejnë veprimet e përshkruara si ofenduese dhe frikësuese.²⁰⁶

Përjetimet e ngacmimeve seksuale

Tabela 8.1 tregon se 18,1% e gravetë moshës 18-74vjeç kanë përjetuar “ndonjëherë” dhe 8.5% “aktualisht”një apo më shumë se një nga gjashtë llojet engacmimeve seksuale të matura nga vërtimi. Më konkretisht, 12.2% e grave raportuan se dikush tjetër, përveç bashkëshortit/të dashurit, iu ka bërë komente ndonjëherë rreth trupit të tyre dhe/ose paraqitjes fizike që i kanë bërë ato të mos ndjehen rehat, të ndjehen të turpëruara dhe/ose të ofenduara; 5.1% e grave e kishin përjetuar këtë lloj të ngacmimit seksual gjatë 12 muajve të fundit përpara sondazhit. Përveç kësaj, 5.9% e grave raportuan se dikush tjetër, përveç bashkëshortit/të dashurit,iu ka bërë pyetje personale të bezdishme rreth jetës së tyre seksuale, intime apo private që i kanë bërë ato të mos ndjehen rehat, të ndjehen të turpëruara dhe/ose të ofenduara; 2.6% e grave e kishin përjetuar këtë lloj të ngacmimit seksual në 12 muajt e fundit përpara sondazhit.

Tabela8.1. Përjetime të ngacmimeve seksuale (të dhëna të ponderuara)

	Ndon- jëherë %	Aktual- isht %
Ngacmimi seksual i përjetuar (një ose më shumë se një nga 6 llojet)	18.1	8.5
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka prekur, përqaftuar ose puthur në mënyrë seksuale pa lejen tuaj, por nuk është përpjekur dhe/ose nuk ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale të çdo lloji	4.0	0.8
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka treguar ose ekspozuar pjesët intime të trupit të tij ose ju ka shfaqur krejt papritur organet e tij gjenitale pa dëshirën tuaj ose kundër vullnetit tuaj	4.5	0.5
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka dërguar ose ju ka treguar në mënyrë të përsëritur piktura ose foto me përmbajtje të qartë seksuale apo pornografike ose dhurata që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar	1.4	0.6
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit)ju ka bërë pyetje personale rreth jetës tuaj seksuale, intime apo private që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar	5.9	2.6
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka bërë komente rreth trupit tuaj dhe/ose paraqitjes fizike që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar	12.2	5.1
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka dërguar e-maile ose mesazhe ofenduese ose me përmbajtje të qartë seksuale dhe/ose ka bërësjellje të papërshtatshme në rrjetet sociale	1.9	1.2

Po ashtu, 4.5% e grave raportuan se dikush tjetër, përveç bashkëshortit/të dashurit, iu ka treguar ose ekspozuar pjesët intime të trupit të tij ose iu ka shfaqur krejt papritur organet e tij gjenitale kundër

vullnetit të tyre dhe 4.0% raportuan se ishin prekur, përqaftuar ose puthur në mënyrë seksuale pa lejen e tyre; më pak se 1.0% e grave kishin përjetuar këto dy lloje të ngacmimit seksual në 12 muajt e fundit përpara sondazhit. Shumë më pak gra raportuan se iu ishin dërguar e-maile ose mesazhe ofenduese ose me përmbajtje të qartë seksuale dhe/ose iu kishin treguar sjellje të papërshtatshme në rrjetet sociale(1.9%); 1.2% e grave e kishin përjetuar këtë lloj të ngacmimit seksual në 12 muajt e fundit përpara sondazhit. Vetëm 1.4% e grave u përgjigjën se iu ishin dërguar ose treguar në mënyrë të përsëritur piktura ose foto me përmbajtje të qartë seksuale apo pornografike dhe/ose dhurata që kanë bërë ato të mos ndjehen rehat, të ndjehen të turpëruara dhe/ose të ofenduara.


Grafiku 8.1 tregon se disa gra kishin përjetuar më shumë se vetëm një lloj të ngacmimeve seksuale të renditura në tabelën 9.1. Megjithëse 10,0% e grave kishin përjetuar “ndonjëherë” një lloj të ngacmimit seksual, 5,3% kishin përjetuar dy lloje, 2,2% kishin përjetuar tre lloje, dhe më pak sesa 1,0% e grave kishin përjetuarkatër lloje të ngacmimeve seksuale gjatë jetës së tyre. Në 12 muajt e fundit përpara

intervistës, 6,0% e grave kishin përjetuar vetëm një lloj të ngacmimeve seksuale, 2,0% kishin përjetuar dy lloje, dhe më pak se 1,0% kishin përjetuar tre deri në katër lloje të ngacmimeve seksuale.


Marrëdhënia ndërmjet moshës dhe ngacmimeve seksuale

Të dhënat u analizuan për tëshqyrtuar marrëdhënien ndërmjet moshës së grave dhe përvojave të tyre të ngacmimeve seksuale (ndonjëherë dhe aktualisht). Grafiku8.2tregon se gratë e moshës 18-24 vjeç (22,2%), 25-34 vjeç (19,7%) dhe 35-44 vjeç (21,0%) kishin më shumë gjasa të përjetonin ndonjëherë ngacmime seksuale, krahasuar me gratëe moshës 45-54 vjeç (18,0%), 55-64 vjeç (15,9%) dhe 65-74 vjeç (9,5%). Po ashtu, gratë e moshës 18-24 vjeç (12,6%), 25-34 vjeç (12,6%) dhe 35-44 vjeç (10,7%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin ngacmime seksuale gjatë 12 muajve të fundit përpara vrojtimit, krahasuar me gratë e moshës 45-54 vjeç (7,0%), 55-64 vjeç (4,3%) dhe 65-74 vjeç (2,1%).Është e dukshme se gratë e grupmoshës

Grafiku 8.1. Numri i llojeve të ngacmimeve seksuale të përjetuara (të dhëna të ponderuara)



Grafiku 8.1. Numri i llojeve të ngacmimeve seksuale të përjetuara (të dhëna të ponderuara)



Ndonjëherë, Sign = .000; Aktualisht, Sign = .000

45 deri 74 vjeçkishin përjetuar ngacmime seksuale në 12 muajt e fundit përpara sondazhit. Këto të dhëna tregojnë se ngacmimet seksuale mund t'u ndodhin grave, pavarësisht moshës së tyre.

Vendet ku ndodhin ngacmimet seksuale

Gratë që raportuan se kishin pësuar ngacmime seksuale u pyetën se ku kishin ndodhur këto incidente. Tabela8.2 paraqet një përmbledhje të të dhënave nga tabela 8.3,e cila zbulon se ku kishte ndodhur secili prej llojeve të ngacmimit seksual. Të dhënat e tabelës8.2 tregojnë se pjesa më e madhe e incidenteve tëngacmimit seksualkishin ndodhur në rrugë/rrugica(82,9%). Përveç kësaj,42,3% e incidenteve të ngacmimeve seksuale ishin kryer në shkolla, 38,3% e rasteve ndodhnin në tregje/dyqane, 29,1% u kryen kur gratëishin në shtëpinë e tyre dhe 25,8% ndodhnin në vendin e punës. Po ashtu, gratë kishin përjetuar ngacmim seksual nëpër makina, autobuse dhe mjete të tjera transporti (19,9%), bare, restorante dhe disko/klube (17,5%), në shtëpinë e dikujt tjetër (15,7%), në fushë ose në vende të tjera në natyrë (14,4%), dhe

Tabela8.2. Vendet ku ndodh ngacmimi seksual (të dhëna të ponderuara)

	N=188,866
	%
Në shtëpinë time	29.1
Në shtëpinë e autorit të krimit	1.2
Në shtëpinë e dikujt tjetër	15.7
Në rrugë	82.9
Në treg/dyqan	38.3
Në shkollë	42.3
Në vendin e punës	25.8
Brenda një makine, autobusi ose mjete tjetër transporti	19.9
Në det, liqen, lumë, vend tjetër me ujë	13.5
Në fushë apo në zonë tjetër në natyrë	14.4
Në bar/restorant, disko/klub	17.5
Vendndodhje tjetër	1.0

në det, liqen, lumë ose në ndonjë vend tjetër me ujë (13,5%). Vetëm 1,2% e grave raportuan që kishin pësuar ngacmime seksuale në shtëpinë e autorit të krimit.

Tabela8.3 tregon se ku e kishin pësuar gratë secilin prej llojeve të ngacmimit seksual. Më konkretisht, gratë që raportuan se ishin prekur, përqafular dhe/ose puthur në mënyrë seksuale pa lejen e tyrekishin më shumë gjasa të përjetonin këtë lloj të ngacmimit seksual në shkolla (46,7%), si edhe në rrugë/rrugica (29,2%), brenda në makinë, autobus ose mjete të tjera transporti (28,8%), dhe në tregje/dyqane (15,0%). Grave që iu ishin treguar ose ekspozuar pjesët intime të trupit të burrit ose iu ishin shfaqur krejt papritur organet e tij gjenitale kundër vullnetit të tyre kishin më shumë gjasa ta përjetonin këtë lloj të ngacmimit seksual në rrugë/rrugicë (79,9%); disa gra e kishin përjetuar këtë lloj ngacmimi seksual edhe në tregje/dyqane (23,4%), në vendet e punës (16,8%), në det, liqen, lumë ose vend tjetër me ujë (13,5%), dhe në një fushë ose zonë tjetër në natyrë (10,7%). Gratë i përjetonin këto dy lloje të ngacmimit seksual edhe në vende të tjera, por në një shkallë më të vogël.

Tabela 8.3 tregon gjithashtu se grave që iu ishin dërguar ose treguar në mënyrë të përsëritur fotografi ose foto me përmbajtje të qartë seksuale apo pornografike dhe/ose dhurata që kanë bërë ato të mos ndjehen rehat, të ndjehen të turpëruara dhe/ose të ofenduara shumicën e herëve e kishin përjetuar këtë lloj të ngacmimit seksual në shtëpinë e tyre (42,5%). Po ashtu, disa gra e kishin përjetuar këtë lloj të ngacmimit seksual në shkolla (20,4%) dhe në rrugë/rrugica (14,5%). Gratë që raportuan se iu ishin bërë pyetje personale të bezdishme rreth jetës së tyre seksuale, intime apo private që i kanë bërë ato të mos ndjehen rehat, të ndjehen të turpëruara dhe/ose të ofenduarae kishin përjetuar këtë lloj të ngacmimit seksual në një numër vendesh, përfshirë në shkolla (32,3%), në shtëpinë e tyre (24,5%), në shtëpinë e dikujt tjetër (22,7%), në vendin e punës (19,7%), në bare, restorante dhe disko/klube (18,0%), në fusha ose vende të tjera në natyrë(16,9%), në rrugë/rrugicë(14,6%), në tregje/dyqane (12,4%) dhe në vende të tjera. Në mënyrë të ngjashme, gratë që iu ishin bërë komente rreth trupit të tyre dhe/ose paraqitjes fizike që i kanë bërë ato të mos ndjehen rehat, të ndjehen të turpëruara dhe/ose të ofenduara gjithashtu e kishin përjetuar këtë lloj të ngacmimit seksual në një numër vendesh, por më shpesh në

Tabela8.3. Vendet ku gratë kanë përjetuar ngacmime seksuale sipas llojit të ngacmimit (të dhëna të ponderuara)

	Dikush tjetër ju ka prekur, përqaftuar ose puthur ndonjëherë në mënyrë seksuale pa lejen tuaj, por nuk është përpjekur dhe/ose nuk ju ka detyruar të kryeni seksuale të çdo lloji? N=41,464	Dikush tjetër ju ka treguar ose ekspozuar ndonjëherë pjesët intime të trupit të tij ose ju ka shfaqur krejt papritur organet e tij gjenitale pa dëshirën tuaj ose kundër vullnetit tuaj? N=47,303	Dikush tjetër ju ka dërguar ose ju ka treguar ndonjëherë piktura ose foto me përmbajtje të qartë seksuale apo pornografike ose dhurata që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar? N=14,912	Dikush tjetër ju ka bërë ndonjëherë pyetje personale rreth jetës tuaj seksuale, intime apo private që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar? N=61,582	Dikush tjetër ju ka bërë ndonjëherë komente rreth trupit tuaj dhe/ose paraqitjes fizike që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar? N=127,180	Dikush tjetër ju ka dërguar ndonjëherë e-mailë ose mesazhe ofenduese ose me përmbajtje të qartë seksuale dhe/ose ka bërë sjellje të papërshtatshme në rrjetet sociale? N=20,161
Në shtëpinë time	3.7	0.8	42.5	24.5	16.5	53.1
Në shtëpinë e autorit të krimit	0.7	0.0	1.0	1.3	0.8	0.0
Në shtëpinë e dikujt tjetër	2.9	2.6	0.0	22.7	10.0	2.7
Në rrugë	29.2	79.9	14.5	14.6	67.1	5.3
Në treg/dyqan	15.0	23.4	0.0	12.4	37.3	0.0
Në shkollë	46.7	6.7	20.4	32.3	24.5	16.2
Në vendin e punës	8.5	16.8	1.8	19.7	16.5	19.7
Brenda një makine, autobusi ose mjeti tjetër transporti	28.8	1.5	0.0	7.4	12.4	0.0
Në det, liqen, lumë, vend tjetër me ujë	8.7	13.5	0.0	5.3	9.7	0.0
Në fushë apo në zonë tjetër në natyrë	8.9	10.7	3.0	16.9	5.6	2.3
Në bar/restaurant, disko/klub	6.6	1.8	9.2	18.0	11.6	10.7
Vendndodhje tjetër	2.4	0.0	0.0	0.4	0.0	3.3

rrugë/rrugica (67,1%), por edhe në tregje/dyqane (37,3%), shkolla (24,5%), në vendin e punës (16,5%), në shtëpinë e tyre (16,5%), brenda në makinë, autobus ose mjete të tjera transporti (12,4%), në një bar, restorant dhe disko/klub (11,6%), dhenë shtëpinë e dikujt tjetër (10,0%).

Së fundi, gratë që iu ishin dërguar e-emaile ose mesazhe ofenduese ose me përmbajtje të qartë seksuale dhe/ose iu kishin treguar sjellje të pa përshtatshme në rrjetet sociale shumicën e herëve e kishin përjetuar këtë lloj të ngacmimit seksual në shtëpinë e tyre (53,1%). Disa gra e kishin përjetuar këtë lloj të ngacmimit seksual edhe në vendin e punës (19,7%), në shkollë (16,2%), dhe në një bar, restorant dhe disko/klub (10,7%).

Autorët e ngacmimeve seksuale

Gratë që kishin përjetuar ngacmime seksuale u pyetën rreth marrëdhënies së tyre me personin që i kishte ngacmuar seksualisht ato. Tabela 8.4 paraqet një përmbledhje të të dhënave të tabelës 8.5, që zbulon autorët e secilit lloj të ngacmimeve seksuale. Të dhënat e tabelës 8.4 tregojnë se gratë raportuan se të panjohurit (79,3%) dhe miqtë/të njohurit (51,2%) kryenin numrin më të madh të ngacmimeve seksuale, të ndjekur nga fqinjët (33,4%) dheshokët e klasës/shkollës (32,6%). Një numër më i vogël i grave raportuan se ishin ngacmuar seksualisht nga të afërmit/pjestarët e familjes (16,8%), kolegët (13,8%) dhe i dashuri aktual/i mëparshëm (10,1%). Përveç tyre, një numër i vogël grash (1,0%) u përgjigjën se punëdhënësit, mësuesit, policët/ushtarët dhe drejtuesit e komunitetit ishin autorë të ngacmimeve seksuale. Asnjë grua nuk identifikoi udhëheqësit fetarë si autorë të llojeve të ndryshme të ngacmimeve seksuale të matur në tabelën 9.5.

Tabela 8.5 tregon autorët e ngacmimeve seksuale sipas sipas llojit të ngacmimit. Në veçanti, gratë që raportuan se ishin prekur, përqaftuar dhe/ose puthur në mënyrë seksuale pa lejen e tyre kishin më shumë gjasa të identifikonin shokët e klasës/shkollës (46,7%) dhe të panjohurit (30,5%) si autorë të ngacmimit seksual. Disa gra raportuan edhe se i dashuri aktual/i mëparshëm (17,3%) dhe miqtë/të njohurit (17,2%) ishin autorë të këtij lloji ngacmimi

Tabela 8.4. Autorët e ngacmimeve seksuale (të dhëna të ponderuara)

	Përjetoi ngacmim seksual (ndonjëherë) N=188.866 %
I dashuri aktual/i mëparshëm	10,1
Mik / i njohur	51,2
Shok klase/shkolle	32,6
Fqinj	33,4
Mësuesi	0,1
Punëdhënësi	1,3
Koleg	13,8
Polic/ushtar	0,5
Drejtues i komunitetit	0,3
Udhëheqësi fetar	0,0
I afërm/anëtar i familjes	16,8
I panjohur	79,3
Tjetër	0,7

seksual. Gratë identifikuan edhe disa autorë të tjerë si ngacmuesit e tyre seksualë, por në një numër më të vogël. Shumica e grave që kishin pasur dikë që iu kishte treguar ose ekspozuar pjesët intime të trupit ose iu ishin shfaqur krejt papritur organet e tij gjinitale kundër vullnetit të tyre identifikuan të panjohurit (90,4%) si autorë të këtij lloji ngacmimi.

Tabela 8.5 tregon gjithashtu se grave që iu ishin dërguar ose treguar në mënyrë të përsëritur piktura ose foto me përmbajtje të qartë seksuale apo pornografike dhe/ose dhurata që kanë bërë ato të mos ndjehen rehat, të ndjehen të turpëruara dhe/ose të ofenduar shumicën e herëve identifikuan si autorë të ngacmimit seksual të panjohurit (66,8%); megjithatë, disa gra raportuan se miqtë/të njohurit (12,3%) dhe i dashuri aktual/i mëparshëm (9,0%) ishin ishin autorë të këtij lloji ngacmimi seksual. Grave që iu ishin bërë pyetje personale të bezdishme rreth jetës së tyre seksuale, intime apo private që i kanë bërë ato të mos ndjehen rehat, të ndjehen të turpëruara dhe/ose të ofenduar raportuan se autorët e kësaj forme të ngacmimit seksual ishin më shpesh miqtë/të njohurit (68,1%). Disa gra identifikuan se autorë

Tabela8.5. Autorët e ngacmimeve seksuale sipas llojit të ngacimit (të dhëna të ponderuara)


	Dikush tjetër ju ka prekur, përqa-fuar ose puthur ndonjëherë në mënyrë seksuale pa lejen tuaj, por nuk është përpjekur dhe/ose nuk ju ka de-tyruar të kryeni marrëdhënie seksuale të çdo lloji? N=41,464	Dikush tjetër ju ka treguar ose ekspozuar ndonjëherë pjesët intime të trupit të tij ose ju ka shfaqur krejt papritur organet e tij gjenitale pa dëshirën tuaj ose kundër vullnetit tuaj? N=47,303	Dikush tjetër ju ka dërguar ose ju ka treguar ndonjëherë piktura ose foto me përmbajtje të qartë seksuale apo pornografike ose dhurata që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar? N=14,912	Dikush tjetër ju ka bërë ndonjëherë pyetje perso-nale rreth jetës tuaj seksuale, intime apo pri-vate që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar? N=61,582	Dikush tjetër ju ka bërë ndonjëherë komente rreth trupit tuaj dhe/ose paraqitjes fizike që ju kanë bërë të mos ndjehe-ni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar? N=127,180	Dikush tjetër ju ka dërguar ndonjëherë e-emeile ose mesazhe ofenduese ose me përmba-jtje të qartë seksuale dhe/ose ka bërë sjellje të pa-përshtatshme në rrjetet sociale? N=20,161
I dashuri aktual/i mëparshëm	17.3	0.0	9.0	2.4	0.7	3.0
Mik/ i njohur	17.2	1.7	12.3	68.1	35.2	1.1
Shok klase	46.7	1.9	3.8	23.7	18.2	14.3
Fqinj	8.2	6.9	0.0	27.7	30.9	0.0
Mësuesi	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0
Punëdhënësi	0.0	0.8	0.0	0.3	1.4	0.0
Koleg	6.5	1.6	3.0	16.8	9.2	0.7
Polic/ushtar	0.9	0.8	0.0	0.0	0.1	0.0
Drejtues i komunitetit	0.5	0.0	0.0	0.0	0.3	0.0
Udhëheqësi fetar	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I afërm/anëtar i familjes	0.4	0.7	0.0	24.5	12.3	2.3
I panjohur	30.5	90.4	66.8	14.6	45.8	85.6
Tjetër	1.9	0.6	0.0	0.0	0.0	1.0

të këtij lloji të ngacimit seksual ishin fqinjët (27,7%), të afërmit/pjestarët e familjes (24,5%), shokët e klasës/shkollës(23,7%), kolegët (16,8%) dhe të panjohurit (14,6%).

Gratë që iu ishin bërë komente rreth trupit të tyre dhe/ose paraqitjes fizike që i kanë bërë ato të mos ndjehen rehat, të ndjehen të turpëruara dhe/ose të ofendua raportuan se pjesën më të madhe të kohës autorët ishin persona të panjohur (45,8%), miqtë/të njohurit (35,2%) dhe fqinjët (30,9%). Po ashtu, disa gra pruan

se autorë të këtij lloji të ngacimit seksual ishin edhe shokë të klasës/shkollës (18,2%),të afërmit/ pjestarët e familjes (12,3%) dhe kolegët(9,2%). Së fundi, gratë që iu ishin dërguar e-emeile ose mesazhe ofenduese ose me përmbajtje të qartë seksuale dhe/ose iu kishin treguar sjellje të papërshtatshme në rrjetet sociale shumicën e herëve identifikuan të panjohurit (85,6%) si autorë të këtij lloji të ngacimit seksual, por disa gra identifikuan si autorë të ngacimit seksual edhe shokët e klasës/shkollës (14,3%).

KAPITULLI 9



PËRNDJEKJA

Sikundër dhuna në familje nga partneri intim, edhe përndjekja është një krim që ka të bëjë me pushtetin dhe kontrollin.²⁰⁷ Përgjithësisht, përndjekje konsiderohet “sjellja ngacmuese ose kërcënuese që një individ bën në mënyrë të përsëritur, të tillë si ndjekja e një personi, shfaqja në shtëpinë ose vendin e punës të një personi, bërja e telefonatave ngacmuese, lënia e mesazheve me shkrim ose objekteve, ose shkatërrimi i pronës së një personi.

Këto veprime mund të shoqërohen ose jo me një kërcënim të besueshëm ose dëmtim të rëndë, dhe mund të jenë ose jo shenja paralajmëruese të një sulmi ose vrasje”.²⁰⁸ Asambleja Parlamentare e Këshilit të Europës e përcakton përndjekjen si “përsëritja e akteve që ndërhyjnë në jetën e një personi që me kalimin e kohës shtohen. Ka shumë mënyra në të cilën mund të kryhet një ndërhyrje e tillë. Një prej tyre që quhet përndjekje kibernetike është ndërhyrje e vazhdueshme dhe kërcënuese në internet. Përndjekja shkakton shqetësim, ankth ose frikë. Ajo është një formë dhune në vetvete, por mund të çojë edhe në forma të tjera të dhunës, përfshirë vrasje”.²⁰⁹

Në përgjithësi, sjellja e autorit të përndjekjes mund të përfshijë modele të vazhdueshme të lënies apo

dërgimit të sendeve apo dhuratave të padëshiruara viktimës, të cilat mund të jenë në dukje romantike deri në të çuditshme, ndjekjen pas apo qëndrimet në pritje të viktimës, dëmtimin apo kërcënimin për dëmtim të pronës së viktimës, përgojimin e karakterit të viktimës, apo ngacmimin e viktimës përmes internetit duke postuar informacion personal rreth saj, apo duke përhapur thashetheme për viktimën.²¹⁰ Përndjekja mund të përfshijë akte që të marra veç e veç, mund të duken të pafajshme, por që së bashku kanë për qëllim të shkatërrojnë ndjenjën e sigurisë së viktimës.²¹¹ Përndjekja më shpesh kryhet nga persona të njohur me viktimën, ose me të cilët viktimë ka pasur më parë një marrëdhënie, të tillë si partneri intim ose i njohuri aktual/i mëparshëm; megjithatë disa gra janë përndjekur edhe nga të panjohur.^{212,213}

Përndjekja mund të kryhet drejtpërdrejt nga personi ose përmes mekanizmave elektronikë (të quajtur përndjekja kibernetike, në internet). Përndjekja në internet përfshin ndjekjen, ngacmimin ose kontaktin me të tjerët në një mënyrë të pakërkuar, në fillim përmes internetit dhe/ose postës elektronike. Përndjekja kibernetike mund të intensifikohet dhe përndjekësit sistematikisht postojnë imazhe dhe mesazhe të turpshme, urryese dhe/ose kërcënuese.²¹⁴ Përndjekësit në internet mund të supozojnë identitetin e viktimës së tij/saj duke postuar informacion (të rremë ose jo) dhe duke kërkuar përgjigje nga komuniteti në internet. Ata mund të përdorin informacionin e marrë në internet për të frikësuar, ngacmuar dhe kërcënuar viktimën e tyre. Megjithëse përndjekja në internet nuk përfshin kontaktin fizik me viktimën, ajo është përsëri një krim i rëndë.²¹⁵

Konventa e Stambollit e Këshillit të Europës iu bën thirrje Shteteve Palë të dënojnë si vepër penale përfshirjen e qëllimshme dhe të vazhdueshme në sjellje kërcënuese të drejtuar ndaj një personi tjetër, që i shkakton viktimës frikë për sigurinë personale. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë e përkufizon përndjekjen si “kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllim për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi me të cilët ka lidhje shpirtërore, apo për t’i detyruar ata të ndryshojnë mënyrën e tyre të jetesës (Neni 121/a).

Ky vërtetim u përqendrua tek matja e rasteve të përndjekjes së përdorur nga gratë, pa përdorur termin përndjekje.²¹⁶ Ky kapitull i paraqet rezultatet e intervistimit si një vlerësim se në çfarë mase janë përndjekur gratë gjatë jetës së tyre dhe në 12 muajt e fundit përpara intervistës (aktualisht), dhe format specifike të përndjekjes që ato kishin pësuar. Po ashtu, kapitulli shqyrton marrëdhënien ndërmjet moshës dhe eksperiencave të përndjekjes dhe cilët janë autorët e përndjekjes.

Tabela9.1. Përjetime të përndjekjes (të dhëna të ponderuara)

	Kampioni gjithsej N=1,040,726	
	(ndon- jëherë)	(aktual- isht)
	%	%
Përdjekja përndjekje (një ose më shumë se një nga 6 llojet)	12.6	6.9
Dikush në mënyrë të përsëritur ju ka dërguar emaile, mesazhe ose mesazhe në rrjetet sociale, adresa interneti që kanë qenë ofenduese dhe /ose kërcënuese	4.6	2.5
Dikush në mënyrë të përsëritur ju ka dërguar letra, kartolina apo dhurata të padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënuese	1.6	0.2
Dikush në mënyrë të përsëritur ju ka bërë telefonata padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënuese ose të heshtura	8.9	4.5
Dikush në mënyrë të përsëritur ka postuar komente ofenduese për ju në internet ose ka shpërndarë foto ose video tuaja intime në rrjete sociale si Facebook and WhatsApp	.1	0.0
Dikush në mënyrë të përsëritur është sjellë rreth shtëpisë tuaj ose ju ka pritur jashtë shtëpisë, punës apo shkollës pa ndonjë arsye të mirëqenë dhe më pas, ju ka ndjekur qëllimisht	1.2	0.2
Dikush në mënyrë të përsëritur ju ka dëmtuar qëllimisht pronën apo ka hyrë me forcë në shtëpinë tuaj	.2	0.0

Tabela9.2. Aftësia për të identifikuar kontakte të padëshiruara ose sjellje ngacmuese si përndjekje (të dhëna të ponderuara)


Konsideruan numrin e kontakteve të padëshiruara ose sjelljeve ngacmuese si përndjekje	Përndjekje e përdorur (ndonjëherë) N=131,630	Përndjekje e përdorur (aktualisht) N=71,777
	%	%
Po	35.6	39.4
Jo	60.0	54.0
Nuk e di	1.6	1.5

Ndonjëherë, Shenja = .000; Aktualisht, Shenja = .000

Përjetimet e përndjekjes

Tabela 9.1 tregon se 12,6% e grave të moshës 18-74 vjeç kanë përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë se një nga gjashtë llojet e ndryshme të maturatë përndjekjes, dhe 6,9% e grave kanë përjetuar përndjekje në 12 muajt e fundit përpara intervistimit. Më konkretisht, 8,9% e grave në mënyrë të përsëritur kanë marrë telefonata të padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënuese të heshtura, dhe 4,6% kishin dikë që në mënyrë të përsëritur iu ka dërguar emaille, mesazhe ose mesazhe në rrjetet sociale, adresa interneti që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënuese; përkatësisht, 4,5% dhe 2,5% e grave përjetuan secilën prej këtyre dy llojeve

Grafiku 9.1. Numri i llojeve të përndjekjes së përjetuar (Të dhëna të ponderuara)



të përndjekjes në 12 muajt e fundit përpara intervistimit. Vetëm 1,6% e grave raportuan se dikush në mënyrë të përsëritur iu ka dërguar letra, kartolina apo dhurata të padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënuese, dhe 1,2% e grave raportuan se dikush në mënyrë të përsëritur është sjellë rreth shtëpisë së tyre ose i ka pritur jashtë shtëpisë, punës dhe/ose shkollës pa ndonjë arsye të mirëqenë, dhe më pas i ka ndjekur qëllimisht. Më pak se 1% e grave kishin përjetuar

përndjekje nga dikush qënë mënyrë të përsëritur ka postuar komente ofenduese për to në internet ose ka shpërndarë foto dhe/ose video të tyre intime në rrjete sociale, dhe dikush iu ka dëmtuar pronën në mënyrë të përsëritur dhe të qëllimishme apo ka hyrë me forcë në shtëpinë e tyre.

Tabela 9.2 tregon se vetëm 35,6% e grave që kishin përjetuar një ose më shumë se një nga gjashtë format e ndryshme të përndjekjes të renditura në tabelën 9.1 i konsideruan kontaktet e padëshiruara ose sjelljet ngacmuese si përndjekje. Në mënyrë të ngjashme, vetëm 39,4% e grave që kishin përjetuar përndjekje “aktualisht” i konsideruan kontaktet e padëshiruara ose sjelljet ngacmuese si përndjekje. Këto gjetje tregojnë se gratë përgjithësisht nuk e dinë se çfarë përbën përndjekje.

Grafiku 9.1 tregon se shumica e grave kishin përjetuar vetëm një lloj të përndjekjeve të renditura në tabelën 9.1, megjithatë, disa gra kishin përjetuar dy ose tre lloje të ndryshme të sjelljeve përndjekëse.

Marrëdhënia ndërmjet moshës dhe përndjekjes


Të dhënat u analizuan për të shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet moshës së grave dhe përvojave të tyre me përndjekjen. Grafiku 9.2 tregon se gratë e moshës 18-24 vjeç (29,1%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin përndjekje “ndonjëherë”, krahasuar me gratë në secilën prej grupmoshave të tjera. Në mënyrë të ngjashme, gratë e moshës 18-24 vjeç (19,7%) kishin shumë më tepër gjasa të përjetonin përndjekjen “aktualisht”. Megjithatë, mbani parasysh se gratë e moshave midis 25 dhe 74 vjeç kishin pësuar përndjekje në 12 muajt e fundit përpara intervistimit.

Autorët e përndjekjes

Gratë që përjetuan llojet e ndryshme të përndjekjes u pyetën për marrëdhënien e tyre me përndjekësin(t) e tyre. Të dhënat në tabelën 9.3 tregojnë se 97,0% e grave raportuan se autorët e përndjekjes së tyre ishin të panjohurit. Një përqindje e vogël e grave raportuan se ato ishin përndjekur nga shokët e klasës/shkollës (14,7%), të dashurit aktualë/të mëparshëm (13,8%), miq/të njohur (10,8%), bashkëshortët aktualë/të mëparshëm (8,9%), fqinjët (7,1%), kolegët (3,5%) dhe punëdhënësit (2,0%). Më pak se 1% e grave ishin përndjekur nga policë/ushtarë dhe të afërm/anëtarë të familjes.

Tabela 9.4 tregon se autorët e përndjekjes janë të ndryshëm, sipas llojit të përndjekjes. Më konkretisht, mes grave që raportuan sedikush në mënyrë të

Grafiku9.2. Marrëdhënia ndërmjet moshës dhe përndjekjes (të dhëna të ponderuara)



Ndonjëherë, Sign = .000; Aktualisht, Sign = .000

Tabela9.3. Autorët e përndjekjes (të dhëna të ponderuara)

	Përndjekja e përjetuar (ndonjëherë) N=131.630 %
Bashkëshorti aktual/i mëparshëm	8,9
I dashuri aktual/i mëparshëm	13,8
Miq/të njohur	10,8
Shokklase/shkolle	14,7
Fqinj	7,1
Mësuesi	1,8
Punëdhënës	2,0
Koleg	3,5
Polic/ushtar	,1
Drejtuesi i komunitetit	0,0
Udhëheqësi fetar	0,0
I afërm/anëtar i familjes	0,5
I panjohur	97,0
Tjetër	3,2

përsëritur iu ka dërguar emaille, mesazhe ose mesazhe në rrjetet sociale, adresa interneti që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënuesekishin më shumë gjasa të identifikonin si përndjekësit e tyre të panjohurit (71,7%). Disa gra gjithashtu identifikuan të dashurit aktualë/të mëparshëm si përndjekës (20,9%) të këtij lloji të përndjekjes.

Gratë që raportuan se dikush në mënyrë të përsëritur iu ka dërguar letra, kartolina apo dhurata të padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënuesekishin më shumë gjasa të identifikonin si përndjekësit e tyre të panjohurit(50,3%), ndjekur nga shokët e klasës/shkollës (30,8%), miqtë/të njohurit (22,9%), të dashurit aktualë/të mëparshëm (19,7%) dhe bashkëshortin aktual/i mëparshëm (12,2%). Shumica e grave që në mënyrë të përsëritur kishin marrë telefonata padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënueseose të heshtura identikuan si përndjekës të panjohurit (85,8%). Gratë që raportuan se dikush në mënyrë të përsëritur kishte postuar komente ofenduese për to në internet ose kishte

Tabela9.4. Autorët e përndjekjes sipas llojit të përndjekjes (të dhëna të pondruara)

	Ju ka dërguar dikush në mënyrë të përsëritur emaile, mesazhe ose mesazhe në rrjetet sociale, adresa interneti që kanë qenë ofenduese dhe /ose kërcënuese? N=,47,470	Ju ka dërguar dikush në mënyrë të përsëritur letra, kartolina apo dhurata të padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënuese? N=16,357	Ju ka bërë dikush në mënyrë të përsëritur telefonata padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënueseose të heshtura? N=92,860	Ka postuar dikush në mënyrë të përsëritur komente ofenduese për ju në internet ose ka shpërndarë foto ose video tuaja intime në rrjete sociale? N=1,162	Është sjellë dikush në mënyrë të përsëritur rreth shtëpisë tuaj ose ju ka pritur jashtë shtëpisë, punës apo shkollës pa ndonjë arsye të mirëqenë, dhe më pas ju ka ndjekur qëllimisht ? N=12,306	Ju ka dëmtuar dikush qëllimisht dhe në mënyrë të përsëritur pronën apo të ketë hyrë me forcë në shtëpinë tuaj? N=2,056
Bashkëshorti aktual/i mëparshëm	6.0	12.2	1.9	0.0	35.8	35.9
I dashuri aktual/i mëparshëm	20.9	19.7	3.6	0.0	7.3	35.9
Miq/të njohur	4.8	22.9	8.0	11.7	5.1	0.0
Shok klase/shkolle	4.1	33.8	10.6	0.0	14.3	9.4
Fqinj	1.4	2.4	7.5	0.0	6.8	22.8
Mësuesi	0.0	0.0	2.5	0.0	0.0	0.0
Punëdhënësi	.5	0.0	2.5	0.0	0.0	0.0
Koleg	.8	1.9	3.4	0.0	4.4	9.4
Polic/ushtar	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	9.4
Drejtues i komunitetit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Udhëheqësi fetar	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I afërm/anëtar i familjes	1.7	0.0	.6	0.0	1.6	0.0
I panjohur	71.7	50.3	85.8	0.0	41.3	32.0
Tjetër	0.0	1.0	4.3	0.0	0.0	0.0


shpërndarë foto ose video të tyre intime në rrjete socialekishin më shumë gjasa të identifikonin si përndjekësit e tyre miq/të njohur (11,7%).

Tabela 9.4 tregon se gratë që raportuan se dikush në mënyrë të përsëritur është sjellë rreth shtëpisë së tyre ose i ka pritur jashtë shtëpisë, punës dhe/ose shkollës pa një arsye të mirëqenë, dhe më pas i ka ndjekur qëllimisht, kanë identifikuar më shpeshsi përndjekës të panjohur (41,3%) dhe bashkëshortin aktual/të mëparshëm (35,8%). Disa gra gjithashtu

identifikuan shokët e klasës/shkollës (14,3%) dhe të dashurit aktualë/të mëparshëm (7,3%) si autorëte kësaj llojpërndjekjeje.

Së fundi, gratë që raportuan se dikush qëllimisht dhe në mënyrë të përsëritur iu ka dëmtuar pronën dhe/ose ka hyrë me forcë në shtëpinë e tyre, më shpesh identifikuan si përndjekësbashkëshortin aktual/të mëparshëm (35.9%), të dashurin aktual/të mëparshëm (35.9%), të panjohurin (32.0%) dhe/ose fqinjin (22.8%).

KAPITULLI 10



PËRFUNDIME

Ky studim ishte studimi i tretë për DhNGV-së i kryer nga INSTAT-i. INSTAT-i zbatoi standarde ndërkombëtare për të mbledhur të dhëna mbi DhNGV-në, përfshirë jo vetëm dhunën në familje, por edhe dhunën në marrëdhënie dashurore, dhunën nga jopartneri, abuzimin seksual në fëmijëri, ngacmimin seksual dhe përndjekjen dhe pasojat negative të dhunës tek gratë dhe sjelljet e tyre në lidhje me kërkimin e ndihmës.

VKDhNGV-ja e vitit 2018 mati edhe normat sociale që lidhen me DhNGV-në dhe perceptimet e grave për ashpërsinë e DhNGV-së në Shqipëri, si dhe rëndësinë e legjislacionit për DhNGV-në. Për të matur përhapjen dhe shtrirjen e DhNGV-së, ky studim përdori metodologji dhe pyetësorë të standardizuar të përdorur në VKDhF-të e vitit 2007 dhe 2013, por të përmirësuara më shumë në studimin e OBSH-së për shëndetin e grave dhe dhunën në familje në shumë vende dhe modele të Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore (ADTh) e studimit të dhunës ndaj grave. Në përputhje me ADTh-në, në rastin e VKDhNG-së 2018 u mor vendimi të merreshin në kampion gra deri në moshën 74 vjeç, ndryshe nga DhNGV-ja e vitit 2013 që mbajti si kufirin më të lartë moshën 55 vjeç dhe DhNGV-ja e vitit 2007 që mbajti si kufi limit moshën 49 vjeç.

Duke pasur parasysh rritjen e kufirit të moshës së grave deri në moshën 74 vjeç në VKDhNGV-në e vitit 2018, u paraqit hipoteza se pjesëmarrja e tyre në kampion do të ndikonte në rezultatet, duke treguar rënie të dhunës në familje nga partneri intim, gjë që nuk është kështu në realitet, veçanërisht nëse të dhënat e VKDhNGV-së së vitit 2018 do të krahasoheshin me të dhënat e VKDhF-së së vitit 2013. Kjo hipotezë u mbështet në supozimin se gratë mbi moshën 55 vjeç kanë shpesh më pak gjasa të përjetojnë dhunë në 12 muajt e fundit përpara intervistës. Për të vërtetuar këtë hipotezë, gjatë procesit të analizës dhe raportimit, u analizuan të dhënat vetëm për gratë e moshës 18-55 vjeç (si në VKDhF-në e vitit 2013) dhe gjetjet treguan se kjo hipotezë nuk ishte e vërtetë. Kur të dhënat e VKDhNGV-së për vitin 2018 u analizuan vetëm për

gratë e moshës 18-55 vjeç,shtrirja e përvojave të dhunës në familje nga partneri intim u zvogëlua me dy deri në tre pikë përqindje. Mbi bazën e këtyre gjetjeve, mund të bëhen krahasime të përqindjeve të përhapjes së kampionit në popullata të ndryshme duke filluar nga VKDhF-ja e vitit 2013, deri tek VKDhNGV-ja e vitit 2018.

VKDhNGV-ja e vitit 2018 u mbështet tek një pyetësor i standardizuar me masa dhe tregues të pranuar në nivel global. Masat që lidhen me normat dhe qëndrimet sociale ndaj DhNGV-së u mbështetën në literaturën ndërkombëtare për matjen e normave sociale dhe pyetjet standarde dhe në masat e përdorura në studimin e vitit 2018 në lidhje me normat sociale të DhNGV-së dhe praktikat e dëmshme në Maluai, të kryer nga agjencia e UN Women në Maluai.²¹⁷

Përqindja e përhapjes së kampionit në popullata të ndryshme

Të dhënat dhe gjetjet e paraqituara në këtë raport ofrojnë informacion të rëndësishëm mbi përvojat e grave për dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore dhe bëjnë të mundur që të kuptohet më mirë natyra dhe përhapja e DhNGV-së në Shqipëri, së bashku me faktorët që kontribuojnë në viktimizimin e grave dhe vajzave, vendet ku ndodh dhuna dhe autorët e kësaj dhune. Ky studim përfaqëson një hap të rëndësishëm në monitorimin e modeleve dhe tendencave të përvojave të grave jo vetëm me dhunën në familje, mbështetur tek VKDhF-të e viteve 2007 dhe 2013, por edhe plotëson mungesën e të dhënave sepse lidhet me përvojat e grave të dhunës së ushtruar nga jopartneri që prej moshës 15 vjeç, me abuzimin seksual të fëmijëve, ngacmimin seksual, dhe përndjekjen. Ky studim iu përgjigjet shqetësimeve për mungesën e të dhënave dhe detyrimeve sipas Konventës së Stambollit.

Në përgjithësi, të dhënat e këtij raporti japin dëshmi se DhNGV-ja është e përhapur në Shqipëri. Në veçanti, 1 në 2, ose 52,9% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar një ose më shumë nga pesë llojet e dhunës (dhunë nga partneri intim, dhunë gjatë

marrëdhënies dashurore, dhunë nga jopartneri, ngacmim seksual dhe/ose përndjekje) gjatë jetës së tyre. Po ashtu, 1 në 3, ose 36,6% e grave kishin përjetuar një ose më shumë nga pesë llojet e tilla të dhunës në 12 muajt e fundit përpara intervistës. Përveç kësaj, 3,1% e grave kishin përjetuar abuzim seksual në fëmijëri përpara moshës 18 vjeçare.

Studimet kudo kanë treguar se dhuna nga partneri intim është një prej formave më të përhapura të dhunës të përjetuar nga gratë në shumicën e vendeve në botë.^{218,219,220} Në mënyrë të ngjashme, gjetjet e këtij studimi konfirmojnë se dhuna nga partneri intim ndaj grave është një problem i përhapur gjerësisht në familje dhe komunitete kudo në Shqipëri. Ky studim konstatoi se 47,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar “ndonjëherë” një apo më shumë se një nga pesë llojet e ndryshme të dhunës gjatë jetës së tyre (sjellje kontrolluese, dhunë ekonomike, dhunë psikologjike, dhunë fizike dhe/ose dhunë seksuale), dhe 33,7% e grave kishin përjetuar një ose më shumë se një nga pesë llojet e ndryshme të dhunës në familje nga partneri intim në 12 muajt e fundit përpara intervistës. Më konkretisht, 21,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar “ndonjëherë” dhe 8,2% “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja nga bashkëshorti/partneri i tyre.

Nga gratë që kishin qenë “ndonjëherë” shtatzëna, VKDhNG-vë e vitit 2018 gjeti se 1,1% e grave ishin goditur, qëlluar, meshpulla, shkelmuar apo keqtrajtuar fizikisht gjatë shtatzënisë (kjo është e ngjashme me gjetjet e VKDhF-së së vitit 2013 që 1,3% e grave të moshës 18-55 vjeç ishin keqtrajtuar fizikisht gjatë shtatzënisë). Gratë që kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike në martesë/marrëdhënien e tyre, kishin dy herë më shumë gjasa të keqtrajtoheshin fizikisht gjatë shtatzënisë së tyre (2,3%). Midis grave që ishin keqtrajtuar fizikisht gjatë shtatzënisë, 30,5% e grave ishin keqtrajtuar fizikisht gjatë shtatzënisë së fundit dhe 10,1% ishin grushtuar apo shkelmuar në bark gjatë shtatzënisë. Vetëm 9,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin kërkuar ndihmë për dhunën në familje të ushtruar nga partneri intim.

VKDhF e vitit 2013 zbuloi se tek gratë e moshës 18-55 vjeç, 59,4% e tyre kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë nga partneri intim dhe 53,7% e grave kishin

përjetuar dhunë nga partneri intim në 12 muajt e fundit përpara vërtetimit. Më konkretisht, VKDhF-ja e vitit 2013 zbuloi se 24,6% e grave të moshës 18-55 vjeç kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim dhe 16,2% kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja në 12 muajt e fundit përpara vërtetimit. VKDhF-ja e viti 2013 nuk bëri dallimin midis dhunës në familje nga partneri intim dhe dhunës në marrëdhënie dashurie, siç u bë në këtë studim të fundit. Krahimisht, sondazhi i vitit 2018 i drejtuar nga OSBE për Mirëqënien dhe Sigurinë e Grave në Shqipëri konstatoi se 19,0% e grave të grupmoshës 18-74 vjeç kishin përjetuar dhunë nga partneri intim që në moshën 15 vjeçare dhe 19,0% kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale që në moshën 15 vjeç. Në 12 muajt e fundit përpara sondazhit të vitit 2018 i drejtuar nga OSBE, 7,2% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim. Gjetjet e këtyre tre studimeve ofrojnë vlerësime për përqindjen e grave që përjetojnë dhunë nga partneri intim në marrëdhëniet e tyre intime. Është e rëndësishme të kuptohet se në varësi të kampionit, përfshirë moshat e grave pjesëmarrëse në kampion, shtrirja e DhPI-së mund të jetë e ndryshme, dhe masat e ndryshme në lidhje me DhPI-në mund të çojnë në përqindje të ndryshme të përhapjes së saj.

VKDhNG-ja e vitit 2018 zbuloi gjithashtu se midis grave të moshës 18-74 vjeç, 18,2% kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë nga dikush tjetër nga bashkëshorti/i dashuri i tyre që në moshën 15 vjeçare, nga të cilat 17,3% kishin përjetuar dhunë fizike nga jopartneri dhe 1,3% kishin përjetuar dhunë seksuale nga jopartneri gjatë jetës së tyre. 3,4% e grave kishin përjetuar dhunë nga jopartneri në 12 muajt e fundit përpara intervistës. Vetëm 4,6% e grave kishin kërkuar ndihmë për dhunën e ushtruar nga jopartneri. VKDhF-ja e viti 2013 konstatoi se midis grave të moshës 18-55 vjeç, 6,9% e grave kishin përjetuar dhunë fizike nga jopartneri; dhuna seksuale nga jopartneri nuk ishte matur në VKDhF-në e vitit 2013. Përveç kësaj, sondazhi i drejtuar nga zyra e OSBE-së në Shqipëri në 2018 zbuloi se 11% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar dhunë nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare, nga të cilat 11,0% kishin përjetuar dhunë fizike nga jopartneri dhe 1,0% dhunë seksuale.²²¹ Të dhënat e këtyre tre

gjetjeve tregojnë se asnjë studim nuk prodhon të njëjtat përqindje të përhapjes së dhunës, por ato japin të kuptosh se 11,0% deri në 18,0% e grave në Shqipëri kanë përjetuar dhunë nga jopartneri që prej moshës 15 vjeç.

VKDhNG-ja e vitit 2018 zbuloi gjithashtu se 18,1% e grave përjetonin “ndonjëherë” ngacmim seksual dhe 8,5% e tyre kishin përjetuar ngacmim seksual në 12 muajt e fundit përpara intervistës, dhe 12,6% përjetonin “ndonjëherë” përndjekje, ndërsa 6,9% kishin përjetuar përndjekje në 12 muajt e fundit përpara intervistës. Sondazhi i drejtuar nga zyra e OSBE-së në Shqipëri zbuloi se 13,0% e grave të moshës 18-74 vjeç kishin përjetuar përndjekje që në moshën 15 vjeçare dhe 4,3% kishin përjetuar përndjekje në 12 muajt e fundit përpara intervistës, ndërsa 34,0% e grave kishin përjetuar ngacmim seksual që në moshën 15 vjeç dhe 17,2% kishin përjetuar ngacmim seksual në 12 muajt e fundit përpara intervistës.²²² Ndërkohë që të dyja këto studime ofrojnë vlerësime të ngjashme për përqindjen e grave në Shqipëri që përjetojnë përndjekje “ndonjëherë” dhe “aktualisht”, vlerësimet për përqindjen e grave që përjetonin ngacmime seksuale gjatë jetës së tyre shkon nga 18,0% deri në 34,0%, dhe përqindja e grave që përjetonin ngacmime seksuale në 12 muajt e fundit përpara intervistës shkon nga 8,0% deri në 17,0%.

Duke patur parasysh këto të dhëna, DhNGV nuk mund të shihet si një çështje që prek vetëm jetët e disa grave dhe vajzave në Shqipëri. DhNGV prek shumicën e grave dhe vajzave dhe çon edhe në ekspozimin e fëmijëve ndaj dhunës, veçanërisht në ato familje ku fëmijët janë dëshmitarë të dhunës ndaj nënave të tyre dhe bëhen viktimat të drejtpërdrejta dhe/ose tërthorta të dhunës në familje. Kjo gjetje tregohet nga përqindja e madhe e grave që raportuan se kishin përjetuar dhunë nga jopartneri që prej moshës 15 vjeç, po ashtu edhe dhunë në fëmijëri nga prindërit, njerku/njerka dhe motrat/vëllezërit. Po ashtu, gratë e ekspozuara ndaj dhunës nga jopartneri që në moshën 15 vjeçare ishin në rrezik më të madh të përjetonin dhunë nga partneri intim në moshë të rritur. Këto gjetje mbështesin punën ndërkombëtare që lidh dhunën e ushtruar nga partneri intim me dhunën e prodhuar në familje. Po ashtu, edhe përdorimi/abuzimi i partnerit me

alkoolin ndikonte tek shtrirja dhe ashpërsia e dhunës në familje nga ana e partnerit dhe tek rreziku i grave për lëndime si pasojë e dhunës në familje.

Të dhënat treguan se shumica e grave që përfshihen në dhunë nga partneri intim dhe jopartneri nuk kërkojnë ndihmë, megjithëse shumica e grave i tregojnë dikujt për përvojat e tyre të dhunës. Pjesa më e madhe e grave kërkojnë ndihmë nga familjet e tyre dhe rrjetet informale, të tilla si miqtë, fqinjët dhe në disa raste edhe nga udhëheqësit fetarë. Megjithatë, shumë pak gra kërkojnë ndihmë nga burime zyrtare, si shërbimet mbështetëse për viktimat të ofruara nga agjencitë, sistemi shëndetësor, policia dhe/ose sistemi i drejtësisë. Shkalla e DhNGV-së e zbuluar në këtë studim nuk pasqyrohet nga të dhënat administrative të paraqitura në kapitullin 1, sepse siç zbuluan të dhënat për sjelljet që kërkojnë ndihmë, të mbijetuarat e DhNGV-së nuk i raportojnë përjetimet e tyre të dhunës në polici ose tek punonjësit e drejtësisë. Prandaj, qeveria duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të krijuar një klimë ku gratë të mund të raportojnë rastet e DhNGV-së dhe ku këto raportime të merren me seriozitet dhe të ndiqen, në mënyrë që gratë të marrin mbështetjen dhe mbrojtjen e nevojshme dhe drejtësinë që meritojnë. Kohët e fundit, fakti që nuk raportohen kaq shumë raste të dhunës do të thotë se shumë autorë të dhunës nuk ndëshkohen.²²³

Ky studim zbuloi gjithashtu se 52,2% e grave të grupmoshës 18-74 vjeç pranonin se të gjithë ose shumica e personave në komunitet besojnë se dhuna ndërmjet burrit dhe gruas është një çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë, dhe 46,5% e grave pranonin se të gjithë ose shumica e personave në komunitet besojnë se një grua duhet të durojë njëfarë dhune për ta mbajtur familjen të bashkuar. Po ashtu, 1 në 4 gra pranonin se të gjithë ose shumica e personave në komunitet besojnë se kur një grua rrihet nga bashkëshorti faji është

pjesërisht i saj dhe se gruas duhet t'i vijë turp nëse flet me dikë jashtë familjes për abuzimin apo dhunën në jetën bashkëshortore. Këto norma sociale mund të kontribuojnë në shtrirjen e dhunës në familje ndaj grave nga ana e partnerit intim dhe në mbajtjen e grave të rrahura në kurthin e marrëdhënieve abuzive dhe të dhunshme.

Megjithë normat sociale që lidhen me dhunën në familje ndaj grave nga partneri intim, 75,4% e grave raportuan se dhuna në familje/në marrëdhëniet bashkëshortore është një problem madhor në Shqipëri, dhe 70,8% e grave pohuan se dhuna seksuale ndaj grave dhe vajzave është një problem madhor në Shqipëri. Përveç kësaj, 69,9% e grave pohuan se ngacmimi seksual i grave dhe vajzave është një problem madhor në Shqipëri dhe 68,4% raportuan se përndjekja e grave është një problem madhor në Shqipëri. Këto të dhëna tregojnë se gratë e pranojnë se DhNGV-ja, në të gjitha format e saj, është një problem madhor dhe i rëndë në Shqipëri. Duke pranuar shtrirjen dhe ashpërsinë e DhNGV-së në Shqipëri, 83,0% e grave pranuan se është shumë e rëndësishme të ketë ligje në Shqipëri që mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesë/familje dhe 81,9% e grave pranuan se është shumë e rëndësishme të ketë ligje në Shqipëri që mbrojnë gratë dhe vajzat nga sulmet dhe përdhunimet seksuale.

Përpjekje të tilla për të monitoruar modelet dhe tendencat në dhunën në familje nga partneri intim janë të rëndësishme dhe do të bëjnë të mundur që qeveria shqiptare, përfshirë politikëbërësit dhe vendimmarrësit, si edhe partnerët për zhvillim dhe ofruesit e shërbimeve, të vlerësojnë efektin e reformave legjislative, zhvillimet e politikave, mekanizmat e programimit dhe të referimit që synojnë të përmirësojnë përpjekjet për parandalimin, mbrojtjen dhe ndërhyrjet dhe nismat për DhFDhNGV-në.

SHTOJCA A

SHEMBUJ TË MASAVE, TREGUESVE DHE PYETJEVE QË LIDHEN ME NORMAT SOCIALE

Masa	Shembuj të treguesve	Shembuj të pyetjeve
Qëndrimet personale kundrejt rrahjes/goditjes së bashkëshortes	Përqindja e burrave dhe grave që pajtohen me formulimin: "Nëse një grua nuk i bindet bashkëshortit të saj, ajo duhet të rrihet/goditet".	Në çfarë shkalle pajtoheni me formulimin: Ka raste kur një grua meriton të rrihet/goditet nga bashkëshorti i saj: a) Pajtohem plotësisht b) Pajtohem c) Nuk e di d) Pajtohem pjesërisht e) Nuk pajtohem aspak Përgjigjet A dhe B mund të jenë tregues të normave sociale
Sjelljet personale	Kryerja e rrahjes/goditjes së bashkëshortes në 12 muajt e fundit (burrat) Eksperienca e rrahjes/goditjes së bashkëshortes në 12 muajt e fundit (gratë)	Në 12 muajt e fundit, sa shpesh e keni goditur, gjuajtur me shuplakë ose rrahur bashkëshorten tuaj? Në 12 muajt e fundit, sa shpesh ju ka goditur, gjuajtur me shuplakë ose rrahur partnerin ose bashkëshortin?
Besimet për sjelljen tipike	Përqindja e burrave/grave që besojnë se shumica e burrave të tjerë në komunitetin e tyre i rrahin/godasin bashkëshortet e tyre nëse ato nuk u binden	Sa prej miqve tuaj meshkuj mendoni se i rrahin ndonjëherë bashkëshortet e tyre sepse nuk iu binden? (burrat) a) Të gjithë b) Shumica e tyre c) Afërsisht gjysma e tyre d) Disa prej tyre e) Asnjë prej tyre Përgjigjet A dhe B mund të jenë tregues të normave sociale
Besimet për sjelljen e përshtatshme	Përqindja e burrave/grave që besojnë se praktika e rrahjes/goditjes së bashkëshortes është e pranueshme në komunitet	Nëse një burrë në këtë komunitet e rreh/godet bashkëshorten e tij nëse ajo nuk i bindet, a mendoni se shumica e miqve tuaj meshkuj do të...? a) Miratonin veprimin e tij b) Kundërshtonin veprimin e tij c) Mendonin se ky veprim nuk ishte puna e tyre Përgjigja A do të ishte tregues i normave sociale, dhe C mund të jetë tregues i normës sociale që rrahja/goditja e gruas është një çështje private
Sanksionet/shpërblimet sociale për mospajtueshmërinë	Përqindja e burrave dhe grave që pajtohen me formulimin: Nëse një bashkëshort nuk e rreh/godet bashkëshorten e tij kur ajo nuk i bindet, burrat e tjerë në komunitet nuk do ta respektojnë atë. Burrat e vërtetë i kanë nën kontroll bashkëshortet e tyre.	Në çfarë shkalle pajtoheni me formulimin: Nëse një bashkëshort nuk e rreh/godet bashkëshorten e tij kur ajo nuk i bindet, burrat e tjerë në komunitet nuk do ta respektojnë atë. a) Pajtohem plotësisht b) Pajtohem c) Nuk e di d) Pajtohem pjesërisht e) Nuk pajtohem aspak Përgjigjet A dhe B mund të jenë tregues të normave sociale

Burimi: Alexander-Scott, M., E. Bell & J. Holden (2016). Udhëzues i DFID: Ndryshimi i normave sociale për trajtimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. London: VAW Helpdesk, f. 16.

SHTOJCA B:

TABELA ME TË DHËNA TË PAPONDERUARA PËR TREGUESIT KRYESORË

Shtojca, Tabela 1. Kampioni i grave sipas prefekturave (të dhëna të paponderuara)	
Prefekturat	Kampioni gjithsej n=3.443
	n
Berati	163
Dibra	166
Durrësi	323
Elbasani	364
Fieri	396
Gjirokastra	88
Korça	264
Kukësi	104
Lezha	168
Shkodra	264
Tirana	932
Vlora	211

Shtojca, Tabela2. Gratë që dhanë përgjigje për dhunën në familje nga partneri intim (të dhëna të paponderuara)	
Grupmosha	Gratë e moshës 18-74 vjeç që janë aktualisht/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose kanë jetuar me bashkëshortin/të dashurin n=3.314
	n
18-24 vjeç	91
25-34 vjeç	294
35-44 vjeç	648
45-54 vjeç	881
55-64 vjeç	930
65-74 vjeç	599

Shtojca, Tabela3. Përjetime të dhunës në familje nga partneri intim (Të dhëna të paponderuara)		
	Gratë e moshës 18-74 vjeç që janë aktualisht/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe/ose kanë jetuar me bashkëshortin/të dashurin	
	n=3.314	
	Ndonjëherë	Aktualisht
	n	n
Përjetoi dhunë në familje nga partneri intim (një ose më shumë se një nga 5 llojet)	1512	987
Sjellje kontrolluese shtrënguese	1294	673
Dhunë ekonomike	214	214
Dhunë psikologjike	1016	574
Dhunë fizike	605	201
Dhunë seksuale	279	83
Dhunë fizike dhe/osedhunë seksuale në familje, apo të dyja	709	229

Shtojca , Tabela 4. Përjetime të sjelljes kontrolluese shtrënguese të ushtruar nga bashkëshorti/partneri (Të dhëna të paponduara)		
	Gratë e moshës 18-74 vjeç që aktualisht janë/ kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe jetojnë/ kanë jetuar me bashkëshortin/partnerin n=3.314	
	Ndonjëherë	Aktualisht
	n	n
Keni përjetuar sjellje kontrolluese shtrënguese (një apo më shumë nga 7 llojet)	1,294	673
Bëhet xheloz/zemërohet kur flisni me burra të tjerë	1,223	541
Ju akuzon se jeni të pabesa	196	79
Përpiqet t'ju kufizojë apo nuk ju lejon të takoheni me shoqet	519	277
Orvatet t'ju kufizojë kontaktet me prindërit apo të afërm të tjerë	166	85
Ju kontrollon sepse dëshiron të dijë ku jeni gjatë gjithë kohës	499	336
Ju kufizon/pengon të merrni kujdes shëndetësor	28	9
Ju bën presion apo ju detyron t'i jepni fjalëkalimin e telefonit celular, emailit apo llogarive të mediave sociale	158	111

Shtojca, Tabela 5. Përjetimetë dhunës ekonomikenga bashkëshorti/partneri (Të dhëna të paponduara)	
	Gratë e moshës 18-74 vjeç që aktualisht janë/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe jetojnë/kanë jetuar me bashkëshortin/partnerin n=3.314
	n
Kanë përjetuar dhunë ekonomike (një apo më shumë nga tre llojet)	214
Ju ndalon të gjeni një punë, të shkoni në punë, të tregtoni, të fitoni para apo të merrni pjesë në projekte që gjenerojnë të ardhura	115
Jua merr të ardhurat apo ju kontrollon paratë apo pronat kundër vullnetit tuaj	126
Refuzon t'ju japë paratë që ju nevojiten për shpenzimet e familjes, edhe kur ka para për gjëra të tjera (si alkool apo cigare)	89

Shtojca, Tabela 6. Përjetime të dhunës psikologjike nga bashkëshorti/partneri (Të dhëna të paponduara)		
	Gratë e moshës 18-74 vjeç që aktualisht janë/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe jetojnë/kanë jetuar me bashkëshortin/partnerin	
	n=3.314	
	Ndonjëherë	Aktualisht
	n	n
Kanë përjetuar dhunë psikologjike	1016	574
(një apo më shumë nga 8 llojet)		
Ju ka fyer/ju ka bërë të ndiheni keq për veten	809	407
Ju ka folur në një mënyrë që ju bën të ndiheni idiote dhe pa vlerë	631	300
Ka thënë/ka bërë diçka që ju ka bërë të ndiheni e poshtëruar përpara njerëzve të tjerë	338	131
Ka thënë gjëra që ju kanë bërë të keni frikë, të tillë si "nëse nuk bëhesh imja, nuk ke për të qenë kurrë e njeriu"	142	39
Ka këmbëngulur të mësojë se ku jeni në një mënyrë që ju ka bërë të ndiheni e kontrolluar apo e frikësuar	263	120
Ka kërcënuar se do t'ju lëndojë juve, apo dikë tjetër që është i dashur për ju	36	14
Ka shkatërruar gjëra që janë të rëndësishme për ju, si diçka vetjake, kafshën që mbani në shtëpi apo sende të tjera	60	30
Ju ka bërë të ndiheni e pazonja si prind	218	108

Shtojca, Tabela 7. Përjetime të dhunës fizike nga bashkëshorti/partneri (Të dhëna të paponduara)		
	Gratë e moshës 18-74 vjeç që aktualisht janë/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe jetojnë/kanë jetuar me bashkëshortin/partnerin	
	n=3.314	
	Ndonjëherë	Aktualisht
	n	n
Kanë përjetuar dhunë fizike	1.016	574
(një apo më shumë nga 11 llojet)		
Ju ka qëlluar me shpullë	579	179
Ju ka shkulur flokët	150	58
Ju ka goditur me diçka që mund t'ju ketë lënduar	122	39
Ju ka hedhur për tokë, shtyrë, tërhequr zvarrë	91	38
Ju ka qëlluar me grusht apo me diçka tjetër që mund t'ju lëndonte	63	35
Ju ka shkelmuar apo rrahur	59	23
Ju ka përplasur pas murit apo diçkaje tjetër	32	11
Ju ka marrë frymën	9	()
Ju ka kërcënuar/sulmuar me thikë, me armë dhe mjete të tjera	5	()
Ju ka prerë apo goditur me thikë qëllimisht	()	0
Ju ka djegur qëllimisht	4	0

Vini re: () të dhënat nuk janë botuar për shkak të numrit të vogël të vëzhgimeve, $n \leq 3$

Shtojca, Tabela 8. Përjetime të dhunës seksuale të ushtruar nga bashkëshorti/partneri aktual/ose i dikurshëm (Të dhëna të paponduara)		
	Gratë e moshës 18-74 vjeç që aktualisht janë/kanë qenë ndonjëherë të martuara dhe jetojnë/kanë jetuar me bashkëshortin/partnerin n=3.314	
	Ndonjëherë n	Aktualisht n
Kanë përjetuar dhunë seksuale (një apo më shumë nga 3 llojet)	279	83
Ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale kur nuk keni dashur, për shembull duke ju kërcënuar apo mbajtur të shtrirë	133	49
Ju ka detyruar të kryeni akte seksuale që nuk i keni dashur apo që ju janë dukur degraduese apo poshtëruese	32	()
Keni kryer marrëdhënie seksuale me bashkëshortin/partnerin sepse keni pasur frikë nga ajo që mund të bënte nëse e refuzonit	232	72

Vini re: () të dhënat nuk janë botuar për shkak të numrit të vogël të vëzhgimeve, $n \leq 3$

Shtojca, Tabela 9. Lëndimet nga dhuna në familje tek gratë që kanë përjetuar dhunë fizike (Të dhëna të paponduara)		
	Dhunë fizike (ndonjëherë) n=605	Dhunë fizike (aktualisht) n=201
	<u>n</u>	<u>n</u>
Kanë përjetuar lëndime nga dhuna në familje (një apo më shumë nga 9 llojet)	349	145
Frikë, ankth, depresion, ndjenja izolimi, pagjumësi dhe/ose nervozizëm	332	118
Të prera, të gërvishitura, dhimbje, skuqje apo ënjtje dhe/ose shenja të lehta	145	50
Lëndime në sy, nxjerrje kockash nga vendi, ndrydhje dhe/ose flluska nga djegiet	28	14
Lëndime, tronditje në kokë dhe/ose humbje dëgjimi	11	()
Lëndime abdominale	13	()
Plagë të thella, kocka të thyera, dhëmbë të thyer, lëkurë të nxirë apo të përzhitur nga të djegurat, apo nga ndonjë lëndim tjetër i rëndë	8	()
Humbje kujtese	5	()
Dështim	13	()
Lëndim apo shpërfytyrim i përhershëm	8	0

Vini re: () Të dhënat nuk janë botuar për shkak të numrit të vogël të vëzhgimeve, $n \leq$

Shtojca, Tabela 10. Përjetime të dhunës nga jopartneri që prej moshës 15 vjeç (Të dhëna të paponderuara)		
	Kampioni gjithsej n=3.443	
	Ndonjëherë n	Aktualisht n
Ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga jopartneri që në moshën 15 vjeç (një ose më shumë se një nga katër llojet)	666	81
Që prej moshës 15 vjeç, një jopartner ju ka goditur, goditur me shuplakë, ju ka gjuajtur me shkelma ose ka kryer ndonjë veprim tjetër për t'ju lënduar fizikisht (dhunë fizike)	632	78
Ka përjetuar dhunë seksuale nga jopartneri që në moshën 15 vjeç (një ose më shumë se një nga tre llojet)	51	()
Që prej moshës 15 vjeç, një jopartner ju ka prekur seksualisht kundër dëshirës tuaj ose u përpoq t'ju prekte seksualisht, por nuk ia doli t'ju detyronte të kryenit marrëdhënie seksuale kundër dëshirës tuaj	0	0
Që prej moshës 15 vjeç, një jopartner ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale kundër dëshirës tuaj, për shembull duke ju kërcënuar, duke ju mbajtur me forcë, ose duke ju vendosur në një situatë ku nuk mund të kundërshtoni	37	0
Që prej moshës 15 vjeç, një jopartner ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale kur ishit shumë e dehur apo e droguar për të refuzuar	41	0

Vini re: () Të dhënat nuk janë botuar për shkak të numrit të vogël të vëzhgimeve, $n \leq 3$

Shtojca, Tabela 11. Përjetime të ngacmimeve seksuale (Të dhëna të paponderuara)		
	Kampioni gjithsej n=3.443	
	Ndonjëherë n	Aktualisht n
Ngacmimi seksual i përjetuar (një ose më shumë se një nga 6 llojet)	592	239
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka prekur, përqafuar ose puthur në mënyrë seksuale pa lejen tuaj, por nuk është përpjekur dhe/ose nuk ju ka detyruar të kryeni marrëdhënie seksuale të çdo lloji	102	12
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka treguar ose ekspozuar pjesët intime të trupit të tij ose ju ka shfaqur krejt papritur organet e tij gjinitale pa dëshirën tuaj ose kundër vullnetit tuaj	169	64
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka dërguar ose ju ka treguar në mënyrë të përsëritur piktura ose foto me përmbajtje të qartë seksuale apo pornografike ose dhurata që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar	26	7
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka bërë pyetje personale rreth jetës tuaj seksuale, intime apo private që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar	179	65
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka bërë komente rreth trupit tuaj dhe/ose paraqitjes fizike që ju kanë bërë të mos ndjeheni rehat, të ndjeheni e turpëruar ose e ofenduar	389	147
Dikush tjetër (përveç bashkëshortit/ të dashurit) ju ka dërguar e-emaile ose mesazhe ofenduese ose me përmbajtje të qartë seksuale dhe/ose ka bërë sjellje të papërshtatshme në rrjetet sociale	49	31

Shtojca, Tabela 12. Përjetime të përndjekjes (Të dhëna të paponderuara)		
	Kampioni gjithsej n=3.443	
	Ndonjëherë <u>n</u>	Aktualisht <u>n</u>
Ka përjetuar përndjekje (një ose më shumë se një nga 6 llojet)	288	116
Dikush në mënyrë të përsëritur ju ka dërguar emaile, mesazhe ose mesazhe në rrjetet sociale, adresa interneti të tilla si Facebook and WhatsApp që kanë qenë ofenduese dhe /ose kërcënuese	63	37
Dikush në mënyrë të përsëritur ju ka dërguar letra, kartolina apo dhurata të padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënuese	46	8
Dikush në mënyrë të përsëritur ju ka bërë telefonata padëshiruara, që kanë qenë ofenduese dhe/ose kërcënueseose të heshtura	198	77
Dikush në mënyrë të përsëritur ka postuar komente ofenduese për ju në internet ose ka shpërndarë foto ose video tuaja intime në rrjete sociale si Facebook dheWhatsApp	4	()
Dikush në mënyrë të përsëritur është sjellë rreth shtëpisë tuaj ose ju ka pritur jashtë shtëpisë, punës apo shkollës pa ndonjë arsye të mirëqenë, dhe më pas ju ka ndjekur qëllimisht	44	7
Dikush ju ka dëmtuar mënyrë të përsëritur dhe qëllimisht pronën apo ka hyrë me forcë në shtëpinë tuaj	9	()

Shënim: () Të dhënat nuk janë botuar për shkak të numrit të vogël të vëzhgimeve, $n \leq 3$

REFERENCA

- Alexander-Scott, M., E. Bell & J. Holden (2016), DFID Guidance Notes: Shifting Social Norms to Tackle Violence Against Women and Girls. London: VAW Helpdesk. (Shënime udhëzuese të DFID-së: Ndryshimi i normave sociale për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe vajzave. Londër, VAW Helpdesk).
- Bicchieri, C. (2015), Norms in the Wild: How to diagnose, measure and change social norms. Cambridge University Press: Cambridge, UK. (Normat në botë: si të diagnostikohen, maten dhe ndryshohen normat sociale).
- Bicchieri C., Lindemans & T. Jiang (2014), Një qasje strukturore ndaj diagnostikimit të praktikave kolektive, *Frontiers in Psychology*, 5(1418): 1-13. (Kufijtë në psikologji).
- Bishwajit, G. & S. Yaya (2017), Dhuna në familje: një barrierë e fshehtë për përdorimin e kontraktivëve nga gratë në Nigeri, Dove Press, (Domestic violence: a hidden barrier to contraceptive use among women in Nigeria), <https://doi.org/10.2147/OAJC.S154733>.
- Black, M.C., K.C. Basile, M.J. Breiding, S.G. Smith, M.L. Walters, M.T. Merrick, J. Chen, dhe M.R. Stevens (2011), Vrojtimi Kombëtar për partnerin intim dhe dhunën seksuale: Raport përmblendës 2010, (The National Intimate Partner and Sexual Violence Survey: 2010 Summary Report), Qendra Kombëtare për parandalimin dhe kontrollin e lëndimeve, Qendrat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve.
- Classen, C.C., O.G. Palesh & R. Aggarwal (2005), Riviktimizimi seksual: një vlerësim i literaturës empirike, Trauma, dhuna dhe abuzimi (Trauma, Violence & Abuse), Vol. 6, Nr. 2.
- Cooper, L.B. & E.K. Fletcher (2013). Pakësimi i diskriminimit shoqëror ndaj vajzave adoleshente përmes përdorimit të normave sociale për të nxitur ndryshime në sjellje, (Reducing Societal Discrimination Against Adolescent Girls Using Social Norms to Promote Behaviour Change). DFID and Girl Hub.
- Këshilli i Evropës (2011). Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, (Council of Europe Convention on preventing and combating violence against women and domestic violence, Seritë e Traktateve të Këshillit të Europës – nr. 210).
- Devaney, J. (2015). Ndikimi i dhunës në familje *Irish Probation Journal*, 12, f. 79-94).
- Elster, J. (2007). Shpjegimi i sjelljes sociale (Explaining Social Behaviour), Cambridge University Press: Cambridge, UK.
- Konsiderata etike për studimin dhe vlerësimin e dhënies fund të dhunës ndaj grave dhe vajzave, 2018. Dokument udhëzues përgatitur nga Instituti Global i Grave (GWI) për Departamentin e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë të Australisë.
- Rekomandime etike dhe të sigurisë për studime kërkimore mbi dhunën ndaj grave. Mbështetja tek mësimet e nxjerra nga botimi i OBSH-së (2016). Organizata Botërore e Shëndetësisë: Gjenevë, Zvicër.
- Komisioni Evropian (1998), Sexual harassment in the workplace in the European Union (Ngacmimi seksual në vendin e punës në Bashkimin Evropian), Bruksel, Drejtoria e Përgjithshme për Punësimin, Marrëdhëniet Industriale dhe Çështjet Sociale e Komisionit Evropian)
- Exner-Cortens, D., L. Gill & J. Eckenrode (2016), Matja e dhunës së adoleshentëve

në marrëdhëniet dashurore: Njëvështrim gjithpërfshirës(Pjesa 1, sjelljet),(Aggression and Violent Behaviour), Vol. 27, f. 64-78.V. 27, f.64-78.

- Ferrari, G., R. Agnew-Davies, J. Bailey, L. Howard, E. Howarth, T.J. Peters, L. Sardinha& G.S. Feder, (2016), Dhuna në familje dhe shëndeti mendor: një vërtetim i kryqëzuar i grave që kërkojnë ndihmë nga shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës në familje. Aksioni Kombëtar për shëndetin, 9:20.3402/gha.v9.29890.
- Florida State University,Kushtet dhe lëndimet e lidhura me dhunën në familje. Paketa kombëtare për parandalimin e dhunës në familje për profesionistët e shëndetësisë(Conditions & Injuries Related to Domestic Violence. National Prevention Toolkit on Domestic Violence for Medical Professionals, 2014).
- Garcia-Moreno, C., H. Jensen, M. Ellsberg, L. Heise& C. Watts (2005), Studimi në shumë vende i OBSH-së për shëndetin e grave dhe dhunën në familje ndaj grave, Gjenevë, Zvicër,(WHO Multi-Country Study on Women's Health and Domestic Violence against Women).
- Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, UN Women, Tiranë, Shqipëri.
- Graham, K. & M. Livingston (2011),Marrëdhënia midis alkoolit dhe dhunës – popullsia, qasja e studimeve kontekstuale dhe e kërkimeve individuale. Revista për drogën dhe alkoolin, (Drug and Alcohol Review), Vol. 30, Nr. 5, f. 453-457.
- Haarr, R.N. (2007), Abuzimi i grave në Taxhikistan,Kriminologjia feministe,(Feminist Criminology),Vol. 2, Nr, 3.
- Haarr, R.N. (2013),Dhuna në familje në Shqipëri: Vërtimi kombëtar me bazë popullatën

2013,Tiranë, Shqipëri.

- Haarr, R.N. & L. Dharmo,Dhuna në familje në Shqipëri: Vërtimi kombëtar me bazë popullatën,INSTAT/UNDP: Tiranë, Shqipëri.
- Heise, L. (2011),Çfarë mund të bëhet për të parandaluar dhunën e partnerit? Një vështrim i përgjithshëm i provave, (What Works to Prevent Partner Violence? An evidence overview), DFIC: London, UK.
- Heise, L.& K. Manji (2015),Hyrje në normat sociale,(Introduction to Social Norms)Shënim përmbledhës për DFID.
- Holt, S., H. Buckley & S. Whelan (2008),Ndikimi i ekspozimit të fëmijëve dhe të rinjve ndaj dhunës në familje: Një vështrim i literaturës,Dhunimi dhe neglizhimi i fëmijëve, (Child Abuse & Neglect), Vol. 32, Nr. 8, f. 797-810.
- Humphrey,J.A.&J.W.,White(2000),Cenueshmëria e grave ndaj sulmeve seksual që nga adoleshënca deri në moshë të rritur,Journal of Adolescent Health, Vol. 27, Nr. 6, f. 419-424.
- Kelly,L., J. Lovett & M. Kocaqi (2015),Raporti përfundimtar i Shqipërisë: Krijimi i hartës së shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave dhe vajzave, Këshilli i Europës/UN Women.
- Krug, G. et al. (2002), Raporti botëror për dhunën dhe shëndetin. Organizata Botërore e Shëndetësisë: Gjenevë, Zvicër.
- Llor, K. & R. McElvaney (2010),Abuzimi seksual i fëmijëve, lidhjet me shfrytëzimin seksual më vonë/Sjellje me rrezik të lartë seksual dhe programet e parandalimit/trajtimet. Trauma, dhuna dhe abuzimi, Vol. 11, f. 159-177).

- Ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, Ligji nr. 9669, datë 12.12.2006.
- Ligji nr. 8876, datë 4 prill 2002, (Ligji nr. 8876, datë 4 prill 2002).
- Leonard, K. (2009). Domestic violence and alcohol: what is known and what do we need to know to encourage environmental interventions? *Journal of Substance Use*, Vol. 6, No. 4, pp. 235-247. (Dhuna në familje dhe alkooli: çfarë dihet dhe çfarë duhet të dimë për të nxitur ndërhyrjet në mjedis? *Revista për përdorimin e substancave*, Vol. 6, Nr. 4, ff. 235-247.)
- Lewis, S.F. & W. Fremouw (2001), Dhuna në marrëdhënie dashurie: një shqyrtim kritik i literaturës, *Revista e Psikologjisë Klinike*. Vol. 21, Nr. 1, f. 105-127.
- Mackie, G. F. Moneti, H. Shakya & E. Denny (2015), Çfarë janë normat sociale? Si maten ato? UNICEF/Universiteti i Kalifornisë, San Diego, Qendra për Drejtësi Globale.
- McGee, H., R. Garavan, M. de Barra, J. Byrne & R. Conroy (2002), Raporti SAVI: abuzimi dhe dhuna seksuale në Irlandë. Raportet e psikologjisë, Departamenti i Psikologjisë, Kolegji Mbretëror i Kirurgjisë në Irlandë.
- Matja e dhunës ndaj grave: shënim udhëzues, 2016, UN Women: New York, NY.
- Messman-Moore, T.L. & P.J. Long (2003), Roli i abuzimit seksual në fëmijëri në riviktimizimin e grave: një shqyrtim empirik dhe riformulim teorik. *Revista e psikologjisë klinike*, Vol. 23, Nr. 4, f. 537-571.
- Metaj, E. (2015), Analizë e funksionimit të reagimit të koordinuar të komunitetit ndaj dhunës në familje në nivel vendor në Shqipëri. UNDP Tiranë, Shqipëri.
- Raporti i ri tregon se shumica e viktimave gra janë vrarë nga bashkëshortët ose partnerë të tjerë intim, *Washington Post*, 20 korrik 2017.
- Moffitt, T.E. & A. Caspi (2003), Parandalimi i vijimësisë ndërbrezore të sjelljes antisociale: pasojat e dhunës së partnerit, (Early Prevention of Adult Antisocial Behaviour), tek Farrington, D.P. & J.W. Coid (red), Parandalimi i hershëm i sjelljeve antisociale të të rriturve, University Press: Cambridge, UK.
- Moylan et al. (2009), Pasojat e abuzimit të fëmijëve dhe ekspozimi ndaj dhunës në familje tek problemet e sjelljes internalizuese dhe ekstreiorizuese të adoleshentëve, *Revista për dhunën në familje*, Vol. 25, f. 53-63.
- Myhill, A. (2015), Matja e kontrollit shtrëngues: Çfarë mund të mësojmë nga Vrojtimet Kombëtare me bazë popullatën? *Dhuna ndaj grave*, Vol. 21, Nr. 3.
- Kostot e dhunës së partnerit intim ndaj grave në Shtetet e Bashkuara. Qendrat për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjes (CDC): Atlanta, GA USA.
- Paluck, E.L., L. Bell, C. Poynton & S. Sieloff (2010), Shënjimi i normave sociale që synojnë dhunën me bazë gjinore: analiza e literaturës dhe vlerësimi kritik. Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit.
- Pinheiro, P.S. (2006), Raporti botëror për dhunën ndaj fëmijëve. UNICEF: Gjenevë, Zvicër.
- Vënia në radhë të parë e sigurisë së grave: rekomandime etike dhe të sigurisë për studime për DhNG (2001). Organizata Botërore e Shëndetësisë: Gjenevë, Zvicër.
- Dallimet raciale dhe etnike në vrasjet e grave të rritura dhe roli i dhunës së partnerit intim – Shtetet e Bashkuara, 2013-2014, Qendrat për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve, Raporti javor për sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë, (Morbidity and Mortality Weekly Report (MMWR)), 21 korrik, Vol. 66, Nr. 28, f. 741-746.
- Radford, L., S. Corral, C. Bradley, H. Fisher, C. Bassett, N. Howat & S. Collishaw, (2011). Abuzimi

- dhe neglizhimi i fëmijëve në Mbretërinë e Bashkuar sot.NSPCC: Londër, Mbretëria e Bashkuar.
- Russell, D.E.H. (1986). Trauma sekrete: incesti në jetet e vajzave dhe grave,(The Secret Trauma: Incest in the lives of girls and women,(The Secret Trauma: Incest in the lives of girls and women,(botim i rishikuar). New York, NY, USA: Librat bazë.)
 - Sackett, L.A & D.G. Saunders (1999), Ndikimi i formave të ndryshme të abuzimit psikologjik tek gratë e rrahura. Dhuna dhe viktimat, 14, Nr. 1, f. 105-117.
 - Riviktimizimi seksual: raport i shkurtër, Qendra kombëtare burimore për dhunën seksuale: Enola, PA USA.
 - Stark, E. (2009), Kontrolli shtrëngues: Si burrat i futin në kurth gratë në jetën personale (Coercive Control: How Men Entrap Women in Personal Life),Oxford University Press: Oxford, Mbretëria e Bashkuar.
 - Stephenson, R., M. Koenig, R. Acharya & T.K. Roy (2008), Dhuna në familje, përdorimi i kontraktivëve dhe shtatzënia e padëshiruar në Indinë rurale,Studime për planifikimin familjar, Vol. 39, Nr. 3, f. 177-186.
 - Tjaden, P. & N. Thoennes,Përndjekja në Amerikë: Gjetjet e Vrojtimit kombëtar për dhunën ndaj grave, (Stalking in America: Findings From the National Violence Against Women Survey), Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Instituti Kombëtar i Drejtësisë,1998,NCJ 169592.
 - UN General Assembly (2016),Intensifikimi i përpjekjeve për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave, Sesioni i 71, pika 27 e programit paraprak, Avancimi i grave.
 - United Nations Children[s Fund, UNICEF (2014), Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (2014),Fshehur në mes të ditës (Hidden in Plain Sight): Një analizë statistikore e dhunës ndaj fëmijëve. UNICEF:New York, NY,ShBA.
 - Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin, Studimi global për vrasjet,(Global Study on Homicide), 2013.
 - Divizioni i Statistikave i OKB-së. Gratë e botës 2015: prirjet dhe statistikat(The World's Women 2015: Trends and Statistics),Kapitulli 6: Dhuna ndaj grave.
 - Buletini i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së ST/SGB/2008/5
 - Vlerësimi periodik universal për Shqipërinë – sesioni i 33-të, maj 2019; Dorëzuar nga ekipi i agjencive të OKB-së në Shqipëri.
 - Dhuna ndaj grave: një sondazh nëmbarrë BE-në, Luksemburg: Zyra e botimeve e Bashkimit European.
 - Vlerësime globale dhe rajonale të dhunës ndaj grave: përhapja dhe efektet shëndetësore të dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale të jopartnerit. Organizata Botërore e Shëndetësisë: Gjenevë, Zvicër.
 - Zippel, K. (2009), “Direktiva e Bashkimit European e vitit 2002 për ngacmimin seksual: një sukses feminist?”, Politika krahasuese europiane, (Comparative European Politics)Vol. 7, Nr. 1, f. 137-159.
 - Rekomandimi i Përgjithshëm i Komitetit të Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave i 1992 (Komiteti i CEDAW).

SHËNIME NË FUND

- 1 Stark, E. (2009), Kontrolli shtrëngues: Si burrat i futin në kurth gratë në jetën personale. Oxford University Press: Oxford, UK.
- 2 Fund dhunës ndaj grave, marrë më 22 mars 2019 nga: http://www.stopvaw.org/dating_violence
- 3 Instituti European për Barazinë Gjinore, marrë më 22 mars 2019 nga: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1096>
- 4 Këshilli i Europës (2011), Konventa e Këshillit të Europës për Parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Seritë e Traktateve të Këshillit të Europës – Nr. 210).
- 5 Instituti European për Barazinë Gjinore, marrë më 22 mars 2019 nga: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1096>
- 6 Këshilli i Europës, 2011.
- 7 Rekomandimi i Përgjithshëm i Komitetit të Kombeve të Bashkuara i vitit 1992 për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti i CEDAW-t), neni 6.
- 8 Këshilli i Europës, 2011.
- 9 Organizata Botërore e Shëndetësisë (2013), Vlerësimet në nivel global dhe rajonal për dhunën ndaj grave: Shtrirja dhe efektet shëndetësore të dhunës nga partneri intim dhe të dhunës seksuale nga jopartneri. OBSH: Gjenevë, Zvicër.
- 10 Instituti European për Barazinë Gjinore, marrë më 22 mars 2019 nga: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1096>
- 11 Instituti European për Barazinë Gjinore, marrë më 22 mars 2019 nga: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1096>
- 12 Këshilli i Europës (2011), Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. (Seritë e Traktateve të Këshillit të Europës – Nr. 210).
- 13 Krug, G. et al. (2002), Raporti botëror për dhunën dhe shëndetin, OBSH: Gjenevë, Zvicër.
- 14 Alexander-Scott, M., E. Bell & J. Holden (2016), Shënime tek Udhëzuesi i DFID: Ndërrimi i normave sociale për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe vajzave. Londër: VAW Helpdesk, f. 9-11.
- 15 Këshilli i Europës, Asambleja Parlamentare, marrë më 22 mars 2019 nga: <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XM-L2HTML-en.asp?fileid=20299>
- 16 Instituti European për Barazinë Gjinore, marrë më 22 mars 2019 nga: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1391>
- 17 Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
- 18 Ky raport ka në qendër temën e DhNGV-së dhe pranon çënueshmërinë e lartë të grave që nga fëmijëria dhe gjatë të gjithë ciklit të jetës së tyre dhe pasojat afatgjata të dhunës seksuale dhe fizike tek gratë dhe vajzat gjatë gjithë jetës së tyre.
- 19 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2,16.
- 20 Termat “dhunë me bazë gjinore” dhe “dhunë ndaj grave” përdoren shpesh në vend të njëra-tjetrës, meqënëse pjesa më e madhe e dhunës me bazë gjinore kryhet nga burrat kundër grave. Megjithatë, “dhuna me bazë gjinore” përfshin edhe dhunën ndaj burrave, djemve dhe pakicave seksuale, ose ndaj atyre me identitete të paqarta gjinore; si e tillë, dhuna ndaj grave është një lloj i dhunës me bazë gjinore. Ky raport ka në fokus DhNGV-në, ndërkohë që dhuna ndaj grupeve të tjera të përmendura shpesh shkakton të njëjtat
- 21 pabarazi dhe norma të dëmshme për shkak të gjinisë.
- 22 Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
- 23 Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
- 24 Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin, Studim global për vrasjet (Global Study on Homicide), 2013, f. 49–56.
- 25 Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (2014), Fshehur në mes të ditës; Analizë statistikore e dhunës ndaj fëmijëve (Hidden in Plain Sight: A Statistical Analysis of Violence against Children), UNICEF: New York, NY, ShBA.
- 26 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 4
- 27 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 4
- 28 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 4; Shih Heise, L. (2011). Çfarë mund të funksionojë për parandalimin e dhunës së partnerit? Një vështrim i përgjithshëm bazuar në prova. DFIC: London, UK, <http://www.oecd.org/derec/49872444.pdf>
- 29 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 4; Shih Heise, L. & K. Manji (2015). Hyrje në normat shoqërore. Shënime të shkurt-ra për DFID.
- 30 Normat gjinore janë veti dhe karakteristika të pranura të të qenit grua ose burrë (Ide se si burrat dhe gratë duhet të jenë dhe të veprojnë) në një moment të caktuar kohe në një shoqëri ose komunitet të posaçëm. Ato bëhen tipare të brendshme që herët në jetë përmes procesit të socializimit gjinor, përdoren si standarde dhe pritshmëri në bazë të të cilave duhet të veprojnë gratë dhe burrat dhe çojnë në stereotype gjinore, marrë më 22 mars nga: <https://unstats.un.org/unsd/genderstatmanual/Glossary.ashx>
- 31 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 4; Shih Heise, 2011.
- 32 Ideologjitë gjinore janë “një pikëpamje botërore se si duhet të jenë marrëdhëniet gjinore”. Shih Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 7.
- 33 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 4
- 34 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (2016). Intensifikimi i përpjekjeve për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Sesioni 71: pika 27 e ax-hendës: Përparimi i grave.
- 35 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (2016). Intensifikimi i përpjekjeve për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave. Sesioni 71: pika 27 e ax-hendës: Përparimi i grave.
- 36 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016. UN Women & UNDP: Tiranë, Shqipëri, f. 37.
- 37 Shqipëria mbetet një nga vendet më të varfëra në Europë me një PPB prej 13.1 miliardë dollarë në 2017. Popullsia e Shqipërisë preket nga pabarazi të mëdha ekonomike që ndikojnë në qasjen e shtetasve në shëndetësi, arsim, përkudjesje dhe mbrojtje sociale. Koeficienti Gini i vendit prej 34.5 (2013) është i treti më i lartë në rajon dhe modeli tregon rritjen e pabarazive. Qeveria synon ta ndryshojë këtë tendencë dhe ta vërë vendin në rrugën e rritjes së qëndrueshme dhe të drejtë, përmes sigurimit të stabilitetit makro-ekonomik dhe konkurrueshmërisë dhe duke investuar për njerëzit dhe kohezionin social. Këto objektiva të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II) përshkohen nga ob-

- jektivi strategjik për garantimin e qeverisjes së mirë dhe shtetit të së drejtës, që do të shtrijnë rrugën për qëllimin përfundimtar të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Çështjet gjinore janë të përfshira në SKZhI II. Por, pabarazitë janë të përhapura, megjithë përparimin e bërë për krijimin e kuadrit ligjor dhe të politikave për zhvillimin e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore, dhe luftën kundër dhunës ndaj grave.
- 37 Shqipëria ka ratifikuar një numër konventash globale dhe traktatesh rajonale që lidhen me çështjet gjinore, përfshirë, Deklaratën universale të të drejtave të njeriut, Platformën për veprim të Pekinit, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, Axyhendën 2030 për zhvillim të qëndrueshëm, dhe Konventën e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (e njohur si Konventa e Stambollit).
- 38 Gratë dekurajohen të marrin pjesë në fuqinë punëtore. Në 2015, gratë përbënin 58,3% të fuqisë punëtore, ndërsa burrat përbënin 74,1%. Gratë mbeten jashtë fuqisë punëtore për shkak të daljes herët në pension (40%) dhe angazhimit në punët shtëpiake (21,5%).
- 39 Marrë më 6 mars 2019 nga: <http://www.hdr.undp.org/en/composite/GII>
- 40 Haarr, R.N. & L. Dharmo (2009), Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtimi kombëtar me bazë popullatën. Tiranë, Shqipëri: PNUD.
- 41 Haarr, R.N. (2013), Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtimi kombëtar me bazë popullatën 2013. INSTAT/PNUD: Tiranë, Shqipëri.
- 42 Në VKDhF-në e vitit 2013, dhuna emocionale u përkufizua si "dëmtimi i ndjenjës së vetë-vlerësimit dhe vetë-besimit të personit" (p.sh. kritika dhe poshtërimi i vazhdueshëm, zvogëlimi i aftësive të personit, thirrja me emra fyes, shkatërrimi dhe dëmtimi i marrëdhënieve me fëmijët e tij/saj) dhe dhuna psikologjike përfshinte "akte të kanosjes, kërcënimit, shkatërrimit të pronës, punës së detyruar, dhe mohimin e mundësisë për para ose ndihmë ekonomike"; Haarr&Dharmo, 2009.
- 43 Sondazhi i drejtuar nga OSBE-ja për Dhunën ndaj Grave: Mirëqenia dhe Siguria e Grave, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, 2019.
- 44 Sondazhi i drejtuar nga OSBE-ja për Dhunën ndaj Grave: Mirëqenia dhe Siguria e Grave, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë, 2019.
- 45 Haarr&Dharmo, 2009.
- 46 Haarr, 2013.
- 47 Marrë më 22 mars 2019: <https://rm.coe.int/grevio-first-base-line-report-on-albania/16807688a7>
- 48 GREVIO është një organ me ekspertë të pavarur, përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Konventës së Këshillit të Europës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje nga Shtetet Anëtare.
- 49 Ai trajton shqetësime që lidhen me DhNGV-në dhe dhunën në familje (DhF), duke përfshirë, mes të tjerash, nevojën për të kundërshtuar stereotipet mbisunduese dhe për të rritur ndërgjegjësimin tek popullsia që dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk duhet të tolerohet në asnjë situatë. Po ashtu, ky raport vë në dukje domosdoshmërinë për të trajtuar në mënyrë efikase të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave, përfshirë martesën e detyruar të fëmijëve, ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale dhe bën thirrje që organet shtetërore përgjegjëse të përmirësojnë legjislacionin përkatës.
- 50 Marrë më 22 mars 2019 nga: <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2017/12/rezolute-kunder-dhunes-ne-familje-dt-4-12-2017.pdf>
- 51 Në vitin 2006, Kuvendi I Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin e parë për dhunën në familje. Qëllimi i ligjit "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" është parandalimi dhe reduktimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe garantimit të mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes që janë viktimat të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të fëmijëve, të moshuarve dhe personave më aftësi të kufizuar.
- 52 Në vitin 2010 u ndryshua ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Një ndër ndryshimet ishte angazhimi për ngritjen e një qendre kombëtare për shërbime të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu, ligji e vuri theksin edhe tek mbrojtja e konfidentalitetit të të dhënave dhe informacionit vetjak të viktimës, rritja e bashkërendimit dhe e mekanizmave të referimit për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje dhe tek shtimi i urdhërave të mbrojtjes.
- 53 Numri i individëve që iu drejtuan gjykatës për shkak të dhunës dhe numri i urdhrave të mbrojtjes të lëshuara nga gjykatat është rritur gjatë periudhës së VKBGj-DhF për periudhën 2007-2010 (gjykatat në qytetet e mëdha dhe të vogla mund të japin urdhra mbrojtje); megjithatë, strukturat e zbatimit e kanë të vështirë të ekzekutojnë urdhrat e mbrojtjes të lëshuara nga gjykatat.
- 54 Ligji "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006.
- 55 Marrë më 5 mars 2019 nga: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/presscenter/articles/2018/albania-sets-up-the-first-center-to-support-victims-of-sexual-vi.html>
- 56 Në 2011, u hap edhe në Tiranë strehëza e parë shtetërore për viktimat e dhunës në familje.
- 57 Marrë më 5 mars 2019 nga: <http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/presscenter/articles/2018/albania-sets-up-the-first-center-to-support-victims-of-sexual-vi.html>
- 58 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 40.
- 59 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 40.
- 60 Ligji nr. 8876, datë 4 prill 2002.
- 61 Rishikimi Periodik Universal (UPR) për Shqipërinë – Sesioni i 33-të i OKB-së, maj 2019, dorëzuar nga ekipi i agjencive të OKB-së në Shqipëri.
- 62 Rishikimi Periodik Universal (UPR) për Shqipërinë – Sesioni i 33-të i OKB-së, maj 2019, dorëzuar nga ekipi i agjencive të OKB-së në Shqipëri.
- 63 Rishikimi Periodik Universal (UPR) për Shqipërinë – Sesioni

- i 33-të OKB-së, maj 2019, dorëzuar nga ekipi i agjencive të OKB-së në Shqipëri.
- 64 Rishikimi Periodik Universal (UPR) për Shqipërinë – Sesioni 33 i 33-të OKB-së, 2019, dorëzuar nga ekipi i agjencive të OKB-së në Shqipëri.
- 65 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 42.
- 66 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f.42.
- 67 Kelly, L., J. Lovett & M. Kocaqi (2015), "Shqipëria - Raport përfundimtar: Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave," Këshilli i Europës dhe UN Women.
- 68 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 39.
- 69 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 42.
- 70 Metaj, E. (2015), Analizë e funksionimit të reagimit të koordinuar të Komunitetit ndaj dhunës në familje në nivel vendor në Shqipëri. PNUD: Tiranë, Shqipëri.
- 71 Rishikimi Periodik Universal (UPR) për Shqipërinë – Sesioni i 33-të OKB-së, maj 2019, dorëzuar nga ekipi i agjencive të OKB-së në Shqipëri.
- 72 Rishikimi Periodik Universal (UPR) për Shqipërinë – Sesioni i 33-të, maj 2019, dorëzuar nga ekipi i agjencive të OKB-së në Shqipëri.
- 73 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 37.
- 74 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 37.
- 75 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 37.
- 76 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 37.
- 77 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 37.
- 78 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 37.
- 79 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 37.
- 80 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 37.
- 81 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 37.
- 82 Raporti i shkurtër për çështjet gjinore në Shqipëri, 2016, f. 38.
- 83 Një studim me të dhëna të kryqëzuara përfshin vëzhgimin e personave me dallime në një karakteristikë kyçe për të cilin kryhet ky studim, në një moment të caktuar kohe.
- 84 Matja e dhunës ndaj grave: Shënim udhëzues, 2016 (Matja e dhunës ndaj grave: Shënim udhëzues), UN Women: Nju Jork, NY, f. 7.
- 85 Garcia-Moreno, C., H. Jensen, M. Ellsberg, L. Heise & C. Watts (2005), OBSH, Studim shumë- vendesh mbi shëndetin dhe dhunën në familje ndaj grave, Gjenevë, Zvicër: Organizata Botërore e Shëndetësisë.
- 86 Matja e dhunës ndaj grave: Shënim udhëzues, 2016, f. 7.
- 87 Garcia-Moreno e të tjerë, 2005.
- 88 Matja e dhunës ndaj grave: Shënim udhëzues, 2016, f. 7.
- 89 Haarr & Dharmo, 2009.
- 90 Haarr, 2014.
- 91 Duke qenë se Kodi Penal i Shqipërisë, neni 130/a, e përkufizon dhunën në familje si "Rrahja, si dhe çdo veprë tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij", termi dhunë në familje nga partneri intim përdoret gjatë gjithë raportit për të sqaruar se ai përqendrohet vetëm tek përvojat e grave nga dhuna në familje ushtruar nga partneri intim (vetëm të grave që ishin ose që kanë qenë të martuara dhe që/ose jetonin me një partner. Dhuna e partnerit intim jashtë një marrëdhënieje bashkëjetuese përkufizohet në këtë raport si dhunë gjatë marrëdhënieve dashurore.
- 92 Dokumentet dhe pyetësorët e Vrojtimit Demografik dhe Shëndetësor (VDSH), veçanërisht, Moduli për Dhunën në Familje, ishin burimi kryesor.
- 93 Rrjeti Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Dhunës në Familje, u ngrit më 1998 dhe përfshin Refleksione, Qendrën Këshillimore për Gratë dhe Vajzat, Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, Aleancën Gjinore për Zhvillim, dhe Strehëzën për Gra dhe Vajza.
- 94 Moduli 1, Moduli i Informacionit (MODHI) u përgatit në përputhje me SKDhF-në e vitit 2013.
- 95 Moduli 2, Moduli i Strukturës së Familjes (MODHL) u përgatit në përputhje me SKDhF-në e vitit 2013.
- 96 Moduli 3, Moduli i Martesës, përdorimi i kontraktivëve dhe sjellja seksuale (MODMA) u përgatit në përputhje me SKDhF-në e vitit 2013.
- 97 Moduli 4, Moduli i Dhunës në Familje (MODDV) u përgatit në përputhje me SKDhF-në e vitit 2013, me disa rishikime dhe shtesa të bazuara në shqyrtimin e studimeve për DhNGV-së të Gjeorgjisë dhe Xhamajkës.
- 98 Moduli 5, Moduli i dhunës gjatë marrëdhënieve dashurore (MODDA) u përgatit në përputhje me MODDV-në, me përjashtim të pyetjeve të MODDV-së, të cilat ishin specifike për marrëdhënien martesore dhe bashkëjetuese.
- 99 Module 6, Moduli i dhunës nga jo partneri (MODNP) që u përgatit në përputhje me SKDhF-në e vitit 2013 dhe përfshi pyetjet e lidhura me dhunën seksuale nga jo-partneri, hartuar në bazë të Vrojtimit për Dhunën ndaj Fëmijëve (VDhNF) të UNICEF-it dhe të sjelljeve që kërkojnë ndihmë në rastet e dhunës nga jo-partneri. Pyetjet për sjelljet që kërkojnë ndihmë ishin të ngjashme me ato në MODDV-në e përdorur në SKDhF-në e vitit 2013.
- 100 Moduli 7, Moduli i Ngacmimit seksual (MODSH) u përgatit bazuar në shqyrtimin e Vrojtimit të mbarë Evropën për Dhunën ndaj Grave (2014) dhe VDhNF-në e UNICEF-it, konsideruar i përshtatshëm për mjedisin shqiptar.
- 101 Moduli 8, Moduli për Përndjekjen (MODST) u përgatit në bazë të shqyrtimit të dhunës ndaj grave: në të u përfshi Vrojtimi për mbarë BE-në (2014) që u konsiderua si i përshtatshëm për mjedisin shqiptar.
- 102 Moduli 9, Moduli i normave dhe qëndrimeve shoqërore të lidhura me DhNGV-së (MODSNA) u përgatit bazuar në shqyrtimin nga zyra të literaturës ndërkombëtare për studimin e normave dhe qëndrimeve shoqërore të lidhura me DhNGV-së dhe në shqyrtimin e Studimit të 2018 për Perceptimet e Normave Shoqërore të dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe praktikave të këqija në Maluaj.
- 103 Intervistueset u trajnuan për të ndihmuar të anketuarat të kujtonin me saktësi ngjarjet e dhunshme, duke i vendosur ato në lidhje me ngjarje të tjera të mëdha (për shembull, lindja e një fëmije, një ngjarje e rëndësishme familjare apo një pushim, zhvendosja në një vend të ri).
- 104 Vendosja e sigurisë së grave në fillim: Rekomandime etike dhe për sigurinë për kërkime mbi DhNG-së. Organizata Botërore e Shëndetësisë: Gjenevë, Zvicër.
- 105 Konsiderata etike për kërkime dhe vlerësime, për dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe vajzave, 2018. Dokument udhëzues përgatitur nga Instituti Global i Grave (CWI) për Departamentin e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Australisë.
- 106 Konsiderata etike për kërkime dhe vlerësime, për dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe vajzave, 2018.
- 107 Vendosja e sigurisë së grave në fillim: Rekomandime etike dhe për sigurinë në lidhje me kërkimet mbi DhNG-së. Organizata Botërore e Shëndetësisë: Gjenevë, Zvicër.

- 108 Konsiderata etike për kërkime dhe vlerësime, për dhënien
fund të dhunës ndaj grave dhe vajzave, 2018.
- 109 Vendorsja e sigurisë së grave në fillim: Rekomandime etike
dhe për sigurinë në lidhje me kërkimet mbi DhNG-së. Orga-
nizata Botërore e Shëndetësisë: Gjenevë, Zvicër.
- 110 Lalor, K. & R. McElvaney (2010). Child Sexual Abuse, Links to
Later Sexual Exploitation/High-Risk Sexual Behaviour and
Prevention/Treatment Programs. Trauma, Violence and
Abuse (11), ff. 159-177.
- 111 Riviktimizimi seksual: Raport studimor, Qendra Kombëtare
Burimore për dhunën seksuale: Enola, PA, ShBA.
- 112 Russell, D.E.H. (1986), Trauma e fshehtë: Incesti në jetën e va-
jzave dhe grave (botim i rishikuar), Nju Jork, NY, ShBA: Librat
bazë.
- 113 Humphrey, J.A. & J.W. White (2000), Cenueshmëria e grave
ndaj sulmeve seksuale që nga adoleshenca në moshë të
rritur. Journal of Adolescent Health, Vol. 27, Nr. 6, f. 419-424.
- 114 McGee, H., R. Garavan, M. de Barra, J. Byrne & R. Conroy
(2002), Raporti SAVI: dhunimi dhe dhuna seksuale në Irlandë.
Raporte për psikologjinë, Departamenti i Psikologjisë, Koleg-
ji mbretëror i Kirurgëve në Irlandë.
- 115 Classen, C.C., O.G. Palesh & R. Aggarwal (2005), Riviktimizimi
seksual: Vlerësim i literaturës empirike. Trauma, dhuna dhe
abuzimi, Vëllimi. 6, Nr. 2.
- 116 Messman-Moore, T.L. & P.J. Long (2003), Roli i viktimizimit
seksual në fëmijëri në riviktimizimin seksual të grave: një
vlerësim empirik dhe riformulimi teorik. Revista e psikolog-
jisë klinike, Vol. 23, Nr. 4, ff. 537-571.
- 117 Paluck, E.L., L. Bell, C. Poynton & S. Sieloff (2010), Shën-
jim i normave sociale që synojnë dhunën me bazë gjinore: Një
rishikim i literaturës dhe vlerësimi kritik. Komiteti Ndërkom-
bëtar i Shpëtimit, f. 8.
- 118 "Normat sociale janë në thelb vetitë e një grupi shoqëror,
ato përshkruajnë sjelljen tipike ose të dëshirueshme të një
grupi të caktuar shoqëror, dhe jo të të gjithë njerëzimit";
Shih Paluck et al., 2010, f. 9.
- 119 Paluck et al., 2010, f. 8.
- 120 Paluck et al., 2010, f. 9.
- 121 Paluck et al., 2010, f. 8.
- 122 Paluck et al., 2010, f. 8-9.
- 123 Paluck et al., 2010, f. 8-9.
- 124 Paluck et al., 2010, f. 9.
- 125 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 8.
- 126 Të tre komponentët janë citime të drejtpërdrejta nga Alex-
ander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 8.
- 127 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 8; Shih Cooper, L.B.
& E.K. Fletcher (2013), Reduktimi i diskriminimit shoqëror
kundër vajzave adoleshente përmes përdorimit të normave
sociale për të nxitur ndryshimin e sjelljes, DFID and Girl Hub.
- 128 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 8; Shih Bicchieri C., Lin-
demans & T. Jiang (2014). Qasje strukturore për diagnostikimin
e praktikave kolektive. Frontiers in Psychology, 5(1418): 1-13.
- 129 Mackie, G. F. Moneti, H. Shakya & E. Denny (2015), Çfarë janë
Normat Sociale? Si maten ato? UNICEF/Universiteti i Kaliforni-
së, San Diego, Center on Global Justice.
- 130 Alexander-Scott, Bell & Holden 2016, f. 8.
- 131 Paluck et al., 2010, f. 12-13.
- 132 Paluck et al., 2010, f. 12-13.
- 133 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 8; Shih Bicchieri, C.
(2015), Normat në natyrë: Si të diagnostikohen, maten dhe
ndryshohen normat sociale. Cambridge University Press:
Kembrixh, Mbretëria e Bashkuar.
- 134 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 8; Shih Elster, J.
(2007). Shpjegimi i sjelljes shoqërore. Cambridge University
Press: Kembrixh, Mbretëria e Bashkuar.
- 135 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 8; Shih Bicchieri, 2015.
- 136 Paluck et al., 2010, f. 11.
- 137 Paluck et al., 2010, f. 12.
- 138 Paluck et al., 2010, f. 12.
- 139 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 11.
- 140 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 8
- 141 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, shih. 11; shih Heise &
Manji, 2015.
- 142 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 11.
- 143 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 12.
- 144 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 17.
- 145 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 17.
- 146 Alexander-Scott, Bell & Holden, 2016, f. 17.
- 147 Rolet gjinore janë norma shoqërore dhe të sjelljes që, brenda
një kulture specifike, konsiderohen gjerësisht shoqërisht
të përshtatshme për individët e një seksi të caktuar. Këto
shpesh përcaktojnë dallimet në përgjegjësitë dhe detyrat
eaktuara grave, burrave, vajzave dhe djemve brenda dhe
jashtë sferës private të shtëpisë së tyre, marrë më 22 mars
2019 nga: [https://unstats.un.org/unsd/genderstatmanual/](https://unstats.un.org/unsd/genderstatmanual/Glossary.ashx)
Glossary.ashx
- 148 Garcia-Moreno e të tjerë, 2005.
- 149 Haarr, R.N. (2007), Abuzimi i grave në Tashkistan, Krimi-
nologjia feministë (Feminist Criminology), Vol. 2, Nr. 3.
- 150 Në VKDhF-të e 2007 dhe të 2013, llojet e ndryshme të
DhPI-së përfshinin dhunën psikologjike dhe emocionale,
dhunën fizike dhe dhunën seksuale.
- 151 Haarr, 2007.
- 152 Departamenti i Statistikave të Kombeve të Bashkuara, Gratë
e Botës 2015: Tendencat dhe statistikat, Kapitulli 6: Dhuna
ndaj Grave.
- 153 Haarr, 2007, f. 248.
- 154 Garcia-Moreno e të tjerë, 2005.
- 155 Haarr & Dharmo, 2009.
- 156 Myhill, A. (2015), Matja e kontrollit shtrëngues: çfarë mund
të mësojmë nga vërtetimet kombëtare të popullatës. Dhuna
ndaj Grave. (Measuring Coercive Control: What Can We
Learn from National Population Surveys. Violence against
Women), Vol. 21, Nr. 3.
- 157 Instituti Evropian për Barazinë Gjinore. Marrë më 22 mars
2019 nga: <https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1096>
- 158 Sackett, L.A & D.G. Saunders (1999). Ndikimi i formave të
ndryshme të abuzimit psikologjik ndaj grave të rrahura.
Dhuna dhe viktimat (Violence and Victims), 14, Nr. 1, f. 105-117.
- 159 Garcia-Moreno, 2005.
- 160 Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
- 161 Sackett & Saunders, 1999.
- 162 Garcia-Moreno, 2005.
- 163 Sackett & Saunders, 1999.
- 164 Garcia-Moreno, 2005.
- 165 Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
- 166 Lewis, S.F. & W. Fremouw (2001), Dhuna gjatë marrëdhënies
dashurore: Një vështrim kritik i literaturës. (Shqyrtim klinik
psikologjik, (Clinical Psychological Review), Vol. 21, Nr. 1, f. 105-127.
- 167 Exner-Cortens, D., L. Gill & J. Eckenrode (2016), Matja e
dhunës së adoleshentëve gjatë marrëdhënies dashurore:
Një vështrim gjithpërfshirës (Pjesa 1, sjelljet). Agresioni dhe
sjellja e dhunshme. (Aggression and Violent Behaviour), 27:
64-78.

- 168 Lewis & Fremouw, 2001.
- 169 Exner-Cortens, Gill & Eckenrode, 2016.
- 170 Statistics Canada <http://www.statcan.gc.ca/pub/85-002-x/2010002/article/11242-eng.htm>
- 171 Kushtet dhe lëndimet e lidhura me dhunën në familje. Toolkit kombëtar për parandalimin e dhunës në familje për profesionistët e mjekësisë, 2014. Florida State University.
- 172 Ferrari, G., R. Agnew-Davies, J. Bailey, L. Howard, E. Howarth, T.J. Peters, L. Sardinha & G.S. Feder. (2016), Dhuna në familje dhe shëndeti mendor: vërtetim i kryqëzuar i grave që kërkojnë ndihmë nga shërbimet mbështetëse për dhunën në familje. *Global Health Action*, 9:20.3402/gha.v9.29890.
- 173 Qendra Kombëtare për Parandalimin dhe Kontrollin e Lëndimeve (2003), Kostot e dhunës së partnerit intim ndaj grave në Shtetet e Bashkuara (Costs of Intimate Partner Violence Against Women in the United States). Qendrat për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve (CDC): Atlanta, GA USA.
- 174 Qendra Kombëtare për Parandalimin dhe Kontrollin e Lëndimeve (2003), Kostot e dhunës së partnerit intim ndaj grave në Shtetet e Bashkuara.
- 175 Qendra Kombëtare për Parandalimin dhe Kontrollin e Lëndimeve (2003), Kostot e dhunës së partnerit intim ndaj grave në Shtetet e Bashkuara.
- 176 Qendra Kombëtare për Parandalimin dhe Kontrollin e Lëndimeve (2003), Kostot e dhunës së partnerit intim ndaj grave në Shtetet e Bashkuara (CDC): Atlanta, GA USA.
- 177 Qendra Kombëtare për Parandalimin dhe Kontrollin e Lëndimeve (2003), Kostot e dhunës së partnerit intim ndaj grave në Shtetet e Bashkuara (CDC): Atlanta, GA USA.
- 178 Garcia-Moreno e të tjerë, 2005.
- 179 Haarr & Dharmo, 2009.
- 180 Haarr, 2013.
- 181 Bishwajit, G. & S. Yaya (2017), Dhuna në familje: një barrierë e fshehtë për përdorimin e kontraceptivëve nga gratë në Nigeri. Dove Press. <https://doi.org/10.2147/OAJC.S154733>
- 182 Stephenson, R., M. Koenig, R. Acharya & T.K. Roy (2008), Dhuna në familje, përdorimi i kontraceptivëve dhe shtatzënia e padëshiruar në Indinë rurale. *Studime mbi planifikimin familjar*, 39(3): 177-186.
- 183 Leonard, K. (2009), Dhuna në familje dhe alkooli: çfarë dihet dhe çfarë duhet të dimë për të nxitur ndërhyrjet mjedisore? *Journal of Substance Use*, 6(4): 235-247.
- 184 Graham, K. & M. Livingston (2011), Marrëdhënia midis alkoolit dhe dhunës – Popullsia, qasja e studimeve kontekstuale dhe e kërkimeve individuale, *Drug and Alcohol Review*, 30(5): 453-457.
- 185 Leonard, 2009.
- 186 Mite për alkoolin dhe dhunën në familje, marrë nga: http://www.stopvaw.org/Myths_About_Alcohol_and_Domestic_Violence.html
- 187 Mite për alkoolin dhe dhunën në familje, marrë nga: http://www.stopvaw.org/Myths_About_Alcohol_and_Domestic_Violence.html
- 188 Devaney, J. (2015), Revistë kërkimore: Ndikimi i dhunës në familje ndaj fëmijëve, *Irish Probation Journal*, 12, f. 79-94 (f. 83).
- 189 Pinheiro, P.S. (2006), Raporti botëror për dhunën ndaj fëmijëve, UNICEF: Gjenevë, Zvicër.
- 190 Radford, L., S. Corral, C. Bradley, H. Fisher, C. Bassett, N. Howat & S. Collishaw (2011), Abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve në Mbretërinë e Bashkuar sot (Child Abuse and Neglect in the UK Today), Londër: NSPCC.
- 191 Moffitt, T.E. & A. Caspi (2003), Parandalimi i vijmësisë ndërbrezore të sjelljes anti-sociale: pasojat e dhunës së partnerit, tek Farrington, D.P. & J.W. Coid (red), *Parandalimi i hershëm i sjelljeve anti-sociale të të rriturve*, (Early Prevention of Adult Antisocial Behaviour). Kembrixh: Cambridge University Press.
- 192 Pinheiro, 2006.
- 193 Holt, S., H. Buckley & S. Whelan (2008), Pasojat e ekspozimit ndaj dhunës në familje tek fëmijët dhe të rinjtë: Një vështrim i literaturës, *Child Abuse & Neglect*, Vol. 32, Nr. 8, f. 797-810.
- 194 Moylan e të tjerë, (2009), Pasojat e abuzimit të fëmijëve dhe ekspozimi ndaj dhunës në familje në problemet e sjelljes internalizuese dhe ekstereizuese të adoleshentëve, *Journal of Family Violence*, 25, f. 53-63.
- 195 Devaney, 2015.
- 196 Pinheiro, 2006.
- 197 Garcia-Moreno et al., 2005.
- 198 Dhuna ndaj grave: një sondazh në BE (2014), Luxemburg: Zyra e botimeve e Bashkimit Europian.
- 199 Dhuna ndaj grave: një sondazh në BE, 2014, f. 96-97.
- 200 Pyetjet e vërtetimit për ngacmimin seksual u morën nga sondazhi i kryer në mbanë BE-në për dhunën ndaj grave, ndërsa pyetjet për vendin ku kryhen ngacmime seksuale dhe autorët e tyre u morën nga UNICEF VACS.
- 201 Dhuna ndaj grave: një sondazh në mbarë BE-në, 2014, f. 96-97.
- 202 Komisioni Europian (1998), Ngacmimi seksual në vendin e punës në Bashkimin Europian, Bruksel, Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Europian për punësimin, marrëdhëniet industriale dhe çështjet sociale.
- 203 Dhuna ndaj grave: një sondazh në BE, 2014, f. 96-97.
- 204 Zippel, K. (2009), "Direktiva e Bashkimit Europian e vitit 2002 mbi ngacmimin seksual: Një sukses feminist?", *Politika europiane krahasuese*, Vol. 7, Nr. 1, f. 137-159.
- 205 Dhuna ndaj grave: një sondazh në mbarë BE-në, 2014, f. 96-97.
- 206 Dhuna ndaj grave: një sondazh në mbarë BE-në, 2014, f. 96-97.
- 207 Zyra e programeve të drejtësisë, Instituti Kombëtar i Drejtësisë, marrë më 12 mars 2019 nga: <https://www.nij.gov/topics/crime/stalking/Pages/welcome.aspx>
- 208 Tjaden, P. & N. Thoennes, Përndjekja në Amerikë: Gjetjet e Sondazhit Kombëtar mbi Dhunën ndaj Grave. Uashington, DC: Departamenti Amerikan i Drejtësisë, Instituti Kombëtar i Drejtësisë, 1998, NCJ 169592.U.S.
- 209 Këshilli i Europës, Asambleja Parlamentare, marrë më 22 mars 2019 nga: <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XM-L2HTML-en.asp?fileid=20299>
- 210 Zyra e programeve të drejtësisë, Instituti Kombëtar i Drejtësisë, marrë më 12 mars 2019 nga: <https://www.nij.gov/topics/crime/stalking/Pages/welcome.aspx>
- 211 Dhuna ndaj grave: një sondazh në mbarë BE-në, 2014, f. 96-97.
- 212 Zyra e programeve të drejtësisë, Instituti Kombëtar i Drejtësisë, marrë më 12 mars 2019 nga: <https://www.nij.gov/topics/crime/stalking/Pages/welcome.aspx>
- 213 Black, M.C., K.C. Basile, M.J. Breiding, S.G. Smith, M.L. Walters, M.T. Merrick, J. Chen, and M.R. Stevens (2011). The National Intimate Partner and Sexual Violence Survey (NISVS): 2010 Summary Report," Atlanta, GA: National Center for Injury Prevention and Control, Centers for Disease Control and Prevention.
- 214 Zyra e programeve të drejtësisë, Instituti Kombëtar i Drejtësisë. Marrë më 12 mars 2019 nga: <https://www.nij.gov/topics/crime/stalking/Pages/welcome.aspx>
- 215 Zyra e programeve të drejtësisë, Instituti Kombëtar i Drejtësisë. Marrë më 12 mars 2019 nga: <https://www.nij.gov/topics/crime/stalking/Pages/welcome.aspx>

- 216 Survey questions related to stalking were adopted from the
EU-wide survey on violence against women and the questions
related to perpetrators were adopted from the UNICEF VACS.
- 217 Haarr, R.N. (2018). Perceptimet për normat sociale për
dhunën ndaj grave dhe vajzave, dhe praktikat e këqija në
Maluai. UN Women: Lilongwe, Malawi.
- 218 Krug et al., 2002.
- 219 Garcia-Moreno et al., 2005.
- 220 Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2013.
- 221 Sondazhi i drejtuar nga OSBE për Dhunën ndaj Grave:
Mirëqenia dhe Siguria e Grave, 2019
- 222 Sondazhi i drejtuar nga OSBE për Dhunën ndaj Grave:
Mirëqenia dhe Siguria e Grave. 2019
- 223 Dhuna ndaj grave: një sondazh në BE, 2014, f. 167.



Empowered lives.
Resilient nations.

